G J O K Ë   D A B A J

RRNOJ EDHE UNË PËR ME TREGUE

Atyre që mendjen e vet
dhe mendjet e të tjerëvet
i kalojnë nëpër sitë.

Nëpër shoshë e nëpër sitë,
gjersa truri, lëndë që digjet,
t'u japë njerëzvet
më pak tym e më shumë dritë.

Gj.D.

~~~~~~

Ky libër nuk është shkruar si reagim ndaj veprës së Atë Zef Pllumit "***Rrno vetëm për me tregue***", botim i "***55-s***", Tiranë, 2006. Titulli tematik fillestar i këtij libri ka qenë: "***Pse dështoi komunizmi në gjysmën e dytë të shekullit XX? Analizë ngjarjesh historike***." Nën këtë titull, tematik, edhe është përfunduar thuajse krejt libri. Dikur, atje nga fundi, mendova t'i vija titullin "***A ky është kapitalizmi***?!", por, mbasi, në shtator të vitit 2013, lexova librin 700-faqesh të Atë Zef Pllumit "***Rrno vetëm për me tregue***", m'u duk se duhej të thosha pikërisht kështu: "***Rrnoj edhe unë për me tregue".***

Është një titull sfidë, sepse vepra e Atë Zef Pllumit pasqyron njërën mënyrë shikimi e kuptimi, ndërsa vepra ime, mënyrën tjetër të shikimit e të të kuptuarit të të njëjtit problem. S'ka asgjë tjetër përtej kësaj që thashë: As Atë Zefi nuk e dinte që unë po shkruaja një libër me këtë temë, as unë nuk e kisha lexuar librin e Atë Zefit, që t'i kundërvihesha atij në formë polemike. Është vetëm pozicioni filozofiko-historik ai që na ndan ne të 2-ve dhe prandaj edhe titujt e 2 libravet tanë përplasen kështu njëri me tjetrin.

Më ka motivuar për këtë titull edhe fakti që parathënien e botimit italisht të veprës së klerikut Atë Zef Pllumi e ka shkruar një monstër e moralit njerëzor Silvio Berluskoni.

Gjatë ripunimit kam futur aty-këtu edhe ndonjë frazë konkretizimi, si mendon Atë Zefi në librin e tij. Mirë është që të 2 këta libra të lexohen së bashku, sepse vetëm ashtu do të mund të nxirret një konkluzion i qëndrueshëm.
2013 Gj.D.

PJESA E PARË
~~~~~~

Si e përjetova unë komunizmin në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë

1.Askush nuk duhet të çuditet që unë i kam adhuruar Envet Hoxhën dhe regjimin e tij në vitet 1960.

Vija prej Shestanit, prej një vendi, ku mësuesi **shqiptar** i kërcënonte me thupër nxënësit e vet **shqiptarë**, që të mos flisnin shqip, por të flisnin sllavisht. Vija prej Kosovet, ku 4-5 vjet më parë ishin deportuar për në Turqi mbi 250000 shqiptarë. Një mjerim i vërtetë: Të lësh vendin e të parëvet dhe të ikësh, se ashtu po do dikush! Një padrejtësi e pakonceptueshme: Një vend që e quante veten komunist, Republika Federative e Jugosllavisë, dhe një vend kapitalist, Republika e Turqisë, të bënin marrëveshje për të shpërngulur një popull, se ashtu u interesonte atyre! Kisha takuar në Gjakovë njerëz me këmbë të ënjtura prej së ndenjurit në ujë nëpër qelitë e UDB-s jugosllave. Me mijëra shqiptarë ishin rrahur e stërrrahur. S'kish mbetur burrë shqiptar pa kaluar nëpër paraburgje dhe burgje.

Lufta e Dytë Botërore kish lënë prapa ndoshta 100000 a më shumë shqiptarë të masakruar, për nga mënyra e asgjësimit, hiçgjëmangut hebrenjvet. Disa i kishin vrarë e grirë çetnikët, disa i kishin vrarë, djegur e sakatuar komunistët jugosllavë, disa, vrarë e përzënë prej shtëpivet venizellistët grekë. Gjermanët kishin vrarë ç'kishin mundur, italianët po ashtu. Megjithatë, do të shihet pak më poshtë që fashistët italianë dhe nazistët gjermanë ishin sjellë ndaj kombit shqiptar shumë më mirë se anglo-amerikanët.

Tani, gazetat e Beogradit shanin Enver Hoxhën, Vatikani shante Enver Hoxhën, Simë Toma (Sima i Tom's Per's) një shqiptar prej Krruçit hiqte një valle toske, duke e karikaturizuar Enver Hoxhën në mënyrën më poshtëruese, dhe këndonte: "***Enver Hoxha, bishti i minit, po ia dredh mustakt Stalinit***". Një grup emigrantësh, të ikur nga Republika e Shqipërisë, kishin një klub të vetin në qendër të Ulqinit. Ata i mbante me rroga UDB-a jugosllave, i çonte si spiunë nëpër fshatra, për të provokuar shqiptarët vendës pale a flasin kundër Jugosllavisë dhe i dërgonte si diversantë në krahinat nga kishin ardhur, për të djegur mullarët e kooperativavet. SHBA-ja dhe Anglia stërvitnin e përgatisnin diversantë dhe i hidhnin në Republikën e Shqipërisë, për të rrëzuar atje pushtetin e Enverit. Nuk u bënin presion Greqisë e Jugosllavisë, që t'u jepnin shqiptarëvet të drejtat që u takonin, Greqia të hapte shkolla shqipe dhe t'i jepte autonomi Çamërisë, Jugosllavia të krijonte

republikë shqiptare, duke përfshirë në të të gjitha trevat shqiptare, por bënin aleancë edhe me Greqinë, edhe me Jugosllavinë, për të rrëzuar pushtetin komunist në Tiranë. Komunistë ishin edhe jugosllavët, por perendimorëvet s'u bëhej vonë fare për komunizmin jugosllav. Ata e kishin inatin vetëm me komunizmin e Enverit. Realisht, ata e kishin inatin me kombin shqiptar, jo thjeshtë me Enverin.

Kur kalova kufirin, hasa në 2 lloje pritjeje: njëri prej kufitarëvet, komandanti i patrullës, së cilës iu dorëzova, më mbuloi me një pallto, që të mos ftohesha, se isha djersitur, dhe më dha një cigare ***partizani***. Tjetri, komandanti i grupit që erdhi për të më marrë, m'u kanos me fjalë të ashpra: "***Hë, qen! Ke dashë me shkelë kufinin e Shqipnisë***!" Unë, natyrisht, e pata më për zemër sjelljen e të parit, por më pëlqeu edhe të sharët e të dytit. Ju nuk mund ta merrni me mend ç'do të thotë të të pëlqejë edhe kur tjetri të shan apo të kanoset. Më shumë se gjysma e Shqipërisë na ish lënë jashtë kufijvet të shtetit të vet dhe askush s'i dilte zot. Të paktën kësaj pjese le t'i dalë zot dikush! Le ta mbrojë dikush këtë pjesë që na ka mbetur! Le ta mbrojë, qoftë edhe me egërsi!

Në Shkodër pashë tabela dyqanesh të dizajnuara në gjuhën shqipe. Ju prapë nuk mund ta merrni me mend ç'përmasa merr gëzimi i një shqiptari, kur sheh në Shkodër tabela në gjuhën shqipe! Një shqiptari, të cilit i është privuar e drejta të shohë tabela shqip në qytetin e vet, në Tivar!

Në Shkodër, në Tiranë, në Durrës, në Tepelenë, përdorej flamuri shqiptar, shqiponja dykrerëshe në pëlhurë të kuqe. Ku kish kënaqësi më të madhe! Në Tivar, në Gjakovë e në Prizren, edhe të vizatuar në një copë letër të ta gjenin flamurin shqiptar, të priste qelia në UDB dhe druri që t'i thyente kockat. Në monedhën shqiptare ish prapë shqiponja me 2 krerë. Njerëzit të përshëndesnin shqip. Dokumentet shkruheshin në gjuhën shqipe. Librat! Më në fund, pata fatin që të shoh libra në gjuhën shqipe! Plot raftet e librarivet në gjuhën time! Këtu, në Republikën Popullore të Shqipërisë, le të ishte komuniste, fashiste, monarkiste, si t'i donte qejfi, vetëm bashkëkrahinasi im, mësuesi konformist, miop dhe, me siguri, edhe frikacak, të mos i kërcënonte fëmijët me thupër thane, për të mos folur gjuhën e vet!

Në Jugosllavinë gjysmëkomuniste, sado që haje dru, sado që të burgosnin, sado që të vrisnin, prapë mund të gjeje edhe shkolla shqipe, edhe libra shqip, por në Turqinë **kapitaliste**, ku kish me miliona shqiptarë, shqiptarët nuk regjistroheshin dot si shqiptarë dhe në Greqinë **kapitaliste** po ashtu, as që duhej të të shkonte mendja se je shqiptar. A kish si të mos më pëlqente

komunizmi shqiptar në të tilla rrethana, ku as zogu nuk mund ta kalonte lirshëm kufirin?! Këto ishin disa nga arsyet që unë e doja regjimin komunist të udhëhequr prej Enver Hoxhës dhe nuk dëshiroja që ai të dështojë.

2. Një arsyetim më i gjërë, që unë nuk doja të dështonte komunizmi në shkallë botërore, ka qenë ky: Keqvajtjet e gjakderdhjet në të kaluarën nuk i kishte shkaktuar komunizmi. Luftën e Dytë Botërore me 50 milionë a më shumë njerëz të asgjësuar, nuk e pat shkaktuar komunizmi. Varfërinë e tejskajshme të fshatarëvet të Rusisë Cariste, para Revolucionit të Tetorit, nuk e pat prurë komunizmi. Kryengritjen e Pugaçovit, dikur në Mesjetë, nuk e kish nxitur komunizmi. Pushtimin e Mançurisë dhe reprezaliet që i patën bërë atje japonezët, s'i pat shkaktuar komunizmi. Fshatarët e Kinës, para ardhjes së komunizmit në pushtet, nuk i pat varfëruar komunizmi. Zezakët e Afrikës nuk i patën çuar komunistët në Amerikë dhe nuk qenë sjellë komunistët me zezakët e Amerikës ashtu siç e dimë të gjithë. Indigjenët e Amerikës, inkasit, majat etj, nuk i patën shfarosur komunistët. Luftën Veri-Jug në Amerikën Veriore nuk e bënë komunistët. Luftën e Parë Botërore nuk e shkaktuan komunistët. Luftën për shkak të ndasivet fetare në Evropën Qendrore, që ka zgjatur 30 vjet dhe që ka marrë 12 milionë jetë njerëzish, s'e kanë shkaktuar komunistët, Luftërat Napoleoniane, që i kushtuan Francës dhe gjithë Evropës viktima të panumërta, nuk i shkaktuan komunistët. Luftën 40-vjeçare midis Francës dhe Anglisë nuk e patën shkaktuar komunistët. Kokat e Robespierit, Maratit e Dantonit nuk i patën prerë komunistët. Perandorinë Osmane, komberobëruese shumëshekullore, nuk e patën krijuar komunistët.

Arsyet ishin mijëfish të mjaftueshme për të kërkuar njerëzimi një mënyrë tjetër të organizimit shtetëror dhe shoqëror. Brenda shtetevet të pasur pasuria ish e pafundme, po varfëria prapë rëdonte mbi miliona shtetas. Në botën e varfër kish edhe të pasur, po varfëria arrinte deri atje sa të vdisnin njerëz nga uria. Nënë Tereza kish zgjedhur një formë tjetër për ta pakësuar mjerimin. Po a do të arrinte? Popujt e kolonizuar kërkonoin të çliroheshin nga kolonializmi, po a do të ishte kjo e mjaftueshme? Në sh XIX kish lindur një teori me anën e së cilës jo vetëm po shpresohej, por edhe i kishin hyrë punës për ta ndërtuar atë sistem të ri shoqëror. Në Bashkimin Sovjetik kish ndodhur ajo përmbysje, e cila quhej **revolucion proletar**. Mbas Luftës së Dytë Botërore sistemi i quajtur **socialist**, pra **shoqërorist**, ishte vendosur në një numër të madh vendesh, midis të cilëvet edhe në një Kinë të madhe, por edhe në Shqipërinë tonë "të Londrës" fare të vogël. **Socializmi**, pra **shoqërorizmi**, ishte përhapur madje, si aspiratë, edhe në popujt

perendimorë, ashtu edhe në ata kolonialë apo të sapodalë nga kolonializmi, në Amerikën Jugore dhe në Afrikë. Në fillim të vitevet 1960 në botë ekzistonin 81 parti me orientim komunist. Ishin 81 parti! Edhe në Angli e në SHBA ishte përhapur ideja e ndryshimit të jetës që nga themelet. Dmth. ideja e zhdukjes së pronës private dhe e zëvendësimit të saj me një formë të re të pronësisë **shoqëroriste**. Një djalë që vinte nga Shestani, nga një mal ku edhe uji mbahej me krahë dhe ku, të kishe një palë këpucë të reja dhe 2 këmisha për t'u ndërruar, ish fat i madh, pasi t'i kish lexuar të gjitha këto, s'kish si të mos entuziazmohej prej idevet të komunizmit. Të rinj si unë në atë kohë thoshin: ***Sikur të vendosej socializmi në SHBA, njerëzimi do të shpëtonte njëherë e mirë prej kaq shumë të këqiave. SHBA-ja që ka potencial të madh ekonomik, duke përdorur metodat socialiste të prodhimit e të shpërndarjes, do të mund ta nxirrte krejt botën nga varfëria brenda pak vitesh.***

Në planin e kombit, të cilit i përkisja unë, copëtimin e Atdheut tim me vendimet e 1878-s, të 1913-s, të 1919-s, nuk e kishin bërë komunistët. Në ndërkohë qe përhapur edhe mendimi sikur Enver Hoxha e kish tradhtuar Kosovën duke ia lënë atë Jugosllavisë. Por unë nuk e besoja një version të tillë. Unë shtroja pyetjen: A kish mundur ta bashkonte krejt Shqipërinë Enver Hoxha, edhe po të donte? Dhe përgjigjja dilte që ai jo vetëm nuk do të mund ta kryente atë mision, por do të rrëzikonte edhe pjesën "londrase". Sidoqoftë, qindra mijë viktima të kombit tim, që nga gjysma e dytë e sh XIX e deri në vitin 1939, nuk i patën shkaktuar komunistët. Kosovën, në vitin 1913, nuk ia dhanë komunistët Sërbisë. Çamërinë nuk ia dhanë komunistët Greqisë. Nëse edhe komunistët do të heshtnin në lidhje me të drejtat që u takonin atyre pjesëve të kombit shqiptar, atëherë unë me siguri do të isha edhe kundër komunistëvet.

Ishte e vërtetë që **në Jugosllavinë Komuniste** shqiptarët trajtoheshin si një popull i paarrirë. Në vitet e Luftës së Dytë, komunistët jugosllavë, në atë pjesë të Shqipërisë, kishin bërë krime njëlloj si çetnikët dhe diskriminimi vazhdonte pa ndërprerje edhe mbas Luftës, nën pushtetin e komunistëvet. Mirëpo, po në atë Jugosllavi, pushtuese dhe diskriminuese, **kishte shkolla shqipe**. Pse **nuk hapeshin shkolla shqipe në Turqi**, nëse kapitalizmi ishte më i mirë se komunizmi?! Pse **në shtetin grek**, që nuk ishte një shtet komunist, **nuk hapeshin shkolla shqipe**?! Pse shteti kapitalist grek nuk u jepte autonomi çamëvet ortodoksë dhe shqiptarëvet të tjerë, siç u kish dhënë Titoja shqiptarëvet të Kosovës?!

S'është fjala këtu për të lartësuar pushtetin e pushtuesit jugosllav mbi shqiptarët, por për të bërë dallimin edhe midis 2 pushtuesvet: atij tërësisht kapitalist grek dhe këtij, qoftë edhe pseudokomunist jugosllav.

3. Në vjeshtë të vitit 1962 qeveria e Republikës Popullore të Shqipërisë (Atëherë nuk quhej RPSSH), (Ministria e saj e Punëvet të Brendshme), më çoi në Tepelenë. Ishte një internim. Më pajisën me një leje qëndrimi dhe më sqaruan që me atë leje, e cila kish formën e letërnjoftimit, mund të lëvizja nëpër Tepelenë e në fshatrat e afërt, por më tutje jo. Madje as në Memaliaj, qytezë që i përkiste të njëjtit rreth. Më vendosën me punë në Ndërmarrjen Bujqësore Lokale (NBL). Punëtor i thjeshtë krahu.

Kisha kaluar kufirin si njeri politik, me mendimin për t'u kthyer në Tivar e në Kosovë dhe për të punuar atje për të mirë të Kombit në trevat ku ai ishte i pushtuar. Programi i organizatës ku unë bëja pjesë, nuk ishte një program aventuror. Kjo do të thoshte që ne i merrnim parasysh të gjitha rrethanat dhe synonim për ta arritur qëllimin tonë, duke bërë maksimumin që ishte e mundur, brenda atyre rrethanave. Papritur doli që duhej të punoja në hapjen e një toke të re, në krijimin e një vreshti dhe të një ullishte.

Në Shestan, në rrethin e Tivarit, kisha lënë 2 prindër, jo mirë me shëndet dhe ende më keq me ekonomi. Kisha lënë edhe 1 vëlla 13 vjeç. Në më pak se 3 muaj më dolën thinjat.

Më dolën thinjat, por nuk i urrejta as shtetin shqiptar, as diktaturën që ish vendosur aty, as rendin shoqëror që ai shtet po përpiqej të konsolidonte.

4.Më pëlqente qetësia në qytetin e Tepelenës. Nuk kish vjedhje, nuk kish rrahje ndër kafenera apo te kinemaja, s'kish grabitje. Mund të udhëtonte shtetasi i atij shteti ditën apo natën ku të donte. Mund të flije përjashta pa u drojtur se do të të sulmojë njeri. Gjithë ditën mund të hasje 1 ose 2 policë në krejt qytezën. Policët nuk mbanin shkopinj gome dhe nuk kishin të drejtë ta rrihnin (të paktën publikisht) shkelësin e ligjevet. Në një skaj të qytezës gjendej Dega e Punëvet të Brendshme. Edhe aty policët ishin të pakët. Në krahun tjetër të qytezës qe vendosur Komiteti i Partisë i Rrethit. Në qendër ishte Komiteti Ekzekutiv.

Kish, veç shkollës 8-vjeçare, edhe 1 shkollë të mesme. Ish një shkollë, e cila vazhdimisht dilte me rezultate të mirë. Mësimdhënësit qenë shumë të përkushtuar. Aty punonin, si profesorë historie e gjeografie, 2 vëllezër

bashkëanas të mi: Hajdar Qetkaj dhe Isuf Qetkaj. Ata ishin nga Funda e Podgoricës. Isufi ishte nëndrejtor i asaj shkolle. Ai, në shtatorin e vitit 1963, u interesua dhe më regjistroi në gjimnazin e natës, për të marrë maturën, e cila më kish mbetur pa marrë në Normalen e Prizrenit. Meqë mësimdhënësit vendës nuk ishin të mjaftueshëm (Dhe për këtë, fajtorë ishin Perandoria Osmane dhe Mbretëria Shqiptare e Ahmet Zogut!) në kolektivin e atyshëm pedagogjik bënin pjesë edhe 3 apo 4 grekë, minoritarë nga Dropulli i Gjirokastrës. Që të gjithë shumë të mirë. Për të gjithë ata mësimdhënës ruajta kujtimet më të mirë.

Tepelena kish një rrjet tregtar normal. Sendet ishin të lirë. Veçanërisht kokat dhe të përbrendshmet e bagëtivet, mëlçi, zorrë, zemër, plënc, veshka, ishin thuajse falas, pasi në pjesën perendimore të qytezës gjendej një thertore, e cila furnizonte Tiranën me mish Labërie.

Po ndërtohej edhe një pallat kulture me gurë të gdhendur dhe jashtzakonisht i bukur. Për ta përuruar, mbasi pallati mbaroi së ndërtuari, erdhi vetë **Enver Hoxha**. Ndonëse afër dhe rrotull meje më vërtiteshin 2 shokë pune (Vija re se ishin mjaft të shqetësuar.), për të cilët e dija se kishin pistoleta, unë u argëtova shumë duke parë pritjen dhe u kënaqa jashtëzakonisht kur e pashë fare afër Enver Hoxhën. Ish vërtet një burrë i pamshëm, me do sy të mëdhenj dhe dukshëm vizionarë, që të ngjallte admirim. Në krahasim me Titon, të cilin e pata parë po kaq afër para 4-5 vjetësh, në Nikshiq të Malit të Zi, Enveri ishte gjigant përballë Titos dhe shumë më i paraqitshëm. Ndoshta mua më dukej i tillë, se ishte udhëheqësi i pjesës së lirë të Kombit tim.

Atë Zef Pllumi e sheh ndryshe **Enver Hoxhën**. Ai e quan tiran e kriminel dhe nuk pranon as të takohet me të, në një rast, kur atë mundësi ia ofron Tuk Jakova. Është pikëpamja e tij.

5.Në vitin e parë, fundi i 1962-shit dhe viti 1963, pata vështirësi për të përballuar punën fizike. Më dhimbnin shumë muskujt. Por, megjithatë, në orët e mbrëmjes lexoja shumë. I blija librat në librarinë e qytezës, relativisht lirë, i lexoja, gjithmonë me nënvizime, me shënime dhe me vërejtje, dhe i renditja në një raft te koka e krevatit. Në qendrën ku punoja, kish nja 200 punëtorë e punëtore. ¼ e tyre ardhur nga fshatrat përrreth. Vinin aty ata fshatarë, të cilëvet u jepej leje, sepse të ardhurat në kooperativë nuk u mjaftonin. Aty pagesa ish diçka më e mirë se ditëpuna në kooperativë. Thoshin që shteti e kish krijuar atë ndërmarrje bujqësore, me subvencionim, pikërisht për të ndihmuar familjet në nevojë.

Në nëntor të vitit 1962 u festua edhe 50-vjetori i Shpalljes së Pavarësisë. Manifestimi qendror u bë në Vlorë. Për mua ish një lumturi e vërtetë. Mënyra si po propagandohej ajo datë, më entuziazmonte. Mënyra si depërtonte domethënia e asjaj feste te secili banor, ish për t'u admiruar. (Vite më vonë do të më vinte keq që ajo datë nuk u bë dot festë familjare e shqiptarëvet.)

Ne ishim 60 vetë në një dhomë. Flinim në krevatë 2-katësh. Dyshekët mbushur me kashtë gruri. Dritë elektrike nuk kishim. Unë pata blerë vetë një llambë me vajgur dhe e mbaja te kryet. Por s'kish natë që të mos këndoheshin një numër këngësh nga më të bukurat: Kënga e famshme për Ismail Qemalin, kënga për Selam Musain, kënga për Çerçiz Topullin dhe dhjetëra kënge të tjera labe e toske. Këndohej edhe një këngë politike e kohës: "***O Stalin, të ishe gjallë! O Stalin, more! A, që nukë je***!"

Nuk mungoja asnjëherë në punë, megjithëse më dhimbte krejt trupi. Në fund të vitit 1963, natën e Vitit të Ri, kur do të fillonte 1964-a, i numrova 300 libra, të vegjël e të mëdhenj, që i kisha lexuar në ata 365 ditë. Filluar nga vjeshta, shkoja edhe në shkollën e natës 3 herë në javë. Dhashë 27 provime atë vit shkollor, për të plotësuar diferencën në lëndët që nuk i pata bërë në Kosovë. Në qershorin e 1964-s mora edhe dëftesën e maturës, falë, siç thashë, edhe profesor Isuf Qetkajt, i cili, pa më pyetur fare, më kish regjistruar në atë shkollë 10 muaj më parë. Kur shihja që, ato brinja, ku shkurrishtat e ferrishtat po shndërroheshin me shpejtësi në ullishta e në vreshta, as që dëshiroja të ketë në botë ndonjë sistem tjetër, përveç socializmit.

6.Lexonim gazeta dhe vinin lajme që në krejt Republikën Popullore të Shqipërisë po bëheshin ndërtime të shumtë. Kjo kish rëndësi të madhe për mua, e mendoj që kjo kish rëndësi të madhe për shumicën e shqiptarëvet të asaj kohe. Kooperativat, si forma të përshtatshme për ta modernizuar bujqësinë, po krijoheshin gjithandej. Ekonomi bujqësore shtetërore kish në çdo rreth. Veçanërisht në disa zona fushore ato po jepnin rezultate mjaft të kënaqshëm. Ndërmarrje shtetërore ndërtimi, të quajtura NSHN, kish tashmë pothuaj në çdo rreth. Tregtia ish e organizuar shtetërisht dhe po mendohej që t'i jepej fund tregtisë private. Minierat dhe nafta ishin **të këtij shteti,** jo të ndonjë shteti tjetër.. Edhe kjo ish tepër e rëndësishme. Dalëngadalë po shtohej edhe industria përpunuese.

Pavarësia **ishte**. Vendi ruhej me forca të mjaftueshme ushtarake. Republika Popullore e Shqipërisë e kish dëshmuar se ishte **e pavarur**, kur qe shkëputur prej Jugosllavisë, prej një Jugosllavie që e rrethonte këtë shtet të vogël thuajse në 2/3 e kufirit tokësor, por po e dëshmonte edhe tash, kur u shkëput prej Bashkimit Sovjetik aq të madh, dhe prej një koalicioni të tërë rreth tij. Mua, si shqiptar, që vija nga trevat tona **të pushtuara**, kjo pavarësi më se e guximshme më ngjallte shpresa se një ditë do të çliroheshim edhe ne matanë kufijvet.

Shkollimi i popullsisë po bëhej. Koha e Perandorisë Osmane i pat lënë shqiptarët tërësisht pa shkollë nacionale. Një mjerim i vërtetë kish mbisunduar mbi ne në fushën arsimore në shekuj, e pakta qysh prej rrëzimit të Kastriotëvet. Edhe Koha e Ahmet Zogut kish mundur të bëjë fare pak për arsimin, dhe s'ish për t'ia zënë për të madhe. Nuk ka qenë lehtë të dilet prej territ shumëshekullor. Tani Partia e Punës i kish hyrë kësaj pune me preokupimin më të madh të mundshëm. Nuk po mbetej fëmijë pa çuar në shkollë.

Për shëndetin tregohej kujdes i veçantë. (Vite më parë, qysh në Nikshiq e në Kosovë, më qenë dëmtuar 4 dhëmbët e përparmë. Isha djalë i ri dhe më vinte turp, por nuk kisha mundur t'i rregulloj. Sapo erdha në Tepelenë, më thanë vetë punëtorët: "***Shko rregulloji, se t'i bëjnë pa para***!") Nënat me shumë fëmijë ishin të privilegjuara. Për të nxitur krijimin me kohë të familjevet të reja, beqarët dhe beqaret paguanin një tatim simbolik, i cili quhej ***tatim beqari***. Sëmundjet ngjitëse, si malarja e tuberkulozi, po edhe sëmundjet veneriane, të cilat në të shkuarën kishin bërë kërdinë, në vitet 1960 thuajse ishin mënjanuar, disa edhe zhdukur, siç thuhej, përgjithmonë.

Më kot thuhej ***përgjithmonë***, sepse, sapo u rivendos kapitalizmi, për të vënë një palë dhëmbë duheshin miliona, ndërsa sëmundjet, së pari do t'ia zbraznin xhepat pjesës më të madhe të popullsisë, pastaj do t'ua merrnin edhe jetën, para kohe, mijëra pacientëve.

7.Dëshira ime më e fortë në ata vite ishte që ky shtet shqiptar (të cilin, shqiptarët, që kishin mbetur jashtë kufijvet, mezi e kishin), të forcohej sa më shumë ekonomikisht. Të forcohej ekonomikisht, sepse ashtu do të ishte i fortë edhe ushtarakisht, edhe në kulturë, edhe në politikë e diplomaci.

Por, krahas me dëshirat ecnin edhe shqetësimet. **Shqetësimi im më i madh** në ata vite ishte, ai që më ngacmonte përditë: ndërgjegjja e ulët e një pjese të

punëtorëve në raport me punën. Një shumicë punëtorësh punonin pa cilësi. Çdo mbrëmje bëhej i quajturi ***5-minutësh***, i cili thuajse rendom e kalonte 30-minutëshin. Analizoheshin punët e ditës, bëheshin vërejtje, kritikoheshin ata që s'e kishin kryer si duhej punën. Por prapë të nesërmen viheshin re të njëjtat shkelje. Nuk kish pushime nga puna. Nuk kish kurrfarë dënimesh. Ata ishin punëtorë të një gjendjeje ekonomike mjaft të ulët. Ku të çoheshin më keq?! Kish vetëm kritika, por ato, me kalimin e kohës, thuajse e humbnin plotësisht efektin.

Sektori i blegtorisë, gjegjësisht një fermë lopësh që ish ngritur pranë ndërmarrjes sonë, dilte vazhdimisht me probleme. Nuk u shërbehej mirë lopëvet. Nuk sigurohej me kohë ushqimi i nevojshëm dhe cilësor. Në anë tjetër, vëreheshin përvetësime, vjedhje të qumështit. Edhe vreshti, mbasi u mbaruan paratë e caktuara si fonde investimi, nuk po dilte rentabël. Dëmtohej prodhimi qysh prej punimevet, harrjevet, spërkatjevet e deri në vjelje, kur një pjesë të madhe e hanim vetë ne që e vilnim. A mund t'i thuhej punëtorit: "***Mos ha rrush***!?" Ai punonte aty gjithë vitin dhe thuhej vazhdimisht me të madhe: "***Kjo është prona jonë! Këto prona s'i kanë më as bejlerët, as latifondistët***!" "***Atëherë, kur qenka e jona***" thoshte punëtori "***përse të mos ha sa të ngopem***?" Edhe ai që vidhte qumështin, po kështu gjykonte. Edhe ajo gruaja, që shkulte patate dhe në mbrëmje mbushte trastën. Në një të tillë situatë, o do ta vije punëtorin nën diktaturën e ndëshkimit, o do t'i thoshe: "***Ha dhe merr sa të duash***!" Ish një problem teoriko-filozofik, i cili do të mbetej i pazgjidhur deri në fund, dmth deri në **ditën e dështimit**.

Jo vetëm te punëtorët, por edhe në administratë ndodhnin gjithnjë shqetësime që nuk dukeshin të kalueshëm. Nuk mund të thuhet se atje kishte sabotime. Zakonisht aty emëroheshin njerëz të mirë. Por rezultonin të paaftë për t'i menaxhuar punët. Mua më rrihte mendja vazhdimisht te rritja e prodhimit. Isha i bindur që, nëse në sistemin komunist do të rritej prodhimi më shumë se në kapitalizëm, mënyra se si shpërndahej ai prodhim, së paku në ata vite, më dukej e atillë që duhej të vinte një ditë kur klasa punëtore, dmth punëtorët, nga Vendet Perendimorë, të synonin për të kaluar kufirin e për të ardhur në Lindje. Fatkeqësisht kjo nuk ndodhi, nuk po ndodhte, dhe ky ishte njëri prej paralajmëruesvet kryesorë që **komunizmi po dështonte**.

Në atë ndërmarrje të vogël bujqësore unë nuk mund të përfaqësoja asgjë. Isha një punëtor i thjeshtë, madje i internuar. Punoja bashkë me shokët e brigadës, që ishin të gjthë vendës, herë në qilizëm, herë në punë me bel, herë

në hapje gropash për mbjellje ullinjsh. Por, për të menduar, edhe për punë të vogla, edhe për punë të mëdha, askush nuk më ndalonte dhe nuk mund të më ndalonte. Kështu, duke punuar në punët më të thjeshta dhe duke lexuar libra në orët e lira, në kokën time formuloheshin gjithfarë ideshë, midis të cilavet vendin qendror e zinin ato që lidheshin me gjendjen dhe me të ardhshmen e pjesëvet të Shqipërisë, të lëna jashtë kufijvet të shtetit të vet, dhe ato që lidheshin me pjesën sovrane të Shqipërisë. Duke mos ditur nëse do të largohem apo jo ndonjëherë nga ajo ekonomi bujqësore, po edhe sikur ta dija, mendimet e mi nuk mund të rrinin indiferentë edhe për punët që bëheshin aty. Në fushën e vogël të Tepelenës më çonte shpesh brigadieri për t'u kujdesur për jonxhat: korrje me kosë dhe ujitje. Në të ujitur kisha vënë re që, ndonëse vinte ujë i mjaftueshëm në krye të arës, ai nuk arrinte te bima, sepse e përpinte toka zallishte. U shqetësova shumë dhe mendova një mënyrë ujitjeje me një sistem tubacioni. Ia paraqita me shkrim drejtorisë. U miratua njëfarë eksperimenti dhe i bëra disa prova, në kushte skajisht primitivë, por në ndërkohë m'u dha e drejta e studimit dhe erdha në Tiranë. Provat që kisha bërë, më kishin bindur se një metodë e tillë ujitjeje do të mund të shërbente për shumicën e tokavet të Republikës dhe jam përpjekur për vite me radhë, kam arritur, vite më vonë, ta parashtroj deri në Ministri të Bujqësisë, por nuk qe e mundur. Ishin **disa** faktorë që i pengonin të këtilla përpjekje për progresin: burokracia, injoranca e zyrtarëvet, indiferentizmi, mungesa e patriotizmit dhe paragjykime të ndryshëm, midis të cilëvet: "***Po ky?! Ka ardhur nga Jugosllavia***" (Në të vërtetë, unë s'kisha ardhur nga Jugosllavia.) "***dhe na shitet sikur shqetësohet për Shqipërinë më shumë se ne!***" Të këtilla ndeshje me realitetin më kanë bërë të mendoj që, sado të përpiqen njerëzit qëllimmirë, **fati i komunizmit ishte më shumë se i dyshimtë**. Lëkundjet ishin të vazhdueshme, por jo si të atyre që e urrenin këtë rend shoqëror, i cili, në të vërtetë, nuk po bëhej, por: po **eksperimentohej**. Po eksperimetohej me kosto tepër të lartë.

Atë Zef Pllumi, ndërkaq, e urren apriori këtë rend shoqëror. Ai as që bën përpjekje për t'i pëlqyer këtij rendi të paktën ndonjërën anë të mirë.

8.Fakulteti më ofroi përshtypje të mira pa mbarim. E para, tani mund t'i shkruaja familjes, që isha vërtet mirë. Gjer atëherë, në kartolinat që ua dërgoja thuajse çdo 2 javë, nuk kisha shkruar asnjë fjalë të keqe për punën dhe për jetën time. Asnjë ankesë. Në të vërtetë, e tillë ish filozofia ime. Në Republikën Popullore (tani Socialiste) të Shqipërisë kish shumë frymëzim për njeriun që e donte këtë vend me gjithë forcën e shpirtit, po edhe me gjithë forcën e arsyes. Në RPSSH edhe ajri ish më i miri i të gjithë botës!

Tirana ish një qytet shumë i qetë dhe shumë i pastër. Fakulteti plot me djem të rinj e me vajza të reja. Ushqimi shumë i mirë. Mensa të pastra e plot dritë. Një qytet studentësh pa plehëra skutave e rretherrotull. Për mua, që isha në moshë gati 30 vjeç, si dhe për të tjerë që ishin si unë, kuzhinieret bënin kujdes disi të diferencuar: Na i mbushnin pjatat më shumë dhe shpeshherë racionin e mishit e kishim dyfish. Nuk besoj t'u kish thënë njeri, por ato ishin vetë shumë të kujdesshme. Në mëngjes, në mesditë dhe në mbrëmje mbusheshin rrugët e Qytetit Studenti. Bulevardi "***Dëshmorët e Kombit***" ishte çdo natë plot e përplot. Aq sa kishe përshtypjen sikur krejt Tirana dilte shëtitje. Mbretëronte gjithandej një qetësi e admirueshme. Dëgjohej vetëm një zhurmëri, si ajo e lumit. Pedagogët në Fakultetin e Histori-Filologjisë ishin profesionalisht mjaft të përgatitur. Disa prej tyre ishin tashmë personalitete të njohur. Takimi im me Prof.Eqrem Çabejn ka qenë një ngjarje e paharrueshme. Ai kish marrë vesh që jam në fakultet. Më thirri, m'u prezantua dhe më tha: "***Unë duhet të të kërkoj falje sepse të kam cituar pa të pyetur në një libër monografik për Gjon Buzukun që sapo e kemi shtypur në Rumani***."

9.Në vitet 1967-1970 etj. në universitetin e Tiranës, përfshirë edhe Institutin e Lartë Bujqësor, kanë studiuar më shumë se 115 studentë nga trevat shqiptare të lëna jashtë kufijvet shtetërorë. Kjo për mua kish një domethënie të madhe: **Shteti shqiptar po i ndihmonte bashkëkombësit**, të cilët historia e keqe i kish lënë jashtë kornizavet të veta shtetërore. Nuk ish vetëm kjo, që i përkrahte Kosovën dhe vise të tjerë të Shqipërisë. Qëndrimi i qeverisë shqiptare ishte i fortë e i rreptë, përballë represionit që bënte atje Jugosllavia, thënë më saktë, përballë represionit që bënin participet sërbë dhe anekset e tyre malazezë e sllavomaqedonë. Kjo shikohej në shtypin e përditshëm, ku vazhdimisht publikoheshin, me sens akuze e demaskimi, gjyqet që bëheshin atje kundër shqiptarëvet. Demonstratat e studentëvet në vitin 1968 u përkrahën prerazi dhe ashpër, duke akuzuar UDB-n dhe policinë sërbe, si forca represioni mbi studentët e profesorët. Artikujt e gjatë, që, me ton të rreptë, i botonte "***Zëri i popullit***", na jepnin zemër veçanërisht ne, që kishim ardhur prej atyre viseve dhe që kishim lënë andej familjet tona dhe shokët tanë, të cilët po torturoheshin burgjeve.

Radio-Kukësi u bë zëdhënësja, frymëzuesja dhe përkrahësja më e flaktë e kërkesavet për të drejtat kombëtare të të gjithë shqiptarëve të mbetur nën Jugosllavi. Po kështu edhe Radio-Tirana, Radio-Shkodra, Radio-Korça, nuk

pushonin së transmetuari këngë patriotike nga më frymëzueset, që lidheshin me të gjithë shqiptarët kudo që ndodheshin.

Si mund të thonë disa pseudoanalistë që Enver Hoxha "***nuk e ka përkrahur Kosovën***"?! Enver Hoxha e ka përkrahur e ndihmuar Kosovën në të gjitha fazat që ka kaluar ai si politikan shqiptar, gjithmonë në përputhje me rrethanat konkrete kombëtare e ndërkombëtare. Analizat objektive, në këtë aspekt të ndriçimit të personalitetit Enver Hoxhë, nuk është aspak vështirë të bëhen.

Do pasur parasysh, megjithkëtë, që, në një kohë kur RPSSH kish dalë edhe ***de jure*** prej Traktatit të Varshavës, nga njëra anë, participet sërbë etj mund të shfrytëzonin rastin dhe të vepronin egër ndaj shqiptarëvet, nga ana tjetër, RPSSH, e kërcënuar realisht prej forcavet të Traktatit, nuk mund t'i lejonte vetes një qëndrim më virulent ndaj shtypjes sërbe. RPSSH-së i interesoi në atë kohë të shfrytëzonte një mundësi "***hapjeje***" ndaj së quajturës Jugosllavi Vetadministruese, me qëllim që t'i ndihmonte më me efikasitet bashkëkombësit e vet përtej kufijvet dhe këtë punë RPSSH-ja e kreu më së miri. Lëvizja intlektuale dhe gjithpopullore shqiptare në Ish-Jugosllavi u intensifikua në ata vite, edhe falë ndihmës e përkrahjes nga ana e RPSSH-së, nga ana e profesoratit universitar të Tiranës, nga rrjeti mediatik, nga forcat krujuese artistike dhe nga vetë udhëheqësi **Enver Hoxha**. T'i thuash vetes patriot dhe të mos gjesh në shpirtin tënd vend për të adhuruar **Enver Hoxhën** e atyre viteve, është njëanshmëri qëndrimi dhe kjo lidhet me mungesa formimi, si në aspektin njohësor, ashtu edhe në aspektin moral. Mund të kesh qenë edhe i keqtrajtuar, por duhet të jesh burrë dhe t'i pranosh si pozitive ato që janë për t'u pranuar si pozitive.

Duhet thënë me këtë rast, që disa qëndrime të përditshëm nëpër mediat tona kundër **Enver Hoxhës**, ka kohë janë bërë të neveritshëm. E kuptoj që shumë prej këtyre shprehësvet të mllefit mund edhe të kenë arsye personale dhe familjare, por mënyra se si shprehen e si arsyetojnë, është vërtet e një niveli vajtimisht të paarrirë. Mjafton vetëm kaq të kalojmë nëpër mendje: Mjekimin e kishin falas edhe "të persekutuarit". Shkollimin, të paktën deri në mbarimin e arsimit të mesëm, e kishin falas edhe "të persekutuarit". Punën, qoftë edhe në bujqësi, por jo vetëm në bujqësi, e kishin të garantuar edhe "të persekutuarit".

Të burgosurit ishin si në gjithë botën: të burgosur. Të internuarit ishin si në gjithë botën: të internuar. Kish edhe të atillë që e pësonin pa qenë fajtorë,

por edhe kjo ndodhte si kudo në botë. Por që, për 2 apo 5 vjet internim, të rrish duke vajtuar 25 vjet, kjo nuk ndodh në asnjë vend të botës.

10. Në Tiranë nuk kish as tregti e përdorim droge, as veprimtari mafioze, e cila në Perendim në vazhdimësi po i manifestonte tiparet e vet shtetshkatërrues, as trafik qeniesh njerëzore, as prostitucion dhe as fenomen lypsarie. Kjo ua shtonte shumë vlerat pastërtisë së ambientit dhe qetësisë publike që aq këndshëm binin në sy në Tiranë. Duke u përpjekur t'i shikoja disi më gjërë problemet, mua më dukej çudi, **pse pjesa pozitive e botës kapitaliste nuk i vinte në dukje këto cilësi të mira të rendit shtetëror këtu në Tiranë**. Edhe për denoncimin që Tirana i kish bërë Traktatit të Varshavës, pa marrë parasysh nëse ajo fliste keq edhe për NATO-n, Perendimi duhej ta kishte lavdëruar Tiranën. **Pse nuk flisnin mirë Vendet Perendimorë të paktën për ato gjëra që i kish të mira RPSSH-ja**? Sigurisht, kjo duhej të ish një shenjë që **borgjezia, edhe pjesa pozitive e saja, kish marrë aq frikë prej komunizmit, sa nuk guxonte t'i pranonte këtij asgjë të mirë**. Në anë tjetër, vetë rendi komunist, në rastin tonë ky i Tiranës, ish pozicionuar aq ashpër përballë kapitalizmit, sa i kish shpallur atij luftë në të gjithë aspektet. Konfrontimi ishte vërtet i egër. Unë, sigurisht, ua vija fajin shtetevet me rend shoqëror kapitalist, si edhe atyre që tashmë ishin orientuar drejt restaurimit. (Më vonë do ta kuptoja që **restaurimi ishte i pashmangshëm**. Ai do të bëhej dhe duhej bërë, por jo me shkatërrime, jo me degradim të ekonimisë: Jo me kultivim, jo me tregti dhe përdorim droge, jo me veprimtari mafioze, jo me trafikim të qenievet njerëzore, jo me prostitucion dhe jo me lypsari nëpër rrugët e qytetevet.)

Në drejtim të Kinës më mbante një shpresë e vagullt se ndoshta ajo do të mund t'i ndihmonte shqiptarët. Mirëpo, kjo ndihmë e Kinës duhej të manifestohej sidomos në qëndrimin e saj ndaj Jugosllavisë. Nëse Kina, veçanërisht mbasi ajo u pranua në OKB, falë edhe veprimevet diplomatikë të RPSSH-së, do t'i përkrahte kërkesat e atyre shqiptarëve, të cilët kishin mbetur nën Jugosllavi, kjo do të dëshmonte që miqësia shqiptaro-kineze mund ta kishte jetën mjaft të gjatë. Mirëpo, një gjë e tillë nuk ndodhi. **Kinezët përkrahën Beogradin**. Unë mendoj që një ndër arsyet që **Enveri** vendosi shkëputjen prej kinezëvet ka qenë pikërisht kjo. Ne kishim në Qytetin Studenti edhe studentë kinezë dhe u thoshim: "***Sa mirë ju kërkoni që Taivani të njihet si pjesë e Kinës, kurse Kosovën nuk e konsideroni pjesë të Shqipërisë!***" Ata nuk përgjigjeshin. Ndonjë prej tyre madje kish studiuar më parë në Beograd, pastaj kish ardhur në Tiranë.

Lidhur me Revolucionin Kulturor mendimi im nuk ishte negativ, por e parashikoja që ai, duke qenë ekstremisht sektar dhe në zbatimin e vet tepër primitiv, nuk do ta kish as jetën të gjatë, as suksesin, i cili në shkallë botërore duhej t'i zgjidhte raportet punë fizike-punë mendore, raportet fshat-qytet, si dhe raportet provincë-metropol. Te **personazhi i Lej Fenit**, sado asketik dhe tejet primitiv, unë shikoja një tendencë, një **thirrje racionale** që propaganda maoiste kineze i bënte njeriut si qenie shoqërore: "***Njeri, ki kujdes, ji rigoroz ndaj vetes!***" S'ish hera e parë që hasej një i tillë personazh. Pothuaj të gjithë shenjtorët katolikë, themelues të rendevet rregulltarë, kanë çuar jetë të ngjashme me atë të Lej Fenit. Një personazh i tillë ishte pa dyshim edhe shqiptarja **Nënë Tereza**, murgesha e Kalkutës, sado që njërën e përkrahte dhe e propagandonte kapitalizmi, ndërsa tjetrin komunizmi maoist.

Intelektualët snobë e mendjemëdhenj nuk janë në gjendje të ushqejnë simpati as ndaj Lej Fenit e as ndaj Nënë Terezës, sado që ata, për politikë apo thjeshtë për servilizëm ndaj kapitalizmit, flasin ndryshe për Nënë Terezën e ndryshe për Lej Fenin. Për Nënë Terezën flasin me adhurim (sigurisht të shtirur) e për Lej Fenin flasin me cinizëm.

11.I shikoja studentët. Ata ishin djem të mirë dhe vajza të mira, me fare pak përjashtime. Ishin të rinj të qetë, të përkushtuar ndaj lëndëvet që studionin (të paktën kjo ishte përshtypja), njerëz që aspironin të pajiseshin me kulturë, dhe kjo shihej në frekuentimin e bibliotekavet, te shkuarjet në kinema, në teatër dhe, jo rrallë edhe në opera. Mirëpo, tek i shihja të atillë, megjithatë, shpesh ia bëja pyetjen vetes: ***A këta do ta vazhdojnë revolucionin? A mund të jenë këta revolucionarët e dekadavet të ardhshme?*** Të gjithë revolucionet janë kohëshkurtër. Ata nuk mund të jenë asnjëherë permanentë.

Midis "***vogëlsiravet***" të përditshme na shfaqeshin disa dukuri që mua, të prirur drejt parashikimevet, më shqetësonin. Djemvet 20-vjeçarë e më të rritur duhej t'u shkonte dikush, psh kujdestari i konviktit, dhe t'u bënte vërejtje për mosrregullimin e krevatit. Hapje dyert e dhomavet dhe shumicën e krevatëvet i gjeje të parregullt, me batanijet e çarçafët rrudhur, bërë grumbull e lënë ashtu. Mua ata krevatë më ngjanin me varre të hapur, në të cilët varrosej personaliteti i përdoruesit të tyre. Sifonët e nevojtorevet shpeshherë bllokoheshin, sepse studenti e kryente nevojën dhe nuk e lante vendin me ujë të bollshëm. Shkonte tjetri dhe e linte po ashtu. Vinte një kohë kur nuk mund të hyhej në nevojtore. Prisheshin bravat e dyervet. Në mensa shpërdorohej buka. Studentët, për shaka, gjuanin njëri-tjetrin me copa

buke. Copa të tjera liheshin nëpër pjata. Grumbulloheshin aq shumë mbeturina buke, sa vetëm në njërën prej mensavet, aty ku ushqehesha edhe unë, çdo ditë u çoheshin derravet më shumë se 2 kuintalë.

Atë Zef Pllumi rrëfen në shumë vende, me të drejtë, mbi ushqimin e keq nëpër burgje. Por këtu ushqimi ishte i mirë dhe keqpërdorej. Nuk ish komunizmi ai që i edukonte kështu këta djem.

Sigurisht, nuk mund t'u kërkoje të gjithëvet të ishin si Lej Feni, por të paktën ndonjë prej vetivet të tija duhej ta kishin. Të ishin studentët dhe studentet edhe në dhomat ku flinin po aq të rregullt sa ç'dukeshin kur dilnin për të shetitur ose kur u drejtoheshin auditorevet, do të ishte edhe parashikimi im disi më optimist. Ndërkaq, studentët, të cilët, para se të vinin në fakultet, i kishin kaluar nga 2 apo 3 vjtet nëpër punëra të ndryshme, ishin shumë më seriozë dhe më të formuar në pikëpamje të edukatës, se sa ata që vinin aty fill mbas mbarimit të së mesmes. Nxirnin krye këtu probleme të sistemit arsimor gjithnjerëzor, jo vetëm të komunizmit.

Vihej re edhe një tendencë pothuaj e përgjithshme. Dëshira për t'u emëruar me punë në Tiranë. Në mos në Tiranë, në qendrat e rrethevet. Në fshat nuk dëshironte askush të shkonte. Kjo, në aspektin e kërkesavet normale që ka njeriu për jetën personale, nuk ka asgjë të keqe. Por kur shikohet puna **për ta vazhduar apo për të mos e vazhduar më tej rendin komunist**, kjo tendencë ishte masivisht kundërkomuniste. Aq e dukshme ishte kjo dëshirë për të ndenjur në Tiranë, sa një shumicë vajzash bënin çmos për t'u njohur me çfarëdolloj mashkulli, mjaftonte që ai të ishte i pamartuar dhe të kish shtëpi e punë në Tiranë. U përhap ashtu **sllogani ironik i 3 T-vet**, që do të thoshte: ***Tiranë, Televizor, Tullac***. S'prishte punë që kandidati për burrë i një vajze, qoftë edhe shumë të bukur, të ishte një tullac 45 apo 50-vjeçar. Mjaftonte që ai të ishte me banim në Tiranë dhe të kish televizor në banesë.

Komunizmit kështu po i mbyllej çdo perspektivë. Po ç'perspektivë po hapej?! A do të përfaqësonte progres "***filozofia***" e 3 T-ve?! Shumë shpejt kjo "***filozofi***" do t'i mbushte hotelet dhe motelet me qindra vajza shkollash të mesme e studente, të cilat, disa vjet pas të atilla "***përvojave***", as që do të dinin pse kanë lindur në këtë botë.

12.Në vitet 1967-1970 etj në jetën e studentëvet shqiptarë bënin pjesë edhe 2 veprimtari të veçanta: stërvitjet ushtarake dhe aksionet. Qëllimi ishte që studentët dhe studentet të bëheshin të aftë ushtarakisht dhe të edukoheshin

me punë fizike, në mënyrë që inteligjenca e ardhshme t'u afrohej edukativisht klasës punëtore dhe fshatarësisë. Por sa realizohej ky qëllim? A ish i gatshëm të pranonte një edukatë të tillë studenti, i cili nuk e kish synimin as për t'u bërë punëtor krahu, as anëtar i kooperativës bujqësore? Synimi i studentit ishte, të largohej sa më shumë e sa më shpejt nga "***kazma***". Madje, ideali i tij ishte që sa më parë të largohej nga profesioni i prindërvet të vet. Në aspektin e kërkesavet individuale kjo, në dukje sipërfaqësore, nuk kish gjë të keqe. Mund t'i bënte keq individit, sepse e paaftësonte fizikisht e, si pasojë, edhe mendërisht, edhe shëndetësisht (obeziteti, sëmundjet e zemrës, çrregullime në metabolizëm). Por, **me mijëra apo miliona individë të tillë**, **rendi që synonte të ndërtonte komunizmi, ish i dënuar të lihej në mes të rrugës**. **Rikthimi në kapitalizëm**, po të mos gjendej një metodë shpëtimi, **ishte kështu i pashmangshëm.** Sikur të mendohej e punohej për të kaluar në një organizim shoqëror, shtetëror etj, i cili të ish më i mirë se kapitalizmi që njihej, kush nuk do të gëzohej?! Por ç'të mirë do t'i sillte vetëvetes dhe fëmijëvet të vet, një i ri, i cili nuk donte të kuptonte sa rëndësi ka edukimi i vetëvetes me punë krahu e me veprimtari të tjera fizike, duke u kthyer shoqëria në atë kapitalizëm që njihej tashmë, historikisht, teorikisht dhe praktikisht?!

Shkonim në stërvitje ushtarake. Atje kish disiplinë. Duhej mbajtur uniforma në rregull. Duhej kujdesur për armën. Ishin rreshtimet, marshimet, zgjimi me alarm, shërbimet e rojës, orët e stërvitjes, qitjet me armë. Realisht të gjitha këto e shkathtësonin studentin. E bënin studentin më të çiltër e më të kthjellët. Por në sferën e botëkuptimit efekti ishte tepër minimal. Unë krijova atëherë mendimin që, sidoqoftë, stërvitja ushtarake i bën mirë njeriut dhe **njerëzimi nuk duhet të heqë dorë nga tradita e shërbimit të detyrueshëm ushtarak.**

Për mua, që pata punuar 5 vjet "***në kazëm***", po edhe një pjesë të rinisë e pata kaluar me blegtori e bujqësi fshati, atje ku isha rritur, aksioni në hekurudhë ishte një argëtim i vërtetë, një shkundje e trupit nga mpirja. Kisha nostalgji për të punuar me lopatë dhe për të shtyrë karrocën e dorës. Sa i përket freskimit të mendjes, puna me kazëm ishte e kundërta e "***të thartuarit të trurit***".

Teorikisht unë e quaja DOMOSDOSHMËRI JETIKE që njeriu të mësohet EDHE ME PUNË KRAHU. Jo të ishte i detyruar njeriu të punojë fizikisht për copën e bukës (kjo do t'i ndodhte një pjese), por njeriu t'i kishte pasion ata lloje punësh, siç i kanë pasion shumë njerëz ushtrimet

gjimnastikorë. Unë nuk isha as për atë që njeriu, i cili bënte punën e punëtorit, ta linte mënjanë punën intelektuale. Kish ardhur koha, pas mendjes sime, që njeriu të kuptojë se i duhen të 2-ja: edhe puna mendore, trulodhëse, "***truthartuese***", edhe ajo fizike, trushplodhëse. Kish ardhur koha, pas mendjes sime, që njeriu ta ketë ideal të jetës së vet këtë formë të vetedukimit.

Por në masën e studentëvet nuk shikohej një e këtillë tendencë. Në të vërtetë, shumë prej tyre s'e kishin të lehtë as të merreshin me libra. Këtë e vura re jo në fillim, por duke u njohur gradualisht me gjendjen. Lodheshin, madje e kishin vuajtje punën në dhé e në baltë, por lodheshin edhe duke shfletuar dispensat, shtrirë mbi krevat. **A ky lloj njeriu do ta çonte përpara atë që quhej revolucion socialist**?! Më vonë të njëjtën pyetje unë do të detyrohesha ta bëja edhe në adresë të krejt njerëzimit: **Me këtë lloj njeriu a do të mund të shmanget katastrofa shfarosëse e luftëravet bërthamore**?!

Në aksionin e hekurudhës Lushnjë-Fier, në sektorin e Gradishtës, më takoi të merresha me një brigadë "***artistësh***". Të shumtët ishin bij e bija intelektualësh të Tiranës. Kishin ardhur aty gjoja për t'u marrë edhe me veprimtari artistike, por, në të vërtetë, shpresa e tyre ishte për t'iu larguar sa më shumë "***mundimevet***" truporë. Duke mos qenë liberal ndaj vetes, unë isha tepër i ngurtë edhe ndaj të tjerëvet. Vura re që një pjesë e aksionistëvet të mi ishin, madje, fëmijë të nomenklaturës dhe të të quajturit ***Bllok***. E kuptova sakaq që nuk do të merresha vesh me atë lloj aksionistësh. Dhe vërtet ashtu më doli. Të vetmit që ma zbardhnin faqen, ishin një grup çunash sportistë, të cilët punonin edhe për vete edhe për "***gocat***".

Një vajzë e Petrit Dumes më rrinte gjithë ditën me bishtin e lopatës nën sqetull. S'ish e vetmja ajo, por mua më binte në sy, se ish fëmija i një personi të njohur, i cili, në shoqërim të Mehmet Shehut, na kish ardhur për inspektim njëherë në orën 1 mbas mesnatet në një repart që quhej ***Rrapi i Treshit***. Njihej si ushtaraku më rigoroz në Ushtrinë tonë Popullore. Iu afrova një ditë asaj vajzës dhe i thashë: "***Të ishte yt atë kështu si ti, kokërr dembeli, ushtria jonë do të kish marrë fund me kohë***." Ajo e ndërroi bishtin e lopatës nga një sqetull në tjetrën, pastaj m'u përgjigj, me një fytyrë të rrumbullakët dhe me ca sy të këndshëm: "*Ua, sa i rreptë e sa i rregullt është babi! Unë nuk mund të bëhem kurrë si ai*." Më vonë, i jati i asaj vajze u pushkatua, ndërsa ajo vetë s'e di si ka përfunduar. Me siguri që s'e ka pasur të lehtë jetën nëpër internime.

Por pyetja që vazhdonte të bëhej me shumë këmbëngulje, ishte përherë kjo: **A mund të çohet revolucioni socialist, dmth a mund të shkohet në komunizëm me këtë brumë të ri intelektualësh?** Shikuar edhe më gjërë e më thellë: **A mund të shpresojë njerëzimi në një shoqëri pa klasa, të atillë siç e kishte projektuar marksizëm-leninizmi?**

13.Lugina e Matit është një krijesë e natyrës nga më të bukurat. Ne u vendosëm në trevën e Kryemates, në krahun jugor të asaj lugine. E gjithë pamja e atij vendi shkakton te njeriu mbresa të jashtzakonshme. Lumi që del si papritur nga kanionet e Martaneshit, përrenjtë që derdhen prej së djathti e prej së majti, Sheu i Shugjunit, Sheu i Cërujës, sheu që quhet Lezedër, Sheu i Darsit, një tjetër she nga Kurdaria, një nga Gjurra, më poshtë akoma Sheu i Shulbatrrës, e gjithë kjo gurgullimë ujërash duket sikur e nanuris krejt vendin, duke i prurë në mendje ëndrrat më të ëmbla. Në pjesët midis rrjerdhavet ka masive shkëmborë nga më madhështorët, pastaj poshtë impozancavet aq mbresëlënëse shkëmbore, renditen në zbritje, toka të shumta që prodhojnë çdo gjë që i nevojitet njeriut. Mendimi i parë që të imponohet, është ky: ***Sa mirë do të jetë këtu! Njerëzit që kanë fatin të lindin e të plaken në këtë parajsë, janë pa dyshim nga më të lumturit***.

Por, a ishte vërtet kështu?! Në vitet kur u vendosëm në Mat, unë dhe bashkëshortja ime, së bashku me djalin tonë 3-muajsh, shpresat ishin, që po shkohej pikërisht drejt një të tillë jete, vërtet të lumtur, në harmoni të plotë me bukuritë dhe me pasuritë e asaj treve më shumë se përrallore.

Që në mëngjes heret, arat e kooperativavet stoliseshin me kooperativistë. Të ndarë në brigada me nga 20-30 vetë, u viheshin punëvet, sot në një parcelë, nesër në një tjetër. Punonin burra dhe gra bashkë. (Sikur aty të mos kish shkelur kurrë këmbë Turku.) Burrat ishin më të pakët, sepse shumica punonin në punë shteti. Vetëm në fshatin Fullqet kishte në atë kohë mbi 18 shoferë, të gjithë të punësuar, o në transport kromi, o në ndonjë tjetër lloj transporti. Ishin edhe nja 10 a 12 mësues vendës. Ishin 3 infermire-mami. Kish edukatore kopshti. Kish agronomë e veterinerë. Një pjesë e burravet punonin në minierat që ndodheshin në krahun lindor të trevës.

Në të gjithë Matin gëlonin shkollat prej nxënësish të shumtë. Askush nuk rrinte pa u përfshirë në një punë. Nuk kish njeri që të mos merrej me diçka: o në kooperativë, o në punë shteti, o në shkollë. Vetëm pleqtë e plakat dhe nënat me foshnja në gji rrinin rrotull shtëpivet.

Pagat e punëtorëvet ishin të pranueshme. Ditëpuna në kooperativë ishte e ulët. Por kur grumbulloheshin të ardhurat e krejt familjes, duke qenë të gjiithë në punë, jetesa nuk ish e keqe.

Në mbledhjet e fshatit, që nuk ishin të rralla, merrnim pjesë edhe ne mësuesit. Më kujtohet një nga mbledhjet, në të cilën bëhej analiza e rezultatevet të fundvitit. S'ishin bërë ende 4 muaj që e kisha filluar punën si mësues. Përfaqësues i kryesisë në atë mbledhje ishte nënkryetari i kooperativës. Në raport u tha që dita e punës për atë vit kish dalë 97 lekë të vjetër. Ishte përafërsisht ½ e pagës ditore që jepej në punë shteti. Unë, në diskutimin tim të shkurtër, kërkova vetëm kaq: "***Nëse vitin tjetër nuk del dita e punës e pakta 98 lekë, dmth e pakta 1 lek më tepër se sivjet, ju si kooperativistë duhet ta shkarkoni nënkryetarin dhe ta çoni në prodhim***. ***Në punë krahu.***" Disa nga të pranishmit qeshën me një lloj ironie të hidhur. Ndërsa të gjithë ata që e morën fjalën mbas meje, thanë kështu: "***Në këtë kooperativë, nëse do të bëhej organizimi si duhet, kushtet janë për të marrë jo 97, por 150 e 200 lekë për ditë pune***."

Për fat të keq, jo vetëm të kooperativistëvet, por të të gjithëve ne që jetonim aty, në vitet që pasuan, paga që merrej në kooperativë, jo vetëm që s'u rrit më, por erdhi gjithnjë duke u ulur.

Unë nuk e urreja kolektivizimin. Mua më vinte keq që bujqësia kolektive nuk po e rritte edhe më shumë prodhimin. Më vinte keq që paga e kooperativistit nuk po rritej dhe fajin për këtë nuk e kishte forma kolektive e punës, por organizimi i keq i saj. Madje, organizimi gjithnjë e më i keq, gjë që kish të bënte me degradimin edukativ të njeriut dhe i cili s'kish ku çonte tjetër, veçse në rindarje të shoqërisë në klasa.

14.Problemet ishin të shumtë. Aq të shumtë, sa njeriu, individi, në shumicë, prirej më shumë për të menduar për vete, për hallet e vet, se sa për interesa të përgjithshëm, ku doemos do të përfshiheshin edhe interesat e tij. Çështjet shtroheshin në mënyrë socialiste (shoqëroriste, Gj.D.), pra, çështjet shtroheshin për t'u zgjidhur kolektivisht, bashkërisht, ndërsa zgjidhjet bëheshin individualisht, vetjakisht, e shumta familjarisht apo si grupe të lidhurish njëri me tjetrin, ose nuk bëheshin fare. Kjo ishte kontradikta. Thirrjet bëheshin frontalisht***: "Të punojmë për lulëzimin e Atdheut! Të luftojmë shfaqjet e huaja borgjezo-revizioniste! Të mos e dëmtojmë pasurinë e përbashkët socialiste*** (shoqëroriste, Gj.D.)! ***Të mos neglizhojmë***

në punë! Ta bëjmë punën me ndërgjegje! Ta shfrytëzojmë mirë orarin e punës dhe ta bëjmë punën me cilësi! Të mos e përvetësojmë pasurinë e përbashkët! (Me fjalë të tjera: ***Të mos vjedhim***!) Të gjitha këto ishin kërkesa të drejta. (Madje, mjaft këso kërkesash, me terma të tjerë dhe shumë më të ashpra, janë edhe në kapitalizëm.) Mirëpo, këtu, zgjidhjet praktike bëheshin prapë individualisht. Dikush punonte e vepronte ashtu si i thuhej, dikush i zbatonte porositë përgjysmë (Këtu hynte shumica e popullatës.), dikush bënte dredhira nga „***më të larmishmet***". Nga këta të fundit disa kapeshin e ndëshkoheshin, por shumica i vazhdonte marifetet duke i përsosur.

Probleme kish veçanërisht në administratë, dmth në të gjitha zyrat ku vepronte kasta e kalemxhinjvet. Por probleme kish edhe në klasën punëtore, atje ku prodhohej dhe atje ku ndërtoheshin vepra të reja. Probleme kish edhe në fshatarësinë tashmë krejt kooperativiste, që ishte numerikisht edhe shtresa më e madhe.

Vite me radhë e kam vrarë mendjen për një rrugë, për një xhade, në fshatin Fullqet të rrethit të Matit, e cila duhej shtruar, por që nuk po shtrohej. Ishte gjithsej 3 km e gjatë, prej të cilëvet, nja 500m a diç më shumë, ishin vërtet problem i madh. Dimrit ata 500m rrugë shndërroheshin në 500m baltë. Balta ish e atillë që këmba humbte 30cm thellë dhe ish vështirë ta nxirje andej pa të mbetur këpuca brenda. Fshati Fullqet ish një fshat i madh dhe nuk kish mbledhje që nuk shtrohej edhe problemi i asaj rruge. Sidomos kur mbledhjet bëheshin në ditë shiu. Propozohej, diskutohej, disa protestonin të revoltuar, merreshin vendime, bëheshin premtime, dhe rruga nuk u ndërtua kurrë, për 1 çerek shekulli. Ajo u ndërtua vetëm në kohën kur në Rep.e Shqipërisë u restaurua kapitalizmi. Pse ndodhi kështu? Pikërisht për këtë e kam vrarë mendjen. Ndodhi kështu, sepse interesi ishte i të gjithëvet, dhe se askush prej individëvet nuk do të fitonte prej asaj rruge diç më tepër, qoftë edhe diç të vogël më tepër se të tjerët. Kryetari i kooperativës e merrte një rrogë dhe s'kish pse ia shtonte vetes mundimet duke organizuar shtrimin e një rruge. Kryetari i komitetit ekzekutiv e merrte një rrogë. Drejtori i ndërmarrjes shtetërore "***Rruga-ura***" e merrte rrogën edhe pa e bërë rrugën e Fullqetit. Sekretari i Parë i PPSH-së për rrethin, e merrte rrogën. Le të bërtiste populli. Moszgjidhja e një të tillë problemi, dava një rruge fshati, peshonte fare pak, në krahasim me morinë e moszgjidhjevet të tjera… Fakti që u bë rruga e Fullqetit **mbas** restaurimit të kapitalizmit, shpjegohet fare thjeshtë: Firma private, duke ndërtuar atë rrugë, do t'i shtonte fitimet e vet ndoshta sa dyfishi i kostos së atij ndërtimi. Asaj i interesonte ta shfaqte "***humanizmin***"

e vet edhe aty ku s'bëhej fjalë për më shumë se 500m baltë. Ky duhet të jetë edhe **thelbi i shkakut** që komunizmi dështoi në shkallë botërore.

Marrë si sektorë pune e veprimtarie veç e veç, probleme të shumtë kishte sektori i arsimit dhe i kulturës. Aty, stafi pedagogjik dhe administrata arsimore manifestonin të metat e veta, shpeshherë deri absurde. Në anë tjetër, masa qindramijëshe e nxënësvet dhe e studentëvet manifastonte edhe ajo handikapet e vet. Në sektorin e tregtisë gjithnjë e më shumë viheshin në plan të parë interesat e atyre që ishin të punësuar në atë sektor. Interesat e atyre që blinin, ishin tashmë të përcaktuar: Ata do të blinin atë mall që do të nxirej në shitje, atë që do të servirej. (Edhe në kapitalizëm, kallamkusuri ha ushqime gjenetikisht të modifikuar, mish të fryrë me kortizon.) Në sektorin e prodhimit ekzistonte kontroll i rreptë i cilësisë, por malli jocilësor megjithatë shumica as hidhej në mbeturina, as riciklohej. Ai shitej ashtu siç ishte. Sigurisht, në tregun e brendshëm, sepse i jashtmi edhe cilësorin mezi e pranonte. Sektori i mjekësisë, e cila u shërbente pacientëvet falas, ndonëse shkëlqente në komponentin e vet humanist, kish edhe ai mjaft probleme rrëzikbartës. Këta ishin të tillë probleme, të cilët një ditë do të mund ta çonin këtë sektor në pozicionin mirëfilli antihuman (antinjerëzor). Edhe drejtësia manifestonte të njëjtët shenja. Heqja e avokatit e la fatin e të pandehurit në duart e prokurorit dhe të gjykatësit. Të 2 këta, faktikisht qëndronin të ndërvarur prej digasterit të vet dhe prej organizatës së Partisë së Punës. Sektori ushtarak, duke kërkuar që kuadrin oficer ta ulë në nivelin e një komandanti të dikurshëm partizan, po njëkohësisht duke e paguar, rrëzikonte ta bëjë ushtrinë të paaftë për ta kryer si duhet misionin e vet të ruajtjes së Atdheut.

Shikuar në tërësi, krejt ky spektër social, u përqëndrua nën direktivat, nën udhëheqjen (në fakt, nën diktatin) e një organizmi të vetëm, i cili quhej Partia e Punës e Shqipërisë. Kjo deklarohej dhe propagandohej gjithandej. ***Partia mbi të gjitha***. Por sa sukses do të kishte një përqëndrim i këtillë i punëvet drejtuese? Partia po paraqitej tani si dikur kisha. Një përqëndrim i këtillë i punëvet po e reduktonte përgjegjësinë te një sekretar i orgaizatës-bazë (aq sa mund ta mbante ai atë përgjegjësi, duke mos u paguar), te një sekretar byroje, më tutje te një Sekretar i Parë (emërtim që shkruhej me shkronja të mëdha, por është e kuptueshme që ai të gjitha punët nuk mund t'i kryente), dhe, më në fund, te Sekretqari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, i cili në atë kohë quhej **Enver Hoxha**, por që një ditë do të ish një tjetër dhe atëherë çdo gjë do të varej vetëm prej atij. A mund të thuhej që RPSSH dalëngadalë po shndërrohej në një lloj mbretërie? Jo në

mbretëri të mirëfilltë, por në një lloj? Siç po bëhej psh Koreja e Vertiut, por këtu jo me trashëgimi familjare?

Megjithatë, në konceptin tim 2 aspekte ishin thelbësorë, të cilët më mbushnin me entuziazëm dhe me admirim sidomos ndaj **Enver Hoxhës**. 1.RPSSH po e ruante **pavarësinë si shtet** dhe kjo mua, ndonëse shpeshherë lëkundesha ndër dyshime, aq sa më kapnin të dridhurat, më dukej tashmë e siguruar, dhe 2. në RPSSH po bëheshin **ndërtime** të shumtë. Ekonomia, shpresoja unë, do të shënonte ngritje të vazhdueshme, përkundër bllokadës së egër, vërtet të egër, që i bëhej këtij vendi në kuadrin e Luftës së Ftohtë.

15.**Ushtrisë** po i kushtohej vëmendje e madhe. Armatimi kish ardhur dikur prej Bashkimit Sovjetik. Tani po vinte edhe armatim kinez. Me një manovër shumë të zgjuar diplomatike ish arritur që nëpërmjet Kanalit të Suezit, ku kontrollin e bënte Egjipti, të lejoheshin sasi të mëdha armësh, të mbuluara me grurë. Pak nga pak po konsolidohej edhe prodhimi në vend i armëvet dhe sidomos i municionevet. Territori i Republikës ishte plotësuar me të gjithë llojet e ushtrisë dhe me të gjithë repartet e nevojshëm ushtarakë. Rregulli, që gjithë populli të konsiderohej ushtar, mua më dukej më se i logjikshëm. Bëheshin stërvitje të të quajturavet çeta vullnetare, ku pjesën më të madhe të efektivavet e përbënin gratë dhe vajzat. Bënin stërvitje periodike edhe rezervistët. Dalëngadalë po realizohej tunelizimi i krejt territorit, në mënyrë që e gjithë popullsia, në rast agresioni, të mund të strehohej në ata tunele. Po bëhej tunelizimi edhe i armatimevet, i aviacionit, i artilerisë, i tankevet, i flotës luftarake dhe i të gjithë llojevet të municionit. Më në fund, u vu në zbatim edhe mbulimi i krejt territorit me bunkerë. **Vetëm armiku, ai që synonte ta pushtonte këtë vend ose ai që ish gati ta shiste a ta falte pavarësinë e këtij vendi, mund të fliste keq për ata bunkerë.** Mua më përshkonte entuziazmi dhe përjetoja çaste qetësimi shpirtëror, kur shihja si ndërtoheshin dhe si shtoheshin, si pozicionoheshin ata bunkerë, në gryka, në brinja e brigje, përballë rrugëvet e përballë detit.

Kish qenë pikërisht pamundësia jonë për t'u mbrojtur **ushtarakisht**, ajo që shtetet fqinjë kishin arritur të na e pushtonin më shumë se gjysmën e Atdheut. **Qindra mijë viktima, që unë i dija tashmë me shifra, i kish kushtuar këtij vendi mungesa e një ushtrie kombëtare dhe mungesa e një aftësie për t'u mbrojtur prej agresorëvet pushtues**. Po them qindra mijë viktima. Nuk e di sa jam i aftë t'ia bëj të përfytyrueshme lexuesit pamjen e masakravet. **Vendi ynë është një varrezë popullate të paarmatosur, grirë e copëtuar në tufa e në grumbuj**, ca këtu e ca aty.

Befasuar e mashtruar, për turp e për faqe të zezë. Të kish Ismail Qemali një ushtri të këtillë, si e kishim tani, as Greku s'do të mund të na i merrte Çamërinë e pjesët e tjera jugore, as Sërbi s'do të mund të na i merrte Kosovën dhe viset e tjerë veriorë e lindorë, as Malazezi, një grusht pushkë-e-sëpatëmbajtësish, nuk do të mund t'i mbante ato që na i kish marrë. Këto ishin arsyet që mua më pëlqente çdo gjë që bëhej në fushën e mbrojtjes, të paktën të kësaj cope të vogël Shqipërie që na kish mbetur për ta qeverisur ne.

Edhe **Armën e Sigurimit të Shtetit**, sado që atje dilnin vazhdimisht probleme, e kam konsideruar një nga veprat më madhore, personalisht të **Enver Hoxhës**. Organet e zbulimit shqiptar, për herë të parë në historinë e këtij Kombi, përjashtuar ndoshta Epokën e Madhe të Gjergj Kastriotit Skënderbeut, ishin një subjekt, të cilin spiunazhi botëror ish i detyruar ta merrte në konsideratë. Nuk sulmohej më kot me aq shumë afeksion organi i zbulimit tonë dhe i kundërzbulimit, njohur me emrin ***Sigurimi Shqiptar***. Nuk sulmohej më kot dhe nuk synohej më kot që të kapej e të vihej në shërbim të kundërt pikërisht kreu i këtij organi, ministri apo dikush afër ministrit. **Sa më shumë të të sulmojë e shajë dikush, dije se aq më i rrëzikshëm je për të e po aq më i dobishëm për vendin tend!**

16. **Bujqësia** kish arritur tashmë të pajisej, sado jo mjaftueshëm, me mjete të mekanizuar. Në çdo rreth funksiononin SMT-të (Stacionet e Makinavet dhe Traktorëvet), si dhe qendrat e furnizimit me farëra të zgjedhura, me fidanë dhe me pesticide e herbicide. Ishin hapur gjithandej kanale ujitës, që nga më të mëdhenjtë, (Vjosë-Levan-Fier, 32 km i gjatë, "***Naum Panxhi***", 30 km, Peqin-Kavajë, 24 km, Milot-Thumanë-Krujë, 24 km, Mat-Lezhë, 16 km, Kanali i Penkovës, 18 km, në Fushë të Korçës, 34 km), deri te të kategorisë II e III, që arrinin gjithsej 20 mijë km. Ishin ndërtuar mbi 600 Ujëmbledhës të kapacitetevet të ndryshëm. Krejt toka e këtij shteti ishte përrallërisht e zbukuruar. Asnjë shqiptar me shpirt patrioti nuk mund të mos ndiente kënaqësi nga një e tillë pamje. Ndërmarrjet bujqësore, ato më të rëndësishmet, ishin: NB në Plasë, NB në Lukovë, NB në Lushnjë, NB në Maliq, NB në Sukth, NB në Kamëz.

Blegtoria po kështu po trajtohej, ose të paktën po punohej për t'u trajtuar në mënyrë bashkëkohore. Qenë krijuar ferma lopësh të racës pranë të gjitha ekonomivet bujqësore. Mirëpo, pikërisht ky sektor, **sektori i blegtorisë, ishte i pari që i dha shenjat se në sistemin komunist, në atë që quhej socializëm "paradhoma" e komunizmit, diçka nuk shkonte.**

Për të parë se si u rrit **industria** në **Epokën e Enver Hoxhës**, e kemi më të lehtë të shfletojmë Fjalorin Enciklopedik Shqiptar të asaj kohe. Në vitin 1912 krejt Shqipëria kishte vetëm 33 ndërmarrje të vogla prodhimi. Në vitin 1929, pjesa "***londrase***", tashmë mbretëri, kish 151 ndërmarrje e punishte industriale me kapital shqiptar dhe 10 ndërmarrje minerare me kapital të huaj. Në të 151 aktivitetet industrialë të këtij vendi bënin pjesë: 57 fabrika e mullinj mielli, 24 sharra mekanike, 15 fabrika vaji e sapuni, 14 shtypshkronja, 9 fabrika duhani dhe 4 centrale elektrikë. Nga 1920-a deri më 1938-n në territorin e shtetit shqiptar, më vonë mbretëri, u themeluan: STAMLES (Shoqëria Tregtare Anonime për Monopolin e Letravet dhe të Shkrepësevet), SAIDE (Shoqëria Anonime Industriale e Duhanevet, Elbasan), SITA (Shoqëria Industriale Tregtare Shqiptare), SESA (Shoqëria Elektrike Shqiptare Anonime) dhe Shoqëria e Përgjithshme Elektrike e Korçës.

Nga viti 1945 deri në vitin 1984 industria në RPSSH është rritur 164 herë. Sikur vetëm te kjo shifër të ndalemi, do të ish e mjaftueshme që koha kur udhëhoqi (disa thonë: sundoi) **Enver Hoxha** të cilësohej ***EPOKË*** me shkronja të madha. Madje Epokë Heroike, Epokë e Lavdshme, Epokë kur një popull i tërë jetoi me **privacione**, me të vetmin qëllim, pra, me të vetmin qëllim, që brezat pasues të mos hiqnin keq siç kishin hequr brezat e mëparshëm. Kush e njeh historinë, e di mirë se ç'kanë hequr, ndër shekuj, dhjetëra breza të Kombit tonë.

U zhvillua një shumicë degësh të industrisë. Disa, madje e shumta, ia nisën nga e para. Që të gjitha ato që kishin ekzistuar më parë, o kishin qenë të nivelit të artizanatit, ose sasiorisht të papërfillshme. Ne po i renditim këtu **disa nga industritë që morën zhvillim në Epokën e Enverit**, sepse lexuesit që nuk e kanë parë RPSSH-në e asaj kohe, kanë nevojë t'i përfytyrojnë ato edhe konkretisht: Industria **e kromit**, eindustria **e çimentos**, industria **e naftës**, industria **e gomës**, industria **e lëndëvet plastike**, industria **e qelqit**, industria **e qymyrgurit**, industria **e sheqerit**, industria **kimike**, industria **elektronike,** industria **e bakrit**, industria **e hekur-nikelit**, industria **e konservavet**, industria **e alkoolit**, industria **e blojës**, industria **e drurit**, industria **e mobiljevet**, industria **e duhanit**, industria **e letrës** dhe **e shtypshkrimit**, industria **e lëkurëvet** dhe **e këpucëvet**, industria **e materialevet të ndërtimit**, industria **e mishit**, industria **e qumështit**, industria **e yndyrnavet**, industria **e qeramikës**, industria **e sapunit**, industria

e vajravet, industria **e birrës**, industria **e verës**, industria **e rakisë** dhe **e konjakut**, industria **e tekstilevet**, industria **e veshjevet**.

Kur shikojmë, me sytë e kujtesës sonë, punishtet, fabrikat, uzinat, kombinatet, ndërmarrjet, nga më të ndryshmet, vendosur në një shtet me sipërfaqe as 30 mijë km katrorë, fitohet përshtypja e një vendi të zhvilluar industrial. Dhe e vërteta është që RPSSH (Nuk them Shqipëria, sepse Shqipëria është nja njëherë e gjysmë më e madhe se RPSSH.), në fillim të vitevet 1980, kish hyrë tashmë në fazën e një vendi industrial të zhvilluar.

Në rreth të Matit, ku shërbeja unë si mësues, kishim uzinën e ferrokromit, në **Burrel**, dhe 2 fabrika (impiante) të pasurimit të kromit, në Klos e në Krastë. Ishin 2 hidrocentrale të mëdhenj, një park automobilash, kryesisht kamiona, 2 ndërmarrje ndërtimi, dhe, në krahun lindor e juglindor, një numër minierash shumë të pasura me krom: Krastë, Thekën, Batër, Cërujë, Shkallë, Majëdren.

Në **Tiranë**, industria përfaqësohej nga një rresht i gjatë veprash: Kombinati i autotraktorëvet, uzina mekanike ***"Dinamo"***, kombinati i materialevet të ndërtimit "***Josif Pashko***", kombinati i përpunimit të mishit e qumështit, fabrka e këpucëvet, uzina e instrumentëvet abrazivë, uzina e pajisjevet për postë e telekomunikacion, uzina elektromjekësore, uzina mekanike "***Enver***", uzina mekanike e gjeologjike, uzina mekanike për pajisje shtëpiake ***"Partizani"***, kombinati i drurit "***Misto Mame***", kombinati i tekstilevet "***J.V.Stalin***", kombinati i tullavet, kombinati ushqimor "***Ali Këlmendi***", ndërmarrja e ndërtimit "***21 Dhjetori***", ndërmarrja e prodhimevet artistikë "***Migjeni***", ndërmarja e prodhimit të ilaçevet "**Profarma**", miniera e Valiasit, miniera e Mëzezit, hidrocentrali "***V.I.Lenin***".

Në **Shkodër,** industria përfaqësohej me uzinën e telavet dhe kabllovet elektrikë, me uzinën mekanike "***Drini***", me fabrikën e pëlhuravet, me uzinën mekanike "***Manush Alimani***", me industrinë e letrës, me industrinë elektrike, me hidrocentralin e Vaut të Dejës.

Në **Vlorë** qenë ndërtuar: fabrika e çimentos, fabrika e llambavet elektrike, uzina e sodës dhe PVC-së, kombinati i konservavet "***Ernest Telman***", hidrocentrali i Smokthinës, kriporet, miniera e Selenicës.

Në **Korçë** ishin: fabrika e lëkurëvet dhe e këpucëvet, UIK-u (Uzina e Instrumentevet "***Petro Papi***"), UMB (Uzina Mekanike Bujqësore),

kombinati i trikotazhevet "***Drapër e Çekan***", 2 termoelektrocentrale, 14 hidrocentrale të vegjël, fabrika e miellit, fabrika e makaronavet, fabrika e birrës dhe e konjakut, fabrika e konservavet, fabrika e tullavet, fabrika e qelqit, fabrika e fajancës.

Në **Maliq** u bë kombinati i sheqerit.

Durrësi, veç portit dhe kantierit detar, që ishin promotorë të zhvillimit tërësor ekonomik, kishte fabrikën e cigarevet "**Telat Noga**", vazhduese e së dikurshmes ***STAMLES***, fabrikën e gomës "***Kozma Nushi***", URT (Uzinën e Radiovet dhe Televizorëvet), UMB (Uzinën Mekanike Bujqësore), industrinë kimike, industrinë e mobiljevet, ofiçinën hekurudhore ku prodhoheshin vagonë treni, kantinën e verës "***Gjergj Kastrioti***", industrinë e peshkut.

Në **Kavajë** u bënë: fabrika e qelqit dhe e xhamit, uzina e gozhdëvet dhe bulonavet. Në **Elbasan** u ndërtua kombinati i madh metalurgjik "***Çeliku i Partisë***", kombinati i drurit "***Nako Spiru***". Në **Lezhë:** fabrika e letrës, në **Kukës**: uzina e bakrit, edhe në **Rubik**, uzina e bakrit, në **Lushnjë**, uzina e lëndëvet plastike, në **Ballsh,** uzina e përpunimit të thellë të naftës, në **Berat**, uzina e pjesëvet të ndërrimit për industrinë tekstile, kombinati i madh i tekstilevet, në **Fier**, uzina e prodhimevet të azotuar, në **Laç**, uzina e superfosfatit dhe kombinati i prodhimit të bakrit blistër, në **Patos**, uzina mekanike e naftës, edhe në **Qytetin Stalin (Kuçovë)**, uzina mekanike e naftës, në **Gjirokastër**, prapë uzina mekanike, në **Fushë-Arrëz**, stabilimentet e përpunimit të drurit.

Me gjithë të metat që shiheshin e që më trembnin, kisha shpresën që Kombi im, më në fund, po dilte nga prapambetja. Edhe jashtë kufijvet të RPSSH-së, në territorin e Shqipërisë, po ndërtoheshin disa degë dhe disa vepra të industrisë, por fitimin prej tyre e shfrytëzonin sunduesit e huaj, sllavë edhe grekë. Nuk kish gjë më të natyrshme për një shqiptar, të çfarëdo shkalle arsimore e kulturore, se sa të dëshironte zhvillim edhe më të madh **të kësaj pjese të Shqipërisë**, që ishte e lirë, dhe çlirim **të pjesëvet të tjera**, në mënyrë që edhe ato të njihnin të njëjtin zhvillim.

Por shqiptarët nuk u treguan seriozë dhe largpamës. Edhe para se të vdiste **Enveri**, një shumicë nesh, siç u pa, nuk ishim sa duhej të kujdesshëm. Por sidomos, sapo e humbëm **Enverin**, mbetëm si peshku në zall. Peshk gjysmë

i ngordhur, të cilit mund t'ia nxirnin sytë dhe t'ia hapnin brinjët lloj-lloj korbash. Viti 1990 më ngjau me vitin 1939.

Sot mund të thuhen shumë gjëra kundër **Enver Hoxhës** dhe kundër **Epokës së Enver Hoxhës**. Mund të botohen libra, mund të krijohen filma, mund të thuhen (numërohen) disa të vërteta, por edhe mund të shpifet apo të shtrembërohen të vërtetat. Ai që e shan **Enverin**, është i lavdëruar, ai që e lëvdon **Enverin**, ai që e lëvdon **Epokën e Enverit**, stigmatizohet ose thjeshtë tallet, vihet në lojë dhe, naivëvet, atyre që s'dinë të mendojnë me kokën e vet, s'u mbetet tjetër, veçse të qeshin edhe ata.

Sot është më lehtë të flasësh kundër **Enver Hoxhës**, qoftë edhe duke gënjyer, se sa të thuash të vërtetën. Megjithatë, shqiptarët seriozë dhe të mençur, duhet t'ia bëjnë vetes këtë pyetje: ***Kujt i intereson që vetë ne shqiptarët të flasim kundë Enver Hoxhës?!***

17.Arsye për t'u ndjerë mirë dhe për të shpresuar, kishte, por arsye për të qenë i shqetësuar dhe për të parashikuar rrënimin, kish edhe më shumë.

Arsimi ish falas dhe i detyrueshëm, mjekësia ish falas, taksa direkte nuk kishte, por pagesat, rrogat mujore, nuk po rriteshin dhe, duke qenë se edhe kërkesat sa vinte e po shtoheshin, të ardhurat familjare po bëheshin përherë e më të mangëta. Njerëzit, të infektuar tashmë nga një **kompleks kërkesash**, filluan ta ndiejnë veten **kreditorë** ndaj shoqërisë, jo **debitorë,** jo **borxhli** ndaj Atdheut. Pra, filluan ta ndiejnë veten të pakënaqur. Po cilat ishin arsyet që njerëzit filluan ta ndiejnë veten të pakënaqur? Për mua, "***arsyet***" ishin të paarsyeshme. Njerëzit donin të punonin sa më pak, por kërkonin ose dëshironin të merrnin më shumë. Njerëzit dëshironin, aspironin të shpenzonin më shumë se ç'merrnin. Ata madje ngushtoheshin, vuanin, që nuk po kishin para për të blerë gjëra dhe nuk vuanin aspak për punët që i kishin lënë pa kryer. Me një të tillë mënyrë të menduari e të vepruari, kuptohet që të ardhurat nuk mund të rriteshin. Kur të ardhurat nuk po rriteshin, ata e pakësonin të punuarit edhe më. Punonin përditë e më pak, ose me hope, kur shtohej presioni nga lart. Erdhi një kohë kur u bë i pranishëm sllogani: "***Ne bëjmë sikur punojmë, shteti bën sikur na paguan***".

Ish krijuar në atë mënyrë një kontradiktë absurde. Pjesa e shtetasvet që drejtonin punët, pra punadministruesit, s'kishin asgjë të vetën. Kishin vetëm rrogën dhe detyrën për të administruar. Te ata lindi **kompleksi i meritavet**: Ne po drejtojmë punët e shtetit. Ne po e mbajmë shtetin më këmbë e po

jetojmë "***si mos më keq***". Punëbërësit, punëtorët dhe fshatarët, e ndienin veten si çdo mëditës. Ata e përfytyronin shtetin si pronar. Thuhej: "***Pushteti i klasës punëtore, diktatura e proletariatit***". Por kjo s'bënte kurrfarë efekti. Punëtorët nuk po e provonin dot në praktikë se ishin vërtet në pushtet. **Enveri** tha që punëtorët tashmë ishin pronarët e krejt pasurisë së këtij shteti. Por punëbërësit anembanë këtij shteti vazhdonin të ndjeheshin mëditës, jo pronarë.

Nga bota kapitaliste vinin sinjalet e një "***lumturie përrallore***". Atje ishte "***parajsa***". Atje rrogat e punëtorëvet ishin dhjetëra e deri qindra herë më të mëdha se këto tonat. Atje, në kapitalizëm, s'kish fare varfëri. Tregonin për ca njerëz të rëndomtë, që kishin arritur të shkojnë atje dhe ishin bërë milionerë, në mos miliarderë. Atje, pasuria rrinte sheshit. Lum kush kish fatin të jetonte atje. Të gjithë ata që kishin pronat e veta, i gëzonin ato prona. Dihej që në kapitalizëm kish edhe punëtorë, por ata merrnin rrogë disa herë më të madhe edhe se vetë anëtarët e Byrosë këtu në RPSSH. Edhe Kosova paraqitej si një "***parajsë***" e mirëfilltë. "***Lum ata që i bëri të lumtur Titoja!***" Unë që e njihja Kosovën, lemerisesha kur dëgjoja të këtilla broçkulla.

Atë Zef Pllumi e përshkruan një rast të tmerrshëm që lidhet pikërisht me të këtilla **fantazi** të njerëzvet që jetonin këtu.

Një familje shkodrane, burrë, grua dhe 1 foshnjë 6-muajshe, edhe 3 djem të rinj, "***po niseshin për liri***", me një sul, nëpër Liqenin e Shkodrës. Atë Zefi thotë: "***Kryesisht për vogëlushin andrrojshin lirinë***." Por foshnja fillon të qajë pikërisht në vendin ku mund t'i diktonin rojet e kufirit. I jati… (O zoti im i arsyes, i shpirtit dhe i moralit njerëzor!)… I jati ia rrëmbeu s'ëmës foshnjën nga gjiri dhe e hodhi në liqen. (F.323-324)

E gjeti "***lirinë***" shkodrani i verbër! Në vend që të ulte kurrizin dhe të punonte, qoftë edhe pastrues në një nga fabrikat apo punishtet e Atdheut të vet, kërkonte derdimeni "***lirinë***" në Jugosllavi! Në atë Jugosllavi, ku mbi 2 milionë bashkëkombësvet të tij u ishte mohuar e drejta, pra **liria**, më elementare, ajo e pasjes së një shteti të vet! Në atë Jugosllavi ku, pikërisht në ata vite, 1953-1954, s'kish mbetur burrë shqiptar pa u shtruar në dajak!

U përhap në atë mënyrë një nostalgji e heshtur dhe e mbushur me trishtim. Shumëkujt s'i hynin më në sy as tokat e zbukuruara, grunoret, vreshtat, plantacionet, as kombinatet, uzinat e fabrikat, as hidriocentralet. Unë kam përshtypjen që, edhe sikur rrogat, të ardhurat mujore, të ishin 2 apo 3-fish

më të mëdha, njerëzit, të infektuar në këtë mënyrë, prapë nuk do të ndjeheshin të kënaqur.

Nostalgjia për atë "***botë përrallore***", e cila gjendej sapo ta kapërceje kufirin, shprehej në zgjatjen e flokëvet, në shkurtimin e fundevet e të fustanevet, në pantallonat kauboj me këmbëza në formë kambane dhe me rripa të gjërë, zbukuruar me kopsa të ndritshme. Asnjë punë nuk do t'i prishnin komunizmit as flokët e zgjatur të djemvet, as minifundet, as pantallonat kauboj. Por fryma ishte e qartë: **Ata të rinj nuk e donin komunizmin**.

Lindi ashtu një lloj kundërshtimi i ashpër nga krahu, i cili, ose nuk donte të dështonte komunizmi, ose i shikonte gjërat si kalë karroce. Nxënësit nuk lejoheshin në klasë me flokë të zgjatur. Quheshin qafëleshë. Quheshin gagarelë.

Nëse do të lejoheshin këto shfaqje që quheshin ***të huaja***, pra, këta sinjale të kapitalizmit, çfarë do të kërkonin më tutje këta ithtarë të asaj bote, kundër së cilës kish luftuar e sakrifikuar një brez i tërë, brezi i prindërvet të tyre? Do të kërkonin ose do të binin pre e kurthevet. Kurthe, të cilët në vazhdim nuk do të ishin të parrëzikshëm. Përkundrazi, ata do të ishin më shumë se të rrëzikshëm, sidomos për pjesën tonë më naive: Bixhozi, lojërat e fatit, bastet, eksperimentet paramartesorë (e quajtura "***bashkëjetesë"***), prostitucioni, homoseksualizmi, droga, sida. Kjo do të ishte rruga, të cilën nuk e kishin zgjedhur me vetëdije, por në të cilën detyrimisht do të ecnin një pjesë e madhe e këtyre mospranuesve të jetesës në komunizëm.

18.Degradimin e shkaktuan intelektualët. Jo aq inteligjenca teknike e shkencore, sa inteligjenca partiake dhe ajo administrative. Ajo, duke i rrumbullakosur gjërat, duke i skematizuar, duke u justifikuar, me manovra që vetëm kasta e të shkolluarvet di t'i bëjë, krijoi brenda vetes dhe rreth vetes një klimë pakënaqësie. Kasta e të shkolluarvet, e cila gjatë gjithë shkollimit është "***stërvitur***" për të marrë notën me qindra marifete, përjashtuar "***marifetin***" e diturisë së mirëfilltë. (Sigurisht, falë edhe sistemit shkollor, jo vetëm kombëtar, por edhe botëror, më se të papërshtatshëm për kohën që erdhi.) **Të tillë, më mirë të themi, kuaziintelektualë, justifikoheshin dinakërisht për çdo mosrealizim**. Kur bëheshin analiza, të cilat ishin shumë të shpeshta, ata nuk mendonin si ta përmirësonin **realisht** gjendjen, por si t'u rrëshqisnin kritikavet. Nuk ndëshkohej asnjë shkaktar i mirëfilltë i mosrealizimevet. (Zakonisht arrestohej ndonjë i pazoti **në zanatin e të dredhuarit**, ndonjë budalla që i binte drejt e që fliste vend e pa

vend.) Edhe kur rezultatet ishin skandalozë dhe kur ndonjë drejtues duhej të shkarkohej doemos, ai çohej, prapë drejtues, në një sektor tjetër. Psh nga komiteti i Partisë në komitet ekzekutiv ose nga SMT-ja në ndonjë ndërmarrje bujqësore.

Fshatarësia kooperativiste qe ajo që e paralajmëroi e para shkatërrimin. Fshatarët nuk dolën as në demonstrata, as hodhën parulla antiparti, as bënë ndonjë marrëveshje komplotuese. Ata, thjeshtë, fare thjeshtë, zhvilluan një grevë shumëvjeçare të pashpallur. Nuk qe grevë e organizuar. Qe grevë spontane, e cila lindi në rethanat e 2 faktorëve: të pagesës shumë të ulët, që vinte gjithnjë duke u ulur, dhe të gjendjes, ndonëse të pakënaqur, gjithsesi të durueshme, sepse, sidoqoftë, varfëria nuk qe aq e skajshme, sa dikush të vdiste nga uria. Kooperativistët mblidheshin dalëngadalë te vendi i punës, e fillonin punën, punonin nja 1 orë a diç më tepër, pastaj uleshin dhe rrinin 2 a 3 orë. Dikur, çohehin prapë, punonin 1 orë dhe prapë uleshin. Gratë mbanin me vete të quajturat punë dore. Thurnin çorape e pulovra, bënin dantella, tirnin lesh. Brigadieri ndërhynte herëpas'here duke thënë: "***Çohuni, more, se për vete e keni!***" Ky lloj "***greve***" zgjati disa vite. Në vend që të punohej, vidhej me të madhe. Zarzavatet, qumështi, frutat, misri, të gjitha shkonin nëpër shtëpira me trasta. Ndërkohë, fshatit iu hoqën të gjitha bagëtitë. (Më parë i qenë hequr 3000 m² tokë bujqësore.) U tufëzuan lopët. U ndalua mbajtja e derravet në oborrin e familjes. U arrit deri atje, sa të ndaloheshin edhe pulat e oborrit familjar. "***Teoricienët***" dhe propaganduesit thoshin që: pulat private, kecat privatë, qepët e njoma private, majdanozi privat, mund ta rikthenin kapitalizmin. Në të njëjtën kohë, **PARAJA** që jepej në formë rroge, ishte tërësisht **PRIVATE**. Asnjë nga "***teoricienët***" nuk kërkonte ta "***hiqte***" apo ta tjetërsonte paranë. Madje as studime nuk bëheshin lidhur me paranë, për të cilën Karl Marksi kish botuar disa vëllime. Unë e pata paraqitur një ekstrat studimi, u bë një konsultë, por vura re që dijetarët tanë ekonomistë as që ia kishin haberin asaj pune. Për qepët e për majdanozin po, ishin dakord që të mos u lejoheshin fshatarëvet, sepse ato "***sillnin pashmangshëm***" kapitalizmin.

Në sektorin shtetëror çdo gjë realizohej "***me të shtyrë***", me direktiva nga lart, me analiza pas analizash. Por edhe atje vërehej MOSPUNA në formë latente. Erdhi një kohë kur **MOSPUNA PAGUHEJ SIKUR TË ISHTE PUNË**. Kish vjedhje sidomos atje ku prodhoheshin artikuj që mund t'u hynin në punë njerëzvet pa përpunim të mëtejshëm: Vaj, biskota, sallam, sheqer, bonbona, bukë, oriz, gota, thika, pirunj, lugë, çorape, kanotiere, këmisha, peshqirë, cigare, verë, raki. Pak sot e pak nesër, me metoda të

"***sofistikuara***" dhe pa ndërprerje. Cilësia e prodhimit ra aq poshtë sa mezi prodhohej një shkrepëse. Shkrepëset tona ishin më të dobëtat në botë. U tentua të prodhoheshin biçikleta. U ble patenta në Kinë, por prodhimi i saj hasi në 1000 pengesa. Deri edhe sistemi i ambalazhimit për mallrat ishte për turpin e dynjasë. Kjo nuk ndodhte, sepse njerëzit tanë ishin të pazotë, por sepse kish humbur çdo dëshirë për punë. Njeriu duhet ta dojë punën që bën. Duhet të jesh: punëdashës, atdhedashës, njeridashës… Pikërisht të këtillë punëdashësvet, atdhedashësvet dhe njeridashësvet, që nuk ishin të pakët në Shqipëri, po u zihej fryma dalëngadalë.

Por në sistemin tonë, që quhej socialist, paga ish e njëjtë ose e përafërt, si për atë që punonte, ashtu edhe për atë që neglizhonte. Madje vetë **Enveri**, duke menduar se kështu po e pengonte rindarjen në klasa, pat dhënë udhëzime që "***gërshëra të vijë duke u mbyllur***". Kjo do të thoshte: Rrogat e larta do të vinin duke u ulur, rrogat e ulëta do të vinin duke u rritur. Ky lloj barazimi në paga e dobësoi shumë motivimin për punë.

Enver Hoxha këtu e kish gabim.

19.Ka shumë të dhëna që **Enver Hoxha** ishte i shqetësuar për fatet e komunizmit në shtetin e tij. Ai e shfaqte këtë shqetësim tërthorazi në fjalimet që mbante me raste të ndryshëm. Kërkonte rrugë për ta ndryshuar gjendjen. Por teoria e deriatëhershme nuk jepte kurrfarë shpjegimesh për këtë fazë të komunizmit. Para **Enverit**, një varg udhëheqësish të tjerë, pasi kishin parë që komunizmi nuk po ecte, kishin zgjedhur gjithfarë rrugësh, por, që të gjithë s'kishin bërë tjetër, veçse ishin rikthyer në kapitalizëm. Disa e kishin bërë këtë punë në mënyrë cinike. Psh Titoja. Mao Ce Duni ish treguar i kujdesshëm, duke mos e çrrënjosur plotësisht pronën private. Kjo duket se i dha Kinës mundësi për t'u rikthyer në kapitalizëm me formën e rishtresëzimit. Edhe në Kinë u bënë prova, por të dhunshme, prandaj jo të pranueshme dhe ashtu u hoq dorë prej komunizmit, ta quajmë ***KLASIK***. Kina tani ka kaluar në një kapitalizëm mjaft të rrëzikshëm.

Enver Hoxha kish trashëguar, siç duket, nga vendlindja e tij, Gjirokastra, mentalitetin e të kursyerit. Ai ngulte këmbë te të kursyerit. Kërkonte të punohej shumë, "***me entuziazëm***", siç shprehej, dhe njëkohësisht të kursehej shumë, në mënyrë që vendi të mund të begatohej pa ndërprerje. Njëri nga gazetarët, dinak në natyrën e vet, botoi një shkrim ku kërkonte shtimin e dyqanevet në qytetin e Gjirokastrës. Siç duket, pat menduar që **Enveri**, meqë e donte shumë Gjirokastrën, do të mund „***të mashtrohej***" dhe do t'i

hapej ashtu rruga një tregtie më të zgjeruar në të gjithë vendin. Mirëpo, **Enveri** foli shumë ashpër kundër atij gazetari dhe madje me terma denigrues.

Për të nxitur vrullin në punë dhe shpirtin e kursimit, **Enver Hoxha** propagandoi disa personazhe të ngjashëm me Lej Fenin e Kinës. Një Fuat Çelë, një Alo Qose, një Athina Mile. Por nuk ish kjo rruga që do të mund ta shpëtonte komunizmin. Ashtu si nuk do të mund ta zhdukte varfërinë nga bota kapitaliste, madje as nga Kalkuta, një Nënë Terezë, ashtu nuk do të mund ta shtonte mirëqenien një Alo Qose apo një Fuat Çelë në botën komuniste. Le të bënte Alo Qosja, që ish brigadier në një brigadë kooperative, jo 300, por 600 ditëpunë, shembulli i tij kurrë më nuk do të mund ta rindizte shpirtin revolucionar, as te fshatarët, as te punëtorët. Duheshin të tjerë operacione për ta shëruar atë sistem shoqëror. Për ta shëruar, ose për ta braktisur përfundimisht, duke kërkuar, sigurisht, jo kapitalizmin ***klasik***, por një marrëveshje sociale jo **të greminshme, jo jetasgjësuese, por njerëzimshpëtuese**.

Komunizmi kish defekte të brendshëm, aq shumë sa ata mjaftonin për ta bërë të parealizueshëm. Komunizmi ish një nismë **pozitive**, e ngjashme me shumë nisma që i kish marrë njerëzimi në të gjitha kohët, herë këtu, herë aty, por që, fatkeqësisht, nuk kishin mundur të çoheshin deri në fund. Kështu as ky nuk do të mund të çohej kurrsesi atje ku e kish qëllimin.

Shoqëria njerëzore duhej të kërkonte PA TJETËR rrugë të reja.

20. Është akuzuar **Enver Hoxha** për **dënime me burgim dhe për vrasje të kundërshtarëvet dhe të bashkëpunotorëvet**. Është folur me mllef për burgjet, për kampet, për internimet.

Nuk është fjala për ata që u ka dhembur kurrizi. Ata mund të japin shumë elementë të së vërtetës dhe ata elementë doemos që u shërbejnë analizavet. Nuk është fjala as për ata që bëjnë sikur u ka dhembur kurrizi. Të tillë ka shumë, por ata nuk mund të japin as edhe 1 element nga ato që kanë ndodhur, le më të jenë të besueshëm në gjoja "***analizat***" e tyre.

Një person, totalisht i painformuar, del e shkruan nëpër gazeta: "***Korrupsioni është komunizëm i ri***". Totalisht i painformuar, që s'ia ka haberin komunizmit, ose totalisht i pamoralshëm, i cili përpiqet të mbulojë

pisëritë e kapitalizmit me akuza në tym, në hava, kundër komunizmit. (14 prill 2016)

Nuk është, pra, fjala as për ata që, para se të fillojnë të flasin apo të shkruajnë, mendojnë, sa para do të fitojnë prej asaj që thonë. Fjala është për analistë të mirëfilltë.

Janë akuzuar të gjithë prijatarët e komunizmit. Edhe Stalini, edhe Lenini. Është folur keq edhe për K.Marksin dhe F.Engelsin. Por ne po marrim si shembull **Enver Hoxhën**. Pyetja e parë shtrohet kështu: Pse ka vepruar në atë mënyrë **Enver Hoxha**? A sepse donte të pasurohej? Kjo bie poshtë menjëherë. **Enver Hoxha** nuk ka grumbulluar kurrfarë pasurie, nuk ka gëzuar kurrfarë pasurie dhe nuk ka lënë kurrfarë pasurie. Kur të quajturit analistë nuk kanë mundur ta ngarkojnë me një të këtillë mëkat, të cilin e kanë pasur dhe e kanë një shumicë sundimtarësh, janë përpjekur që t'i mveshin atij njëfarë **paranoje**. Paranoja është një lloj çrregullimi mendor progresiv, siç thuhet në mjekësi, që zhvillohet ngadalë dhe karakterizohet nga ideja e madhështisë, e persekutimit, e dyshimit, e ambicies etj. A është e vërtetë që **Enveri** vuante nga një e tillë sëmundje? Janë thënë të njëjtat gjëra edhe për Stalinin. Është trajtuar si i tillë edhe Çaushesku. Nëse do të kish pasur edhe 20 a 200 të tillë kryesues të shteteve komunistë, me siguri që, për që të gjithë do të thuhej e njëjta gjë.

Por historia ka nevojë për analiza shkencore. A nuk kish në të njëjtën kohë edhe në Greqinë kapitaliste kampe internimesh? Atje kundërshtarët e regjimit, madje shumica jo realisht kundërshtarë, por të cilësuar si të tillë, apo thjeshtë sepse ishin shqiptarë myslimanë dhe kundërshtonin të deportoheshin për në Turqi, çoheshin nëpër ishuj dhe mbaheshin atje me muaj apo me vite. Në Turqi kundërshtarët politikë çoheshin nga Stambolli në Kurdistan. Në Jugosllavi gjithashtu ka pasur kampe internimi. Shqiptarët e Kosovës internoheshin në Vojvodinë. Edhe në Itali e gjetkë nëpër Evropë, kish kampe grumbullimi për klandestnët. Në shumë vende kapitalistë ka edhe sot kampe klandestinësh. Pra, internimi, krijimi i kampevet, nuk ka qenë praktikë vetëm e **Enver Hoxhës**. Burgje ka pasur dhe ka në të gjithë vendet. Burgjet e Greqisë ishin plot me të burgosur politikë. Në ish-Jugosllavi të gjithë kombet i **kishin** "***përfaqësuesit***" nëpër burgje, por shqiptarët ishin më të shumtët. Shqiptarët kanë vuajtur në ish-Jugosllavi jo më pak e gjysmë milioni vite burg. (shih librin e Kolë Berishës "***Djajtë nuk flënë***".) **Enveri**, thuhet, dhe është e vërtetë, ka dënuar e ndëshkuar me ashpërsi, jo vetëm kundërshtarët origjinorë të regjimit, por edhe ish-

bashkëpunëtorët, madje të atillë bashkëpunëtorë që dikur i kish pasur shokë. Po cili sundimtar ose pretendent për sundimtar, aq më tepër diktator, nuk i eliminon kundërshtarët? Presidentët e SHBA-së kundërshtarët e vet, për t'i diskreditуar, i quanin "***komunistë"***, ky i quante ***"borgjezë" dhe "revizionistë"***. Nuk është qëllimi këtu për të justifikuar punët e këqia të **Enver Hoxhës**. Ato mbeten të këqia për cilindo. Qëllimi është që gjykimi të konvergojë drejt objektives. Sepse, fundja, cili ishte motivi që e shtynte **Enver Hoxhën** të vepronte ashtu? Motivi ishte: **Të qëndronte në pushtet, të mos rrëzohej nga pushteti, dhe, duke qëndruar në pushtet, të mund të realizonte vizionet e vet, projektet e vet.** Po cilët ishin projektet e **Enver Hoxhës**? Projektet e **Enver Hoxhës** ishin: **Shkollimi sa më masiv i shtetasvet të vet, shërbimi shëndetësor ndaj shtetasvet të vet sa më efikas, zhvillimi i një ekonomie socialiste, i një bujqësie sa më të përparuar, socialiste (se dihej ku e kish lënë bujqësinë shqiptare feudalizmi osman), i një industrie që të ecë me këmbët e veta, t'i sigurojë shtetit të vet një mbrojtje sa më të fortë.** Këta ishin projektet e **Enver Hoxhës: Projekte atdhedashës dhe projekte thellësisht humanë**. Askush nuk mund të thotë se ka pasur projekte të tjerë.

Problemi nuk qëndron te objekti, kundër të cilit flet njëri apo tjetri. Konkretisht, problemi nuk qëndron te një **Enver**, te një Stalin apo te krejt një sistem, të cilin ata u përpoqën ta ndërtojnë. Problemi qëndron te vetë këta të quajtur "***analistë***", "***shkencëtarë***" me tituj doktorësh e profesorësh, "***politikanë***", të cilët gjithë jetën thonë vetëm ç'u intereson atyre për të thënë. Si ai që e citova pak më lart: „***Korrupsioni është komunizëm i ri***". Në ç'drejtim po e çojnë opinionin këta kuazivlerësues, këta kuazianalistë? Ç'të mira apo të këqia i sjellin **KËTA** njerëzimit, sepse **ATA** e bënë punën e tyre dhe ikën! Perifrazuar me një shprehje të bukur popullore, problemi shtrohet kështu: Gomari, që njerëzimi u mundua ta përdorë në të mirë të vet, tashmë ka ngordhur. Po me mizat si t'ia bëjmë?! Mizat, që po e ndotin krejt ambientin rreth gomarit të ngordhur!

21.Duke pasur nëpër duar veprat e **Enver Hoxhës**, të cilat po botoheshin në vazhdimësi, duke lexuar e skeduar K.Marksin, F.Engelsin, V.I.Leninin, J.V.Stalinin, Mao Ce Dunin, duke pasur këtë literaturë në dispozicion, duke e studiuar e analizuar edhe realitetin në të cilin jetonim, për mua, si intelektual, ish krejt e natyrshme që të meditoja dhe të arrija në disa konkluzione. Nuk isha vetëm unë, por ish krejt populli e veçanërisht inteligjenca, ajo seriozja, që i kish ose mund t'i kish këta 2 burime në dispozicion: **Literaturën komuniste dhe përvojën konkrete**. Diskutohej në

mbledhjet e organizatavet, të quajtura organizata të masavet apo leva të Partisë, ***Bashkimet Profesionalë, Fronti Demokratik, Organizata e Rinisë, Organizata e Gruas***. Diskutohej në organizmat arsimorë, në organizmat shëndetësorë, në formacionet e ushtrisë, në dikasteret, në institucionet e specilizuar, deri në Komitetin Qendror. 1 herë në vit secila organizatë-bazë e PPSH-së jepte llogari përpara kolektivit, ku ajo militonte. Aty diskutohej mbi mënyrën si i kish zbatuar ajo organizatë-bazë direktivat e Partisë dhe si ishin reflektuar ato direktiva në jetën dhe punët e përditshme.

Kështu, secili banor i moshës madhore, veçanërisht secili intelektual, i mirëfilltë ose jo, mund ta nxirte një konkluzion dhe mund të shprehte mendimin e vet në të gjitha mbledhjet që bëheshin. Mund të shpreheshin mendimet, dhe ne ishim dëshmitarë, që shpreheshin gjithfarë mendimesh. Një pjesë e madhe e tyre ishin pa pikë vlere, një pjesë kishin vlerë, ishin racionalë, por nuk zbatoheshin dhe situata sa vinte dhe keqësohej.

Në vitet 1975-1982, duke jetuar në një të atillë mjedis dhe duke i kuptuar gjërat në mënyrën time, por seriozisht, unë arrita në përfundimin që **defektin kryesor e kish pikërisht Partia e Punës e Shqipërisë**.

Enver Hoxha po mundohej të gjente një rrugë për të ndërtuar një parti në përshtatje me kohën, në përshtatje me fazën e zhvillimit (apo stagnimit), ku ndodhej RPSSH, por ai nuk po arrinte ta ndërtonte një të tillë parti funksionale.

Rrugët e të gjitha partivet të tjera komuniste e ish-komuniste, socialiste dhe eurokomuniste, apo socialdemokrate të dikurshme, pavarësisht nga modusi, **ishin rrugë që çonin pësëri në kapitalizëm**.

Enver Hoxha nuk donte që RPSSH të kthehej as në kapitalizëm, as në feudalizëm, dhe arsyeja, për mendimin tim, ka qenë kjo: Në të gjitha kohët e shkuara Kombi ynë ka qenë i nëpërkëmbur dhe ai kish bindjen që, nëse do të ndodhte restaurimi, ky Komb kish për t'u nëpërkëmbur përsëri, ndoshta edhe më keq se dikur. Natyrisht, unë nuk e di saktësisht se ç'mendonte ai. Prandaj edhe thashë: ***Për mendimin tim***. Por fakt është se ai po mundohej ta ruante Partinë prej intelektualizmit, sëmundje antirevolucionare, e cila do të çonte pashmangshëm në restaurim. Për t'iu kundërvu intelektualizmit, **Enveri** dha rekomandimin që shumica e "***gjakut të ri***" në Parti të vinte nga klasa punëtore dhe nga fshatarësia. Për mua, që e shihja nga afër se çfarë po ndodhte në terren, kjo ishte një **rrugë e gabuar**, madje shkatërruese, dhe

prandaj i hyra punës për të bërë një studim dhe për të kërkuar një rrugë tjetër më të sigurtë.

Shkrova një libër, të cilin arrita ta përfundoj në vitin 1982. E daktilografova, i bëra një lidhje të bukur dhe ia adresova personalisht **Enver Hoxhës**. Nuk mora asnjë përgjigje.

Nuk po e mohoj që rrugëzgjidhja e propozuar në atë libër, ka qenë një utopi. Utopira për një shoqëri njerëzore më të mirë ka me shumicë. Por jam i sigurtë që, në rast se do të studiohej me vëmendje ajo utopi e imja, përfundimi më i afërmendshëm do të ishte ky: **Të kërkojmë një rrugë RACIONALE, në mos për të bërë komunizmin, të paktën për t'u rikthyer në një kapitalizëm të pranueshëm, pa e shkatërruar vendin.** Nuk u bënë, as njëra, as tjetra, dhe vendi u rrokullis atje ku tashmë e kemi parë dhe po e shohim të gjithë.

Unë do ta risjell këtu atë libër, me fare pak shkurtime dhe duke i shoqëruar pasazhet dhe kapitujt me vërejtjet e rastit, shikuar prej pikës ku ndodhemi sot. Besoj që nuk është pa interes për t'u lexuar, qoftë edhe me kuriozitetin e një… bibliofili.

PJESA E DYTË

Një libër që u shkrua në vetet 1975-1982
(Si kuptohet sot?)

Titulli i librit:

"NJË PJESË E KAPACITETEVET DUHET T'I KTHEHEN KLASËS ME ANË TË PRANIMEVET NË PARTI"

(f.1, 1982)

{Një titull më konkret mund të ishte ky:

“DONI TË BËNI KOMUNIZËM?! KOMUNIZMI BËHET KËSHTU!” 2012}

{ VO! Në të gjitha faqet që vijojnë, shënimet e vitit 2012, në dallim nga teksti i vitit 1982, që shkruhet me stilin Times New Roman dhe shoqërohet edhe me faqen dhe vitin përkatës, do të shkruhen me stilin Bookman Old Style. 2012}

Jam i vetëdijshëm se studimi e argumentimi duhej të ishin më të plotë, por një gjë e tillë do të mund të bëhet vetëm në të ardhshmen. Pothuaj për çdo problem që ngrihet aty dhe për çdo pohim që bëhet, është e nevojshme që të bëhen studime të veçantë. (f.5, 1982)

Megjithëse unë kam bindjen e plotë se teza që po parashtroj, është e drejtë, prapë ekziston mundësia që ajo të jetë e gabuar.

E para, praktika është kriteri i së vërtetës. (Tezë leniniste e njohur.) Pra, një teori duhet provuar, duhet vërtetuar në praktikë, pastaj do të mund të gjykohet përfundimisht për të.

E dyta, që unë të mund të isha shumë më i sigurtë në ato që them, duhej të kisha një bazë më të plotë mbështetëse… Duhej të kisha bërë jetë partie. Një gjë e tillë mua më ka munguar për shkaqe të kuptueshëm… Duhej të kisha mbaruar ***Shkollën e Lartë të Partisë*** “***V.I.Lenin***”. Edhe kjo më ka munguar… Në shërbim të mirëfilltë të temës, që ajo të ishte më e argumentuar, unë duhej të kisha studiuar me këtë synim një vëllim më të madh literature, si dhe një material të domosdoshëm statistikor e arkivor.

Pra, siç shihet, për të qenë teza plotësisht e argumentuar, mua më mungojnë disa nga elementët e rëndësishëm të bazës mbështetëse studimore. Së këndejmi, kushdo që t’i lexojë këta rreshta, ka mundësi të thotë: “***Të parashtrosh një mendim teorik në kushte të këtillë, ky është një gabim, në mos një aventurë.***”… Mirëpo unë mendoj se, ta thuash mendimin ashtu siç e ke, është më pak gabim se sa të mos e thuash atë fare… (f.6, 1982)

{Ky tekst hyrës duhet të jetë argument i mjaftueshëm për të treguar se unë, me gjithë mangësitë e tmerrshme që kisha, nuk mund të rrija pa folur. Nuk rrija dot pa folur, se isha

vërtet i shqetësuar. Isha i shqetësuar, jo aq për sistemin, sa për fatet e Kombit tim. Ashtu siç jam edhe sot. 2012}

Sot socializmi është më shumë se kurrë synim i masavet punonjëse në mbarë botën. Ai është bërë sot aq shumë synim i proletariatit dhe i të gjitha forcavet përparimtare të botës, sa me të drejtë është quajtur nga shoku Enver "***një problem i shtruar për zgjidhje***". (f.7, 1982)

{Në të vërtetë, në ata vite, masat punonjëse dhe forcat përparimtare, ose e kishin humbur atë synim, ose e kishin modifikuar apo tjetërsuar. Së dyti, problemi vërtet ish shtruar për zgjidhje, por në procesin e asaj zgjidhjeje nuk fitoi komunizmi. Përkundrazi, fitoi kapitalizmi. 2012}

Që socializmi është një synim i pandalshëm i njertëzimit, tregon veçanërisht fakti që vetë armiqtë e socializmit, borgjezët dhe fundërrinat e gjithfarshme e kanë më lehtë të maskohen me frazat e socializmit, sesa të dalin hapur kundër tij. Në këtë aspekt revizionistët u ngjajnë sundimtarëvet të dikurshëm të Romës që… e gjetën më me levërdi ta bënin të vetën fenë e Krishtit, sesa ta luftonin atë. Ylli i kuq sot në Moskë i ngjan shumë kryqit të kishës paleokristiane të vitit 313. (f.7, 1982)

{E thamë parë që socializmi tashmë nuk ishte synim. Me shprehjen "*fundërrinat e gjithfarshme*" mendohet kryesisht për pseudokomunistët, të cilët kishin mbushur radhët e partivet komuniste e punëtore. Mendimi im lidhur me ***Ediktin e Milanos*** të vitit 313, tashmë ka ndryshuar. Shën Konstantini ishte një vizionar i madh, i cili pa te feja e krishterë bartësin e Epokës së Re, në të cilën njerëzimi kish kohë që kishte hyrë. 2012}

Në të njëjtën kohë, dmth në po atë kohë kur socializmi është më shumë se kurrë synim i klasës punëtore dhe i aleatëvet të saj, është fakt i hidhur që ai (socializmi) ka triumfuar në fare pak vende të botës, bile në minimumin e mundshëm, … vetëm në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë. Kjo pa tjetër i ka bërë dhe i bën komunistët të mendojnë seriozisht për gjendjen. Klasa punëtore dhe komunistët duhet t'i tregojnë botës se socializmi nuk është një "***krishtërim***", që të mund ta përdorin klasat shfrytëzuese si t'u levërdisë atyre. Si duhet treguar kjo, që socializmi e komunizmi nuk janë një

"***krishtërim***"? Si mund t'u hiqet përgjithmonë mundësia lloj-lloj shfrytëzuesve për t'u maskuar nën emrin e komunistit? Kjo është çështja e cila duhet zgjidhur si në teori edhe në praktikë. (f.7, 1982)

{Vazhdon gabimi im në lidhje me synimin. Pohimi që në vendin tonë kish "***triumfuar***" socializmi, nuk është i vërtetë. Por thirrja për t'u menduar e thelluar në këtë pikë nuk është e kotë. Krahasimi me krishtërimin mendoj se është me vend. Të gjitha partitë socialiste, socialdemokrate e komuniste, të sotmet, u ngjajnë shumë keqpërdoruesvet të krishtërimit të të gjitha kohëve, deri te peshkopët e sotëm pedofilë, deri te Amfillohijet e sotëm, deri te peshkopi Janullatos dhe mijëra të tjerë gjoja "***të krishterë***". 2013}

Ndoshta në planin krahasues do të mund të meditohej edhe kështu: Skllavopronarët e shekullit IV u detyruan të bëjnë kompromis me idenë antiskllavopronare të krishtërimit. Kolapsi, ku kishte hyrë shoqëria e atëhershme, i detyroi skllavopronarët ta pranojnë parimin themelor të krishtërimit se ***të gjithë njerëzit janë të barabartë para Zotit***. Kolapsi, ku ka hyrë shoqëria e sotme njerëzore, duhet ta detyrojë plutokracinë, ose t'i pranojë parimet kryesorë të komunizmit, nëpërmjet një religjioni gjithbotëror, të zhveshur nga misticizmi, ose të ngrejë duart para vetëshkatërrimit dhe vetasgjësimit, vetëshkatërrim dhe vetasgjësim me "***ndihmën***" e 3 lloje armësh që vetë plutokracia i ka shpikur e krijuar: armë bërthamore, armë kimike dhe armë biologjike, ndihmuar efektivisht prej kibernetikës.

Parimi i analizavet të revoucionevet buron nga kuptimi dialektik i tyre. Marksi, Engelsi, Lenini e Stalini, i kanë bërë analiza të hollësishme ***Komunës së Parisit*** dhe kanë zbuluar me saktësi shkaqet e dështimit të saj. Nuk ka aspak dyshim se ato analiza i shërbyen shumë ***Revolucionit të Tetorit*** dhe e dhanë edhe ato ndihmesën e vet në faktin që pushteti i punëtorëvet këtë herë nuk zgjati 71 ditë, por më se 36 vjet.

Por një gjë duhet të mbahet parasysh: Çdo analizë duhet të jetë e saktë, qoftë analiza e një pike gjaku, jo më analiza e një revolucioni. Prandaj unë jam i mendimit se është detyrë e madhe e kohës sonë që, përmbysjes së pushtetit të punëtorëvet në Bashkimin Sovjetik duhet t'i bëhen analiza të sakta, duke marrë shembull për këtë klasikët e Marksizëm-leninizmit mbi Komunën e

Parisit. Në këto analiza, them unë, thelbësore është kjo: **Nuk duhen parë vetëm ato punë që bënë armiqtë, por duhen parë sidomos gabimet e klasës punëtore që ishte në pushtet, të organevet të saj të pushtetit, të organizatavet të saja, të bazës dhe superstrukturës e në mënyrë të veçantë të Partisë Bolshevike.**

Ato që kanë bërë armiqtë, duhen analizuar dhe duhen njohur mirë, por kjo nuk do të ishte asnjëherë e mjaftueshme, në qoftë se nuk do të njiheshin lëshimet e gabimet që kanë bërë vetë forcat pozitive në atë ish-shtet punëtorësh.

Vetëm në këtë mënyrë përvoja e hidhur e Bashkimit Sovjetik do të mund t'i shërbejë revolucionit tonë dhe revolucionevet të tjerë për të mos rënë në greminën e **dështimit**. Vetëm në këtë mënyrë ne do të mund t'ia zgjatim jetën socializmit në Shqipëri… (f.8, 1982)

{40 vjet mbasi i kam shkruar këta rreshta, mendoj që, jo vetëm ish-komunistët duhej t'i kishin analizuar dështimet e tyre, por edhe studiuesit e kapitalizmit duhet t'u bëjnë analiza revolucionevet të sh XIX e XX, jo shabllon e me denigrime cinikë, por kthjellët dhe me seriozitetin më skrupuloz. Në shekujt e kaluar kjo punë bëhej më së miri. Në kohën tonë kjo nuk po bëhet aspak mirë. 2012}

Klasikët ia bënë analizat Komunës së Parisit, siç thuhet, "***të pamëshirshme***", por ata kurrë nuk hodhën baltë as mbi Komunën as mbi komunarët. Ata, sa më të "***pamëshirshëm***" tregoheshin në analizat e veta (shembull për këtë është K.Marksi), aq më lart i ngrinin komunarët dhe heroizmin e tyre.

Ky duhet të jetë edhe qëndrimi i të gjithë studiuesvet seriozë të ***Revolucionit të Tetorit***, të epokës së socializmit në Bashkimin Sovjetik dhe i të gjithë revolucionevet të tjerë. (f.9, 1982)

{Duke qenë se për këtë problem, për problemin e objektivitetit në studime, është folur më parë në këtë libër, unë nuk po e rishkruaj këtë pjesë. Qëndrimi im (dhe dua të besoj që nuk është vetëm imi), është i qartë: Në analiza duhet të jemi seriozë. Duhet ta njohim të vërtetën dhe ta themi të vërtetën. Nuk mund të mjaftohet historiografia botërore me ca

thashetheme në lidhje me një revolucion të përmasavet aq të mëdha dhe me udhëheqësit e atij revolucioni, të cilët kurrsesi nuk mund të ishin të vegjël. 2012)

Në Plenumin VIII të KQ të PPSH, viti 1980, është vënë në dukje me shumë forcë nevoja e studimevet në fushë të marksizëm-leninizmit. Po cekim këtu vetëm disa pasazhe nga ai plenum i PPSH-së.

"*Vendi ynë*," thotë shoku Ramiz Alia aty, f.46, "*ka hyrë tani në një fazë të tillë të zhvillimit socialist, kur shtrohen* ***shumë probleme të rinj*** *për t'u zgjidhur dhe për të cilët* ***mungon përvoja*** *e nevojshme. Në këto rrethana, përpara shkencavet tona shoqërore,* ***sot më tepër se kurrë****, shtrohet detyra që, duke u mbështetur në parimet e marksizëm-leninizmit dhe në përvojën e derisotme,* ***të zhvillojnë më tej mendimin krijues****, të përballojnë me kurajo e guxim problemet e mëdhenj që nxjerr jeta, të argumentojnë teorikisht perspektivat e zhvillimit tonë*."

Po aty, në f.46: "*Të përgjithësosh përvojën, nuk do të thotë të regjistrosh faktet e të përshkruash ngjarjet… ajo kërkon* ***të zbulosh ligjësitë*** *e procesit të zhvillimit,* ***të nxiren mësime e konkluzione për të sotmen e për të ardhmen***."

Ndërsa pak më tutje, në f.47, shoku Ramiz Alia thotë: "*studimet është e nevojshme të përqëndrohen* ***veçanërisht në çështjet themelore****…* ***Objekt i studimevet shkencorë duhet të bëhen proceset e zhvillimit të sotëm të revolucionit socialist.***" (Theksimet e fjalëvet janë bërë nga Gj.D.) (f.10, 1982)

{Kisha 5 vjet që i pata kuptuar pikërisht këto që po thoshte Ramiz Alia në vitin 1980. Kisha 5 vjet që studioja dhe përpiqesha, shumë sinqerisht, që **të zbuloja** diçka nga **ligjësitë** dhe **të nxirja konkluzione veçanërisht për çështjet themelore**. Pikërisht ashtu siç thuhej në atë plenum.

Veç kësaj, një tjetër arsye që e citova Ramizin, ishte, se tashmë të gjithë po e kuptonim që ai do të bëhej zëvendësuesi i Enver Hoxhës. Mirëpo, koha tregoi që Ramiz Alia as që kish ndërmend **të nxirte mësime e konkluzione "*për të sotmen e për të ardhmen*"**. Ai praktikisht e lëshoi Atdheun tonë tërësisht në duart e anarkisë.

Ramiz Alia u bë fajtor, jo se e lejoi restaurimin e kapitalizmit në Republikën e Shqipërisë (restaurimi gjithsesi do të bëhej), por sepse nuk inicioi, nuk nismoi, **studimin e mënyravet, si duhej bërë kjo punë**. Unë, që jetoja në një provincë dhe që s'kisha asgjë në dorë, përveç një regjistri nxënësish, në librin tim e pata përdorur më se 10 herë fjalën **dështim**. (Dhe ia kisha çuar Komitetit Qendror atë libër.) A ish e mundur që Ramiz Alia, në krye të atij Komiteti Qendror, të mos e kish kuptuar **dështimin**? Të ish Enveri gjallë, do të kishim thënë të njëjtën gjë për Enverin. Por ai kish 5 vjet që kish vdekur dhe, disa vite më parë, siç është dëshmuar tashmë, kish vuajtur nga sëmudje të rënda. Kështu që, përgjegjësia kryesore historike bie, jo mbi Enver Hoxhën, por mbi Ramiz Alinë. Përgjegjësia, pse nuk u bë restaurimi i kapitalizmit pa dëmet e pa shkatërrimet që i pësoi Republika e Shqipërisë pas vitevet 1990. 2012}

Partia është **vepër subjektive**. Ajo krijohet nga njerëzit, organizohet nga njerëzit, jeton në saje të veprimtarisë së ndërgjegjshme të njerëzvet. Ajo është vepër **subjektive**, por, njëkohësisht, është vepër që krijohet në një rrethanë ose tok rrethanash **objektive**. Pikërisht nga lidhja, mendoj unë, midis realitetit objektiv dhe veprimit subjektiv lind jetëgjatësia ose jetëshkurtësia, thënë ndryshe, cilësia e mirë ose e dobët e një partie. Realiteti objektiv është domosdoshmëri, por është domosdoshmëri edhe trajtimi subjektiv i këtij realiteti, për të arritur në një kualitet të ri të dëshiruar. Lumi mund të rrjedhë 100 mijë vjet në shtratin e tij, por, që ai të japë dritë, duhet veprimi vendimtar i klasës punëtore, i inxhinierëvet të ditur, duhet veprimtaria e një populli të tërë, të organizuar e të udhëhequr nga dikush.

Realiteti **objektiv** për kryerjen dhe zhvillimin e revolucionit socialist ka ekzistuar prej kohësh në shumë vende. Bile, është krijuar në një varg vendesh, para se të krijohej në Shqipëri. Mirëpo, **veprimi subjektiv** mbi këtë realitet ka qenë i ndryshëm në vende të ndryshëm. Analiza historike e secilit vend do të na i jepte të dhënat një për një… dhe atëherë ne do të shihnim se, po të kish pasur një varg veprimesh subjektivë, të studiuar e të zbatuar shkencërisht, shumica e vendevet, në mos krejt vendet e botës, sot do të ishin socialistë.

Nga e gjithë kjo, unë vij në këtë përfundim: Kushtet objektivë për zhvillimin e revolucionit në vendin tonë, u krijuan në vitet 40 të këtij shekulli. Këto i shfrytëzuan dhe i trajtuan me mjeshtërinë e duhur subjekte të caktuar, njerëz revolucionarë, bij të klasës punëtore e të masavet të tjera të popullit tonë, të shtypur e të shumëvuajtur, njerëz të qartë ideologjikisht, të shkathtë në politikë, patriotë, të vendosur për të punuar e për të shkrirë jetën në të mirë të Atdheut. Kjo ishte dhe është Partia jonë. Në krye të kësaj Partie **Enver Hoxha është njeriu që ka meritën e jashtzakonshme** për të gjitha fitoret që ka arritur ky vend.

Ky është, pra, shkaku kryesor që Partia jonë ruajti vijën e saj marksiste-leniniste dhe që socializmi në RPSSH mbijetoi: **Lidhja e mirë midis realitetit objektiv dhe veprimit subjektiv**. Na takon nderi të pohojmë me krenari ne shqiptarëvet se, me t'u krijuar kushtet objektivë për socializëm, bijtë e këtij vendi u gjendën gati për t'i shfrytëzuar ata kushte. Kjo ne na mbush me besim se edhe në të ardhshmen nuk do të lejojmë të na ikë nga dora asnjë rrethanë objektive për ta çuar shoqërinë tonë përpara. Gjithashtu, ky veprim i madhërishëm i brezit që bëri Luftën, na ngarkon ne edhe me përgjegjësi të madhe.

Ç'duhet bërë që faktori subjektiv të jetë gjithnjë një mjeshtër i pagabueshëm në trajtimin e realitetit objektiv?

Për t'ia arritur këtij qëllimi, **Partia**, si një organizëm i gjallë, si një qenie sociale e një shkalle të lartë ndërgjegjeje, **duhet ta vërë veten gjithmonë në ca kushte të VETËDETYRIMIT**, në mënyrë që ajo të mos ketë mundësi të gabojë. Thënë ndryshe, me veprimin e saj **subjektiv**, partia duhet t'i krijojë vetes rrethana të tilla **objektive**, të cilat nuk do ta linin më vonë të shkojë në rrugë të shtrembër. Ndryshe çdo gjë mbetet në mëshirën e rastit, që, në kushtet e një presioni të madh të reaksionit, do të thotë: Çdo fitore vihet në rrëzik. Pikërisht **rrethanën e vetëdetyrimit** për të mos u gabuar **Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik nuk ia kishte krijuar vetes** në kohën kur duhej ta krijonte. Po kështu, mendoj unë, **as Partia jonë nuk ia ka krijuar vetes akoma një rrethanë të tillë të domosdoshme**, ndonëse, me masat që janë marrë mbas tradhtisë së hrushovianëvet, ajo ka hyrë në rrugën e mundësivet për ta bërë një gjë të tillë. (f.12, 1982)

{I gjithë ky arsyetim, i cili sot mund të duket i padobishëm, është bërë për të thënë në fund që **as në Partinë e Punës të Shqipërisë punët nuk ishin mirë**. Aty thuhet shkoqur: "***As***

Partia jonë nuk ia ka krijuar vetes një rrethanë të tillë të domosdoshme"* rrethanën e vetëdetyrimit**. Kuptohet që vetë Enver Hoxha nuk do ta ketë lexuar këtë libër, qoftë se në ata vite ai ishte i sëmurë, qoftë për shkak të punëvet të tjera. Të ish një letër 1 apo 2-faqëshe, edhe mund ta lexonte, sepse, siç thuhet, ai secilin mëngjes ia rezervonte leximit të letravet që i vinin nga populli. Mirëpo, me sa duket, as ndonjë nëpunës i atyshëm, nuk i ka hyrë punës për ta lexuar këtë libër. Kush do të lodhej me kësi problemesh, në një kohë kur njëra pjesë e njerëzvet mendonte se çdo gjë është e siguruar, "deri sa në krye kishim Enverin***", ndërsa pjesa tjetër mezi priste që Enveri të vdesë?! 2012}

Karl Marksi te "***Lufta civile në Francë***" ("***Mbi Kom. e Parist***", f.155), thotë: "***Të qëndrosh 3 muaj në pushtet, madje edhe në Paris, dhe të mos e përmbysësh botën, por të vdesësh nga paaftësia tënde…- a nuk tregon kjo se partia nuk ka gjallëri***?"

Këtë thënie të K.Marksit në kohën tonë mund ta perifrazojmë kështu: "***Të qëndrosh 36 vjet në pushtet, madje edhe në atdheun e Leninit e të Stalinit, në vendin e Revolucionit të Madh të Tetorit, dhe të mos e përmbysësh botën, por të vdesësh nga paaftësia tënde, a nuk tregon kjo se partia nuk e ruajti dot gjallërinë e duhur?***"

Natyrisht, tragjedinë e Bashkimit Sovjetik ne nuk do ta kuptojmë as si paaftësi të Stalinit apo të Leninit, sepse kjo nuk do të ishte e vërtetë, por mësime do të nxjerrim nga pësimi. Ajo tragjedi duhet pa tjetër të bëhet djepi i një hapi më tej në revolucionin botëror. **Çdo mosnxjerrje mësimesh nga pësimet do të ishte mosvazhdim i rrugës së Leninit e të Stalinit**.

Ku qëndron, pra, defekti që në Bashkimin Sovjetik dështoi revolucioni?

Defekti, që në Bashkimin Sovjetik dështoi revolucioni, qëndron te Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik. Ajo, sado që luftoi me heroizëm, e udhëhequr nga Stalini dhe bashkë me popullin, prapëseprapë **e humbi luftën kundër burokratizmit** dhe kundër të gjithë izmavet të tjerë.

Në vitin 1919 Lenini konstatoi se **burokratizmi** s'është veti vetëm e njerëzvet të kapitalizmit, por është veti edhe e njerërzvet të socializmit. Qysh atëherë Lenini nuk flet në mënyrë më shqetësuese për asgjë tjetër, sa për **burokratizmin**. Unë i kam studiuar me vëmendje një pjesë të mirë të vepravet, ku Lenini e Stalini flasin për këtë çështje. Kam studiuar, po për këtë problem edhe veprat e shokut Enver Hoxha. Atje ndodhet një thesar i tërë dokumentar e shkencor, që mua më ka shërbyer shumë për të formuluar tezën time.

Lenini e Stalini luftuan shumë kundër **burokratizmit** dhe për forcimin e diktaturës proletare e, megjithatë, **burokratizmi triumfoi**. Si ndodhi kjo mynxyrë?!

Unë mendoj që kjo **fatkeqësi e madhe shoqërore** ndodhi kështu: **U nda Partia Bolshevike në 2 pjesë**. Në pjesën intelektuale dhe në pjesën jointelektuale. U polarizua Partia Bolshevike. Në shkallë organizate-bazë, pjesa intelektuale ishte më e gojës, ishte "***më me tru***" dhe, në organizatë, ndonëse mund të ndodhte që ta thoshte fjalën e vet edhe pjesa tjetër, gjithnjë e më shumë bëhej ashtu siç thoshte "***truri***", inteligjenca. Në ato organizata ku militonin si komunistë vetëm intelektualë, lufta që bëhej, ishte në fakt luftë intelektualësh, sado që operohej me fraza marksiste. **Në shkallë partie**, gjithnjë e më shumë po e thoshte fjalën e vet **burokratizmi**, aparatçikët, siç e përmend shpeshherë shoku Enver Hoxha. Zbatimi i verbër i direktivavet ose kalimi në mënyrë indiferente dhe nënvleftësuese sipër tyre, pranimi me fjalë dhe moskryerja e detyravet, kudo që të ishte e mundur, gradualisht u bënë "***të modës***".

Me kohë u bë që **pjesa intelektuale e Partisë Bolshevike u bashkua me pjesën tjetër të inteligjencës pa parti** dhe filloi "***TË PROSTITUOJË***", siç thotë Lenini, në kurriz të masavet punonjëse.

Të gjithë këtë proces, Lenini e Stalini, revolucionarët, populli, e shihnin dhe e gjykonin si të dëmshëm dhe shkatërrues, por **ILAÇI I VËRTETË, ILAÇI EFIKAS,** për ta luftuar atë dukuri, **NUK U GJET DOT**.

Kyçi i problemit, i thjeshtësuar, është ky: **Nga njëra anë**, masa e anëtarëvet të Partisë Bolshevike, e pashkollë ose me pak shkollë, inaktive, e pagojë, e përgjumur, e mefshët, teorikisht e pangritur, **nga ana tjetër**, intelektualët, bij punëtorësh, me origjinë të mirë klasore, pa normë ditore në punë, e shkathët për t'u ikur përgjegjësivet dhe për të thënë ndryshe e bërë ndryshe, "***e zonja***"

për të filluar 1000 punë e për të mos çuar deri në fund asnjë, siç e karakterizon Lenini, mendjemadhe dhe, më në fund, një përvehtësuese e paskrupull e djersës së të tjerëvet.

Ajo pjesë e inteligjencës popullore revolucionare, e cila, në të vërtetë, nuk ishte e pakët, qëndroi sa qëndroi, por, më në fund, si inteligjencë që ishte, në lëkundshmërinë e saj, ra në grackën e konjukturavet të reja.

U polarizua, pra, Partia Bolshevike. Pse? (Kur themi ***Bolshevike***, kemi thënë edhe për të tjerat.) Ajo u polarizua, se u gjend në befasi dhe nuk i nxori dot mësimet e duhur nga historia e vet. Më 16 maj 1928, Stalini thotë: "*Edhe partia më e madhe mund të zihet në befasi, edhe partia më e madhe mund të mbarojë, në qoftë se ajo nuk nxjerr mësime nga historia, në qoftë se ajo* ***nuk farkëton përditë e më shumë gatishmërinë luftarake të klasës së saj***." (J.V.Stalin, ***Vep***.11,f.68. Nëviz.janë të mitë. Gj.D.)

Me gjithë këtë konstatim tepër të rëndësishëm të Stalinit, ajo parti prapëseprapë **u gjend në befasi dhe mbaroi**. Pse? Pikërisht sepse nuk e gjeti dot mënyrën e duhur **për të farkëtuar** përditë e më shumë **gatishmërinë luftarake** të klasës së vet. (f.13-15, 1982)

{Siç shihet, edhe në këtë pjesë ka vazhduar analiza e shkaqevet që po e çonin Bashkimin Sovjetik, dhe krejt komunizmin botëror, drejt restaurimit të kapitalizmit. Më vonë, mbasi të mbarojmë punë me librin që e kam shkruar më 1982, do të sjellim edhe argumente të tjerë, pse u restaurua kapitalizmi në ish-vendet komunistë, dmth pse dështoi komunizmi. Nuk është pa vend të flitet për këto gjëra, sidomos në kohën tonë, kur ***edhe botën kapitaliste po e lëkundin krizat***. Dmth, kur edhe kapitalizmi, i cili shikohej si **parajsë** prej miliona banorëve të vendevet që quheshin socialustë, po dëshmohet më se i egër. Ku do ta shikojnë "***parajsën***" tani **të indinjuarit**? 2012}

Mjaftoi që të vdiste Stalini, mbrojtësi i hekurt i rendit shoqëror socialist, dhe ky rend shoqëror në Bashkimin Sovjetik të shpartallohej si një vile, si një bistak rrushi, të cilit i këputet mbajtësja dhe bie e shkërmoqet përtokë. (f.16, 1982)

{Në Republikën e Shqipërisë do të ndodhë 100-fish më keq se në Rusi. 2012}

Shtrohet pyetja: A kishte mundësi që, mbas Stalinit, të zgjidhej në krye të Partisë Komuniste të Bashkimiut Sovjetik një udhëheqës marksit-leninist? Përgjigjja është: Jo! Nuk kishte mundësi të zgjidhej një udhëheqës i tillë, për arsye se subjektet që do të vendosnin për këtë kryesubjekt, nuk ishin më revolucionarë. Te libri "***Hrushovianët***" këtë gjë mund ta kuptojmë më së miri. (f.16, 1982)

{Nuk është vështirë të kuptohet që aludimi im lidhej me Republikën e Shqipërisë. Mbas vdekjes së Enverit, në krye të PPSH-së nuk mund të vinte një njeri si Enveri, gjë që u vërtetua 3 vjet më vonë, me pasoja tejet të hidhura. Edhe po të ekzistonte **NJË**, një i tillë person, atë nuk kish kush ta zgjidhte.

Asnjë REVOLUCION nuk mund të jetë permanent, vijimor, kohëgjatë. Permanent, vijimor, kohëgjatë, mund të jetë vetëm EVOLUCIONI! 2012}

Pra, janë disa shkaqe që, para se të vdiste (ose të vritej) Stalini, ishte degjeneruar Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik. Këta shkaqe duhet të jenë objektivë, nga ata që nuk u arrit të njihen në kohën e Stalinit e që veprojnë pak a shumë në mënyra të njëjta në çdo vend socialist dhe në çdo parti marksiste-leniniste që ndodhet në pushtet. Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik nuk arriti t'i njohë këta shkaqe, dhe, si pasojë, ajo u shndërrua në parti revizioniste. Nga kjo disfatë, nga partitë që janë në pushtet sot, vetëm PPSH i ka kushtet dhe mundësitë për të nxjerrë mësime. Ajo ka gjithkështu edhe për detyrë kombëtare e internacionaliste për ta bërë këtë punë. Gjëja e parë që duhej të bënte Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik, ishte, të kërkonte dhe të gjente me kohë **mënyrën e VETËDETYRIMIT,** për të mos u gabuar kurrë. (f.16, 1982)

{Në të vërtetë, as PPSH, si edhe ajo e Bashkimit Sovjetik, nuk kish mundësi për të bërë thuajse asgjë. Gjëja më e mirë do të ishte, që ky libër **të botohej** dhe **të debatohej** mbi problemet që e shqetësonin, jo vetëm një republikë të vogël me një grusht popull, por krejt njerëzimin. 2012)

VETËDETYRIMI është shtërngimi me mënyra të ndryshme i VETËVETES për të përballuar vështirësi në rrugën e arritjes së një qëllimi. Në procesin e **VETËDETYRIMIT** njerëzit heqin dorë nga lehtësitë e kënaqësitë e **çastit**, për të arritur synimin e caktuar **më të largët**.

Dukuria e **VETËDETYRIMIT** midis njerëzvet është shfaqur që heret, ndoshta qysh atëherë kur janë shfaqur parimet. Atë e hasim në përmbajtje e forma nga më të ndryshmet: herë pozitive, herë negative, herë vetjake, herë të përbashkët e të organizuar, herë bestyte, herë të mbështetur në kërkesat reale të shoqërisë. Mund të numërojmë këtu disa prej tyre, që janë të njohura prej të gjithëvet: Agjërimi (kreshmet te të krishterët, ramazani te myslimanët, besnikëria bashkëshortore, të detyruarit e vetëvetes për të mos marrë sende që nuk duhen marrë, vënia e interesit të përgjithshëm mbi interesin personal).

Aktet e **VETËDETYRIMIT** janë pasojë e bindjes së individit ose të grupit, ose të një mase të tërë njerëzore, se **QËLLIMI MUND TË ARRIHET VETËM ME KËTË MËNYRË**. Kështu, çdo formë **VETËDETYRIMI** është para së gjithash çështje **botëkuptimi**. Ai përpunohet në ndërgjegjen e njerëzvet gjer në atë shkallë, sa ata ta pranojnë atë si të vetmen rrugë të mundshme për të realizuar një objektiv. Aktet e **VETËDETYRIMIT** shoqërohen nga një kompleks i tërë forcash volitive, të cilat shpeshherë i çojnë individin ose grupin gjer në **vetëmohim**. Le të kujtojmë aktet e mospërkuljes së heronjvet, kur gjenden përballë armikut. Ndodh që atyre u falet jeta, bile u premtohen të holla, grada e poste, megjithatë ata nuk dorëzohen, por pranojnë më mirë të vdesin për hir të idealevet të vet. Nuk është lehtë ta **DETYROSH VETEN për të vdekur**. Megjithatë, me mijëra njerëz **e kanë DETYRUAR VETEN**, që nga Leonidha i Termopilevet, deri te Heronjtë tanë të Vigut në Mirditë. Kjo është **shkalla më e lartë e VETËDETYRIMIT**: **vetëmohimi** apo **vetëflijimi**.

Për t'ia arritur një qëllimi, njerëzit shpesh herë i krijonë vetes disa **RRETHANA VETËDETYRUESE,** të cilat i shpien ata në mënyrë të pashmangshme në realizimin e qëllimit. Kjo është edhe forma më e suksesshme e **VETËDETYRIMIT**: krijimi **subjektivisht** i një rrethane që, duke vepruar mbi ne si faktor **objektiv**, na çon me doemos te të përmbushurit e synimit tonë.

Pikërisht një mjet të tillë të VETËDETYRIMIT Partia Bolshevike nuk e kërkoi ose nuk e gjeti dhe prandaj MBAROI.

Thuhet se **Viktor Hygoi**, njëherë, për ta çuar deri në fund një vepër të tijën, e pat qethur mjekrën e vet. Duke qenë pa mjekër, ai nuk mund të dilte përjashta, kështu që, i mbyllur brenda në shtëpi dhe, gjersa iu rrit mjekra, e përfundoi veprën.

A është e nevojshme që edhe komunistët, në rrugën e realizimit të idealevet të tyre, të kryejnë edhe ata një "***mjekërqethje hygoiane***"? Unë mendoj se po. Një lloj **VETËDETYRIMI** është historikisht i domosdoshëm për një parti që dëshiron ta shpjerë shoqërinë njerëzore në komunizëm. (f.17-18, 1982)

{Sot mendoj që, shoqëri komuniste, ashtu siç përfytyrohej atëherë, as që mund të ketë. Mund edhe duhet të ketë SHOQËRI PA PLUTOKRACI, shoqëri ku të mos kenë as të drejtë, as mundësi 5% e njerëzimit të zotërojnë 50% të pasurisë botërore. Ndëkaq, njerëzimi duhet doemos të ketë FORMA SA MË EFIKASE TË VETËDETYRIMIT. Në një libër tjetër do ta zhvillojmë më tej këtë ide. 2012}

Cila do të ishte "***mjekërrruajtja hygoiane***" e komunistit të periudhës mbas ndërtimit të bazës ekonomike të socializmit? "***Mjekërrruajtja hygoiane***" e komunistit të kësaj periudhe do të ishte që ai, pa qenë i detyruar nga ndonjë nen i veçantë i statutit, **të mos pranojë më të marrë rrogë për punën e tij MENDORE.** (f.18, 1982)

regulltarësh të Kishës Katolike pikërisht kështu 2012)

I RROGËS PËR PUNË MENDORE. TË JETUARIT UNËN E KRAHUT. PUNA MENDORE FALAS PËR

m për këtë "***sakrificë***", kjo kastë njerëzish, duke itike, do të mbante mbi shpatulla **UDHËHEQJEN** 16)

Kjo do të ishte forma më e efektshme e **VETËDETYRIMIT**, me anën e së cilës partia marksiste-leniniste do ta çonte me sukses të sigurtë gjer në fund veprën e filluar të komunizmit. Bile, kjo nuk është vetëm forma më e efektshme, por edhe **e vetmja formë** që krijon kushte të sigurtë që socializmi të mos dështojë. (f.18, 1982)

Veç burokratizmit, polarizimit në parti, mosaplikimit të një "***instrumenti***" **VETËDETYRUES** etj, që u vunë në dukje deri këtu, disa nga faktorët e tjerë të prishjes së partisë e të sistemit socialist, janë edhe këta: **synimet e rindarjes së shoqërisë në klasa**, dukuria e **shproletarizimit** të klasës punëtore dhe e kthimit të saj, qoftë edhe fiktivisht, nga skllave në pronare, mosmarrja si duhet e masavet që, nga gjiri i klasës punëtore, i fshatarësisë dhe inteligjencës popullore, të mos shkëputet **një klasë e re borgjeze**, mosndryshimi i politikës së kuadrit në etapa të ndryshme të zhvillimit të shoqërisë socialiste, **dukuria e fryrjes së aparatevet administrativë**, **mungesa e analizavet të plota shekncore** lidhur me momentin delikat të **ndërrimit** të parë **të brezavet**, vënia e arsimit të lartë jo në dispozicion të partisë e të klasës, por **në dispozicion të inteligjencës**, ruajtja e **mitit të diplomës** gati të pandryshueshme si në shoqërinë kapitaliste, mosevitimi rrënjësor i dobësivet në punën e organizatavet të masavet, mosrealizimi si duhet i kontrollit punëtor e fshatar dhe, më në fund, kuptimi jo i drejtë i **njeriut të komunizmit**, shkelja, qoftë edhe pa dashur, i parimit leninist mbi ndryshueshmërinë e vetë partisë, të **kriterevet të pranimit në parti** simbas kushtevet të rinj në kohët mbas ndërtimit të bazës ekonomike të socializmit.

Pikërisht këtë kompleks të madh shkaqesh e faktorësh, shumica jehonë e drejtpërdrejtë e kapitalizmit të sapokapërcyer, që krijon në socializëm një tërësi zhvillimesh shoqërorë të atillë që lënë përshtypjen e **pashmangshmërisë së kthimit në kapitalizëm**, apologjetët e kapitalizmit, me sa duket, e kanë quajtur ***evolucion paqësor***. Pra, teoria e ***evolucionit paqësor*** **e ka një bazë reale**, po të përjashtojmë vetëm atë që ajo teori thotë se ky evolucion është i pashmangshëm. I ashtuquajturi ***evolucion paqësor*** është plotësisht i ndalueshëm dhe i shmangshëm, por ai mund të ndalet e të shmanget vetëm ashtu siç na meson Partia jonë: **me revolucion të vazhdueshëm**. Mirëpo, borgjezët, fatkeqësisht, gjer tani u është dhënë kënaqësia që të gëzohen, për arsye se **hallka kryesore** ku duhet të kapet partia marksiste-leniniste për të realizuar një revolucion të vazhdueshëm e të pandalshëm, **nuk është gjetur ende**. Le të shqyrtojmë tani një e nga një faktorët që thashë unë se ndikojnë për keq në socializëm. (f.19, 1982)

{Gjykimi im këtu ka qenë i gabuar. E vërteta është se ai i quajturi ***evolucion paqësor*** nuk mund të shmangej, qoftë edhe për të vetmen arsye se, siç është thënë edhe më parë, asnjë revolucion kurrë nuk mund të jetë **afatgjatë** dhe "***i vazhdueshëm***". 2012}

Në socializëm janë shumë të fortë **synimet** (tendencat) **e rindarjes së shoqërisë në klasa.** Kjo shfaqet në **luftën e ashpër klasore**, që e ka theksuar vazhdimisht Partia jonë. Shkaqet e kësaj dukurie janë së paku 2: I **pari**: Në socializëm ka prodhim më tepër se ç'do t'i duhej shoqërisë "***për të mbajtur frymën***", bile shumë më tepër… Edhe kur është ndarë fillimisht shoqëria në klasa, shkaku themelor objektiv sipas marksizëm-leninizmit, ka qenë pikërisht ky. Në shoqëri qe shtuar prodhimi aq sa të mund të tepronte diçka mbi sasinë e domosdoshme për të mbajtur frymën. Këtë tepricë prodhimi e grabitën ose e fituan në formë shpërblimesh për merita, individët më të zotë. Teprica e prodhimit, e cila në të vëretë, duhet të jetë më e madhe se në kapitalizëm, (përndryshe: Ç'kuptim mund të ketë ndryshimi i sistemit?), në socializëm haset në çdo hap. Edhe mundësia për ta përvetësuar atë pasuri individualisht ekziston kur më pak e kur më shumë, kështu që çdo individ i **pandërgjegjshëm** në çdo vend e në çdo rast mundohet dhe gjen mundësinë të rrëmbejë diçka. Individë të **pandërgjegjshëm**, ndërkaq, dihet që në socializëm ka me shumicë… Shkaku i dytë që synimet e rindarjes së shoqërisë në klasa janë të fortë, është se aty ndikimet e shoqërisë me klasa janë të pranishëm dhe tepër të fortë dhe kjo aq më tepër është e dëmshme kur njerëzit e shtetit socialist nuk e njohin shfrytëzimin. Ata ndikime kanë mbetur aty në forma nga më të ndryshmet dhe, gjersa ka rretherrotull botë kapitaliste, ata ndikime vazhdojnë të hyjnë aty edhe me forma të reja. Njerëzit e padjallëzuar të shoqërisë pa klasa bëhen viktimat e tyre, si fëmijët.

Panorama e shfaqjes së këtyre synimeve, në jetën e përditshme, paraqitet me një "***kolorit***" të habitshëm, sa do të meritonte komeditë më të bukura e ndonjëherë edhe tragjeditë më të tmerrshme. Një berber, klientit që i jep bakshish, ia rregullon flokët me mënyrën më të bukur të mundshme, ndërsa tjetrin e shëmton aq keq, sa ai pendohet që ka hyrë në atë floktore e rrojtore. Një prind, për të mos e lënë djalin "***në kazëm***", kap 100 vetë për xhakete, një kooperativist, pa pasur aspak nevojë për kontroll nga ana e brigadierit, e punon kopshtin e vet për bukuri, ndërsa arën e kooperativës, me gjithë kontrollin e brigadierit, e punon prapë për faqe të zezë. Është i njëjti kooperativist që, sikur të sillet për shumë kohë ashtu, do të bjerë përsëri në pozitën e bujkrobit, ose do të shtojë radhët e të papunëvet nëpër qytete.

Të këtilla "***tablo***" mund të përshkruhen me miliona dhe në fund vetëm një përfundim do të nxiret: **Po u lanë pa u luftuar në çdo hap këta "*shenja të vegjël*", të borgjezomanisë, shoqëria socialiste një ditë do ta shohë prapë veten në kapitalizëm.** Ligji i ndryshimevet sasiorë, të cilët çojnë në ndryshime cilësorë, këtu vepron në mënyrë të habitshme. Veprimet, që një ditë janë krejt rastësorë, të nesërmen shndërrohen në rregullsi dhe shoqërohen rendom me proverba dekadentë: "***Do lyer rrota, që të ecë qerrja***." "***Bllokadën e jashtme e çan kromi, të brendshmen konjaku***."

Natyrisht, ata që ndihmojnë në këtë punë të **rindarjes së shoqërisë në klasa**, nuk bëhen dot kurrë që të gjithë borgjezë. Përkundrazi, shumica e tyre janë të vetëdënuar të rikthehen në proletarë. Por ata, mikroborgjezë të mjerë, as që e dinë një gjë të tillë. Bile, as që kanë qejf ta dinë, sepse janë të verbuar nga dëshira për t'i rrëmbyer shoqërisë ç'të jetë e mundur dhe sa të jetë e mundur më shumë.

Në fund të fundit, historia e ka treguar tashmë se në sipërfaqe të shoqërisë, si borgjezi e re, del përherë inteligjenca burokratike. Duke ua rrëmbyer pak nga pak pushtetin masavet punojëse, duke e burokratizuar aparatin shtetëror socialist, ajo, një ditë, bëhet e aftë të rrëmbejë **në mënyrë të organizuar** edhe tepricat e prodhimit që akumulon me aq sakrifica shoqëria socialiste. Në këtë mënyrë për këdo bëhet e qartë se rrëzikshmëria më e madhe e **rindarjes së shoqërisë socialiste në klasa** qëndron te ruajtja e ndarjes së shoqërisë në **njerëz të punës mendore** dhe **njerëz të punës fizike**. Gjersa të mos vihet në rrugën e **sigurtë** të zhdukjes kjo ndarje, **rrëziku i kthimit në kapitalizëm** do të mbetet gjithnjë shumë i madh dhe **i pashmangshëm**. Si mund të pengohet kjo qorrollepsje drejt greminavet të reja sociale? Këtë rendje prapa, këtë qorrollepsje drejt greminave të reja sociale, s'është e mundur ta pengosh, veçse me një veprimtari rigorozisht shkencore. Forca që e luftojnë **synimin e rindarjes së shoqërisë në klasa**, ka shumë, por ato duhet të mobilizohen e duhet të udhëhiqen, dhe këtë detyrë është në gjendje ta kryejë **vetëm e vetëm** ai detashment njerëzish **të një shkalle më të lartë të zhvillimit**, që quhet **parti marksiste-leniniste**. Me qenë se forcat që synojnë, qoftë edhe pa dashur (siç ndodh në shumicën e rastevet), për ta kthyer shoqërinë prapa, veprojnë si pa të keq oreçast në çdo hap të jetës sonë të përditshme, është e qartë se edhe komunistët e masat e udhëhequra prej tyre duhet të veprojnë kundër këtyre forcave në çdo hap të jetës. **Po s'u bë kështu, s'ka komunistë as komunizëm**! Por, të ç'brumi duhet të jenë këta komunistë? Si i kërkon koha e re këta njerëz? (f.21-22, 1982)

{Konstatimet ishin të saktë. Me gjendjen në të cilën ndodhej rendi i pretenduar i ri, ish tashmë tërësisht i dështuar. Rruga të cilën unë e shihja si të vetmen mënyrë shpëtimi, gjithashtu ish e dështuar, sepse s'kish kush ta zbatonte. 2012}

Thelbi i rendit shoqëror socialist dihet se është prishja, shkallmimi, **shkatërrimi i shoqërisë me klasa** dhe ndërtimi mbi gërmadhat e saj të shoqërisë re pa klasa (f.22, 1982).

{Është e vërtetë që ky ish thelbi, por më vonë unë arrita në përfundimin që një gjë e tillë jo vetëm nuk mund të arrihej, por edhe nuk duhej bërë. Nuk duhej bërë, sepse rrafshimi ekonomik i shoqërisë sjell edhe rrafshimin ekonomik të individëvet, gjë që sjell diskriminimin e të aftëvet. Në vend të fjalës shkatërrim do të duhet përdorur në të ardhshmen shprehja ***rregullim i shoqërisë me ligje të rreptë kundër çdo diskriminimi***. Në këto pika, nostalgjikët e komunizmit me siguri që do të më anatemojnë. 2012}

Po pasi të jenë shkatërruar klasat shfrytëzuese dhe pasi të jetë ngritur më këmbë shoqëria pa klasa, cili do të jetë thelbi i këtij rendi të ri shoqëror? Thelbi i rendit shoqëror socialist, nga çasti kur janë zhdukur në një vend klasat shfrytëzuese, do të jetë, pa dyshim, **lufta kundër rindarjes së shoqërisë në klasa.** (f.23, 1982)

{Koha vërtetoi që rindarja e shoqërisë në klasa ishte e pashmangshme. Një e tillë luftë nuk do të mund të ishte e suksesshme dhe kjo nuk varej nga dëshira as e individëvet, as e grupevet apo partivet. Por unë kam vazhduar të shkruaj me bindjen që kam pasur atëherë. 2012}

Mbi këtë bazë duhet të ndërtohen e të zhvillohen, politika, ideologjia, ekonomia e çdo gjë tjetër. Ky është aspekti i ri i luftës klasore në këtë fazë të zhvillimit të shoqërisë, ku përfshihet, natyrisht, edhe lufta kundër rishfaqjes së klasavet të vjetra. Po s'u kuptua kjo, nuk mund të ketë kuptim të drejtë të këtij rendi të ri dhe, atje ku kjo nuk kuptohet, socializmi nuk mund të bëjë jetë të gjatë. Pasi të analizohet kjo dhe të pranohet si e vërtetë shkencore, është e nevojshme të kërkohet, si të themi, thelbi i këtij thelbi, hallka

kryesore ku do të kapej shoqëria pa klasa, punëtorët e shproletarizuar, partia etj, për ta zhvilluar sa më me sukses këtë luftë. Për këtë gjë mendoj unë se, midis tjerash, duhet të studiohen e **të njihen mirë proceset e ndarjes fillestare të shoqërisë në klasa** dhe njohja e atyre proceseve të bashkohet me njohjen e rindarjes aktuale në klasa të vendevet ish-socialistë. Kjo njohje të jetë e qartë jo vetëm për disa dijetarë, por për të gjithë njerëzit, në mënyrë që ata të kenë mundësi ta zhvillojnë efektivisht luftën kundër rindarjes, në çdo hap të jetës së tyre.

Në shoqërinë fillestare, pa klasa, individët a u pasuruan më parë, pastaj morën pushtetin, apo morën pushtetin njëherë si grup e pastaj u pasuruan? Kur t'i përgjigjemi kësaj pyetjeje, do të gjejmë se skllavopronarët në kohën e rendit fisnor nuk kanë qenë skllavopronarë, por vetëm prijës. Privilegjet ekonomikë e politikë ata i realizuan më vonë, gradualisht. Ç'do me thënë kjo? Kjo do me thënë se edhe udhëheqësit e proletariatit, duke qenë në fillim prijës, më vonë mund të shndërrohen në kapitalistë. Me fjalë të tjera, shtresa e drejtuesvet, e nëpunësvet, kuadrot, pra, ruajtkan në vetëvete mundësinë për t'u shndërruar dalëngadalë në klasë shfrytëzuese! Këtë e shpjegon qartë historia e renegatizmit në gjithë lëvizjen punëtore në botë… A mund të bëhet, veç këtyre, një shtresë tjetër, klasë shfrytëzuese? Jo! Të gjithë të tjerët, shoferë, berberë, fshatarë, rrobaqepës, muratorë, mekanikë, muzikantë (që shkojnë nëpër dasma për para), marrangozë, me veprimet e tyre eventualë e të pandërgjegjshëm antisocialistë, s'bëjnë gjë tjetër, veçse ndihmojnë shtresën e nëpunësvet, të atyre nëpunësve që i shkelin normat e shoqërisë socialiste, për t'u shndërruar në klasë kapitaliste.

Arsyetim mbi bazën e një shembulli konkret: Shoferi që përvetëson paratë e biletavet të pasagjerëvet, zakonisht, nuk bëhet vetë borgjez, por ai me ato para korrupton shefat e vet, korrupton aparatin e pushtetit në rreth, për t'u siguruar punë të lehtë fëmijëvet, dhe kështu, jo ai, por fëmija i tij, tashmë me gjendje nëpunës, po t'i vijë rasti, mund të shndërrohet në borgjez. Atëherë, ku duhet përqëndruar vëmendja kryesore? Vëmendja duhet të kihet në çdo aspekt të synimevet të rindarjes në klasa, që nga gjesti më i vogël i 20-qindarkëshes së kamerierit, e moslarjes së enëvet në familje nga djemtë, e gjer te të gjitha format e shfaqjes së burokratizmit. Kjo është fusha e luftës kundër rindarjes në klasa, ku duhet të angazhohet gjithë populli, gjithë partia, me vëmendjen më të përqëndruar, natyrisht, te shtresa e nëpunësvet.

Për të realizuar me sukses këtë detyrë, **përgjegjëse** dhe udhëheqëse **për të gjitha, është PARTIA marksiste-leniniste**. Mirëpo, për këtë, **partia duhet**

të jetë nga çdo pikëpamje, e midis tjerash **EDHE INTELEKTUALISHT, MË LART SE INTELIGJENCA.** Ndryshe, **rindarja e shoqërisë në klasa nuk mund të pengohet**. (f.23-24, 1982)

Me marrjen e pushtetit, **klasa punëtore nga skllave shndërrohet në pronare**. Është afërmendsh që ky lloj transformimi social mbart me vete edhe rrjedhimet e vet. Kështu ka ndodhur me të gjitha klasat: Ndryshe janë paraqitur para se të vinin në pushtet, ndryshe mbasi e kanë marrë pushtetin. Karakteristika e klasave të tjera ka qenë fakti se ato në fillim janë paraqitur si përparimtare, kurse mbas marrjes së pushtetit kanë kaluar në pozita reaksionare, duke shkelur çdo premtim të dhënë. Mirëpo, klasa punëtore ka disa veçori që e dallojnë nga klasat e tjera që kanë luftuar për pushtet në të kaluarën. Së pari, ajo nuk i ka dhënë askujt tjetër asnjë premtim, përveç vetes dhe fshatarësisë, së dyti, ajo, mbas marrjes së pushtetit nuk ka për të shfrytëzuar njeri, veç vetes. Atëherë, çfarë rrjedhimesh mund të sjellë me vete dalja në skenë e kësaj qenieje të re sociale? **A do të mund t'i hedhë prangat dikujt kjo, mbasi të ketë marrë pushtetin? Po. Mundet. VETËVETES**! A do të mund t'i shkelë premtimet që ka dhënë dhe të tradhtojë? Po. **Ajo mund të tradhtojë VETËVETEN**. A nuk është në radhë të parë tradhtar i vetëvetes roja jovigjilente e një kështjelle, të cilin sulmuesit e therin të parin? Në jetën shoqërore këto dukuri mund të ndodhin. Në rastin tonë kjo ndodh me anën e shkujdesjes, si në një ushtri.

Stalini e ka vënë re këtë dukuri dhe ka tërhequr vëmendjen disa herë. Shkujdesja dhe përgjumja, liberalizmi, indiferentizmi dhe euforia, janë shfaqjet më të rrëzikshme që bien në sy në këtë periudhë. Thënies: "***Proletarët s'kanë ç'humbasin, veç prangavet të tyre***", me t'u thyer ato pranga, i bie vlera. Bashkë me këtë edhe vendosmëria për t'u sakrifikuar, zvenitet. Pranga nuk ka më, skllavëria mori fund, tani çdo gjë e kemi ne në dorë, përse duhet të shqetësohemi? Në pushtet janë vendosur gjithandej bijtë e klasës punëtore, revolucionarët që nuk kanë kursyer as jetën për këtë ditë të lumtur. Përse të shqetësohemi?! Ndërsa do të duhej të ndodhte e kundërta: Shqetësimi duhej të ishte i madh, për t'u ruajtur nga një **rirënie** eventuale **në pranga**.

Si të veprohet?! Që të shpëtojë klasa punëtore nga një **rirënie tragjike në pranga**, asaj i duhet një ndërgjegje shumë e lartë, e përditshme, i duhet një mekanizëm i tillë që të mos e lërë të dremisë për asnjë çast, i duhet, pra, një **parti e përbërë nga anëtarë tepër syçelët**. Udhëheqjes shtetërore administrative nuk ka pse të mos i besojë klasa punëtore, **por shpresat nuk**

duhet t'i varë kurrë tek ajo. Klasa punëtore duhet t'i mbështesë **shpresat** e veta në radhë të parë **te anëtarët e thjeshtë të partisë**, që janë klasë punëtore si edhe ajo vetë. (25-26, 1982)

{Mirëpo, ata, anëtarët e thjeshtë, në rastin tonë, të PPSH-së, ishin ca injorantë, të cilët nuk dinin as nga bie komunizmi. Enveri e dinte që partia duhej të përbëhej nga punëtorë e fshatarë, por s'e kish parasysh që ata punëtorë e fshatarë tani s'ishin tjetër, veçse ca injorantë, të cilët kishin ngelur në klasë, ndërsa shokët e tyre qenë bërë me kohë me universitet. 2012}

Për **burokratizmin** (ose pushtetin e zyrës) janë thënë shumë gjëra, por një gjë ende nuk është thënë fare shkoqur: **Zyrtari i dalë nga populli, intelektuali popullor, nuk dëshiron kurrë të bëhet burokrat**. Ai detyrohet të bëhet burokrat në disa rrethana të caktuara. (Natyrisht, kjo nuk duhet kuptuar në asnjë mënyrë si justifikim për burokratët.) **Kur "*detyrohet*" intelektuali popullor të bëhet burokrat**? Ai "*detyrohet*" të shndërrohet në burokrat atëherë kur në sektorin e tij të punës ka heshtje ndaj gabimevet dhe shkeljevet. Po heshti klasa ndaj çdo lloj shkelësi, qoftë ai punëtor, qoftë zyrtar, pushteti i zyrës, tirania e zyrës, burokracia, vetëvetiu vihet në veprim. Po foli klasa, burokracia vetëvetiu ul kryet e bën punën. Nuk po hyjmë tani të bëjmë analiza në tërë gjerësinë, thellësinë, kompleksitetin e kësaj dukurie. Nga mijëra e miliona urdhëra të vegjël zyrtarë **lind burokracia e madhe**. Nga ndërthurja e veprimevet zyrtarë të mijëra zyrtarëve, që, në pjesën më të madhe, nuk janë armiq, **lindin burokratët e mëdhenj**, që janë armiq të socializmit. Gjersa këta armiq të socializmit të zbulohen dhe të ndalohet puna e tyre armiqësore, fakt është se çështja e socializmit dëmtohet shumë. E keqja më e madhe është atëherë kur këta nuk zbulohen fare. Atëherë **përmbyset diktatura e proletariatit**. Gjarpri zgjat kokën nga shtrati ku e kemi vendosur ne vetë dhe na kafshon. Si duhet bërë? Duhet bërë që të flasë klasa! Këtë detyrë e ka shtruar Lenini që në kohën e tij, këtë detyrë nuk e kanë lënë mbas dore as Stalini në kohën e vet, as Enver Hoxha në kohën tonë. Megjithkëtë, fakt është që **klasa nuk ka mësuar ende të flasë si duhet** kundër çdo shfaqjeje të burokratizmit. Në shkallë botërore klasa punëtore **heshti në mënyrë** aq **tragjike**, sa me miliona punëtorë u riskllavëruan dhe çështja e revolucionit proletar botëror, në vend që të ishte një punë e kryer ose gati e kryer, u shty për një kohë të ardhshme. Po të kish mësuar të flasë **si duhet**, ashtu siç e porositnin Lenini e Stalini, klasa punëtore e Bashkimit Sovjetik kundër burokratizmit, në Bashkimin Sovjetik nuk do të kish ndodhur ky regres që ndodhi.

Në vendin tonë, në shumë kolektiva punonjës, klasa e thotë si duhet fjalën e vet, por e vërteta është se rastet kur masa e punonjësvet i lë të gjitha punët e organizimit në dorë të zyrtarëvet, janë ende të shumtë, aq të shumtë sa ne kemi të drejtë të shqetësohemi. Partia sigurisht që për këtë i ka të dhënat e veta, që mund edhe të vërtetojnë të kundërtën, por përshtypja ime është e tillë dhe mendoj që në këtë fushë duhen bërë studime, në mënyrë që të shihet saktë se gjer ku është i shtrirë pushteti i zyrës dhe gjer ku masat kanë mësuar të qeverisin vetë nën udhëheqjen e organizatës-bazë të PPSH-së. (f.27-28, 1982)

Liberalizmi gjen shtrat gjithashtu në ambientin e mosveprimit të masavet punonjëse në sferën e organizimit të punëvet. Bëhet gabimi, dhe, për të mos u dëmtuar autori, gabimi mbulohet. Organizata e partisë nuk e luan rolin që duhet, po kështu, si pasojë, edhe organizatat e masavet. Masa hesht ose murmurit në mënyrë spontane, gjë që është gati njëlloj sikur ka heshtur. Individët flasin, por flasin vetëm atëherë kur cënohet interesi i tyre vetjak. Mbulimi i gabimevet dhe i shkeljevet bëhet kështu metodë pune. Lind kompromisi midis grupeve e kategorive të ndryshme shkelësish dhe, si ekonomia, ashtu edhe kultura socialiste, dëmtohen aq rëndë, sa **vendi socialist mund të ndodhet edhe para të paprituravet**. Dëmtohet diktatura e proletariatit, dëmtohet vija e partisë, prishet morali komunist, vërshon vala e ndikimevet josocialistë në të gjitha fushat dhe, më në fund, vendi gjendet aq ndushtë, **sa që vetëm burokracia "*është e zonja*" "*ta shpëtojë*" situatën**. Në vazhdën e liberalizmit vjen revizionizmi. (f.29, 1982)

{Ose vjen restaurimi. Në Republikën e Shqipërisë erdhi restaurimi krejt i paorganizuar. Republika e Shqipërisë nuk kaloi nëpër revizionizëm apo të ashtuquajturën ***pjerestrojkë.*** Ndoshta kjo është një nga arsyet që ky vend u shkatërrua kaq dhimbshëm. 2012}

Në vitet e parë mbas marrjes së pushtetit, shteti i ri i punëtorëvet ka shumë nevojë për kuadro e specialistë. Në atë kohë, siç dëshmon historia e vendit tonë, kuadrot nxiren bile edhe me kurse dhe me forma operative nga më të ndryshmet. Kështu që, puna për krijimin e inteligjencës popullore në atë periudhë, përbën një nga preokupimet kryesorë të partisë marksiste-leniniste. Hapen shkolla kudo, krijohen ose vihen në shërbim të shtetit të ri universitetet, krijohen institute nga më të ndryshmit, shkolla të mesme të profilevet të ndryshëm, akordohen bursa me shumicë, dërgohen studentë në

shtete të tjerë. Në këtë mënyrë, shteti i ri, si dhe në fushat e tjera të zhvillimit, arrin edhe këtu një përparim të rëndësishëm. Krijohet për një kohë relativisht të shkurtër **armata e madhe e inteligjencës popullore** dhe, me ndihmën e saj, me diturinë e saj, me aftësitë organizuese, me besnikërinë ndaj klasës nga e ka origjinën, shteti i klasës punëtore arrin të bëjë mrekullira në të gjitha fushat e shkencës e të teknikës, në art e në kulturë, në politikë e në diplomaci. Dëshmi bindëse për këtë është zhvillimi i vrullshëm i Bashkimit Sovjetik që, në atë kohë, nga një vend gjysmëfeudal, për një çerek shekulli, arriti që në shumë pika t'ua kalojë edhe vendevet më të zhvilluar kapitalistë. Këtu, inteligjenca popullore, pa dyshim, ka dhënë kontributin e vet të madh. Të njëjtët hapa viganë kemi bërë edhe ne në këta 4 dhjetëvjetësh në fushën e shkencës e të kulturës dhe në të gjitha fushat ku ka gjetur zbatim dituria e inteligjencës sonë të re popullore. **Krijimi i inteligjencës popullore** përbën një nga fitoret më të mëdha të pushtetit të ri popullor, të themeluar këtu nga partia marksiste-leniniste.

Mirëpo, unë nuk e di nëse është menduar në fushën e teorisë marksite-leniniste mbi një të këtillë mundësi: **Mos vjen vallë një kohë kur normat e vendosura lidhur me politikën e kuadrit duhen rishikuar**? Në politikën ekzistuese të kuadrit, në sferën e nëpunësvet hyjnë pareshtur njerëzit më të përgatitur të shoqërisë. A është e drejtë kjo nga pikëpamja marksiste-leniniste? A është e drejtë që njerëzit e mendjes të vazhdojë t'i thithë pa mbarim një shtresë e veçantë e shoqërisë dhe 2 klasat bazë, punëtoria dhe fshatarësia, të mos marrin fare prej këtyre? **Uria për kuadro nuk mund të mbetet përjetësisht preokupacioni numër 1 i shtetit socialist**. Aq më tepër kur në bazë të marksizëm-leninizmit, aparatet administrativë duhet të vijnë gjithnjë duke u thjeshtuar. Në bazë të marksizëm-leninizmit, sa më afër komunizmit që të shkojmë, aq më pak nëpunës duhet të ketë. Mos vallë edhe ky është një nga faktorët që ndikuan në përmbysjen e rendit socialist në Bashkimin Sovjetik? Duke u rrëmbyer nga problemet e ekonomisë, nga kërkesat e zhvillimit të vrullshëm, që gjithmonë linte përshtypjen se ka nevojë akoma për kuadro, me sa duket, pushteti sovjetik nuk arriti të shihte edhe anën tjetër, anën e dëmshme të këtij problemi. Në këtë mënyrë është bërë zakon që nëpër kongrese, kur konstatojmë se numri i kuadrovet u shtua, ta konsiderojmë këtë si një sukses të arritur në këtë fushë. Ndësa duhet të dimë që **në socializëm vjen një fazë kur në kongrese duhet të konsiderohet sukses pakësimi i numrit të kuadrovet TË PAGUAR**, jo shtimi i tyre. **Krahas me shtimin gjithnjë e më të shpejtë të njerëzvet me universitet në një vend socialist, duhet të pakësohet numri i kuadrovet**

TË PAGUAR. Po s'e bëri këtë shteti socialist, **diktatura e proletariatit aty nuk do të mbahet dot për gjithnjë.** (f.30-31, 1982)

{Jo vetëm që shtohej numri i nëpunësvet, por rendimenti i punës së tyre sa vinte e ulej. Mbaronte njeriu shkollën, emërohej në një punë dhe kohën më të madhe e kalonte me binomin cfilitës: "***Punove, s'punove***". Mbledhje pa fund, justifikime pa fund, lodhje pa bërë punë. **Rrogat të njëllojta.** Ndaç puno, ndaç mos puno, ndaç kritikohu, ndaç mos u kritiko, rrogën kishe për ta marrë të pacëuar. Përfundimisht, punonin vetëm patriotët, të ndershmit, të përkushtuarit. Të tjerët bënin gallatë. 2012}

Parimet e qarkullimit shoqëror në socializëm janë këta: Në relacionin qytet-fshat e anasjelltas, në relacionin klasë (punëtore e fshatare)-inteligjencë, si dhe brendapërbrenda inteligjencës, në relacionin qendër-bazë e anasjelltas. I rëndësishëm është për temën tonë të shqyrtohet problemi i qarkullimit në relacionin klasë-inteligjencë dhe anasjelltas. Për kalimin nga sfera e klasës në inteligjencë ekziston tashmë një rregull: Fëmija i punëtorit (ose vetë punëtori) meson në shkollë, merr diplomën dhe bëhet nëpunës. Kjo është një rrugë e sigurtë, që çon vit për vit me mijëra nga klasa punëtore e fshatarësia në sferën e inteligjencës. Kjo është gjë e mirë, se njerëzit që dalin nga klasa (punëtore ose fshatare), kur bëhen nëpunës, të edukuar nga PPSH dhe të brumosur me mësimet e marksizëm-leninizmit, pa tjertër që do të punojnë në interes të klasës nga rrjedhin, së paku më mirë se sikur këta nëpunës të vinin tërësisht nga shtresa e inteligjencës.

Mirëpo, për **lëvizjet në relacionin inteligjencë-klasë** nuk ka ndonjë rregull as teorikisht të parashikuar, në kuptimin që klasa punëtore e klasa fshatare të kenë në gjirin e vet sa më shumë të jetë e mundur njerëz të ditur me arsim universitar. Punëtor mund të bëhet shumë-shumë ndonjë kuadër që nuk e ka arsimin përkatës, ndonjë kuadër që ka bërë gabime ose fëmija i ndonjë të deklasuari, të cilit nuk i jepet e drejta për t'u bërë nëpunës. Ky nuk është qarkullim me kuptimin e vërtetë të fjalës. **Qarkullim të vërtetë në relacionin inteligjencë-klasë punëtore e klasë fshatare do të kishim kur për këtë të ekzistonte një rregull dhe ai të kryhej sistematikisht simbas atij rregulli.**

Në "***Raporte e fjalime***" 1974-1975, f.134, shoku Enver thotë kështu: "***Ne duhet t'i mësojmë punëtorët që t'i zëvendësojnë kuadrot në drejtim dhe***

këta të zëvendësojnë punëtorët në punën e tyre." Kjo është e vetmja rrugë që duhet të ndiqet, por, për ta zbatuar këtë, duhet një **mekanizëm i sigurtë**, duhet gjetur një i tillë mjet, që, siç e bën diploma punëtorin nëpunës, ai mjet ta bëjë universitarin punëtor dhe me këtë mënyrë të kalojnë vit për vit me mijëra universitarë në gjirin e klasës, pra, në bazën nga e kanë prejardhjen. Në sistemin socialist, që është, si të thuash, paradhoma e komunizmit, ka nevojë për një qarkullim të kësaj natyre. Mirëpo, për ta zbatuar këtë, pengojnë rregullat ekzistuese në politikën e kuadrit, **pronësia mbi diplomën** dhe e drejta tradicionale për të kërkuar punë mbi bazën e diplomës, kuptimi konservator se punëtorit ose fshatarit nuk ka ç'u duhet universiteti.

Edhe këtu duhet kërkuar një nga shkaqet që çon në restaurimin e kapitalizmit në një vend socialist: Mungesa e një rregulli të qarkullimit nga inteligjenca, dmth nga sfera e njerëzvet të shkolluar, kryesisht me qëllim që klasa të pasurohet me dituri. **Po nuk u pasurua klasa me dituri, ajo nuk do të dijë kurrë të qeverisë ashtu si duhet, simbas normavet leniniste të shtetit të punëtorëvet. Klasa punëtore duhet të jetë në çdo aspekt më e ditur se inteligjenca, dhe kjo do të realizohet vetëm atëherë kur NJË PJESË e bijvet të punëtorëvet, mbasi të kenë mbaruar universitetin, të bëhen prapë punëtorë**. Ai komb që do të arrijë i pari këtë objektiv, do të jetë kombi më i lumtur në botë. (f.33-34, 1982)

{Në rrethanat, nën të cilat po rrokullisej shoqëria socialiste, për të këtilla ëndrra as që i shkonte kujt mendja. "***Të kesh punëtorë e fshatarë me njohuri universitare!?*** *Punëtorë që bëjnë punë punëtori dhe fshatarë që bëjnë punë fshatari, ç'po thua kështu?!* ***Punëtor me universitet, midis llaçit dhe tullavet****!?* ***Fshatar me universitet, midis baltës dhe plehut të lopëvet!?*** *Atyre s'ka ç'u duhet as fillorja, jo më universiteti! Një e këtillë filozofi sigurisht që s'është veçse llomotitje njerëzish të paformuar dhe ekstremistë haluçinantë."* Me siguri që kështu do të thoshin ata që do t'i lexonin këta rreshta. Por unë kam vazhduar. 2012}

Për shkak se **puna e njerëzvet të lapsit** është një punë e pafundme dhe shpeshherë mjaft abstrakte, ekziston përshtypja e përhershme sikur në sektorë të ndryshëm mungojnë nëpunësit. Puna pa normim atje krijon gjithashtu një rrethanë "***të mrekullueshme***" për të ndenjur, për t'u sorollatur, për të mbyllur ditët, muajt, vitet, pa bërë shumë punë e shpesh pa bërë asgjë

të saktë dhe, natyrisht, **atje ku rrinë 3 nëpunës kot ose gjysmëkot, lind nevoja për një të katërt**, me shpresën se ai do ta plotësojë boshllëkun në punët që kanë mbetur pa u bërë. Kështu që, sado të shtohen nëpunësit, prapë askush nga ajo sferë nuk do të thotë: "***Mjaft i kemi***." (Në të vërtetë, kështu ndodh edhe në sektorët e prodhimit, por atje nuk dëmtohet asgjë me shtimin e forcavet, sidomos kur ka normë pune.) Në mjaft raste vihet re se **sa më shumë shtohen nëpunësit, aq më tepër ndjehet mungesa e tyre**. Sidomos kur konstatohen të meta në punë, nëpunësit e kanë në majë të gjuhës justifikimin: "***Kemi mungesë të tmerrshme në kuadër***." Këtyre njerëzve as që u shkon mendja se shoqëria duhet të ecë në drejtim të komunizmit, e kjo, midis tjerash, do të thotë **duhet të vijë gjithnjë duke u pakësuar numri i nëpunësvet TË PAGUAR**. Këta njerëz harrojnë se në të vërtetë nuk është sasia e nëpunësvet **TË PAGUAR** ajo që vendos në zgjidhjen e punëvet, por është zhdërvjelltësia e tyre, operativiteti, lidhja me punëtorët, zotërimi i shkencës dhe, në fund të fundit, preokupimi serioz i tyre për punën, ndërgjegjja në punë. Si përfundim, fryrja e aparatevet të administratës në socializëm mund të arrijë në atë shkallë, sa ajo të përbëjë një rrëzik serioz për rendin. Këtë konstatim ne e gjejmë në kohën e Leninit, në një kohë kur, nga njëra anë kish vërtet nevoja të mëdha për kuadro, por, nga ana tjetër, ata grumbulloheshin me qindra e mijëra në qytetet kryesorë e nëpër dikasteret. Këtë lloj grumbullimi e gjejmë edhe në vendin tonë, sidomos nga mbarimi i vitevet 1960 e këndej.

Shumë nga ata që mund ta lexojnë këtë kapitull, mund të thonë e me siguri do të thonë: "***Ky dashka të kemi më pak mjekë, llogaritarë, inxhinierë, mësues, studiues, agronomë, nëpunës të komitetevet të Partisë e të komitetevet ekzekutivë! Simbas këtij, u dashka që ne ta pakësojmë numrin e studentëvet dhe t'i mbyllim fakultetet***!" Por nuk është ashtu. E vërteta është se kjo punë duhet menduar më seriozisht e më thellë, sepse kjo ka të bëjë me të sotmen e me të ardhshmen e shoqërisë njerëzore. Njerëzit me arsim të lartë e me fakultet nuk duhet të pakësohen, por përkundrazi, duhet të shtohen gjersa të përfshijnë në gjirin e tyre gati krejt popullsinë, përjashtuar të paaftët. Por, që të arrijmë në një gjykim shkencor, duhet pa tjetër të pranojmë faktin se dukuria e pangopësisë në zyra, dukuria e fryrjes së aparatevet administrativë, është një dukuri antisocialiste dhe se përshtypja që përherë mungojnë nëpunësit, është një përshtypje e rreme. (34-35, 1982)

{Edhe atëherë, edhe sot, kur nuk ka më socializëm, kur socializmi, me kuptimin ***komunizmi,*** ka dështuar në të gjithë hapësirën, ku ishte vendosur në gjysmën e dytë të shekullit

XX, dukej dhe duket sikur këta pretendime vijnë prej një planeti tjetër. Në vend të një të këtillë gjykimi, është më lehtë të pranosh në shoqërinë njerëzore një "***seleksionim natyror***" , një "***luftë për ekzistencë***" dhe kush të jetë më i fortë e më dinak, ai të marrë më shumë para, të marrë para madje edhe pa punuar fare. Por ***luftë për ekzistencë*** bëjnë edhe viruset. Ç'bëhet kur **virusi** e zapton një organizëm njerëzor? Ai organizëm... **VDES**! 2012}

Përcaktimi edhe në Kushtetutë (Është fjala për Kushtetutën e vitit 1976.) që **kuadrot** në socializëm **të merren me punë fizike**, përbën një shans, që klasa punëtore të mund ta konsolidojë pushtetin e vet në rrugën e luftës kundër **rindarjes së shoqërisë në klasa**. Ai përcaktim duhet kuptuar tepër seriozisht dhe nuk duhet lejuar as në një përqindje të vogël të mbetet formal, vetëm në letër.

Fatkeqësisht, praktika jonë po tregon se **puna fizike e nëpunësvet**, me gjithë seriozitetin që ka imponuar Kushtetuta, **nuk po kryhet as përafërsisht ashtu si duhet**. Unë mendoj se puna fizike e nëpunësve nuk duhet kryer çdo vit nga 1 muaj, por mbas çdo 5 vjet punë mendore, 1 vit të plotë punë fizike me normë dhe me pagë simbas realizimit të normës. Në këtë mënyrë, ky përcaktim kushtetutor do të mund të vihej në udhën e zbatimit. Me këtë rast do të zgjidheshin gjithashtu edhe disa probleme të qarkullimit të kuadrit, mbasi secili kuadër do ta kish "***me tapi***" vendin e punës jo më shumë se 5 vjet. Mbas 5 vjetësh ai edhe mund të kthehej në po atë punë, por kjo, mbas 1 vit pune si punëtor i thjeshtë, pa një emërim të ri, nuk do të mund të bëhej. (f.36, 1982)

{Në vend që të ndodhte ashtu, mbas 1990-s ajo kushtetutë u hodh poshtë dhe një shumicë nëpunësish tanë e panë veten "***të lumtur***" duke punuar si bujq nëpër plantacionet e Greqisë e të Italisë apo si punëtorë llaçi, deri në SHBA. Një pjesë tjetër u bënë shitës zarzavatesh, qoftexhinj, taksistë, apo kambistë, me tufa monedhash nëpër duar dhe me rrëzikun e përditshëm për t'iu ngulur ndonjë thikë në shpatulla. 2012}

Për ta vënë sistemin shkollor në shërbim të klasës punëtore dhe të fshatarësisë, te ne është bërë shumë punë. Në këtë pikë mund të themi me të drejtë se u zbatua mirë porosia e Leninit, për të ngritur shkallën kulturore të

masavet, se, pa ngritur shkallën kulturore të masavet, nuk ka socializëm. Këtë qëllim e realizoi sidomos përfshirja në arsimin fillor e tetëvjeçar të të gjithë fëmijëve të Republikës, pa lënë as edhe 1 jashtë këtij arsimimi. Deri diku edhe shkollat e mesme shërbyen dhe shërbejnë për të krijuar punëtorë të kualifikuar. Mbi të gjitha, rol vendimtar luajti përmbajtja e re e mësimit dhe kështu shkolla socialiste u bë me të vërtetë një "***përhapëse e parimevet të komunizmit***", siç thotë Lenini. (***Vep***.bot.shq.vëll.29,f.134) Shkolla e lartë u bë një institucion me rëndësi në duart e pushtetit popullor e të partisë, për të krijuar inteligjencën popullore. Të gjitha këto dhe shumë të tjera janë anët e mira të sistemit shkollor të ngritur në shërbim të rendit të ri shoqëror në një vend socialist.

Megjithkëtë, ne nuk mund të themi se çdo gjë sot ndodhet në vendin e vet dhe se nuk ka asgjë për të ndryshuar. Ashtu si në shumë fusha të tjera, edhe këtu ndikimi i sistemevet shoqërorë me klasa shfrytëzuese vazhdon të ekzistojë e të dëmtojë rendin e ri në formën e tradicionalizmit. Marrim e krahasojmë këto 2 skema të sistemit arsimor:

1.Sistemi shkollor borgjez: Shkollë 8-klasëshe ose më pak, për proletarët, pak më tepër shkollë për aristokracinë punëtore, shkollë të lartë për borgjezinë dhe për sistemin e saj administrativo-profesional.
2.Në socializëm: Shkollë 8-vjeçare për punëtorët e fshatarët, shkollë të mesme për punëtorët e kualifikuar, shkollë të lartë për nëpunësit dhe në përgjithësi për kastën e intelektualëvet.

A nuk duket se kjo skemë heret a vonë mund të çojë në dallime klasorë? Aq fort është rrënjosur kjo skemë në ndërgjegjen e njerëzvet, sa, në qoftë se dikush do të parashtronte një skemë tjetër, pothuaj çdo lexues do të qeshte, me iuroni ose me sarkazëm. Psh në qoftë se do të thuhej kështu: **Arsim universitar në radhë të parë për punëtorët e për fshatarët**, që janë klasë sunduese në socializëm, **pastaj për nëpunësit**. Pa dyshim, të gjithë do t'i shtrembëronin buzët. Mirëpo, e vërteta është se me skemën ekzistuese dhe me konceptet ekzistues, ky sistem shkollor nuk ka shërbyer për shkatërrimin e plotë "***të sundimit klasor të borgjezisë***" dhe "***PËR ZHDUKJEN E PLOTË TË NDARJES SË SHOQËRISË NË KLASA***". (V.I.Lenin, ***Vep***.29, shq.f.134) Kur do ta kryente deri në fund këtë rol shkolla socialiste? Ajo do ta kryente këtë rol deri në fund atëherë kur universiteti nuk do të nxirte vetëm nëpunës, por do të nxirte së pari punëtorë e pastaj nëpunës. Sigurisht, këtu nuk e kemi fjalën për 2 a 3 dhjetëvjetëshat e parë mbas marrjes së pushtetit.

Në ata vite vetëm ëndrra mund të thureshin për një të atillë luks arsimor. (f.37-38, 1982)

Në vitet kur shteti punëtor ka ngushtësi ekonomike, kufizimi i të drejtavet të studimit është i domosdoshëm, ashtu siç është i domosdoshëm edhe racionimi i bukës, i vajit, i mishit. Mirëpo, me t'u kapërcyer ngushtësitë ekonomike, gjëja e parë që duhet dhënë "**pa racion**", është **shkolla**, deri në shkallët më të larta të sajat. Çdo veprim i kundërt, çdo lloj kufizimi për fëmijët e punëtorëvet, të fshatarëvet e të intelektualëvet popullorë, me përjashtim të cilësisë, është një veprim antisocialist që bie në kundërshtim me parimet e marksizëm-leninizmit mbi problemet e arsimit. Si duhet proceduar në këtë fushë? Në këtë fushë duhet proceduar kështu: **Të gjithë nxënësit e aftë që kërkojnë për të vazhduar shkollën e mesme, duhet të lejohen të shkojnë në atë shkollë që dëshirojnë.** Ata që, në bazë të rregullavet të vendosura përfitojnë bursë, le ta marrin atë, me kusht që të shkojnë në ata profile ku ka më shumë nevojë vendi. Për shkollat e larta, po kështu: **Të gjithë studentët e aftë të ndjekin kryesisht ata fakultete që dëshirojnë** dhe **le të mbarojnë** kështu **sa më shumë njerëz universitetin**. Ata që, mbi bazën e të ardhuravet, përfitojnë bursa, mirë është të çohen në ato degë ku duket se do të ketë më shumë nevoja vendi për kuadro të paguar.

Fill mbas leximit të këtyre rreshtave, të gjithë ata njerëz që janë mësuar të gjykojnë simbas një tradite të konservuar, bëjnë këtë pyetje: "***Në qoftë se do të veprohej kështu, ku do të çoheshin të gjithë ata studentë të sapodiplomuar?! Po në prodhim kush do të mbetej?!***" Pikërisht ky është një **gjykim antidituri**, simbas të cilit vetëm ai që nuk ka shkollë, ai i ulti, ai relativisht injoranti, duhet të punojë në kazëm, ndërsa ai i dituri, ai me shkollë të lartë, ai me diplomë, është paracaktuar vetëm për të drejtuar punët nga zyra. Këta njerëz nuk i analizojnë aspak thellë ato që thotë shoku Enver Hoxha se, të gjithë ata që mbarojnë shkollat, **nuk e** "***kanë marrë me tapi*****" të qenët nëpunës**. Këta njerëz, që gjykojnë kështu, pasjen e diplomës e konsiderojnë tamam tapi. Për të thyer këtë koncept, si edhe shumë koncepte të tjerë të gabuar, duhet thyer në shoqërinë socialiste "***miti***" **i diplomës**. (f.39, 1982)

Në kapitalizëm, të rinjtë që mbarojnë një shkollë, kanë plotësisht të drejtë që, në bazë të diplomës, të kërkojnë edhe punën (te kapitali). Atje, proletariati dhe masa e popullit të thjeshtë duhet të luftojnë për të gjitha të drejtat e veta e midis tyre edhe për të drejtën bazë të diplomës.

Por, ç'është diploma në socializëm, ku shkollimi është falas dhe mundësia për të mbaruar shkollë është kaq e gjërë? Në socializëm **diploma s'është tjetër, veçse një dëshmi që tregon se aksh individ është i aftë për të punuar në një sektor të caktuar.** Me qenë se në bazën e arsimit socialaist, simbas K.Marksit, qëndron arsimi **politeknik**, atëherë njeriu i socializmit duhet të jetë i aftë të punojë në sa më shumë profesione. Por, doradorës, gjersa shoqëria të ketë krijuar mundësitë për t'u dhënë pjesëtarëvet të vet nga 5 e nga 6 profesione, çdo njeri i ka mundësitë të jetë "***politeknik***" të paktën në 2 drejtime: në drejtim të punës **fizike** dhe në atë punë **inelektuale**, për të cilën ka kryer studimet. Pra, ai i ka 2 diploma, pavarësisht se njëra prej tyre mund të mos jetë e shkruar. Atëherë, pse të fetishizojmë njërën e tjetrën ta injorojmë zyrtarisht e shtetërisht? Sepse të këtillë e kemi trashëguar konceptin nga e kaluara. **Në të vërtetë, në socializëm diploma si shkresë duhet të ketë vlera kryesisht për shoqërinë**. Atje ku përputhet interesi i shoqërisë me atë të individit, ajo duhet t'i japë punën përkatëse edhe individit. Atje ku nuk përputhen këta interesa, poseduesi i diplomës ka shkollën, diturinë, që gjithsesi e bën atë një pjesëtar të denjë të shoqërisë. Po nuk gjykuam kështu, atij që mund të ketë 3 diploma, mos vallë shoqëria është e detyruar t'i sigurojë punë në atë vend ku dëshiron ai? Në socializëm s'ka asnjë arsye objektive që të ruhet, në dobi të individit, rëndësia e diplomës dhe të kthehet kështu diploma në mit. Miti i diplomës në socializëm do thyer përfundimisht, për arsye se ai i shërben **rindarjes së shoqërisë në klasa.** Pronësia mbi diplomën i ngjan shumë pronësisë së vogël mbi tokën ose ndonjë lloji tjetër të pronësisë së vogël. **Ashtu si pronësia e vogël mbi tokën lind çdo orë e minutë kapitalizmin, ashtu edhe pronësia mbi diplomën krijon çdo orë e minutë burokratizmin**, e, së këndejmi, edhe ajo, si çdo lloj tjetër i pronës private, krijon, **pra, kapitalizmin.**

Në kapitalizëm, pikërisht sepse është e lirë pronësia private mbi tokën, ka aq shumë të patokë. Në kapitalizëm, po kështu, pikërisht se të drejtën e pasjes së një pune në bazë të diplomës e kanë të gjithë, ka aq shumë të diplomuar të papunë.

Kjo është e vërteta, të cilën duhet ta njohim dhe të konkludojmë se **edhe diploma duhet "shoqërizuar"**. **Bashkë me konceptin mbi pronën private në përgjithësi, duhet të ndryshojë me doemos edhe koncepti mbi diplomën**. Në të vërtetë, goditjet e para dhe vendimtare i janë dhënë këtij koncepti, por puna duhet çuar gjer në fund. Fakti që kuadri i lartë është monopol i partisë, puna e bërë për ngushtimin e dallimevet midis punës

fizike dhe asaj mendore, ngushtimi i dallimevet në paga, ideja e përhapur midis rinisë shkollore dhe në kuadrot për të punuar atje ku ka nevojë atdheu, koncepti se njeriu nuk mëson për notën e për diplomën, por për dije, të gjitha këto flasin në favor të pohimit se miti i diplomës po thyhet. (f.41,1982)

{Shumica e këtyre ishin propagandë e pasuksesshme. Ato ishin shprehje e një këmbënguljeje për të zbatuar parimet e marksizëm-leninzmit, të cilët pakkush i bënte të vetët me sinqeritetin e duhur. Ndërkaq, **ngushtimi i dallimevet në paga** ishte **objektivisht** një **punë e keqe**, e cila i dëmtonte shumë sidomos njerëzit që punonin pa hilera. 2012}

Miti i diplomës duhet shkallmuar përfundimisht me një masë të përcaktuar qartë e drejt, e cila për çdo vit do të çonte një numër të caktuar universitarësh në prodhim. **Shkalla më e lartë e ngritjes së një universitari duhet të konsiderohet shkuarja e tij në prodhim.** Ky duhet të jetë nderi më i madh për një bir punëtori, bir fshatari apo bir intelektuali. Ndërsa të gjitha shkallët e nëpunësisë duhet të jenë të ndërmjetme dhe të konsiderohen vetëm detyrë. Vetëm atëherë nuk do të na ndodhë më që kuadrot "***ne t'i nxjerrim nga dera, ata të na hyjnë nga penxherja 2 herë më shumë***", siç thotë shoku Enver në një vend ku flet për fryrjen e aparatevet të administratës. Vetëm atëherë socializmi nuk do të vihet më në rrëzik nga restaurimi. (f.41, 1982)

Problemi i **kontrollit punëtor e fshatar** ka qenë ngritur nga Lenini qysh në vitet e parë të Revolucionit të Tetorit. Atëherë qe krijuar ***Inspektimi Punëtor e Fshatar***, me qëllim që klasa punëtore të ketë në dorë një formë kontrolli mbi administratën dhe të pakësohen disi veprimet e burokracisë. Gjithë historia e mëvonshme e pushtetit sovjetik tregoi se **ky institucion nuk arriti asnjëherë që ta kryejë si duhet misionin që i ishte ngarkuar**. Përndryshe, po të ishte gjetur një formë e atillë që klasa punëtore të ushtronte me të vërtetë kontroll mbi administratën, restaurimi në Bashkimin Sovjetik nuk do të ishte kryer. **Në vendin tonë,** gjithashtu, PPSH ka bërë përpjekje që kontrollin punëtor e fshatar ta vërë në veprim, sidomos nga fundi i vitevet 1960 e këndej. Mirëpo, e vërteta është se, përsëri, **të gjitha format e punës që janë përdorur me këtë qëllim, nuk e kanë dhënë reazultatin e dëshiruar.**

Shtrohet pyetja: A nuk duhet të ketë kontroll punëtor e fshatar në një vend socialist? A mos është kjo një provë e dështuar, të cilën e nxori koha të

pavlerë? Jo, nëse duam të kemi shtet të punëtorëvet e të fshatarëvet. **Kontrolli punëtor e fshatar është një domosdoshmëri e tillë në rendin socialist, pa të cilin pushteti i klasës punëtore e fshatare nuk mund të mbahet gjatë**. Nga fakti se sa e si vepron pikërisht ky institucion i rëndësishëm i klasës punëtore, mund të gjykojmë se **sa e gjallë është jeta politike e bazës** si edhe në çfarë shkalle merr pjesë ajo në qeverisjen e vendit. Atëherë, si të veprohet? **Si të bëhet që klasa të fillojë të flasë normalisht vetë**, pa qenë shumë ose aspak nevoja që të shtyhet nga lart, me urdhëra e udhëzime zyrtarë? (f.42, 1982)

{Në kapitalizmin e sotëm "***kontrollin***" e qeverisjes e bën vetëm mekanizmi i votës. Shpallet me kushtetutë e drejta për të votuar. Bëhet zhurmë e madhe në kohë zgjedhjesh, blihen votat, vidhen votat, më në fund edhe rrëmbehen, dhe kështu efikasiteti i "***kontrollit***" shndërrohet sërish në një zero. 2012}

PPSH ka një politikë të drejtë lidhur me organet drejtues, **të zgjedhur**, në pushtetin qendror dhe lokal dhe në organizatat e masavet, në të gjitha instancat. Ata të instancavet të ulëta, që zgjidhen nga **gjiri i masës**, janë kryesisht punëtorë ose fshatarë. Kështu ruhet karakteri klasor i këtyre të quajturavet ***leva të partisë***. Mirëpo, vihet re që këta njerëz **të zgjedhur**, ndonëse janë njerëz të mirë, të partishëm etj, në shumë raste, sidomos në fshat, janë të plogët. Nuk janë të zotë, nuk janë të përshtatshëm për punë drejtuese. Puna arrin deri aty, sa **organet E EMËRUAR ua marrin shpesh kompetencat organevet TË ZGJEDHUR**. Shoku Enver Hoxha, në "***Raporte e fjalime***" 1965-1966, f.239, thotë kështu: "***Nga njëra anë legjislativin e kemi lënë formal, nga ana tjetër ekzekutivin e kemi rënduar, e kemi bërë impotent me një administratë të fryrë.***") Po në këtë vepër, në f.236, shoku Enver Hoxha konstaton kështu: "***As që i shkon ndërmend këshillit popullor të rrethit apo të fshatit të kritikojë, kur është rasti, veprimet e qeverisë, ligjet dhe Kuvendin Popullor***." Pyetja që shtroj unë, është kjo: ***Pse ndodh kështu?*** Përgjigjja është: ***Sepse ata nuk kanë shkollë sa duhet***. Edhe atë shkollë që e kanë, shumica e tyre e kanë marrë me 5-a, pa e çuar asnjëherë dorën për të folur para mësuesit. Po ku kanë vajtur ish-nxënësit e mirë, ata të rregulltit, ata nismëtarët e dalluar që hidhen të parët në çdo punë? Ata i ka marrë shtresa e inteligjencës. U ka dalë bursa, kanë shkuar në universitet (dhe mirë kanë bërë që kanë shkuar atje) dhe **miti i diplomës**, koncepti i ligjësuar i pronësisë mbi punën që garanton diploma, i ka hedhur në sferën e inteligjencës dhe i ka varfëruar mendërisht e intelektualisht klasën punëtore e fshatarësinë. **Klasa kështu është varfëruar**

aq shumë, sa aty ke vështirë të gjesh disa njerëz për t'i vënë në krye të organizatavet të masavaet. Lind prapë një pyetje tjetër: ***Si gjendeshin këta njerëz në kohën e Luftës ose fill mbas Luftës, kur ¾ e popullsisë ishin analfabete?*** Ata ishin pa shkollë atëherë, sepse pushtetet antipopullorë i patën lënë ashtu, por ishin shpuzë nga mendja dhe kjo bënte që ata, si të zgjedhur, ta kryenin me sukses detyrën. Kurse tani, nuk janë pa shkollë, se i la pushteti, por janë pa shkollë se s'ishin në gjendje intelektualisht për të vazhduar shkollën. A mund të pritet prej të këtillëve që të drejtojnë **legjislativin**?

Kjo është gjendja, prandaj, për ndreqjen e saj, PPSH duhet të ndëmarrë masat e nevojshme. (f.43, 1982)

{E gjithë kjo po dëshmonte që përpjekjet e udhëheqësvet të komunizmit, për të krijuar një shoqëri ku të sundonte drejtësia, po dështonin. Por, tani të shohim: Ç'kanë thënë filozofët e komunizmit lidhur me këto punë që nuk po ecnin mirë dhe si e pata analizuar unë situatën 100 vjet pas tyre? 2012}

"***Çdo brez, nga njëra anë e vazhdon veprimtarinë e trashëguar në kushte krejt të ndryshuar, ndërsa, nga ana tjetër, i ndryshon kushtet e vjetër me anë të veprimtarisë krejt të ndryshuar***." (K.Marks, F.Engels: "***Ideol.gjerm***." f.66) Ku konsiston "***vazhdimi i veprimtarisë së trashëguar***" i brezit, mbas atij që bëri luftën? Ky vazhdim i veprimtarisë së trashëguar konsiston në ndërtimin e mëtejshëm të socializmit.

Cilët janë "***kushtet krejt të ndryshuar***"? Kushtet krejt të ndryshuar, midis tjerash, janë: Borgjezia nuk është më në pushtet, nuk ka më proletarë, klasa punëtore ka pushtetin në dorë, nuk ka (institucionalisht) shfrytëzim të njeriut prej njeriut, nuk ka varfëri ekstreme. Si pasojë, ekziston i fortë rrëziku i shkujdesjes dhe i kthimit prapa. Këta kushte ***krejt të ndryshuar*** nuk janë të paktë e të papërfillshëm. Këta janë pra "***krejt të ndryshuar***", siç e thonë edhe klasikët e marksizëm-leninizmit.

Më në fund, brezi i Mbasluftës, çfarë "***veprimtarie krejt të ndryshuar***" do të zhvillojë për t'i "***ndryshuar kushtet e vjetër që gjeti***"? "*Ai e gjeti socializmin të ngritur në këmbë. Ç'i mbetet tjetër për të bërë?*" Do të thotë dikush.

Veprimtaria e brezit të Mbasluftës, ***krejt e ndryshuar***, normalisht, duhet të jetë kjo: Ai brez nuk do të bëjë më luftë me armë për të përmbysur rendin e vjetër, por do të bëjë luftë (një lloj tjetër lufte) për përsosjen e rendit të ri. Ai brez nuk do të bëjë luftë për përmbysjen e klasavet shfrytëzuese, por do të bëjë luftë kundër ridaljes në skenë të klasavet shfrytëzuese.

Këto gjëra janë tepër të rëndësishme. Këto gjëra kërkojnë studime seriozë dhe, mbi bazën e shkencës marksiste, ata studime me siguri do të çojnë në zbulime të rinj. Veprimtaria është veprimtari. Ajo, siç mund të jetë e drejtë, mund të jetë edhe e gabuar. Lufta është luftë. Ajo, siç mund të fitohet, mund edhe të humbet. Në Jugosllavi e humbi luftën vetë brezi i luftës. Në Bashkimin Sovjetik u humb lufta kryesisht për arsye se rruga e mëtejshme nuk njihej.

Midis një situate të këtillë, është e qartë se shumë gjëra varen nga trajtimi **subjektiv** (i cili mund të jetë shkencor ose joshkencor) i realitetit **objektiv.** Pra, kur themi se ato **shumë gjëra** "***varen nga trajtimi subjektiv***", kjo do të thotë se ato **varen nga partia**.

Cila do të ishte puna më e mirë e mundshme që do të duhej të bënte brezi i vjetër, për të siguruar një veprimtari sa më të suksesshme të brezit mbasardhës? Puna më e mirë e këtij brezi, në fund të jetës së vet, do të ishte kjo: Në bashkëpunim të ngushtë me brezin që gradualisht po e merr detyrën historike, **të kryejë, sa të jetë e mundur më të saktë, studimet përkatës për periudhën që po fillon**. Kjo do të thotë që brezi i vjetër duhet ta vërë veten, sa të jetë e mundur, në pozitën e brezit pasardhës. Për të arritur rezultatin e dëshiruar, është e qartë se asgjë nuk mund të bëhet me porosira. Të gjitha shpresat e siguritë duhet të kërkohen vetëm te krijimi i kushtevet objektivë të rinj, në mënyrë që subjekti, brezi i vjetër, me gjithë ç'ka krijuar ai, të jetë një rrethanë objektive **e volitshme** për brezin e ri. (f.44-45, 1982)

{Enver Hoxha u përpoq të bëjë analiza dhe të japë orientime, por nuk arriti të nxjerrë konkluzionet, që do të mund ta shpëtonin nga shkatërrimi atë që është ndërtuar. U krijuan edhe institute, por as ata nuk bënë asgjë. Nëse, në zyrat e atyre instituteve do të ishin ulur jo vetëm njerëz të përkushtuar, por edhe me kapacitetin e nevojshëm, mbase atje do të mund të arrihej në të atillë konkluzione që të bëheshin ato punë që duheshin bërë. Nëse nuk mund të shpëtohej komunizmi, siç rezultonte faktikisht, atëherë së

paku të studioheshin mënyrat se si mund të bëhej **restaurimi,** kthimi në kapitalizëm, por jo në atë kapitalizëm që u pat sjellë mynxyra popujvet.

Nuk është strateg i suksesshëm ai, i cili, në planet e tij të sulmit, nuk përpunon edhe variantet për t'u tërhequr. Madje edhe për të nënshkruar marrëveshje me armikun.

Mirëpo, ne jemi të detyruar të shohim edhe anën tjetër të kësaj beteje, që u quajt ***Luftë e Ftohtë***. As borgjezia ndërkombëtare, kryesisht ajo evroamerikane, pjesa e saj **POZITIVE**, nuk i studioi mënyrat se si do të **restaurohej** kapitalizmi në vendet ish-socialistë. Ajo u kushtoi vëmendje vetëm mënyravet se si do të shpartallohej komunizmi, por se ç'do të bëhej më vonë, në të mirë të të quajturit **rend i ri botëror**, ajo as që e vrau mendjen fare. **Restaurimin e kapitalizmit në ish-vendet me regjim socialist, të dështuar tashmë, e bënë fare praktikisht dhe pa kurrfarë teorie paraprake, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, pjesa NEGATIVE e kapitalizmit dhe pjesa NEGATIVE e ish-sistemit socialist.** Bënë një lloj përjashtimi Gjermania dhe Kina. Sidoqoftë, kjo mungesë strategjie, ky boshllëk fatal në fushën e strategjisë nga të dyja palët, unë kam bindjen se do t'i kushtojë njerëzimit, në radhë të parë Evropës e Amerikës, **jashtëzakonisht** shumë shtrenjtë. 2012}

{Më poshtë, unë kam vazhduar me mënyrën si e konceptoja unë problemin në atë kohë. 2012}

Njerëzimi dëshiron që ta realizojë ëndrrën e komunizmit. Ai ka derdhur shumë energji, mundim edhe gjak, për ta bërë realitet këtë ëndërr. Ëndrrat e komunizmit janë madhështore dhe ato çojnë peshë zemrat e miliona njerëzve. (f.46, 1982)

{Të paktën deri në vitet 1960 kështu ishte. 2012}

Ne shqiptarët nuk mund të mos jemi krenarë, kur mendojmë se ato ëndrra që e shtyjnë njerëzimin në sakrifica, kalojnë sot pikërisht nëpërmjet realitetit tonë. Ne shqiptarët gjithkështu nuk mund të mos ndjejmë përgjegjësi të

madhe, kur ta mendojmë se gjithë bota prokomuniste sytë i ka drejtuar nga ne. (f.46, 1982)

{Një qytetare angleze, e cila po bënte vizitë në Shqipëri, duke ndjekur rrugët nga kish kaluar dikur Edith Durhami, deklaroi në vitin 2011, se, në rininë e saj, e kishin adhuruar Shqipërinë Socialiste. Ia tha këtë z.Auron Tare. 2012}

Cilat janë ëndrrat e komunizmit? **Jetë në barazi. Pa ndarje në të pasur e në të varfër. Punë për të gjithë dhe: TË PUNOJNË TË GJITHË**. Industri të madhe e të gjithdegëshme. Bujqësi të lulëzuar kudo. Jetë në një bollëk **TË ARSYESHËM**. Epokë pa luftëra dhe pa shpenzime të çmedur armatimi. Organizim sa më të përsosur në çdo fushë. Kulturë cilësore. Sjellje të mirë e mirëkuptim gjithnjerëzor. Minimizim permanent të budallallëqevet shoqërorë, të atillë si besimet fetarë (Besime te një fuqi madhore të mbinatyrshme, e cila u kujdeska veçanërisht për milingonat-njerëz!) dhe të gjithë çfarë lidhet me ata besime. Mungesë e urrejtjes nacionale e raciste. Mungesë korrupsioni dhe imoraliteti të çdo lloji. Jetesë përgjithësisht e njëllojtë në qytet e në fshat. Arsim të njëshkallshëm maksimal për të gjithë. Vënien e parasë, të kësaj shkaktareje të shumë fatkeqësive shoqërore, nën një disipline të rreptë shkencore. (f.46, 1982)

{Paraja është një shpikje njerëzore, e cila, me doemos, duhet vënë nën kontroll. Përndryshe ajo, në një krah bën mirë, në krahun tjetër i shndërron në kufoma, herë edhe të gjalla, miliarda njerëz. Me këtë temë pata bërë një elaborat të posaçëm dhe ai u diskutua në nivel instituti, por pa kurrfarë rezultati. 2012}

Si do të vijë, ose: Si mund të vijë ky komunizëm? Vetëkuptohet që ai nuk vjen vetë. Atë do ta sjellin njerëzit, ashtu siç i kanë sjellë njerëzit edhe sistemet e tjerë shoqërorë e veçanërisht socializmin, në rrethana të caktuara historike. Komunizmin nuk mund ta sjellë në skenë askush tjetër, veçse **NJERIU I KOMUNIZMIT**. Për këtë **NJERI** ka ardhur koha tashmë që të shfaqet në skenën e historisë **më i plotë dhe më i perceptueshëm**. Aq më tepër sot, kur qindra mijë sharlatanë kanë guximin ta quajnë veten komunistë dhe miliona të tjerë mbas tyre, po ashtu pa qenë as përafërsisht njerëz të komunizmit, e quajnë veten të tillë. Ka ardhur koha, them unë, që tiparet e **NJERRIUT TË KOMUNIZMIT** të jenë të përcaktuar mirë dhe të jenë dallimisht të qartë për cilindo. Ku dhe kur do të shfaqet ky **NJERI**? I vetmi

vend, që sot i ka mundësitë dhe kushtet objektivë, për t'u shfaqur **NJERIU I KOMUNIZMIT**, që ta shohë qartë gjithë bota dhe të marrë shembull prej tij, është RPSSH-ja. Ndaj dhe detyra e saj është, sa e vështirë dhe me përgjegjësi, aq edhe madhështore. (f.46-47, 1982)

{Në të vërtetë, RPSSH nuk kish kurrfarë mundësish, as kurrfarë kushtesh, as objektivë, as subjektivë. 2012}

{Pata thënë kështu, sepse besoja në mendjen dhe arsyetimin e kthjellët të Enver Hoxhës. Prandaj edhe ia dërgova pikërisht atij këtë libër. Por, sidoqoftë, një **NJERI** me tipare ndryshe nga i derisotmi, duhet të shfaqet në botë, sa nuk është vonë. 2012}

NJERIU I KOMUNIZMIT. (Fjala ***NJERIU***, në njëjës, është përdorur këtu me kuptimin përgjithësues. Në atë koncept përfshihen dhjetëra mijë e më vonë qindra mijë e miliona individë.) Simbas Engelsit, **NJERIU I KOMUNIZMIT** është ky: **Kur e kërkon nevoja, inxhinier, kur s'ka nevojë për punë inxhinieri, punëtor i thjeshtë që punon me karrocë dore.**

Kur shfaqet **NJERIU I KOMUNIZMIT** dhe a bëhen të gjithë njerëzit pënjëherësh të tillë, apo dalin tek-tuk, nga 1 e nga 2, dhe pastaj vijnë duke u shtuar? **Skllavopronari dhe skllavi**, si përbërës socialë të rendit skllavopronar, janë shfaqur jo në rendin skllavopronar, por më parë, qysh në komunitetin primitiv. **Feudali dhe bujkrobi** janë shfaqur në periudhën e shthurjes së rendit skllavopronar, dmth, para feudalizmit. **Kapitalisti dhe proletari** janë shfaqur në feudalizëm. Pra, secili, 1 formacion shoqëror më parë se i veti dhe secili ka bërë **luftë të madhe** për ta prurë në arenën e historisë formacionin e vet "***të dashur***".

Në qoftë se socializmi është pararendës i komunizmit, atëherë pa tjetër që **NJERIU I KOMUNIZMIT duhet të shfaqet qysh në socializëm, madje qysh në kapitalizëm**, i atillë siç do të jetë në komunizëm. Vetëm se këtu është e nevojshme të bëhet një sqarim "***i vogël***". Formacionet e deritashëm shoqërorë nuk kanë qenë **vepra shkencore**. Ata, sado që as atyre s'u kanë munguar traktatet e manifestet, dilnin, si të thuash, vetëvetiu, në rrethana të caktuara historiko-shoqërore. Kështu që edhe klasat që do të hynin në përbërjen e tyre, lindnin, si të thuash, vetëvetiu, si pjellë e zhvillimit të forcavet prodhuese. (f.48, 1982)

{Mund të marrim si shembull njeriun monoteist, religjion i feudalizmit, i cili u shfaq në mohim të politeizmit, religjon i skllavopronarisë. Njeriut monoteist iu deshën 300 vjet për t'u bërë zotërues në shkallë të gjërë në një pjesë të konsiderueshme të botës. Tash monoteizmi mistik është plakur dhe njerëzimi do ta zëvendësojë me një religjion jomistik. Kjo është e pashmangshme, nëse njerëzimi nuk "*dëshiron*" të shndërrohet në pluhur radioaktiv. Njeriu e ka të domosdoshme të besojë në diçka dhe kjo nuk arrihet ndryshe, veçse me anë të predikimit. Kur K.Marksi pat shkruar që "***feja është opium për popullin***", e kish fjalën për monoteizmin mistik. Ndërkaq, për një religjion jomistik, për një "***opium pozitiv***", njeriu do të ketë nevojë në të ardhshmen, siç ka nevojë për oksigjenin. 2012}

Edhe komunizmi është, po ashtu, pjellë e zhvillimit të forcavet prodhuese. Mirëpo, komunizmi është një vepër e mirëfilltë shkencore, e ndërtuar **ME DASHJE** nga njeriu, i cili tashmë, duke pasur shkencën e marksizëm-leninizmit në dispozicion, është bërë njohës i ligjësivet shoqërore dhe rrjedhimisht, mund të bëhet edhe shfrytëzues efikas i atyre ligjësive. (f.48, 1982)

{Njeriu i monoteizmit kish në dispozicion ***Biblën***, ***Kur'anin*** etj. 2012}

Ky fakt nuk duhet nënvleftësuar, sepse tregon që **NJERIU I KOMUNIZMIT nuk shfaqet si lulëkuqja në grunajë**. **Ai vetëkrijohet me ndërgjegje**, duke e parë se kushtet historikë e kërkojnë dhe e favorizojnë një vetëkrijim të tillë.

Pyetja dhe sqarimi i dytë "***i vogël***": Midis gjithë njerëzve që përbëjnë shoqërinë socialiste, cila kategori njerëzish është ajo nga duhet të dalë **NJERIU I KOMUNIZMIT**? **Njeriun e komunizmit** ka për detyrë ta krijojë **partia marksiste-leniniste**. I pari që do të marrë tiparet e këtij lloji njeriu, do të jetë **komunisti**, pastaj atë do të mund ta ndjekin edhe të tjerët në të njëjtën rrugë. Lexuesi këtu e ka vënë re pa tjetër që unë bëj dallimin midis nocionit ***komunist*** ose ***anëtar partie*** dhe **NJERIUT TË KOMUIZMIT**. **Komunisti i sotëm nuk i ka të gjithë tiparet e NJERIUT TË**

KOMUNIZMIT, ndërsa **NJERIU I KOMUNIZMIT** i ka tiparet e **kominist**it, por ka edhe më tepër, madje shumë më tepër, sepse ai është njëkohësisht **edhe punëtor krahu, edhe i pajisur me njohuri universitare**. **NJERIU I KOMUNIZMIT**, pra, është një zhvillim i mëtejshëm i **komunistit** të derisotëm.

Lenini, në të vërtetë, kërkesën për krijimin e këtij lloj njeriu e ka shtruar me kohë, por ajo kërkesë nuk u zbatua. Ja si thotë Lenini në tetor të vitit 1920: "***Ai*** (komunisti) ***duhet të kuptojë se këtë shoqëri*** (shoqërinë komuniste) ***mund ta krijojë vetëm mbi bazën e një arsimi modern dhe, në qoftë se ai nuk do ta zotërojë këtë arsim, komunizmi do të mbetet vetëm një dëshirë***." (V.I.Lenin, J.V.Stalin: "***Mbi rininë***", f.140) Pra, Lenini e ka thënë prerë, por kjo, me sa duket, nuk pat rënë më sy në Bashkimin Sovjetik për shkak se vëmendja më e madhe ishte përqëndruar te **ekonomia** dhe, për të përparuar sa më shumë **ekonominë**, u konsiderua si problem kryesor kujdesi ndaj kuadrit, ndaj nëpunësvet dhe specialistëvet. Dëshira për të pasur nëpunës dhe specialistë sa më të zotë, bëri që të lihet pas dore **domosdoshmëria për të krijuar NJERIUN E KOMUNIZMIT**, i cili do ta zgjidhte 1000 herë më mirë edhe problemin e ekonomisë, edhe të kuadrit, edhe edukimin e punëtorëvet e të fshatarëvet. (f.49, 1982)

{Duke shkruar këtë pjesë, në atë kohë, unë mund ta kem përfytyruar që ky lloj njeriu as që do të mund të krijohej në këtë fazë të zhvillimit të shoqërisë njerëzore. Kurse tani po kam frikë, po kam shumë frikë, që shoqëria njerëzore e ka më **"*të lehtë*" të rikthehet në stadin e vet të dikurshëm primitiv** (thjeshtë si pasojë e një **lufte bërthamore)**, sesa t'i hyjë "***zahmetit*" "*për të modeluar*" NJERIUN E KOMUNIZMIT**. Sidoqoftë, nëse nuk **"*dëshiron*"** të qorrollepset drejt greminës së komunës primitive, e cila **vjen apo nuk vjen** pas luftëravet bërthamoro-kimiko-bakteriologjike, **NJERËZIMI** do të jetë i detyruar ta krijojë një **SHPËTIMTAR**. Ai, pas gjithë gjasave, do të jetë **ILUMINISTI** apo **NEOILUMINISTI** i kohëvet që ende nuk kanë ardhur. 2012}

Në komunizëm thuhet që puna e njerëzvet nuk do të paguhet, sepse atëherë thuhet që nuk do të ketë para. Me ta pranuar si të besueshme këtë hamendje, arsyeja e njeriut bën përnjëherësh një varg pyetjesh: ***A do të fillojnë të gjithë njerëzit, me një urdhër, me një vendim, që të mos marrin para për punën***

që bëjnë? Përgjigjja pohuese nuk është fort e besueshme, pasi kushtet nuk piqen në të njëjtën kohë për të gjitha kategoritë e njerëzvet. (f.50, 1982)

{Por mendimi im sot është, që, sido që të vijnë punët, nëse njerëzimi do t'ia dalë për të sajuar një botë ku luftërat të jenë të ndalueshme, një të atillë botë që **Xhek Londoni** e ka quajtur ***Epoka e Vëllazërimit të Popujvet***, puna e njerëzvet prapë do të matet në një farë mënyre, pra, do të ketë një lloj paraje, por ajo do të kontrollohet elektronikisht, në mënyrë që askush të mos mund të marrë shpërblim pa e merituar **realisht** atë shpërblim. 2012}

Pyetja tjetër që bëhet, është kjo: ***Cila kategori njerëzish do të fillojë e para të mos pranojë pagë për punën që kryen?*** (Këtu ka rëndësi përdorimi i shprehjes ***të mos pranojë*** në vend të shprehjes ***të mos i jepet***, sepse kjo e dyta nuk do të sillte **komunizmin**, por **sistemin skllavopronar**. (f.50, 1982)

{Në vitet kur po shkruhej ky libër, në një numër kooperativash gjendja e fshatarëvet (edhe e komunistëvet, bashkë me ta), kish filluar t'i ngjante gjendjes së **SKLLEVËRVET**, por **PA SKLLAVOPRONARË**. Themi ***PA SKLLAVOPRONARË***, sepse ata që i drejtonin keq punët, s'kishin as vetë kurrfarë pasurie. Ish vërtet e neveritshme të shihje si silleshin "***drejtuesit***" në situata të tilla. "***Skllavopronarë***" mjeranë, që e shisnin veten për një kafe, për një drekë (një turli e një birrë) apo, e shumta, për një kec apo qengj të rrjepur, çuar në një thes te banesa e tij. Këta ishin **"*SKLLAVOPRONARËT"*** e atëhershëm! Të neveritshëm në kuptimin më poshtërues të fjalës!

Atë Zef Pllumi ka perceptim të nxituar në këtë çështje, sepse ai e quan skllav krejt popullin nën një regjim komunist. Ai nuk shikon që komunizmi, në fazën e parë, e **ÇLIRON** njeriun nga skllavëria (përveç atyre që i fut në burg). Pastaj, dmth më vonë, komunizmi, duke **DEGJENERUAR në ANTIKOMUNIZËM,** e **RISKLLAVËRON** masën e madhe të popullit dhe, njëkohësisht, i nxjerr nga burgu ithtarët e antikomunizmit.

{Por unë, në atë kohë, pata vazhduar me këtë lloj gjykimi. 2012-2013:}

Kategoria e parë e njerërzvet që nuk do të pranojnë pagë për punën që kryejnë, do të jenë, pa tjetër, anëtarët e partisë marksiste-leniniste, komunistët. Në rast se nuk do ta bëjnë këtë punë komunistët, askush tjetër në shoqërinë socialiste nuk do ta bëjë, dhe **komunizmi nuk do të vijë.**

Pyetja e tretë: ***Komunistët a do të heqin dorë menjëherë nga çdo lloj page?*** As kjo s'është e besueshme, pasi do të ishte shumë e vështirë për t'u zbatuar në praktikë. Si do të rronin ata? Çfarë do të hanin? Me se do t'i mbanin ata fëmijët e vet, në një kohë kur të gjithë njerëzit e tjerë, për punën që bëjnë, marrin një pagë të caktuar dhe pothuaj të gjithë sendet blihen ende me para? Pra, komunistët fillimisht **vetëm një pjesë të punëvet** të tyre do ta kryejnë **pa shpërblim** dhe, me shembullin e tyre vetjak, do të tërheqin në këtë mënyrë veprimi edhe njerëz të tjerë. Vetëm pasi të jetë arritur kjo në shkallë të gjërë, shoqëria njerëzore do të mund të kalojë në një stad tjetër të zhvillimit, por përsëri nën udhëheqjen e komunistëvet, që gjithnjë e më tepër do të jenë vetëshndërruar në **NJERËZ TË KOMUNIZMIT**.

Pyetja e katërt: ***Cila punë duhet të fillojë të kryhet pa shpërblim, a puna fizike apo puna mendore?*** Prodhimi është baza e shoqërisë. Puna prodhuese është karakteristika themelore e klasës punëtore. Ajo i jep emrin kësaj klase. Në qoftë se komunistët do të fillonin papritur ta kryenin pa para këtë punë, kjo do të ishte një **shaka e rrëzikshme**, një kuptim së prapthi i këtij problemi. Një veprim i tillë do ta shpallte primare, të domosdoshme, punën mendore, organizimin etj., ndërsa sekondare do të mbetej puna e krahut. Por komunistët nuk do të veprojnë kështu. Komunistët do të vënë në shërbim të shoqërisë, pa shpërblim, **mendjen** e tyre. **Puna fizike, puna e specialistit, profesioni, zanati, për një kohë të gjatë, e ndoshta për gjithnjë, do të mbeten të paguara.** (f.51, 1982)

{Enver Hoxha, në atë kohë, po bënte një eksperiment me një të quajturin Alo Qose, i cili rrogën e merrte si brigadier, pra, si nëpunës, ndërsa bënte edhe 300 ditë-punë në vit, si punëtor krahu, pa pagesë. Ky fragment i librit tim një të tillë eksperiment e quante **shaka të rrëzikshme**. Kjo, pa dyshim, ka qenë një disidencë, por jo drejt kapitalizmit. Sot shtrohet kjo pyetje: A nuk është lexuar ky libër i imi dhe s'është vënë re kjo **kundërshti**, kjo **disidencë**, apo regjimi i Enver Hoxhës

nuk i dënonte njerëzit që shpreheshin hapur dhe sinqerisht? Mund të jenë të 2-ja. 2012}

Kjo është e vetmja rrugë që mund të ndiqet. Gjatë historisë, në mënyrë primitive, ka pasur shumë raste të ushtrimit të funksionevet shoqërorë ose të mjeshtërivet të ndryshme **PA PAGESË**. Kështu, prijësit e disa fiseve të lirë, në Mesjetë, ndonëse paraja ekzistonte, nuk paguheshin për funksionet e tyre. Mjekët popullorë, në shumicën e rastevet, e ushtronin profesionin e mjekut pa shpërblim. Mësuesit e gjuhës shqipe në vendin tonë në shumë raste e bënin atë punë jo kundrejt një shpërblimi, por bile duke shpenzuar vetë. Rapsodët, gjithashtu, për krijimin e rapsodivet e të poemavet të tyre, kurrë nuk janë paguar në kuptimin e mirëfilltë. (f.51, 1982)

{Sot, duke pasur tanimë tjetër qëndrim ndaj religjionevet, mund të shtoj edhe këtë: Rregulltarët e Kishës Katolike, filluar prej benediktinëvet, dominikanëvet e këndej, për punën që kryenin apo kryejnë në përmbushje të misionit të vet fetar, merrnin e marrin si shpërblim vetëm ushqimin, veshjen dhe banimin. 2012}

Ndërkaq, në kohën tonë, kur ideja e komunizmit është përhapur në krejt planetin, ne i **paguajmë** njerëzit për t'u bërë mësues, mjekë, letrarë etj (u japim bursa), pastaj, për shërbimet që na kryejnë, psh për një të vënë të stetoskopit në parzma apo për një shkronjë që na u mësojnë fëmijëvet, prapë i **paguajmë**. Natyrisht, gjersa kjo mënyrë është futur në shoqëri, duke luajtur edhe si e këtillë rolin e vet progresiv, njerëzimi do ta praktikojë edhe në të ardhshmen. Por logjika komuniste duhet ta pranojë që në këtë traditë ka shumëçka për të ndryshuar. Se si do të kryhet kjo punë, është çështje tjetër. Bëhen studime, diskutohet, nën udhëheqjen e partisë dhe mbi bazën e marksizëm-leninizmit, dhe vendoset për të vepruar. Unë them që kjo punë do të mund të realizohej në këtë mënyrë: Mjekët komunistë, mësuesit komunistë, inxhinierët komunistë, agronomët komunistë, muzikantët komunistë, sportistët komunistë, shkrimtarët komunistë, studiuesit komunistë, ekonomistët komunistë, gazetarët komunistë, pra, jo të gjithë ushtruesit e këtyre profesineve, por vetëm ata që janë **komunistë**, dhe bile ata që pranohen rishtas në parti, pasi të jetë marrë vendimi përkatës partiak, vendosin që profesionin e vet **intelektual** ta kryejnë **pa pagesë**. Mjetet e jetesës ata vendosin që t'i sigurojnë me punë të drejtpërdrejtë prodhuese, duke punuar si punëtorë të thjeshtë dhe duke marrë shpërblimin për punën e kryer si të gjithë punëtorët e tjerë.

Ndonëse, për t'u zbatuar kjo reformë, është shumë vështirë, për t'u kuptuar këtu s'ka asgjë të vështirë. Dikush duhet të fillojë të punojë **pa pagesë**, disi duhet të fillohet të punohet **pa pagesë**, në të kundërtën, s'ka zhdukje të parasë dhe s'ka komunizëm, gjë që do të thotë se kapitalizmi është i përjetshëm. (f.52, 1982)

{Unë tani mendoj që kapitalizmi, në qoftë se klasa kapitaliste (pjesa pozitive e saj) nuk dëshiron të zhduket bashkë me proletarët e vet, do të duhet ta krijojë vetë një rend të ri: një rend që do të udhëhiqet nga **ILUMINISTËT** ose, ndoshta, **NEOILUMINISËT**. Nëse nuk do të veprojnë kështu (pjesa pozitive e kapitalistëvet bashkë me pjesën pozitive të shtresavet të tjera), edhe jeta e kapitalizmit do të jetë shumë e shkurtër dhe atë, pasi të jenë larguar retë radioaktive të luftëravet atomike, do ta zëvendësojë komuna primitive (siç thamë edhe pak më lart). Rrugë tjetër shpëtimi nuk ka, përveç një marrëveshjeje gjithnjerëzore, të iniciuar prej **NEOILUMINISTËVET**. 2012}

Natyrisht, s'besoj të ketë njeri që këtë ide ta konceptojë kështu: Komunisti-mjek punon 8 orë punë krahu, me pagesë, pastaj shkon në spital dhe bën 8 orë të tjera shërbim te të sëmurët. Ose: Komunisti-mësues bën 8 orë punë në kooperativë, pastaj shkon dhe u bën 5 orë mësim nxënësvet, bën edhe 5 orë të tjera studim e përgatitje për mësimin e nesërm. Kjo do të ishte një mënyrë të menduari për të hedhur poshtë krejt idenë. Do të ishte një mënyrë tepër e shkurtër e të arsyetuarit. As mjeku-komuninst nuk do të bente më shërbim **me orar** pranë të sëmurëvet, as mësuesi-komunist nuk do t'u jepte më nxënësvet mësim sipas një **orari** tradicional. Profesionin e tyre si mjek dhe si mësues ata do ta ushtronin krejt ndryshe. Si **NJERËZ TË KOMUNIZMIT**, profesioni bazë i tyre do të ishte e do të mbetej: **punëtorë**. (f.52, 1982)

{Nëse ithtarët e komunizmit do ta kishin kuptuar seriozisht misionin e vet, të proklamuar prej vetë atyre, ata duhej të kishin vepruar pikërisht kështu. Por ata, ose brezi fill pas tyre, sapo morën pushtetin, vepruan siç kanë vepruar në të gjitha kohët të gjitha klasat **sundimtare**. 2012}

Aspiratat e komunizmit tashmë dihen. Ato i kanë ndezur në shpirtrat e njerëzvet krijuesit e doktrinës së komunizmit, K.Marksi, F.Engelsi, V.I.Lenini, J.V.Stalini. Disa prej tyre, në shërbim të temës që jam duke trajtuar, unë i përmenda këtu. Por faktori vendimtar subjektiv në realizimin e këtyre **aspiratave** ka qenë dhe mbetet për gjithnjë **PARTIA**. Kur s'ka një parti të vërtetë marksiste-leniniste, individët mund të dëshirojnë, mund të aspirojnë, por, po s'u bënë pronë e një partie, ato do të mbeten përgjithmonë ëndrra. Ndërkaq, kur ka një parti të stabilizuar teorikisht, individi edhe mund të gabojë, madje edhe mund të tradhtojë, por aspitatat e asaj ideje realizohen. **Prandaj**, defekti kryesor, kur u bë restaurimi i kapitalizmit në Bashkimin Sovjetik, qëndronte tek Partia Komuniste e Bashkimit Sovjetik. Ajo parti nuk e kuptoi kohën në të cilën kishte hyrë, nuk bëri analizat e duhura shkencore dhe nuk arriti të zbulojë **një ligj objektiv** që vepron në socializëm në kohën e zhvillimit të vrullshëm të forcavet prodhuese. Ky ligj mund të formulohet kështu:

Pararoja e klasës punëtore, në socializëm, në kushtet e një zhvillimi të vrullshëm të forcavet prodhuese, nuk mund ta udhëheqë më tej shoqërinë, pa qenë e ARSIMUAR NË SHKALLËN MË TË LARTË e, në të njëjtën kohë, ajo nuk do të mund të quhet pararojë e klasës punëtore pa qenë anëtarët e saj PUNËTORË TË THJESHTË.

Ky ligj është i së njëjtës kategori me ligjet e tjerë të njohur si: ***Pa pasur një parti të vetën në ballë, klasa punëtore nuk mund ta kryejë me sukses revolucionin***. Ose: ***Pa u bërë kolektivizimi i bujqësisë, nuk mund të triumfojë socializmi*** etj.

Partia Bolshevike nuk e zbuloi këtë ligj. Për këtë arsye ajo nuk i rregulloi me statut kriteret e pranimit në parti, të diktuar nga kushtet e rinj historikë, dhe dështoi në misionin e saj. Por, për këtë ajo mund të akuzohet aq sa mund të akuzohet Arkimedi se nuk e ka shpikur dot makinën me avull ose aq sa mund të akuzohet Xhejms Vati se nuk e ka shpikur lokomotivën me motor dizel. E vetmja vërejtje që mund t'u bëjmë Stalinit dhe bashkëkohësvet të tij, është se ata nuk u thelluan në natyrën e dukurivet të reja të kohës. Në qoftë se nuk do të kish penguar Lufta e Dytë dhe në qoftë se J.V.Stalini nuk do të kish vdekur aq shpejt, ne kemi të drejtë të mendojmë se ky ligj ndoshta do të ishte zbuluar edhe atje. (f.53, 1982)

{Mendimi im i sotëm është se J.V.Stalini, me gjithë meritat që ka në fuqizimin aq të vrullshëm të Bashkimit Sovjetik, ligjin në

fjalë, nëse mund të quhet ligj, ai nuk do ta kish zbuluar dot asnjëherë. 2012}

Që kriteret e pranimevet në parti mund dhe duhet të ndryshojnë herëpas'here, ky është një parim i njohur dialektik. Gjithë puna është, të gjenden momentet, **kur** duhen bërë ndryshime në këta kritere dhe **çfarë** duhet ndryshuar. Për partinë marksiste-leniniste është gjithkështu e domosdoshme të mbahet kurdoherë parasysh edhe ky parim: **Të gjithë ndryshimet që bëhen, t'u shërbejnë rigorozisht interesavet të klasës punëtore**. Ky, për një parti punëtore, është i vetmi kriter i pandryshueshëm, në mes të ndryshueshmërisë së pafund të kriterevet të tjerë.

Deri këtu unë kam folur për mjaft dukuri shoqërore të periudhës së socializmit, ku partia marksiste-leniniste duhet të tregojë kujdes të veçantë. Po i përsërisim edhe njëherë në formë enumeracioni: 1.Dukuria e **POLARIZIMIT** në gjirin e partisë. 2.Mosgjetja në kohën e duhur e një mekanizmi të **VETËDETYRIMIT**, që ta mbante partinë përherë në pozita revolucionare. 3.Mospasja parasysh sa duhet e synimevet të **RINDARJES** së shoqërisë socialiste **NË KLASA**. 4.Mospasja parasysh e dukurisë së **SHPROLETARIZIMIT** të klasës punëtore në socializëm. 5.Mosndryshimi i politikës së **KUADRIT** në kohën kur duhej bërë ky ndryshim. 6.Zbatimi gjysmor i kërkesës së **QARKULLIMIT** në shoqërinë socialiste. 7.Lufta pa sukses kundër **FRYRJES** së aparatevet. 8.Mosgjetja e një mjeti efikas për të kapërcyer me sukses momentin **e NDËRRIMIT TË BREZAVET**. 9.Përdorimi **i ARSIMIT TË LARTË** vetëm për prodhimin e inteligjencës. 10.Moszhvlerësimi **i MITIT TË DIPLOMËS** universitare. 11.Paaftësia e organizatavet-bazë të partisë për të evituar dobësitë në **punën e ORGANIZATAVET TË MASAVET**. 12.Mosrealizimi si duhet **i KONTROLLIT PUNËTOR E FSHATAR**. 13.Moskrijimi **i NJERIUT TË KOMUNIZMIT** (sipas projektit të F.Engelsit) me të gjithë tiparet e tij, në çastin kur ai duhej "***krijuar***". 14.Shkelja e parimit leninist **mbi NDRYSHUESHMËRINË E VETË PARTISË**, ose, më mirë të themi, pamundësia për të gjetur me saktësi atë që duhet ndryshuar në parti, në një situatë të dhënë.

Në gjithë këtë gamë të gjërë problemesh, marksizëm-leninizmi na meson që duhet gjetur se cili prej tyre është **KRYESORI**, zgjidhja e të cilit do të sillte mundësisht zgjidhjen e të gjithë të tjerëvet. Pikërisht për këtë qëllim jam munduar që, të gjithë tekstin ta trajtoj në atë mënyrë që leximi i tij të na çojë në gjetjen pikërisht të kësaj **HALLKE KRYESORE**, e cila në praktikë do

të na i zgjidhte vetëvetiu të gjithë problemet që i shtron koha. Kjo hallkë është: **ADOPTIMI I NJË KRITERI TË RI TE PRANIMET NË PARTI**.

Por, para se të shpreh mendimin **konkret** për këtë problem kyç, e shoh të nevojshme të trajtoj edhe disa probleme të tjerë, që prapë kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me partinë. Këta probleme janë: 1.**ROLI I ORGANIZATËS-BAZË** të partisë në një parti. 2.Pse në periudhën e socializmit **SULMOHEN** aq shumë **DYERT E PARTISË**? 3.Dukuria **e MEFSHTËSISË** në parti. 4.Si mund ta justifikojnë realisht komunistët cilësimin ***BRUMË I VEÇANTË***? 5.Çfarë **SHKOLLE** duhet të ketë mbaruar një komunist? 6.Cilët janë **TË RINJTË MË TË MIRË**, të devotshëm për t'u pranuar në parti?

Do t'i trajtojmë këto sa më shkurt, me qëllim që të sqarohen sa më mirë problemet që i kemi shtruar.

"***Partia është e fortë, kur janë të fortë themelet e saj, organizata-bazë***." ("*Ndërt.dhe jeta e part*.", f.183) Mjafton kjo, që të kuptojmë çdo gjë lidhur me rolin dhe rëndësinë e organizatës-bazë të një partie. Organizata-bazë duhet të udhëheqë të gjitha punët në terren. Çdo dobësim i saj, do të thotë forcim i diçkaje tjetër, që s'është në të mirë të revolucionit, që është **kundërevolucion**.

Mirëpo, çfarë ka ndodhur në praktikë? Në praktikë ka ndodhur që kërkesa lidhur me organizatën-bazë të shndërrohet, në fakt, në një problem të pazgjidhur përfundimisht. Ka arritur puna gjer atje, sa ajo të ketë nevojë për mbrojtje nga lart, duke u thënë drejtuesvet të kategorivet të ndryshme: "***Dëgjojeni organizatën-bazë! Mos e spostoni rolin e saj!*"** A është e rregullt një gjë e tillë? Natyrisht që jo. Partia duhet ta forcojë organizatën-bazë në atë mënyrë që askujt të mos i shkojë dot ndërmend që ta **spostojë** rolin e saj. Vetëm atëherë kur të arrihet që drejtuesvet të çfarëdo kategorie të mos ketë nevojë t'u thuhet, por ata vetë ta ndiejnë e ta kuptojnë epërsinë e organizatës-bazë të partisë në çdo pikëpamje, partia do të mund të thotë se e ka forcuar bazën e vet dhe se kështu ia ka siguruar vetes një të ardhshme të sigurtë. Si do të mund të arrihej kjo? Kjo do të mund të arrihej duke bërë që edhe në socialuizëm, edhe në kohë paqeje e jo vetëm në kohë luftërash, komunistët të jenë **realisht** një ***BRUMË I VEÇANTË***, siç thotë J.V.Stalini. (f.56, 1982)

{Në kapitalizëm, siç e dimë dhe siç po e shohim, ka jo 1, por 10-ra parti. Cili është parimi bazë i pëbashkët i ekzistencës së atyre partive, është vështirë të thuhet. Sidoqoftë, forca e tyre, jo parimi, por forca, matet me forcën e grupevet ekonomikë që mbështesin njërën apo tjetrën parti. Pra, matet me sasinë e paravet që i suportojnë. Duhen bërë studime! Doemos që duhen bërë studime! Ndryshe, **S'KA GJË NË VIJË AS KAPITALIZMI**! Në sistemin 2-partiak (ose shumëpartiak) kapitalizmi "***ka gjetur***" mënyrën më të keqe të së quajturës "***demokraci***". Unë nuk e di nëse klasa punëtore, në kësi kushtesh jodemokratikë, do të mund të krijonte një parti të këtillë siç po e paraqes këtu dhe të synojë për të marrë pushtetin. Gjithsesi, jam i sigurtë që, pa e krijuar **RELIGJIONIN JOMISTIK**, që do t'i zëvendësonte të gjithë religjionet e deritashëm mistikë, nuk do të mund të bëhet asgjë për ta shpëtuar njerëzimin nga katastrofa, e cila tashmë është qartësisht e dukshme. 2012-2016}

Ç'do me thënë të jesh ***BRUMË I VEÇANTË***? Si "***gatuhet***" ai "***brumë***"? Në kapitalizëm këtë "***brumë***" e "***gatuajnë***" në një masë të konsiderueshme rrethanat. Vjedhin dituri, mësojnë fshehurazi ose hapur, por kundër ideologjisë zyrtare, marksizëm-leninizmin, kaliten në ndeshjet e përditshme me armikun e klasës dhe kështu bëhen ***BRUMË I VEÇANTË***. Në socializëm shfrytëzim nuk ka. Është hequr, pra, njëra nga rrethanat e rëndësishme objektive që "***gatuan***" këtë "***brumë***". Në socializëm marksizëm-leninizmi përvetësohet nga shumica e popullsisë. Është hequr, pra, edhe një rrethanë tjetër objektive për të qenë komunisti ***BRUMË I VEÇANTË***. Brumë mund të jetë, por **JO** "***I VEÇANTË"*** në këso rrethanash. (f.57, 1982)

{Lidhur me çështjen, ka apo s'ka shfrytëzim në socializëm, duhet folur më gjërësisht, gjë që do të na largonte nga tema. Mund të themi vetëm kaq: **Shfrytëzimi i njeriut prej njeriut në socializëm vjen si rezultat i moszbatimit, i mosvënies në jetë, të parimevet të atij sistemi**. **Ai shfrytëzim manifestohet veçanërisht dhe kryesisht në të paguarit e mospunës**. Mijëra njerëz punojnë përgjysmë ose më pak, ndërsa rrogën e marrin njësoj si ata që punojnë normalisht. Pra, **shfrytëzohen ata që punojnë normalisht prej atyre që**

nuk punojnë normalisht. Kjo sjell edhe rënien, rrokullimën, në ekonomi. 2012}

Në socializëm, njëfarë "***BRUMI I VEÇANTË***" do të mund të quhej vetëm **INTELIGJENCA**. Ajo ka origjinë prej klasavet dikur të shtypura, ajo në shkollë ka qenë gjithnjë e lavdëruar, asaj i janë dhënë bursa dhe mundësi për t'u shkolluar gjer në shkallën më të lartë, asaj në shoqëri e në shtet i janë besuar punë drejtuese. Kush mund të jetë në socializëm më "***BRUMË I VAÇATE***" se e quajtura ***INTELIGJENCË POPULLORE***? Mirëpo, kjo nuk është as në interesin e klasës punëtore, as në interesin e socializmit. Kjo është, në mënyrë flagrante, **NË DËM TË REVOLUCIONIT** dhe, në qoftë se lejohet edhe më tej një gjendje e tillë, **KOMUNIZËM NUK KA**. Duhet arritur patjetër që, jo inteligjenca, por **KOMUNISTËT TË BËHEN**, realisht e jo me fjalë, ***BRUMË I VEÇANTË*** i shoqërisë, të cilën ata aspirojnë për ta krijuar. Kjo, kuptohet, jo duke ulur inteligjencën, por duke ngritur komunistët në shkallën që u takon në bazë të marksizëm-leninizmit. (f.57, 1982)

{Erdhi shumë shpejt koha, madje më shpejt se ç'mund të pritej, kur brezi i ri i inteligjencës, tashmë **JOPOPULLORE**, iu vu punës, jo për të **NDRYSHUAR** sistemin (ai sistem **DUHEJ NDRYSHUAR**), por për të **SHKATËRRUAR** krejt ç'kishin krijuar prindët e tyre, që nga kanalet vaditës, deri te kombinatet e industrisë madhore. Iu vu "***punës***" kjo inteligjencë, mirëfilli **JOPOPULLORE** dhe trishtueshëm **JOPATRIOTIKE**, bashkë me pjesën tjetër të rinisë, krejtësisht të vetëtrullosur, duke thirrur: "***MJAFT KEMI DURUAR***!" dhe duke thurur ca **ËNDRRA BOSHE MBI DOFARË "*ÇEQESH*", TË CILËT I PASKËSHIN TEPRUAR KAPITALIZMIT.** 2012}

Në anë tjetër, në partinë marksiste-leniniste në këtë kohë shfaqet dukuria e **mefshtësisë**. Pse shfaqet kjo dukuri? Shkaqet, që një anëtar i partisë është **i mefshët**, mund të jenë disa, por shkaku kryesor është, pa dyshim, **pashkollësia**. Kur anëtarit të partisë i mungon përgatitja teorike, kur i mungon elokuenca, forca e argumentimit, kur nuk i nxjerr dot përfundimet e duhur teorikë nga dukuritë që e rrethojnë, ç'i mbetet tjetër atij, veçse të tërhiqet e të heshtë?! Ai mund të jetë i mirë, mund ta dojë rendin shoqëror (jo "***mund***", por e **do** me siguri), mund t'i dallojë veprimet e këqinj nga veprimet e mirë, por për të gjitha këto ai s'është në gjendje të japë, veçse një

mendim të thjeshtë, madje të zbehtë. **Zjarri revolucionar** tek ai nuk arrin të shpërthejë dhe në këtë mënyrë ai jo vetëm nuk arrin të bëhet ***brumë i veçantë***, (sido që të punojë partia për kalitjen e ngritjen e tij), por në shumicën e rastevet mbetet një ***brumë krejt i zakonshëm*****,** në krahasim me djemtë e shkolluar dhe vajzat e shkolluara, të cilët nxjerrin ujë edhe nga rrasa e gurit. (f.58, 1982)

{Duhej thënë: ***I NXJERRIN UJË TË ZI KREJT ATDHEUT, KU KANË LINDUR E JANË RRITUR.*** Ajo që ndodhi në Republikën e Shqipërisë pas vitit 1990, dhe jo vetëm aty, është **PËR TË ULURITUR.** 2012}

A mos çalon puna te kriteret e pranimit në parti? "***Ne kemi edhe nga ata sekretarë që nuk punojnë me librat***", thotë diku shoku Enver. "***Kemi nga ata sekretarë partie të vjetër e me eksperiencë,… që e kanë zor të madh të bëjnë edhe një referat ideologjik…***" A nuk vjen një kohë, pra, që duhet ndryshuar diçka **rrënjësisht** në kriteret e pranimevet? (Fjala ***rrënjësisht*** këtu, natyrisht, nuk duhet kuptuar si diçka që do të përmbyste parimet bazë leninistë lidhur me pranimet në parti, por diçka që nuk do të lejonte më të ketë, as anëtarë të tillë të mefshët, as sekretarë të atillë që "***e kanë zor të madh të bëjnë edhe një referat".)*** (f.58, 1982)

J.V.Stalini, në kohën e vet, e vuri në dukje faktin që, në vitet **pasi kish triumfuar Revolucioni**, pasi sukseset e mëdhenj të Bashkimit Sovjetik e kishin treguar sheshit epërsinë e rendit socialist dhe, në fund të fundit, pasi Pushteti Sovjetik kishte treguar se ishte një pushtet i fortë, **në parti dëshironin të hynin mijëra e miliona njerëz**. Dyert e Partisë Bolshevike po sulmoheshin nga të 4 anët dhe, po të hapeshin ato (ashtu siç u hapën më vonë), mund të hynte atje edhe kallamkusuri. Bile më shumë duket se e sulmonin ata që do ta prishnin partinë, se ata që ishin të dobishëm vërtet. Kjo tregonte se tashmë jo vetëm që nuk ishte e vështirë të jesh komunist, por ishte edhe përfituese në kuptimin personal të fjalës.

Partia e Punës e Shqipërisë, për ta shmangur këtë dyndje kandidatësh, mori disa masa të rëndësishme. Ajo, midis tjerash, vendosi për kandidatët nëpunës edhe **stazhin** 3-4-vjeçar në kushte "***të vështirë***". Kjo (Vini re, ju lutem, vetëm **kjo masë**, e cila në kushtet e jetës së një punëtori në socializëm, as që mund të quhet sakrificë!), bëri që, në kërkesat për të hyrë në parti, të "***normalizohet***" gjendja. (Dmth të mos ketë shumë kërkesa.) Mirëpo, çfarë shikojmë tani? Tani shikojmë këtë dukuri edhe më shqetësuese: "***Është***

vështirë", thonë, "***pak kohë, sa të kryesh stazhin, pastaj***…" Çfarë "***pastaj***"? "***Pastaj je zot. Nëpunës je, komunist je***…" Me 1 fjalë, përsëri plani personal i jetesës me sa më pak strapace dhe me sa më shumë mundësira e privilegje. Ndërkaq, për ata që pranohen në parti nga radhët e klasës punëtore e të fshatarësisë, çështja e stazhit nuk është konceptuar drejt. **Stazhi i këtyre kandidatëve duhet të jetë, jo në punë prodhuese, por në shkollë të lartë**. Bile, ata kandidatë të mos pranohen në parti, në qoftë se nuk e mbarojnë shkollën e lartë me notë mesatare mbi 8.

Si përfundim, në mënyrën që ka adoptuar Partia e Punës e Shqipërisë për pranimet në parti, me gjithë bazën e shëndoshë që ka, ruajtjen e karakterit militant klasor të partisë, vërehet kjo dukuri: **Fshatarët dhe punëtorët janë bërë disi indiferentë ndaj faktit nëse do të militojnë apo jo në parti**. Atyre, në shumë raste, duhet t'u bësh "***agjitacion***" që të hyjnë në parti. **Inteligjenca**, në anë tjetër, **mendohet pak përpara "*pengesës*" së stazhit, por prapë e gjen mënyrën për ta kapërcyer atë "*pengesë***". Që të mos mbushet Partia e Punës e Shqipërisë me inteligjencë, barrikadë është bërë **vetëm raporti në përqindje** që kërkohet nga Komiteti Qendror. Në këtë mënyrë, dyert e Partisë së Punës të Shqipërisë prapëseprapë mbeten "***të pasulmuara***" (me kuptimin: "***të palakmuara***") pikërisht andej nga **duhet** "***të sulmohen***", (me kuptimin: "***të lakmohen***"). Duhet bërë, pra, që në partinë marksiste-leniniste, edhe në periudhën e zhvillimit të vrullshëm të shoqërisë socialiste, të hyjnë në mënyrë normale njerëzit që i **duhen** asaj. (f.59-60, 1982)

{Thënë tani më hapur, në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, tashmë pakkush po mendonte për komunizmin. Tanimë, pothuaj secili mendonte për të rregulluar veten. Por si mund të rregullohej vetja pa pronë private? Duhej rivendosur, pra, prona private. **Duhej rikthyer kapitalizmi**. Dmth makina shoqërore, që kish tentuar të ecte përpara, tanimë kish ngecur në baltë dhe duhej rikthyer mbrapsht. Studimi im mbase nuk do të çonte në zgjidhje, por ai me siguri do të zgjonte debate dhe **debati do të mund të na çonte në zgjidhje**. Duhej të bëheshin studime. Thënë figurativisht, duhej gjetur mënyra për t'u tërhequr dhe për të dalë nga balta. Gjëja kryesore që duhej menduar me këtë rast, ishte kjo: **KAPITALIZMI I RESTAURUAR NUK DUHEJ TË DILTE MË I KEQ SE PJESËT E PËRPARUARA TË TIJAT.** Një kapitalizëm i

restauruar **keq** mund të rezultonte tepër i rrëzikshëm, jo vetëm për Republikën e Shqipërisë, por edhe për të tjerët, sidomos për viset shqiptarë, me të cilët ish e rrethekuar Republika e Shqipërisë. Në planin e ritiratës, që tashmë po paraqitej i domosdoshëm, duhej llogaritur mirë sidomos fakti që të gjithë shtetet rreth nesh, përjashtuar në një farë mase Italinë, ishin **të interesuar** për të mos shkuar mirë rikthimi ynë në sistemin e mëparshëm. 2012}

Që **komunisti duhet të ketë shkollë**, kjo është e ditur, qoftë edhe për arsyen se ai jeton në një epokë kur është shtruar kërkesa që shkolla të jetë pronë e gjithë masavet punonjëse. Diktatura proletare e bën realitet këtë kërkesë. Komunistët, ndërkaq, si pararojë e klasës punëtore, janë, pa dyshim, edhe **iluministë**. Ata e kanë parim përvetësimin e diturisë. Pra, **sa shkollë duhet të ketë komunisti i thjeshtë**? (Nuk po bëjmë fjalë këtu për komunistin intelektual, gjegjësisht për komunistin nëpunës, sepse **komunisti nëpunës nuk është baza e klasës punëtore**.)

Historia, ndonëse studime statistikoro-dokumentarë në këtë drejtim nuk janë bërë, prapëseprapë na tregon disa gjëra me rëndësi. Klasa punëtore në kapitalizëm ka njëfarë arsimi, por kapitalizmi mundohet që të mos i japë asaj më shumë arsim se sa kërkon vendi i saj i punës. Pararoja e saj, **partia**, nga pikëpamja arsimore, **është ajo pjesë e klasës punëtore që ka arritur të mbledhë më shumë dituri nga ç'jep borgjezia**. Jo vetëm udhëheqja e saj, por çdo anëtar partie, në periudhën para revolucionit, nga pikëpamja e diturisë, qëndron më lart se masat punonjëse. Si shkencë, marksizëm-leninizmi dihet se qëndron më lart nga çdo shkencë sociale borgjeze. Si pasojë, edhe si individë, borgjezët, me gjithë fakultetet e tyre, para shumë komunistëve janë injorantë të një shkalle për t'u mëshiruar. Rruga se si e përvetësojnë diturinë komunistët në kushtet e shfrytëzimit kapitalist, është çështje tjetër. (Por është pikërisht ruajtja e njëfarë tradite të asaj kohe në mënyrën e pëvetësimit të diturisë nga ana e komunistëvet të thjeshtë të sotëm, mënyrë që pa dyshim atëherë ka qenë e rezultatshme, në periudhën e socializmit e dëmton rëndë partinë marksiste-leniniste.) **Fakt është**, ndërkaq, **se në kapitalizëm komunistët kanë etje të madhe për dituri dhe ia arrijnë të kenë dituri**. (Kujtojmë Pavël Vllasovin). Vetë revolucioni socialist që udhëhiqet prej tyre, si një vepër e mirëfilltë diturie, e dëshmon këtë.

Në socializëm partia ka pushtetin. **Politika** e saj **arsimore** mbi arsimimin e gjithanshëm të masavet të popullit, është një nga prioritetet e vijës së saj. Në socializëm arsimimi i gjithë popullit merr hov të paparë ndonjëherë më parë. Ai bile përbën **një nga treguesit e epërsisë së socializmit mbi kapitalizmin**.

Po **për vete** ç'bën partia në këtë drejtim? (E kam fjalën për anëtarët e thjeshtë, jo për kuadrot e partisë.) **Për vete** ajo në radhë të parë bën atë çfarë ka bërë për gjithë masat punonjëse: Bashkë me shkallën arsimore të masavet, rritet edhe shkalla arsimore e anëtarëvet të thjeshtë të partisë. Veç kësaj, partia ka kërkesa të veçanta, klasike, ndaj anëtarëvet të vet, për të marrë arsim sidomos lidhur me njohjen e parimevet të marksizëm-leninzmit, lidhur me vijën politike të partisë, me njohjen e gjendjes në vend e në botë etj. Këtu zënë një vend të mirë "**format e edukimit"** në parti. Pra, nuk mund të thuhet se partia marksiste-leniniste nuk e ka këtë çështje nën kujdes. Mirëpo, **nuk mund të thuhet**, gjithkështu, **se partia marksiste-leniniste e ka zgjidhur këtë problem, as në fushën teorike e as në atë praktike**. Është fakt se deri tani anëtarët e thjeshtë të partisë pak dallim kanë pasur nga masa tjetër e punonjësvet, ndërsa në krahasim me inteligjencën popullore ata kanë qëndruar **shumë prapa** dhe, **sa më shumë pajiset me dituri inteligjenca, aq më prapa mbeten komunistët e thjeshtë**. (Relativiteti këtu nënkuptohet.) Po kështu, edhe në krahasim me udhëheqjen e vet, me hierarkinë e partisë, komunistët e thjeshtë kanë mbetur shumë prapa. Pikërisht **kjo rrethanë është arsyeja themelore që në një varg vendesh socialistë**, e sidomos në Bashkimin Sovjetik, **u përmbys diktatura e proletariatit**. **NUK MBAHET MË KËMBË DIKTATURA E PROLETARIATIT DUKE PASUR BAZËN E PARTISË TË PRAPAMBETUR**, qoftë edhe relativisht të prapambetur. Komunisti i periudhës së pararevolucionit dhe i revolucionit mund të ketë qenë më pak i arsimuar se komunisti i periudhës së socializmit (megjithse edhe kjo jo në çdo rast), por relativisht, në krahasim me ambientin, ai ka qenë ku e ku më përpara, prandaj edhe qëndronte në ballë të revolucionit. Ndërgjegjja klasore te punëtorët rritet në proporcion të drejtë me diturinë.

Po çfarë duhet bërë që kjo gjendje arsimore e komunistit të thjeshtë të përmirësohet rrënjësisht? A mund të arrihet kjo me këshilla, me orientime e direktiva? A mund të arrihet kjo me një punë të veçantë të çdo organizate-bazë, me punë individuale? Me asnjë nga këto mënyra nuk mund të arrihet rezultati i dëshiruar. Historia e komunizmit në botë dhe realiteti ynë tregojnë se **JO**. **Rezultati i dëshiruar arrihet duke e parë me sy real vetë**

realitetin që sjell socializmi dhe duke vepruar sipas këtij realiteti me STATUT PARTIE. Rrugë tjetër nuk ka. **KOMUNISTI I THJESHTË NË KËTË PERIUDHË DUHET TË KETË ARSIM UNIVERSITAR.** (f.61-63, 1982)

{Nëse do të kish ndodhur me kohë vendosja e një regjimi të tillë **NË BAZËN E PARTISË**, sipas idesë sime të atëhershme, do të kish sjellë **RRITJEN E PRODHIMIT**. Për pasojë edhe **MIRËQENIEN,** deri në shkallë, aq sa, masa e të papunëvet, prej Perendimit të vërshonte drejt vendevet të Lindjes Komuniste. 2012}

Me çfarë diturie duhet të pajiset një komunist? Cila duhet të jetë shkolla e tij? Mos duhet të hapen shkolla të veçanta për anëtarët e partisë? (**E kam fjalën** përsëri për masën dhjetëramijëshe e në shkallë botërore dhjetëramilionëshe të komunistëvet të thjeshtë, **jo për hierarkitë partiake**.) Kjo, jo vetëm që do të ishte shumë e vështirë për t'u zbatuar në praktikë, por do të ishte edhe gabim parimor. **A do të mund të krijoheshin shkolla speciale për komunistët, kur të qenët komunist nuk është diçka e paracaktuar?** Shteti mund të thotë: ***"Këtë do ta bëjmë mjek, këta të 2 do t'i bëjmë inxhinierë gjeologë, ndërsa këta të 5-të do t'i bëjmë agronomë."*** Po kështu edhe një individ mund të thotë: ***"Unë kam qejf të bëhem agronom."*** Ndërsa **për t'u bërë komunistë, normalisht duhet të synojnë të gjithë**. Kështu që shoqëria, në këtë rast, partia, nuk është në gjendje kurrqysh të vendosë që më parë se cilin të ri do ta bëjë komunist. Aq më tepër kur ajo ka nevojë të shohë konkretisht nëse i ka apo nuk i ka aksh kandidat cilësitë e komunistit.

Shoku Enver Hoxha thotë: "***Komunisti duhet të jetë si të thuash deri diku edhe enciklopedik.***" (*Rap.e fj., 1965-1966, f.25*) Po edhe në rast se në kohën e sotme një individ nuk mund të bëhet enciklopedik në kuptimin klasik të fjalës, partia në vetëvete, në bazën e saj, mund dhe duhet me doemos të jetë e tillë. **Çdo organizatë-bazë, në caqet e mundësivet që sjell koha, duhet të ketë në vetëvete njohuri të gjithanshme**. Duke u mbështetur këtu, logjikisht del që **kërkesa themelore arsimore për një komunist, të epokës pas ndërtimit të bazës ekonomike të socializmit, duhet të jetë, që ai të ketë mbaruar me sukses shumë të mirë njërën prej shkollavet të larta (fakultetevet) që ka vendi.** Se cilin fakultet do të ketë mbaruar kandidati për komunist, kjo nuk ka shumë rëndësi. Në sistemin shkollor socialist

sistemi i edukimit mbështetet në një ideologji të vetme. Pikërisht kjo rrethanë jep dorë që të mos ketë rëndësi se çfarë fakulteti ka diplomuar komunisti. Bazën e kulturës ai gjithsesi do ta ketë të shëndoshë. Duke qenë komunist i thjeshtë, dmth punëtor i thjeshtë, jo kuadër, jo nëpunës, kjo shkollë atij do t'i shërbejë thjeshtë për nivel kulturo-arsimor, për epërsi diturore e gjithformuese mbi kategoritë e ndryshme të nëpunësvet dhe mbi masat e gjëra të popullit, në mënyrë që kështu të jetë i aftë për të udhëhequr nga pozitat e klasës punëtore.

I vetmi PRIVILEGJ i komunistit në shoqëri duhet të jetë epërsia politike, ideologjike, kulturore dhe arsimore. Në këtë mënyrë çështja se çfarë shkolle duhet të ketë kryer një ***kandidat për anëtar partie***, është e zgjidhur vetëvetiu, falë masivizimit të arsimit në socializëm. **Le të bëjë rinia**, gjaku i partisë dhe gjaku i krejt shoqërisë, **sa më shumë shkollë** dhe, midis kësaj rinie të shkolluar, partia marksiste-leniniste do të mund t'i zgjedhë anëtarët e vet në komoditet të plotë. (f.64-65, 1982)

{Në të vërtetë, misionit të komunizmit duhej t'i kushtoheshin vetë individët. Ashtu siç i kushtohen misionit të klerikut individë thuajse të vetëcaktuar. Vetëmse, në këtë rast, mjetet e jetesës komunisti nuk do t'i siguronte nga të qenët komunist.

Dua të theksoj këtu që unë, në ata vite, pata konstatuar të meta të karakterit **thelbësor** në **krejt sistemin arsimor botëror** dhe e pata përcaktuar mënyrën se si do të mund të dilej nga kolapsi, ku e kishte çuar konservatorizmi burokratik arsimin. Por burokracia, si gjithmonë, është mjegull, krijuese e territ jetë-e-dritëmbytës dhe ruajtëse me këmbëngulje e të gjithë llojeve të progrespengimit. **Sistemi arsimor botëror** është në një të atillë krizë, sa ai, në vend që ta ndërtojë, praktikisht **po e shkatërron individin.** 2012}

Saktësimi se cilët janë të rinjtë më të mirë, i duhet partisë marksiste-leniniste për arsyen e thjeshtë se ajo vetëm andej i ushqen, vetëm andej i shton radhët e veta. Rinia është, pra, gjaku ushqyes i partisë marksiste-leniniste, ashtu si te të gjitha partitë e tjera, ç'prejse janë krijuar ato. Është e vërtetë se partia, kur pranon një anëtar, niset edhe nga veçoritë vetjake, individuale, të secilit, dhe kjo është e domosdoshme, por ajo njëkohësisht i shikon anëtarët e vet edhe si kategori: Punëtorë, fshatarë, intelektualë, femra, meshkuj. (Raca e

nacionaliteti kanë rëndësi vetëm për të treguar kujdes që në parti të përfaqësohen si shumicat, ashtu edhe pakicat.) Sidoqoftë, ka rëndësi, madje vendimtare, për të ditur se cilët janë të rinjtë më të mirë, si kategori, në një etapë të caktuar të zhvillimit shoqëror dhe ekonomik. (Ndoshta fjala ***i mirë*** këtu nuk është fort e saktë, se në shoqëri ka shumë njerëz të mirë, të cilët nuk bëjnë fare për anëtarë partie. Mirëpo, unë nuk po gjej dot fjalë tjetër.)

Në kapitalizëm të rinjtë më të mirë, të përshtatshëm për anëtarë partie, të partisë marksiste-leniniste, janë **ata të rinj që rriten me 1000 halle e vështirësi dhe që, përmes atyre vështirësive,** bashkë me urrejtjen klasore**, marrin edhe ca dituri** dhe, bashkë me atë pak dituri, formojnë edhe vetëdijen shoqërore. Bij të klasavet të shfrytëzuara, pra, që fitojnë një **ngritje teorike**

{por edhe të klasavet të pasura (shtesë e tashme) 2012},

të rinj të tillë që u shpëtojnë vesevet të ulët, mashtrimit, vjedhjes, alkolizmit, imoralitetit në pikëpamje seksi, narkotizmit. Një të ri të tillë na e ka përshkruar M.Gorki në romanin "***Nëna***". Ai është **Pavel Vllasovi**. Disa qindra mijë Pavel Vllasovë e udhëhoqën dhe e bënë Revolucionin e Tetorit në Rusi. Të tillë janë tek ne: **Mihal Duri, Vasil Shantoja, Gogo Nushi**. Të tillë tek ne janë pothuaj të gjithë komunistët që e udhëhoqën Luftën dhe Ndërtimin e Socializmit gjer në këta vite. (Sado që gjysma e tyre ishin analfabetë, edhe ata grumbulluan dituri.) Në botë, sot, të tillët si **Pavel Vllasovi**, janë anëtarë e militantë të partivet marksiste-leniniste. Pikërisht në saje të një të këtillë **brumi** bëhet e mundshme që në një vend të triumfojë revolucioni proletar. Pikërisht nga frika e një **brumi** të tillë, borgjezia e ka infektuar sot gjithë ambientin shoqëror me narkomanë, me pornografi e nudizëm, me gangsterizëm, letërsi e art dekadent, me ideologji fetare. (f.66, 1982)

{Në ata vite patëm rastin të takohemi edhe me një grup të rinjsh marksistë-leninstë nga vendet skandinavë. Erdhën dhe deshën të përziheshin me ne në vendin ku po punonim. Morën karrocat dhe lopatat, por as lopatën s'mund ta mbushnin, as karrocën s'mund ta shtynin. Atëherë më thotë një shok i imi, Viktor Sharra e quajnë: "***O Gjokë, a këta dashkan ta bëjnë revolucionin në vendet skandinavë***?!" E vërteta ish se, as ata, që e kishin vullnetin, por s'kishin fuqinë fizike, as ne, që e

kishim fuqinë fizike, por s'kishim bindjen, nuk do të mund ta çonim botën drejt një shoqërie më racionale.

Në librin tim të atëhershëm, këtë ide, unë e pata shprehur kështu: (2012)}

Në socializëm, ndërkaq, **një kategori të tillë të rinjsh nuk e gjejmë**. Në radhë të parë, sepse në socializëm nuk rritet rinia **me 1000 halle e vështirësi**, në radhë të dytë, sepse **kjo rini nuk është më proletare**, borgjezinë e njeh vetëm për së largu dhe nuk ëndërron që t'ia marrë pushtetin askujt. **Në socializëm nuk ka më Pavël Vllasovë, as Vasil Shanto, as Lym Ketë, as Gogo Nushë**. Por cilët janë atëherë të rinjtë më të mirë në socializëm, që të mund t'i shërbejnë partisë si gjak i ri? Cili do të jetë ai ***BRUMË I VEÇANTË***, që të dallohet nga masa tjetër e popullit, që ta udhëheqë popullin? Ku janë ata të rinj? Ata të rinj ne i hasim ditë për ditë **NË SHKOLLË**. Po pse në shkollë? Për arsyen e thjeshtë se në socializëm e gjithë rinia shkon në shkollë. Mirëpo, nxënësit e dobët nuk janë të rinjtë më të përshtatshëm. Kjo vetëkuptohet. Jo se ata janë çuna të këqinj, por thjeshtë se, të paktën hë për hë, nuk kanë zell për të studiuar. **Nxënësit më të mirë, ata nxënës që kryejnë me angazhim të plotë detyrat e përditshme mësimore (gjë që s'është aspak e lehtë), ata nxënës që janë të shkëlqyer në të 3 komponentet, që janë veprimtarë të papërtueshëm të Pionierit e në vazhdim, të Rinisë, që marrin pjesë në diskutime, që lexojnë shumë libra, që janë shtylla e veprimtarivet kulturore e sportive të shkollës, ja cilët janë të rinjtë më përshtatshëm për anëtarë partie!** Ata janë kryesisht bij punëtorësh, bij fshatarësh, bij komunistësh e luftëtarësh, bij intelektualësh, të devotshëm, patriotë e të partishëm. Ata, në shkollat e një vendi të çliruar nga shtypja, janë aq të shumtë, sa, siç thamë pak parë, partia mund të zgjedhë midis tyre me komoditet të plotë.

Mirëpo, në praktikën e derisotme ka ndodhur një gjë e çuditshme. **Është gabuar pikërisht këtu** dhe kjo, midis tjerash, ka bërë që në kaq shumë vende të dështojë revolucioni komunist. Cilat janë mundësitë e gabimit në këtë mes? **Mundësitë e gabimit** këtu janë 2: **Ose pranohen në parti pikërisht këta të rinj, duke i lënë në sferën e inteligjencës, ose nuk pranohen në parti, duke i quajtur intelektualë dhe duke u ruajtur me të drejtë kështu, që të mos intelektualizohet partia.** Kriteri i parë niset, me të drejtë, nga fakti se këta janë të rinjtë më të zgjuar, më të aftë, më të armatosur me teorinë marksiste-leniniste, por **harron se gjendja shoqërore e tyre nuk është më PUNËTORE**, ndonëse ata mund të jenë bij punëtorësh

e fshatarësh, bij revolucionarësh. **Ky kriter e çon partinë menjëherë në revizionizëm,** sepse pjesën më të madhe të saj e përbën inteligjenca. Ky kriter çon madje edhe në gabime të tillë që në parti të pranohen edhe intelektualë me origjinë joproletare, mjafton që këta, me fjalë dhe në dukje, të pranojnë programin e vijën e partisë, pa çka se më vonë ata mund t'i bëjnë paçavure atë program dhe atë vijë. Në Jugosllavi ka ndodhur pikërisht kështu, ndonëse aty ka edhe faktorë të tjerë, që e kanë çuar atë shtet drejt rivendosjes së kapitalizmit. Kriteri i dytë niset nga parimi i drejtë klasor dhe pranimet në parti i bën kryesisht nga radhët e klasës punëtore dhe nga fshatarësia, por **harron se këtyre klasave që më parë u është marrë ajka, duke hedhur bijtë më të mirë të tyre, me anë të politikës së kuadrit, në sferën e inteligjencës**. Ky kriter e zgjat ca më tepër jetën e diktaturës së proletariatit, por, më në fund, **edhe ai çon në revizionizëm, për shkak të polarizimit të partisë**. Pëgjithësisht kështu ka ndodhur në Bashkimin Sovjetik.

Si duhet vepruar? Në radhë të parë **duhet ndryshuar mendimi se nxënësit më të zotë i duhen partisë për kuadro** (qoftë partie, qoftë të administratës shtetërore). E vërteta është se **NXËNËSIT MË TË MIRË**, në këtë periudhë, **i duhen partisë në radhë të parë për anëtarë të thjeshtë partie, dmth për ndërtues të drejtpërdrejtë të komunizmit**. **Ata DALIN NGA KLASA PUNËTORE DHE I DUHEN ASAJ, KLASËS PUNËTORE, PËR TA MBAJTUR AJO, KLASA PUNËTORE, VETEN NË LARTËSINË E DUHUR**. (Çështja e udhëheqësvet të partisë, që zgjidhen, është çështje tjetër, gjë që ky parim nuk e cënon fare.)

Natyrisht, nuk është fjala këtu për t'ia marrë sferës së **inteligjencës** popullore të gjithë shkollarët e talentuar, as për ta nënvleftësuar inteligjencën popullore, as për të shprehur mosbesim ndaj saj. Ajo, në shoqërinë socialiste ka vendin që i takon të ketë. Por në kushtet e një shkollimi masiv, mundësitë për plotësimin e nevojavet me kuadro janë optimalë. Nuk është, gjithkështu, fjala as për t'i lënë shkencën, drejtimin e ekonomisë dhe administratën, në duart e ca "***ish-nxënësve të dobët***". Këtu është fjala për **cilësitë udhëheqëse të partisë** dhe për ruajtjen e karakterit të saj klasor. Këtu kemi të bëjmë me një çështje shumë të rëndësishme **PARIMORE**, nga zbatimi ose moszbatimi i së cilës varet **FATI I VAZHDIMIT TË REVOLUCIONIT**. Nuk ka mbetur akoma ndonjë vend socialist pa u ndërtuar për shkak se i ka munguar kuadri. Vështrësi ka pasur, por, kur në krye të atij vendi ka qenë një parti marksiste-leniniste, çështja e kuadrit është zgjidhur bashkë me morinë e problemevet të tjerë. Ndërsa, për mungesë ose ndërtim joshkencor të një

partie, shumë popuj sot vuajnë, pa ndonjë shkak tjetër, nën kapitalizëm, të vjetër ose të restauruar. (f.67-69, 1982)

{Shqetësimi ish i madh. Punët nuk shkonin mirë. **Mendja ime**, nga dëshira që të mos shkonin ashtu punët, **mundohej ta gjente një rrugë**. E dija që kthimi në kapitalizëm do të sillte fatkeqësi të mëdha, në radhë të parë për Kombin tim, i cili ishte i copëtuar, i sakatuar, i poshtëruar. Por edhe në shkallë botërore **kapitalizmi** po sillte dhe, sidomos pasi të çlirohej nga frika e komunizmit, **do të sillte edhe më shumë fatkeqësi**. Zezakët e Afrikës së Jugut kishin dekada që kërkonin për të mos u diskriminuar, por kapitalizmi britanik dhe ai botëror nuk po ua jepnin të drejtat. Në Vietnam po bëhej luftë e ashpër. Atje kish shkuar ushtria amerikane. Ç'donte ushtria amerikane në Vietnam? Në Indonezi u mbyt përpjekja për të kaluar në socializëm. Shqetësimi ishte i madh, por edhe **rruga që po mundohesha të gjeja, e ndjeja që nuk ishte shpëtimtarja e mirëfilltë, sepse nuk ish e zbatueshme**. S'ish e zbatueshme në radhë të parë, sepse **njerëzimi ende nuk e kish pësuar në atë masë që të mos shihte rrugëdalje tjetër veç kësaj**. Njerëzimi, nën sundimin skajisht mizor të skllavopronarëvet të Romës, pat arsye shumë të forta që e pranoi dhe e përhapi Krishtërimin. 2012}

Pasi partia studion një tezë teorike dhe arrin në përfundimin se teza në fjalë është drejtë, ajo merr vendimin për ta zbatuar atë në praktikë. Në rastet kur çështja ka të bëjë me normat statutore, ajo, natyrisht, **bën** edhe **ndryshimet e nevojshëm në statut**. Edhe problemi që ngrihet në këtë tezë, është i një rëndësie të atillë që, pasi të jetë pranuar nga një parti (në rastin tonë nga PPSH), kërkon **të bëhen ndryshimet gjegjës edhe në statut**.

Rregulla më e re në Statutin e Partisë së Punës të Shqipërisë, në këtë fazë të ndërtimit të socializmit, do të ishte kjo:

a) Në Prtinë tonë pranohen ata shokë e shoqe që, veç kushtevet të tjerë, plotësojë edhe këtë kusht: **Kanë mbaruar një shkollë TË LARTË me notë mesatare mbi 7 dhe pranojnë TË HEQIN DORË përgjithnjë NGA NËPUNËSIA E PAGUAR.**

b) Në Partinë tonë pranohen edhe ata shokë e shoqe që nuk kanë kryer ndonjë shkollë të lartë, por me kusht që **të kenë bërë mbi 10 VJET PUNË KRAHU** dhe, gjatë stazhit, të **kryejnë një shkollë TË LARTË me notë mesatare mbi 8**. Këta shokë e shoqe, pas kryerjes së stazhit, hyjnë në radhën e **NËPUNËSVET**.

c) Të gjithë qarkullimet e **tjerë,** brenda Partisë sonë, në relacionin klasë-inteligjencë dhe anasjelltas, kryhen me vendime të posaçëm të Partisë. (f.70, 1982)

{Kështu, sipas gjykimit tim të atëhershëm, do të mund të krijohej **KASTA UDHËHEQËSE** në një vend ku të gjithë banorët do të ishin mjaftësisht të pasur dhe të mbrojtur nga çdo lloj diskriminimi. Edhe sot, ndonëse në mjaft gjëra kam ndryshuar pikëpanje (Psh, nuk e shoh të justifikuar zhdukjen e pronës private), jam i mendimit që shoqëria njerëzore nuk mund të shpëtojë nga **KATASTROFA** e quajtur ***BIBLIKE***, **PËRFUNDIMTARE**, nga "***KATAKLIZMI***", po nuk u vu në krye të saj **NJË KASTË MENDËRISHT E KTHJELLËT DHE VETËSAKRIFIKUESE.** Vetësakrifikuese, jo në kuptimin **asketik**, si të krishterët e hershëm, por në një mënyrë gjithsesi të pranueshme. 2012}

Një *PYETJE SQARUES* (Në mbështetje të tezës së sapoformuluar.)

Posa i lexon njeriu këto rregulla, që kanë pretendimin për të hyrë në një statut partie, atij pa tjetër i vijnë në mendje një varg pyetjesh. Të gjitha atyre pyetjeve u duhen dhënë përgjigje dhe argumentime të plotë, ndryshe rregulla e saposhqiptuar nuk e fiton dot "***të drejtën e qytetarisë***". Unë këtu më poshtë po vë disa prej pyetjeve të mundshme dhe po mundohem t'u jap përgjigje të shkurtëra, duke menduar kështu: Një pjesë e përgjigjevet tashmë është dhënë, një pjesë tjetër do të mund të sqarohet në vazhdim dhe, së treti, krejt ky material ka nevojë të studiohet me hollësi nga njerëz më kompetentë, gjë që shpresoj se do të kryhet nga ndonjë studiues i ***Institutit të Studimevet Marksistë-leninistë***, dhe kështu secilës pyetje do të mund t'i jepet përgjigjja e duhur. (f.71, 1982)

{Atje, në atë ***institut***, ishin Nexhmie Hoxha dhe Fatos Nanoja, 2 personazhet më kryesorë. **Fatos Nanoja** erdhi në krye të

PPSH-së së reformuar, erdhi edhe në krye të shtetit, dhe **ia ndreqi samarin Republikës së Shqipërisë**. U katandis Republika e Shqipërisë në një lypsare të mjeruar, të cilën do ta ushqente me miell, me vaj, me sheqer, deri edhe me kripë, "***Pelikani***" nga Italia. Në fund, pasi u telendis ky vend si mos më keq, pasi edhe vetë bëri burg, bashkë me Ramiz Alinë dhe me Nexhmien, pasi e moli edhe njëherë vendin e vet në mënyrën më moskokëçarëse, shkoi për t'u eglendisur nëpër buzuqe e kazinora. 2012}

Disa nga pyetjet e mundshme janë:

1.*A DO TË ISHTE MARKSISTE-LENINISTE KJO MASË, KJO MËNYRË PRANIMI NË PARTI*? Kjo mënyrë pranimi në parti është marksiste-leniniste, nuk përmban asnjë revizionim të tezavet themelore të marksizëm-leninizmit. Njëkohësisht, ky formulim shpreh një **zbulim të ri**, mbështetur mbi faktet që na i ka ofruar gjysma e dytë e shekullit XX.

2.*ÇFARË FITON PARIA MARKSISTE-LENINISTE NGA NJË E KËTILLË MASË ORGANIZATIVE*? Partia marksiste-leniniste, me zbatimin e një rregulle të këtillë, forcohet në bazën e vet, realizon me sukses të padiskutueshëm rolin e vet **UDHËHEQËS**, veç tjerash, ***edhe mbi inteligjencën***, ruan e forcon karakterin pararojë të klasës punëtore, bëhet më e aftë të udhëheqë konkretisht masat në terren, në frontin e prodhimit, bëhet më e aftë të punojë me organizatat e masavet, lufton burokratizmin me efikasitet të atillë, sa që burokratizmi, gradualisht, vjen duke u minimizuar, duke qenë vetë komunistët në ballë të vështirësivet, partia marksiste-leninste lufton liberalizmin më me sukses, forcohet organizativisht, i shmanget polarizimit në radhët e veta, shërohet nga mefshtësia, rrit shpirtin luftarak në radhët e veta, zhvillon me sukses kritikën dhe autokritikën vertikalisht edhe horizontalisht, krijon gradualisht në gjirin e vet **NJERIUN E KOMUNIZMIT** me tipare gjithnjë e më të plotë dhe hap kështu perspektiva më të qarta, për ta çuar shoqërinë në komunizëm. (f.71, 1982)

{Krejt ky **ENUMERACION** pasqyronte në fakt vargun e **TË METAVET** tashmë "***TË KONSOLIDUARA*"**, të cilat po e çonin rendin socialist, gjegjësisht komunist, **DREJT DËSHTIMIT TË PANDALSHËM**. Prodhimi po binte, organizatat e masavet qenë bërë krejt formale, burokratizmi po forcohej, liberalizmi po

shtrihej, po merrte përhapje, polarizimi po ndodhte, mefshtësia e partisë ish kudo e dukshme, për ndonjë lloj ***NJERIU TË KOMUIZMIT*** as që i shkonte kujt ndërmend. **DËSHTIMI ISH TASHMË KREJT I EVIDENTUESHËM**. Megjithatë, askush nuk mund të thotë që, sikur t'i mbushej mendja dikujt, në shkallë botërore ose e pakta në gjysmën e botës, ta vërë në jetë një të këtillë ***"FANATIZËM"***, nuk do të mund të sillte efekte progresistë. Njeriu nuk po prishej vetëm në komunizëm. Njeriu ish prishur tashmë gjithandej, edhe në komunizëm edhe në kapitalizëm. Njeriun e mirë e kish mbërthyer **PARALIZA TOTALE**, si Pavel Korçaginin në gjysmën e parë të shekullit XX. 2012}

3.*ÇFARË FITON SHOQËRIA SOCIALISTE, GJITHË POPULLI, DUKE PASUR NJË PARTI TË TILLË NË KRYE*? Shoqëria socialiste, i gjithë populli, nga ky ndryshim kualitativ i partisë, siguron një të ardhshme të shkëlqyer në të gjitha pikëpamjet. Nga pikëpamja **EKONOMIKE** do të shënohej një vrull i paparë ndonjëherë. Entuziazmi i masavet do të ishte gjithmonë në nivelin e duhur. Besimi te partia do të shtohej ende më shumë, revolucioni tekniko-shkencor do të merrte zhvillim të madh, në thellësi dhe në gjërësi. Lufta e klasavet, në të mirë të masavet që punojnë, do të zhvillohej më me sukses në të gjithë aspektet. Do të luftoheshin më me sukses të gjithë llojet e shfaqjevet të huaja dhe shoqëria do të shpëtonte njëherë e mirë nga rrëziku i rindarjes në klasa. (f.72, 1982)

{Ekonomia dhe përparimi në shkencë do të ishin treguesit konkrtë, a vlen apo nuk vlen sistemi komunist, i cili qysh në shekullin XIX vërtet ishte përfytyruar si një fantazëm, por në të njëjtën kohë ish propaganduar si i vetmi **sistem shpëtimtar**. Nëse komunizmi nuk do t'ia kalonte kapitalizmit në aspektin konkret ekonomik, ai s'kish ç'i duhej njerëzimit. Lufta e klasavet, në konceptin tim, ishte edhe luftë kundër së keqes te individi. Klasat e pasura, në të gjitha kohët, kishin bërë dhe bëjnë edhe sot luftë ndaj klasavet të varfëra. T'i përgjigjesh kësaj lufte "***nga lart***" me luftë "***nga poshtë***", nuk mund të quhet punë e keqe. 2012-2016}

4.*MOS DO TË SILLTE KJO MASË INTELEKTUALIZIMIN E PARTISË, PËRDERISA TË GJITHË ANËTARËT E SAJ DO TË ISHIN ME ARSIM TË*

LARTË? Jo. Puna në prodhim do t'i **punëtorizonte** njerëzit dhe, sado që këta, duke qenë të ditur, do të merreshin jashtë orarit, por edhe në kohë pune, edhe me shkencat, prapëseprapë, jeta prej punëtori nuk do t'i linte të notonin nëpër ujërat e intelektualizmit. Parimi i gradualitetit në pranimet në parti do ta ruante edhe më mirë partinë nga ky rrëzik i mundshëm.

5.*A MOS ËSHTË KY NJË EKSTREMIZËM "I MAJTË", NJË "MAJTIZËM*"? Jo. Kjo tezë nuk përmban në vetëvete asnjë nga karakteristikat e "***majtizmit***". Së pari, kjo nuk është shprehje e mosbesimit ndaj inteligjencës. Në marrëdhëniet me inteligjencën kjo është një vënie në vendin e vet të gjëravet. Kjo nuk presupozon anarkinë, nuk nxit sektarizmin etj.

6.*MOS ËSHTË KJO NJË TEZË UTOPIKE*? Ai që do ta shpallte utopike këtë tezë, ai do të shpallte njëkohësisht vetë komunizmin utopik. Gjithashtu, as e parakohshme nuk besoj të jetë, pasi duhet të kemi parasysh që, për të kaluar tërësisht në cilësinë e re, një partie do t'i duheshin afërsisht 50 vjet. Veç kësaj, kjo rregull duhet futur në statut para ndërrimit të brezavet, pasi ndërrimi i brezavet, siç kam thënë, është një moment delikat në historinë e shoqërisë së re socialiste. Në këtë ndërrim armiku i socializmit shpreson shumë. (f.72, 1982)

{Koha tregoi që komunizmi, me mënyrën si kish proceduar deri atëherë, ishte vërtet një përpjekje e dështuar. Forma që propozova unë, nuk u provua, prandaj nuk dimë ç'të themi, sado që tashmë kjo ide e imja ka evoluar. Ka evoluar, por nuk është braktisur dhe nuk është hedhur poshtë në thelbin e saj. 2012-2016}

7.*A NUK DO TË ISHTE MË MIRË DHE MË NORMALE TË PUNOHEJ PËR NGRITJEN E NIVELIT IDEO-KULTUROR TË KOMUNISTËVET TË THJESHTË ME METODAT E NJOHURA TRADICIONALE*? Jo. Është pikërisht ky tradicionalizëm, i ruajtur në formë rutine, që e ka dëmtuar partinë dhe ka bërë që ajo, në një shkallë më të lartë të zhvillimit të shoqërisë socialisate, të mos e kryejë dot rolin e vet si duhet.

8.*NGA DO TË DALIN KUADROT E PARTISË (KUPTOHET, MARKSISTE-LENINISTE), KUR KOMUNISTËVET TË THJESHTË DO T'UA KEMI PRERË RRUGËN PËR NËPUNËSI*? Normat marksiste-leniniste nuk janë kurrë dogma të ngurta. Natyrisht, një shok komunist që do të zgjidhej në

forumet më të lartë, ai do të shkonte atje. Por kjo "***shkelje e statutit***" do të shoqërohej me motivacionin përkatës, të parashikuar në pikën **c**.

9.*MOS KJO IDE ËSHTË NJË SHPREHJE E MOSBESIMIT NDAJ PPSH-SË, KËSHTU SIÇ ËSHTË AJO SOT*? Të ishte shprehje e mosbesimit, kjo ide nuk do t'i paraqitej kësaj partie. Unë kam mendimin se një masë të këtillë revolucionare sot është në gjendje ta ndërmarrë vetëm **kjo parti** dhe në këtë mënyrë kjo të hapë për të gjithë vendet e ardhshëm socialistë një udhë të sigurtë. (f.73, 1982)

{Nuk ish shprehje e mosbesimit. Unë në atë kohë besoja më së shumti te fakti **i dukshëm** që Enver Hoxha po kërkonte një rrugë për ta çuar më tej atë që botërisht quhej ***revolucion socialist***. Isha i sigurtë që, nëse nuk ndërmerrej kjo masë, në Republikën e Shqipërisë s'kish ç'bëhej tjetër, përveç restaurimit. E unë nuk doja të bëhej restaurimi, sepse e dija ç'ditë të zeza mund të sillte ai restaurim. 2012}

10.*MOS KA NDONJË "HILE", "DJALLËZI", KJO METODË PRANIMI NË PARTI*? Po dhe jo. Komunistët, ndonëse me arsim universitar, duke jetuar gju më gju me popullin, do të shkriheshin shpejt me masat, duke ruajtur, për shkak të nivelit të lartë kulturor e arsimor, cilësitë e udhëheqësit të masavet. Megjithatë, praktika është ajo që e verifikon saktësinë ose pasaktësinë e një teorie. Doemos kjo do të lidhej me një ideal, ***idealin komunist***, i cili ndryshe do të mund të quhej edhe ***fanatizëm komunist***. (f.73, 1982)

{E dimë tashmë që metoda e propozuar as që u tentua të eksperimentohej, mbase as që u lexua. Shoqëria shqiptare e gjeti më me vend të heqë dorë prej komunizmit në mënyrë stihike dhe t'u nënshtrohet perturbacionevet të lemerishëm që do të sillte **RESTAURIMI I PAKONTROLLUAR I KAPITALIZMIT**. Lufta e klasavet do të kthehej në krah të kundërt: **KLASA PUNËTORE DHE KLASA FSHATARE DO TË SHKATËRROHESHIN TOTALISHT**. Këtë punë shkatërruese do ta bënin vetë bijtë e punëtorëvet dhe të fshatarëvet. Fshatarët e Vandesë kërkonin me doemos ta kthenin mbretin në fronin e Francës. Ata nuk rronin dot pa dajak feudalësh. (Krs. Viktor Hygo: "***Viti 93***". 2012}

12.*MOS DO TË SHNDËRROHESHIN KOMUNISTËT NË KËTË MËNYRË NË NJË ARISTOKRACI PUNËTORE*? Po. **Rrëziku ekziston**. Kujdesi duhet pasur, megjithatë, partia marksiste-leniniste, me një organizim të mirë të jetës së brendshme, me rregulla të përcaktuara qartë, do të mund të bënte kujdes dhe të mos lejonte me u shfaqë një e tillë dukuri, ku komunisti me arsim të lartë të shfrytëzonte punën e punëtorëvet pa parti.

13.*A NUK DO T'U NGJANIN TË TILLË KOMUNISTË ME SHKOLLË TË LARTË QË PUNOJNË NË TORNO, QË SHTYJNË VAGONAT ME MINERAL E QË MBLEDHIN ULLINJ, CA ASKETËVE, QË MUNDOJNË VETEN PËR HIR TË NJË IDEJE*? Jo. Në qoftë se marrjen me punë fizike të një njeriu do ta quajmë mundim asketik, se ai na qenka me universitet, atëherë ne nuk do të mund të thoshim se e kemi kuptuar në thelb jetën e klasës punëtore.

14.*MOS KA KËTU FILOZOFI TË "BARAZIMTARISË MIKROBORGJEZE*"? S'di ç'të them. Mua më duket se komunisti shkon atje, në bazë, ku e ka origjinën, për të realizuar një ideal të lartë shoqëror e gjithnjerëzor, idealin që ia frymëzoi njerëzimit pikërisht klasa punëtore. Për komunistin nuk duhet të jetë tjetërsoj, veçse nder i madh që i jepet rasti të punojë e të jetojë si punëtor.

15.*A NUK DËMTOHET KËSHTU EKONOMIA, DUKE I ÇUAR SPECIALISTËT E DEGËVET TË NDRYSHME TË INDUSTRISË E BUJQËSISË NË PUNË TË THJESHTA*? Nuk dëmtohet. Përkundrazi, ajo kështu do të mund të marrë një zhvillim që deri më sot nuk ka ndodhur në histori. Madje ky është edhe qëllimi i çuarjes së të shkolluarvet atje ku prodhohen të mirat materiale: **TË RRITET PRODHIMI**, jo të dëmtohet, jo të pakësohet.

16.*A ËSHTË E RREGULLT, A IA VLEN BARRA QËRANË, TË HARXHOJË SHTETI GJITHATO PARA PËR TË SHKOLLUAR NJERËZ, E PASTAJ KËTA NJERËZ T'I DËRGOJË NË "KAZËM"?* Shteti, për arsimimin e popullit shpenzon shuma kolosale. Se po shpenzon një sasi shtesë, relativisht të vogël, mjetesh për shkollimin e anëtarëvet të mundshëm të partisë, jo vetëm ia vlen barra qeranë, por del me levërdi të madhe edhe ekonomike, edhe sociale, morale etj. **Dituria është e vetmja pasuri, që i lejohet partisë ta ketë më të madhe se kushdo tjetër**.

17.*A VETËM TË SHKOLLUARIT QENKAN TË DENJË PËR NË PARTI? PO TË TJERËT*? Dyert e partisë marksiste-leniniste nuk janë të hapura për të gjithë. Kjo dihet. Në qoftë se faktori dituri do ta ngrinte ose do ta ulte cilësinë e saj, atëherë pse të mos jetë njëri ndër kushtet e pranimit edhe ky? Veç kësaj, që ta duan partinë dhe të punojnë në frymën e saj, mundësitë i kanë të gjithë, edhe pa qenë anëtarë.

18.*DUKE LËNË NJË PJESË TË TË SHKOLLUARVET, BILE ATA MË TË DOBËTIT, NË SFERËN E INTELIGJENCËS DHE DUKE E ÇUAR PJESËN TJETËR NË PUNË PRODHUESE, NËPËRMJET PRANIMIT NË PARTI, A NUK DO TË ISHTE KJO NJË PADREJTËSI QË DO T'U BËHEJ KËTYRE QË DETYROHEN TË BËJNË PUNË TË THJESHTA*? Duke i pranuar në parti, atyre u bëhet një nder i madh. U bëhet nder i madh, sepse ata, duke vepruar kështu, nuk zbresin, në pikëpamje të pozitës shoqërore, nën inteligjencën. Përkundrazi, **ATA E UDHËHEQIN INTELIGJENCËN** nga pozitat e klasës së cilës i përkasin. Gjithë puna është te kuptimi leninist i këtyre parimeve.

19.*A NUK DËMTOHEN KËSHTU, ADMINISTRATA, SHKENCA, ARTI, REVOLUCIONI TEKNIKO-SHKENCOR? NE MEZI PRESIM TË NA DALË NJË MJEK, NJË INXHINIER, NJË EKONOMIST I MIRË…* Kjo do një shpjegim pak më të gjatë, prandaj do t'i kthehemi në një pjesë tjetër. E vërteta është se, si administratës, si shkencës, si artit, si revolucionit teknikо-shkencor, me një të këtillë **REVOLUCION NË PARTINË MARKSISTE-LENINISTE**, vetëm mirë u bëhet, nuk u bëhet kurrfarë dëmi.

20.*SI MENDOHET TË KRYHET PUNA E PAPAGUAR? NJË MËSUES, KUR TË JETË SHNDËRRUAR NË KOOPERATIVIST TË THJESHTË, A DO TË KETË MUNDËSI TË MERRET EDHE ME MËSUESI*? Secili njeri që dëshiron të punojë, i gjen mënyrën dhe kohën për të punuar. Për këtë kategori njerëzish nuk kemi pse të dyshojmë se nuk do të kenë pasione. Sa për komunistin ish-mësues a ish-profesor, ja se çfarë do të mund të bënte ai: Në këshillin pedagogjik të shkollës më të afërt do të merrte pjesë, në komisionet e provimevet do të merrte pjesë, në kontrollin të quajtur ***punëtor e fshatar***, në komitetin e prindërvet, si një prind i kualifikuar, në brigadë do të punonte për aftësimin pedagogjik të prindërvet, 1 temë pedagogjike në vit do të mund ta shkruante dhe ta botonte, 5 artikuj, për organet e shtypit të përditshëm lidhur me arsimin, do t'i shkruante dhe do t'i botonte…Kështu do të vinte një kohë kur inspektorët e arsimit do të reduktoheshin në minimum. Madje, mbase nuk do të ishin fare të nevojshëm. **Ç'duhet më**

tepër? Organizata e partisë, në këtë mënyrë, do ta realizonte më me sukses rolin **UDHËHEQËS** në fushën e arsimit.

21.*KUR TË SHOHË RINIA SE, PAS FAKULTETIT, E PRESIN PUNËT NË FABRIKË, NË MINIERË, NË BUJQËSI E JO NË ZYRË, A DO TË PËRPIQET TË MËSOJË*? Kuptimi bazë i shkollës socialiste, dhe jo vetëm, është: ***Të mësojmë për jetën, jo thjeshtë për diplomën***! Kjo do të kërkonte një zbërthim: Ç'është jeta? Ç'është diploma, pra, ç'është dëshmia, që njeriu ka një profesion? Sa diploma do t'i duheshin njeriut në jetë, për të mos i kaluar këta pak vite në ankth e në frikë? Por ne po kufizohemi vetëm te pyetja në kuptimin më të ngushtë. Me vendosjen e një rregulle të tillë, e cila kapacitetet do t'ia kthente klasës me anë të pranimit në parti, mund të shfaqej ndokund ndonjë reagim, shprehje mentalitetesh mikroborgjezë dhe intelektualistë, por masa e rinisë s'kish pse të stepej para një të këtillë kërkese. Përkundrazi, rinia do ta priste me entuziazëm këtë lloj reforme, sepse do ta kuptonte që ka edhe ajo një mision të rëndësishëm, të ndryshëm nga ç'e ka pasur brezi i mëparshëm, por po aq heroik sa misioni i paraardhësvet. Ky do të ishte hapi i vërtetë, më i domosdoshmi, për ta çuar shoqërinë njerëzore më përpara. (f.74-75, 1982)

{Jeniçerët edukoheshin me parimin se ata, në emër të sulltanit (që ishte "***përfaqësuesi dhe zëdhënësi***" i Allahut), duhej të vdisnin. Marinsat e sotëm edukohen po me atë metodë, me metodën për të mos iu trembur vdekjes, pra, për të shkuar me guxim drejt vdekjes. Ushtarët e Napoleonit shkonin në luftë, o për të fituar, o për t'u vrarë. Ushtarët e Hitlerit ishin edhe më të gatshëm për të vdekur. Përse të konsiderohej e papranueshme kjo "***sakrificë***", e cila, në fund të fundit, nuk kërkonte as vdekje, as jetë prej asketi? Përse, një i ri universitar të kish frikë, jo për të vdekur, por për të punuar si punëtor i thjeshtë, në emër të një ideali që s'është për t'u marrë si shaka, një ideal që s'është as jeniçer, as hitlerian?! 2012}

22.*MOS DO TË POZICIONOHEJ INTELIGJENCA KUNDËR NJË MASE TË KËTILLË*? Në këtë pikë kjo çështje duhet të trajtohet ashtu siç trajtohet kolektivizimi i bujqësisë. Ndoshta me një nuancë veprimi pak më të butë. Cili ishte qëndrimi i fshatarit ndaj kolektivizimit? A kërkohej atje një punë bindëse? Po. Madje kërkohej punë bindëse shumë e fuqishme. Por, PPSH, si

edhe mjaft parti të tjera marksiste-leniniste, e kish quajtur kolektivizimin të domosdoshëm, prandaj dhe nguli këmbë që ai të realizohej. Te fshatari, me anë të kolektivizimit, bëhej shpronësimi i kulakut apo feudzotëruesit të deriatëhershëm, te kjo masë partiake, me një formë tjetër, bëhet shpronësimi i një borgjezie revizioniste të mundshme. Realisht, edhe po të nisemi nga interesat e saj klasorë, inteligjenca popullore nuk duhet të jetë kundër një mase të këtillë. (f.76, 1982)

{**KOOPERATIVISTËT SHQIPTARË**, përfshirë aty administratë edhe punëtorë, **E SABOTUAN KOOPERATIVËN**, me dëshirën përvëluese për t'u ribërë pronarë individualë të tokavet. Desh u tretën nga nostalgjia deri sa ia arritën të riprivatizoheshin. **PASTAJ**, pa kaluar as 6 muaj, **I LANË DJERR QINDRA MIJË HEKTARË** (tokë tashmë jo të kolektivizuar, por mirëfilli individuale) **DHE SHKUAN NË GREQI E ITALI**, për të punuar atje si bujq nga më të përvuajturit. Tokat e tyre këtu i mbuluan shkurret. 2012}

23.*A DO TË GJENDEN KANDIDATË MIDIS INTELIGJENCËS, QË TË PRANOJNË PËR T'U FUTUR NË PARTI, ME KËTË KUSHT KAQ "TË RËNDË"?* Në inteligjencën tonë, kështu siç e ka edukuar PPSH deri më sot, mendoj se do të gjendej numri i nevojshëm i kandidatëvet, deri më 2000 të tillë në vit. **Në rast se nuk do të gjendeshin, kjo do të ishte shenjë që inteligjenca, si shtresë, është larguar tashmë nga idealet e klasës punëtore.** (f.76, 1982)

{Doli që ajo shtresë, kuptohet, në pjesën më të madhe, jo krejt, vërtet ishte larguar prej idealevet të **klasës punëtore** dhe, për të qenë sa më **LARG** atyre idealeve, ajo u hipi **gomoneve** dhe mori botën në sy. U shpërnda nëpër Evropë apo Amerikë. Atje u gjend si mundi secili individ për vete. Do të ish interesant të bëhej një studim: Sa prej tyre e arritën **LUMTURINË** dhe sa **DËSHTUAN**, duke u katandisur gjithsesi në **klasë punëtore** ose edhe më keq në larës këmbësh të afendikonjvet. 2012}

24.*PO SIKUR, LARG QOFTË, NDONJË NGA ATA KOMUNISTË TË SËMURET DHE TË KETË NEVOJË PËR PUNË MË TË LEHTË, A DO TA LËMË TË VDESË NË PUNË KRAHU*? Ka edhe të këtilla kuazipyetje.

25.*SI DO TA PRISNIN DHE SI DO TA INTERPRETONIN JASHTË, NË KAPITALIZËM, KËTË MASË TONËN "MË SE DRASTIKE*"? Ashtu siç kanë pritur kolektivizimin. Ashtu siç kanë pritur qëndrimin ndaj fesë. Ashtu siç kanë pritur dhe interpretuar luftën pa kompromis që e ka bërë partia jonë kundër armiqvet të brendshëm. Borgjezia, forcat reaksionare: Me indinjatë, me armiqësi, me propagandë kundër komunizmit. Forcat përparimtare: Me simpati, me shpresë. (f.76, 1982)

{Edhe sot, kur **ka vdekur** çdo gjë që mund të quhet komuniste, shfryrjet kundër këtyre që i numërova më lart, nuk po pushojnë. Ku e kanë problemin ata që po sillen kështu? A sepse komunizmi ishte aq i keq, apo se ata vetë janë të këqinj? Apo se nuk dinë fare cili ishte qëllimi i mirëfilltë i atij sistemi shoqëror, që u tentua të ndërtohej? 2012}

{Teza që e parashtrova, jo vetëm nuk u diskutua, por as që u vu re fare. **Njerëzimi kish punë të tjera "më të rëndësishme"**. Mijëra të rinj duhej të vdisnin nën efektin e drogës ose nga sëmundja e sidës. Mijëra do të shkonin e do të vdisnin në Irak për idealet e kapitalizmit. Në krahun tjetër, mijëra kamikazë do të vetazgjësoheshin në emër të islamizmit, duke vrarë bashkë me veten disafish më shumë njerëz të tjerë, të cilët ndoshta as që dinë ç'janë idealet. 2012)

Procedimi, në rast se teza do të quhej e pranueshme, do të ishte kështu: Vitin e parë nja 2000 organizata-bazë do të pranonin nga 1 kandidat sipas kushtevet të rinj. Në të njëjtën kohë do të çoheshin nëpër fakultete të ndryshëm një numër studentësh më shumë nga "***plani"***. (Nga i quajturi "***plan" për studimet në arsimin e lartë***, për të cilin unë nuk do të isha dakord të ekzistonte.) Kështu do të veprohej vit për vit. Do të synohej që të bëheshin aq pranime në vit, sa organizata-bazë partie ka, në rastin tonë, Republika e Shqipërsë. Në këtë mënyrë, mbas 4 vjetësh, kur kandidati i parë të ketë mbaruar **stazhin** dhe të pranohet anëtar, kandidati i dytë do të kishte 3 vjet stazh, e me radhë. Puna e **brumosjes klasore** të të parëvet do të shkonte paralelisht me pranimet e rinj. Pas 10 vjetësh në çdo organizatë-bazë do të kishte maksimuni nga 10 anëtarë e kandidatë **të cilësisë re**. Partia atëherë do të kishte një përvojë shumë të pasur në zbatimin e këtij **parimi të ri**, të diktuar nga kushtet e rinj të zhvillimit të shoqërisë. Në rastet kur

ndonjëri nga kandidatët nuk do ta justifikonte veten, kuptohet që ai nuk do të pranohej, dmth nuk do të ngrihej nga kandidat në anëtar, ose do të përjashtohej, nëse në ndërkohë ishte bërë anëtar. Por kjo do të ndodhte pasi të jetë bërë analiza e shkaqevet, pse personi në fjalë nuk është treguar **i denjë për të qenë komunist**. Pas mospranimit ose përjashtimit nga partia, organizata do të ruante të drejtën që t'u rekomandojë organevet të shtetit që personit në fjalë të mos i lejohet të punësohet as **si nëpunës pa parti**. Ai gjithsesi do të mbetej punëtor. Kjo ka shumë rëndësi të mbahet parasysh, sepse, **PO NUK QE PARTIA MARKSISTE-LENINISTE E RREPTË NDAJ VETES, AJO NUK MUND TË KËRKOJË KURRFARË RIGOROZITETI AS NË ASPEKTET E TJERË TË JETËS SHTETËRORE E SHOQËRORE**. Në ato zona ku pranimi në parti i shkollarëvet do të sillte, si pasojë, mungesë kuadri në sektorë të ndryshëm, aty do të plotësoheshin nevojat e kuadrit, si zakonisht, me specialistë të prurë nga rrethet e tjerë ose nga kryeqyteti. (f.77, 1982)

{Kjo pjesë është njëri prej shembujsh, ku **autori u flet partivet proletare të mbarë BOTËS sikur ato të ishin kalamaj shkolle**. Pyetjet që imponohen nën këtë kontekst, janë 2. E para: A **kalamaj** ishin ata udhëheqës revolucionesh, që u prinë popujvet në beteja, në të cilat u derdh gjaku njerëzor lumë, në emër të një ideali? Përgjigjja ime është: **JO**! E dyta: A **kalamaj** ishin këta kryesues partish dhe shtetesh që, në gjysmën e dytë të shekullit XX, po i çonin vendet e tyre drejt shkatërrimit e, për rrjedhojë, drejt gjakderdhjesh të tjera, ndoshta pa kaluar gjysma e dytë e shekullit XXI? Përgjigjja ime është: **PO**! Këta ishin më keq se **kalamaj,** loço fare**,** që nga Hrushovi deri te Ramizi dhe ky quhet ***degjenerim***! 2012}

Natyrisht, me një rregull statutore, me një veprim të vetëm zyrtar, nuk mund të përmbyset çdo gjë në asnjë vend dhe në asnjë fushë të veprimtarisë njerëzore. Partisë marksiste-leniniste, për t'ia arritur synimit të vet, i duhet një punë e një luftë shumë këmbëngulëse. Një arsyetim teorik i plotë, në shkallë kombëtare e ndërkombëtare, një punë bindëse e gjithanshme, por, më në fund, me këtë rrugë, një pjesë e mirë e kapacitetevet intelektualë do të gjendeshin në gjirin e klasës nga rrjedhin. Ky është thelbi i luftës kundër rindarjes së shoqërisë në klasa. Kthimi në gjirin e klasës i një pjese të kapacitetevet intelektualë e shndërron klasën punëtore vërtetësisht në

"***KLASË PËR VETE***", siç e ka thënë K.Marksi. **NJERËZIT E MËSUAR, TË ARMATOSUR, SI TËRËSI, ME TË GJITHA DITURITË NJERËZORE, DUKE QENË PUNËTORË TË THJESHTË, PËRBËJNË PRAKTIKISHT NJË SHKALLË TË LARTË TË NDËRTHURJES SË TEORISË ME PRAKTIKËN NË TË GJITHË ASPEKTET E JETËS**. Ata, thjeshtë si **PJESËTARË TË KLASËS**, si punëtorë, i japin klasës punëtore gjallërinë dhe qartësinë mendimore. Ndërsa, duke qenë si **ANËTARË PARTIE**, udhëheqës të një tipi rë ri, të tipit leninist, ata i sigurojnë klasës punëtore hegjemoni të përhershme në shoqëri, pra **I SIGUROJNË NJË TË ARDHSHME TË SIGURTË GJITHË NJERËZIMIT**. Ndërkaq, duke jetuar **vetë** si punëtorë, në gjirin e klasës nga rrjedhin, ata e ndiejnë të fortë tabanin që i mban, marrin fuqi prej atij tabani, si Anteu, dhe janë të mbrojtur nga çdo fluturim fantazmagorik intelektualist. Çdo mundësi për t'u bërë ndonjë ditë renegatë, në këtë mënyrë, atyre u është prerë, u është prerë rruga dhe mundësia për t'u bërë braktisës, tradhtarë të idealevet të klasës së vet dhe kjo s'ka si të mos jetë një lumturi, si për ata, ashtu edhe për klasën punëtore. (f.78, 1982)

{Në kapitalizëm po praktikohet, me sistemin e votimevet, përballja midis **2 partive** (kryesisht 2, pasi të tjerat janë më shumë garniturë). Skema që propozohet për sistemin komunist, faktikisht do të krijonte edhe aty **2** "***parti***": **Intelektualët punëtorë**, që do të kontrollonin administratën, dhe **intelektualët nëpunës**, që do ta administronin shtetin, nën survejimin dhe kontrollin e të parëvet. 2012}

Klasa punëtore, e shproletarizuar, tani do ta kish më të qartë të ardhshmen. Ajo do të shkonte me hapa të sigurtë drejt komunizmit. Udhëheqja e Partisë do të vinte duke u forcuar gjithnjë e më shumë. Njerëzit e ditur tani realisht nuk do të mund të thoshin: "***Bëjeni punën***!", por: "***Hajdeni, ta bëjmë punën së bashku!***" Kjo do t'ia shtonte klasës punëtore dëshirën për të punuar, sepse nuk do ta ndiente veten të shfrytëzuar. Këta njerëz të ditur që do të punonin me "***kazëm***", pra në torno, në makinë, në bërje muri, në nxjerrje minerali, do të ishin një shembull i gjallë frymëzimi për masën tjetër të punonjësvet. Punonjësit, në shoqëri me ta, duke i përballuar bashkë vështirësitë, do ta ndienin veten kurdoherë të mbrojtur nga të këqiat e burokratizmit, të formalizmit dhe të liberalizmit dhe do të mësonin të luftonin në vetëvete çdo mbeturinë e ndikim të quajtur "***të huaj***". Në rrethanat e një zhvillimi akoma më të vrullshëm të sitemit arsimor, klasa punëtore dhe fshatarësia do të vinin gjithnjë duke u afruar nga çdo

pikëpamje me **NJERËZIT E KOMUNIZMIT**, që do t'i kishin si model imitimi. Klasa punëtore do të njihte kështu vetëm ngjitje e forcim në luftë kundër tendencavet të rindarjes së shoqërisë në klasa. Nën udhëheqjen e të këtillë komunistëve, jo sundimin por udhëheqjen, klasa punëtore do të kishte gjithmonë në duart e veta iniciativën e luftës klasore. Revolucioni teknikо-shkencor do të bëhej plotësisht çështje e masavet dhe ato, masat, do të merrnin pjesë, si në shkencë, edhe në qeverisjen e shtetit, gjithnjë e më tepër, ëndërr e vjetër e klasikëvet të marksizmit. (f.79, 1982)

{Klasa punëtore do të duhej të arrinte kështu ta ketë rrogën 2 herë më të madhe se punëtori më i mirë në kapitalizëm. Por **KOMUNIZMI U MËRZIT SË QENI** shoqëri e përbashkët, u mërzit **SË QENI SHOQËRI KOMUNE**. 2012}

Inteligjenca popullore përbën një shtresë më vete në shoqërinë socialiste. Ajo është në shërbim të bazës, të klasës punëtore dhe të fshatarësisë. Komunisët në gjirin e saj, faktikisht janë të dërguar atje nga klasa, për të realizuar shërbimin që duhet të kryejë inteligjenca ndaj klasës. **Komunistët-nëpunës janë të dërguarit e klasës. Ata nuk janë inteligjencë, pavarësisht se detyra i thërret për të punuar atje me laps. "*Ata nga ne*,"** thotë V.I.Lenini**, "*që janë dënuar të mbeten në organet qendrorë, do të vazhdojnë të punojnë për të përmirësuar aparatin qendror*."** (V.I.Lenin**,** *J.V,Stalin*: "*Kundër burokratizmit*", f.247**) "*që janë TË DËNUAR…*"** thotë Lenini**.** A nuk të bën kjo të konkludosh se **VENDI MË I NATYRSHËM PËR KOMUNISTIN, PËR PRIJËSIN E KLASËS PUNËTORE, ËSHTË PRODHIMI**, baza?.. Në këtë kuptim, komunistët-nëpunës janë një kategori e veçantë njerëzish, janë shpirtërisht punëtorë, të cilët detyra e partisë së tyre i ka çuar në një front tjetër pune që quhet ***nëpunësi***. Prandaj, siç thuhet në pikën **b**) të rregullës së projekt-statutit, ideuar prej meje, unë mendoj se është me vend që kandidatët për anëtarë partie, që do të kalojnë në sferën e nëpunësisë, duhet të kenë një stazh pune si punëtorë jo më pak se 10 vjet. Këta duhet të jenë të mbrujtur me brumin punëtor, përndryshe nuk do të jenë në gjendje kurrsesi që, në gjirin e inteligjencës, ta kryejnë misionin që u ka ngarkuar klasa. Këta duhet ta ndiejnë veten atje "***të DËNUAR***" dhe "***ME SHËRBIM***" në kuptimin figurativ të fjalës. Kuptohet, inteligjenca nuk është klasë armike, as shtresë armike. Kështu që, ky pozicion i komunistëvet ndaj saj në asnjë mënyrë nuk duhet kuptuar si pozicion armiqësor apo mosbesues. Kur klasa punëore dërgon përfaqësuesit e vet te fshatarësia, për të realizuar aleancën midis këtyre 2 klasave, për t'u mbushur mendjen fshatarëvet që ta kolektivizojnë tokën, a mund të quhet

armiqësore kjo shkuarje atje e përfaqësuesvet të klasës punëtore? Prandaj kërkesa që komunistët-nëpunës duhet të kenë pa tjetër një stazh të gjatë si punëtorë, është themelisht e arsyetuar, është një domosdoshmëri që e diktojnë kërkesat jo veç të diktaturës së proletariatit, por edhe mbasi të mos ketë më diktaturë. Shkolla që bën punëtori kandidat për në partinë marksiste-leniniste, para se të shkojë për të punuar si nëpunës, nuk është tjetër, veçse një "***kurs***" për t'u bërë i aftë me punue në sferën intelektuale. (f.81, 1982)

{Do të kish qenë një mënyrë shumë efikase për ta shëruar shoqërinë njerëzore nga të gufosurit mbytës prej burokracisë. Miliona burokratë e marrin rrogën kot, duke menduar se, pa ata bota do të përmbysej. 2012}

Komunistët-punëtorë me arsim maksimal, duke qenë njerëz eruditë, nuk kanë se si të mos e mbajnë pranë inteligjencën me gjendje sociale nëpunës. Me krijimin e një kategorie të tillë njerëzish në çdo sektor ku punohet e prodhohet, mundësitë për t'u intelektualizuar dhe për t'u burokratizuar do të jenë gjithnjë e më të pakta. Këto mundësi do të jenë gjithnjë e më të pakta, sepse intelektuali, kur të hasë pengesa në punët e tija, përkrahjen më të ngrohtë dhe mirëkuptimin më të plotë do ta gjejë, jo te intelektualë të të njëjtit rang ose të rangut më të lartë, por në radhë të parë te ky **LLOJ PUNËTORËSH QË DINË, KANË DITURI,** më shumë se kushdo. Në të njëjtën kohë, duke pasur përrreth shokë punëtorë me universitet, intelektualit nëpunës as që do t'i jepet rasti të mendojë se zyra është e plotfuqishme. Kujt mund t'i shkojë ndërmend në rrethana të tilla se zyra është e plotfuqishme? Rruga më e natyrshme do të ishte rruga e bashëpunimit midis komunistëvet punëtorë me universitet dhe nëpunësvet intelektualë pa parti, nën udhëheqjen e të parëvet. Udhëheqja e partisë mbi inteligjencën pa parti në atë kohë, që ende s'ka ardhur, do të realizohej e plotë dhe e kualifikuar. Në këshillat shkencorë ata do të gjendeshin bashkë, në byrotë teknologjike bashkë, në kërkimet tekniko-shkencorë prapë bashkë dhe kështu intelektualët do të afroheshin gjithnjë e më shumë me **NJERIUN E KOMUNIZMIT**, do të familjarizoheshin gjithnjë e më tepër me punën prodhuese, me vetë prodhimin, sa edhe vetë ata do të bëheshin, një nga një e duar-duar, **NJERËZ TË KOMUNIZMIT**. (f.81, 1982)

{Nuk mendoj se do të formoheshin mirëfilli 2 parti, por sidoqoftë, kontradikta do të ekzistonte. Administrata nuk do ta pranonte lehtë diktatin "***së poshtmi***". Në anën tjetër, partia, e përbërë prej punëtorësh të atillë që kanë sakrifikuar rehatinë e

zyrës **për hir të një ideali shoqëror** me synim sigurimin e mbarëvajtjes në krejt planetin Tokë, nuk do të tregohej aspak të butë ndaj zyrtarëvet. A do të funksionontе një i tillë sistem shoqëror? Por edhe a mund të lihet njerëzimi në gjendjen siç e ka katandisur kapitalizmi, nën kërcënimin e vazhdueshëm të krizavet e të luftëravet, të urisë e të padrejtësivet? 2012}

SOCIALIZMI, SISTEMI MË I PËRPARUAR SHOQËROR, DUHET TË REALIZOJË MEDOEMOS NJË PRODHIM MË TË MADH SE KAPITALIZMI DHE TË ARDHURA MË TË MËDHA PËR FRYMË. (f.82, 1982)

{Ishte **KUSHTI KRYESOR**, jo se po e theksoja unë, por vetë motivi shtytës i të gjitha lëvizjevet dhe revolucionevet, kish qenë mirëqenia e përgjithshme. Milionat e njerëzvet e kishin pranuar alternativën komuniste, ishin sakrifikuar, me të vetmin synim **QË NJERËZIMI TË RRONTE MË MIRË**. 2012}

Nëse socializmi nuk e realizon synimin që t'ia kalojë kapitalizmit në prodhim dhe në të gjithë aspektet e progresit, fitore mbi kapitalizmin nuk ka. Kjo është porosi e njohur e V.I.Leninit. Përparimi tekniko-shkencor i vazhdueshëm, është një ndër kushtet kryesorë për ta realizuar këtë kërkesë. Ai, në socialize, bëhet ndryshe nga ç'bëhet në kapitalizëm. Në socializëm është jo vetëm vepër e masavet, por edhe problem i masavet dhe në shërbim të masavet. (f.82, 1982)

{Praktikisht kjo nuk bëhej kështu. Duhej të ishte kështu, por nuk bëhej, sepse postet zyrtarë qenë okupuar prej mediokrish nga më banalët. 2012}

Në Bashkimin Sovjetik, në kohën e Stalinit, ka qenë e njohur lëvizja e quajtur **STAKANOVISTE**, që kish për qëllim ta bënte sa më shumë problem të masës çështjen e përparimit tekniko-shkencor. PPSH kësaj çështjeje i ka kushtuar gjithashtu një rëndësi të madhe dhe tashmë është e qartë se interesi i socializmit e do që në masën e prodhuesvet të

drejtpërdrejtë të ketë sa më shumë shpikës. FATET E REVOLUCIONIT TEKNIKO-SHKENCOR NË SOCIALUIZËM, **PËR T'I SIGURUAR ATIJ EPËRSI MBI KAPITALIZMIN, VAREN NGA FAKTI NËSE DO TË MERREN ME KËTË PUNË EDHE PUNËTORËT DHE FSHATARËT.** Dhe është e qartë se punëtori e fshatari nuk mund të merren në kuptimin e mirëfilltë me shpikje, po nuk patën, krahas praktikës, edhe teorinë, pra, po nuk njohën shkencën. Nga ana tjetër, është e ditur gjithkështu se as intelektuali nuk mund të jetë një shpikës i vërtetë pa njohur mirë, krahas teorisë, edhe praktikën, pra, pa punën e thejshtë të punëtorit ose të fshatarit. Ngritja e nduarnduarshme e shkallës arsimore të masave s'do mend që shkon gjithnjë në të mirë të përparimit tekniko-shkencor, për arsye se midis masës së shkolluar do të gjenden gjithnjë e më shumë njerëz që do të merren edhe me shpikje. (f.82, 1982)

{Praktikisht ndodhte kështu: **NË SOCIALIZËM** (komunizëm) atyre që kërkonin ta rrisnin prodhimin duke i përsosur teknologjinë, makineritë, metodat, ua kish **mbyllur** totalisht **të gjitha dyert** armata e madhe e mediokërvet. **NË KAPITALIZËM**, ndërkaq, pa injoruar aspak realizimet pozitivë, ishin **hapur të gjitha dyert** e zhvillimit të teknologjisë, që prej metodavet më të përsosura për prodhimin e drogës deri te metodat, prapë tejet të përsosutra, për të prodhuar me miliarda tonelatë ushqime surrogato gjenetikisht të modifikuar. 2012}

Duhet pranuar se edhe këtu paraqitet nevoja për një **PRIJËS**, për një **SHEMBULL** të gjallë. Ky prijës duhet të ndodhet, pa tjetër, në skuadër, në brigadë (njësi prodhuese në socializëm), ku punon e vepron punëtori apo fshatari. Intelektuali që paguhet për punë mendore, mund të jetë një **UDHËZUES**, mund të jetë edhe një **URDHËRUES**, kur vishet me pushtet burokratik, por kurrë nuk mund të jetë një **PRIJËS**, një **SHEMBULL** për të këtilla punë. **PRIJËS** në të këtilla punë të përparimit tekniko-shkencor mund të jetë vetëm një punëtor ose fshatar që mjetet e jetesës i siguron me punë krahu, dhe njëkohësisht ka njohuri në fusha të caktuara të shkencës. Ky është **NJERIU I KOMUNIZMIT** që e kemi përshkruar në faqet e mëparshme të këtij libri. Ky është **ANËTARI I PARTISË MARKSISTE-LENINISTE ME UNIVERSITET, I CILI PUNON SI PUNËTOR I**

THJESHTË (që, në të vërtetë, nuk është i thjeshtë). **KY ËSHTË GJENIU I VËRTETË I PROSPERITETIT TEKNIKO-SHKENCOR, JO VETËM I KOMUNIZMIT, POR I TË GJITHA KOHËVET**. Në qarqet intelektualistë mund të ketë, lidhur me këtë, një mendim të këtillë: "***Njeriut me talent, që ka prirje për t'u marrë me shkencë, shteti socialist, shoqëria socialiste, duhet t'i krijojnë mundësi për t'u marrë ekskluzivisht me shkencë***." Dhe me fjalën "***mundësi***" ata kuptojnë atë që ai të jetë një nëpunës shkencëtar, pra, një njeri që paguhet si **prodhues mendimesh**. Mirëpo, e vërteta është se në këtë mënyrë atij i shkurtohet, i ngushtohet dhe i pakësohet mundësia për t'u marrë **REZULTATIVISHT** me shkencë. Njeriut me talent do t'i jepej mundësia për t'u marrë **REZULTATIVISHT** me shkencë vetëm atëherë kur ai të punonte drejtpërsëdrejti në prodhim. **VETËM ATJE, NË PROCESIN E PRODHIMIT, LINDIN E ZHVILLOHEN IDETË MADHËSHTORE TË SHKENCËS SË VËRTETË.** Të mos harrohet në këtë mes se fjalën e kemi për njeriun që punon e jeton në socializëm. Në socializëm puna e punëtorit nuk është kurrë rraskapitëse si në kapitalizëm. Njeriu aty nuk punon 10 apo 12 orë dhe intensiteti i punës nuk është kurrë i atillë, që, kur të vijë në shtëpi, të mos jetë gjendje as bukë të hajë. Punëtori në socializëm ka mundësi fare mirë që, në orët pas punës, të merret edhe me shkencë e shpikje. T'i referohemi pak historisë! Pjesa më e madhe e shkencëtarëvet të mëdhenj që njeh bota, nga kanë dalë? A mos kanë dalë ata nga klasat e pasura?! Ata kanë dalë prej ambientevet ku punohej. Arsimi i tyre kryesisht ka qenë autodidakt ose, ashtu si tërë jeta e tyre në rini, i mbushur plot me peripeci e pengesa. Natyrisht, shoqëria e re nuk do të marrë si pozitive pengesat e peripecitë që u krijonte njerëzvet me talent sistemi njerishfrytëzues. Kjo do të ish jonjerëzore. Por ajo do të nxjerrë nga kjo përvojë historike përfunimin se njeriu i talentuar, me qëllim që ta zhvillojë më tutje talentin e vet, duhet të merret, të paktën deri në moshën 40-45 vjeç, me një veprimtari jo vetëm mendore, por edhe prodhuese. Vetëm pas një të këtillë praktike (kuptohet, edhe gjatë saj), ai do të mund t'i japë njerëzimit vepra dinjitoze. Është e vetëkuptueshme që ne nuk po merremi këtu me raste, por po merremi me ligjësi përgjithësuese. Si përfundim, me kalimin e partisë marksiste-leniniste në cilësinë e re, ku anëtarët e saj do të jenë punëtorë të thjeshtë, por me arsim të lartë, përparimit tekniko-shkencor di t'i hapen perspektiva të reja, madje të papara gjer më sot në histori. (f.83, 1982)

{Unë ruaj bindjen se, që të gjitha tezat teorike të shtruara këtu, hiq terminologjinë, herë-herë të komunistizuar, qëndrojnë për të gjitha kohët. 2012}

Në rregulloren e re, që e propozoj unë, si normë të pranimevet në partinë marksiste-leniniste, familjet e punëtorëvet e të fshatarëvet revolucionarë, ato familje që kanë marrë pjesë në luftëra e që kanë dhënë kontributin e tyre me vlera në ato luftëra, kanë **KËTË FAT**, dmth **KËTË TË ARDHSHME**: Një pjesë e fëmijëvet të tyre mbeten objektivisht në gjirin e klasës, për të cilën ato familje kanë shkrirë jetën. Ata pjesëtarë, duke qenë të edukuar mirë në familjet e veta, duke qenë bij prindërish me merita, pasi të mbarojnë studimet, do të kenë mundësi të pranohen në partinë marksiste-leninise dhe **TË MBETEN** kështu **PËRJETË PUNËTORË DHE FSHATARË, avangardë**, **pararojë**. Pra, ato familje nuk do të largohen kurrë nga origjina. Merret me mend, ndonjëri nga fëmijët e tyre do të mund të bëhet edhe nëpunës, pa parti, por themeli i atyre familjeve do të mund të mbetet në vazhdimësi punëtor edhe komunist.

Ndërsa me normat e derisotme në shoqërinë e rendit socialist, ja se cili është "***FATI***" i këtyre familjeve që i kanë dhënë gjithçka, shpeshherë edhe pjesëtarë të vet, luftës dhe revolucionit proletar: **Ato familje, ose duhet t'i lënë fëmijët pa shkollë dhe të mbeten punëtorë, ose t'u japin shkollë e t'i bëjnë nëpunës**. Si cilësi e përgjithshme është kjo: **Cila nga këto familje ka fëmijë të këqinj e të paaftë, ajo i mbetet klasës, ndërsa cila familje ka fëmijë të mirë e të zotë, ajo, për "*merité*", e braktis klasën e vet**. E këtillë është pasoja e konceptevet të gabuar ndaj diplomës, ndaj nëpunësisë dhe ndaj punës së krahut. **KA MARRË PJESË FAMILJA PUNËTORE NË REVOLUCIONIN PUNËTOR, PËR TË MOS QENË MË FAMILJE PUNËTORE.** Kjo **ANOMALI** duhet të ndreqet pa tjetër. (f.84, 1982)

{Kur njeriu kalon nëpër mendje krejt këtë tufë arsyetimersh, ai, krejt natyrshëm, ka për të xjerrë këtë përfundim: ***RENDI KOMUNIST DËSHTOI, PIKËRISHT SEPSE PARAROJA E ATIJ RENDI NUK DESHI TË MBETEJ KOMUNISTE***. Thënë ndryshe: Pararojës, prijëses së revolucionit komunist, ***PARTISË MARKSISTE-LENINISTE, NUK IA MORI MENDJA TA ÇOJË MË TUTJE ATË PUNË, E LA NË MES DHE IU KTHYE KAPITALIZMIT.*** Kjo ndodhi në shkallë botërore, ku më heret e ku më vonë. 2012}

Meqenëse në socializëm **burokratët** ndodhen në mesin e inteligjencës popullore, këta nuk është lehtë të dallohen e të veçohen. Këta fshihen pas titullit që u ka dhënë partia marksiste-leniniste, pas origjinës së mirë, pas

meritavet që kanë, nën hijen e shokëvet e të kolegëvet, në mjegullnajat e liberalizmit. Ata nuk zbulohen lehtë dhe, gjersa të zbulohen, dëmet që i kanë shkaktuar ata ekonomisë, janë të papërfytyrueshëm, janë shumë të mëdhenj. Dëmet që bëjnë në fushën politike dhe ideologjike, janë edhe më të mëdhenj. Si duhet vepruar, që të evitohen këta dëme kolosalë? Duhen luftuar **VEPRIMET** burokratikë, pa pritur që bartësi i tyre të shfaqet si burokrat i mirëfilltë, pa pritur që ai të shndërrohet në armik të pushtetit popullor. "***Të vendoset në radhë të parë kontrolli mbi nëpunësit, mbi funksionarët dhe mbi specialistët nga ana e anëtarëvet të rinj të partisë.***" Thotë V.I.Lenini ("*Kundër burokratizmit*", f.177) S'ka ku të vejë më qartë. Në një vend tjetër, në f.141, V.I.Lenini thotë ndërkaq kështu: "***Një pjesë të pozitavet që ka humbur*** (pas Revolucionit), ***burokracia, orvatet t'i rifitojë duke shfrytëzuar… nivelin jo të lartë kulturor të masavet të popullsisë***." Sot, pas 60 vjetësh, kur shohim se burokracia i rifitoi aq mirë pozitat në një varg shtetesh ish-socialistë, sa ajo ia hapi dyert dykanatësh restaurimit kapitalist, ne na vjen keq dhe revoltohemi, pse ***nuk u vendos kontrolli mbi nëpunësit dhe funksionarët nga anëtarët e rinj të partisë***. Mos vallë edhe këta ishin ***në nivel të ulët kulturor***? 2 mund të ishin arsyet: O këta ishin ***në nivel të ulët kulturor***, o u bënë edhe vetë **burokratë**. Le t'i vëmë, pra, anëtarët e rinj të partisë marksiste-leniniste në atë pozitë që ata të mos jenë as ***në nivel të ulët kulturor***, as të mos kenë mundësi për t'u bërë vetë **burokratë**! Po u bë kështu, burokratizmi do të njohë vetëm shuarje, vetëm minimizim të pandërprerë. (f.85, 1982)

{Unë po pësërisja atë që të tjerrët, madje duke qenë në pushtet, e kishin thënë shumë kohë para meje. E kishin thënë dhe s'i kish dëgjuar njeri. Vetëm kjo duhej të mjaftonte, që unë të hiqja dorë nga harxhimi kot i bojës dhe i letrës. 2012}

Te **liberalizmi** s'ka pse zgjatemi shumë. Deri sa komunisti, i atillë siç e kam projektuar unë, është treguar aq rigoroz **NDAJ VETES**, sa, për hir të idealevet të komunizmit, ka braktisur komoditetin e nëpunësit dhe ka shkuar e është bërë punëtor i thjeshtë, ai nuk mund të tregohet lëshues as ndaj vetes, as ndaj të tjerëvet. Rrjedhimisht, ai nuk do ta durojë liberalizmin në çfarëdo forme që të shfaqet. Kur vetë partia marksiste-leniniste, në bazën e vet, e lufton kaq natyrshëm libealizmin, atëherë është e qartë që edhe liberalizmi kish për të njohur vetëm shuarje, vetëm minimizim në vijueshmëri. (f.86, 1982)

{Sërish shpenzim i kotë, edhe i letrës, edhe i bojës, edhe i kohës. Por unë prapë po e ngushëlloj veten: Sa qindra mijë, madje miliona njerëz, i humbin edhe kohën, edhe energjitë, duke luajtur domino nëpër lulishte? Apo: edhe kohën, edhe paratë, nëpër lojëra fati?! T'i lëmë këto gjëra të shkruara! Mund të ndodhë që dikur të hyjnë në punë, qoftë edhe të rishikuara. 2012}

Vetë akti i **KALIMIT NË PRODHIM I NËPUNËSVET QË PRANOHEN NË PARTI**, do të bëhej një prej shkaktarëvet më efikasë të shfryrjes së aparatevet të administratës. Por mjeti më vendimtar e më i rëndësishëm do të ishte fakti se **KËTA PUNËTORË KRAHU** (ose punëtorë makinerish) **ME UNIVERSITET, DUKE PASUR FORCËN VENDIMPRURËSE NË PARTI,** nuk do të lejonin, **NUK DO TË TOLERONIN** kurrfarë rëndimi, pra **KURRFARË TEPRIMI NË APARATE ADMINISTRATIVË.** Çdo nëpunës, aty e tutje do të kishte 2 rrugë: O të punonte shumë mirë e t'ia hapte udhët vetes për t'u pranuar, po të donte, edhe ai në parti dhe kështu për t'u bërë punëtor i thjeshtë, ose të punonte keq dhe të shkarkohej nga posti administrativ për punën e tij të keqe, pra, prapë të bëhej punëtor.

Mjeti i tretë do të ishte fakti që ata komunistë **(NJERËZ TË KOMUNIZMIT)**, një ditë, ndoshta mbas 100 a 200 vjetësh, një pjesë të punëvet mendore dhe organizative do t'i kryenin vetë, pa para. Siç i kryen njeriu pa para punët organizative, po dhe të tjera punë, në familje. Psh. kur të kish 3 apo 5 mjekë komunistë, që do të punonin në bujqësi, në një fshat 2000-banorësh, ç'nevojë do të kish për mjek të paguar? Arkitektët dhe inxhinierët do t'i bënin projektet **për t'u shërbyer** bashkëfshatarëvet apo bashkëqytetarëvet, jo për të marrë para prej tyre. Poetët do t'i shkruanin veprat e veta **PËR NJERËZIMIN**, pa kërkuar para. Piktorët do t'i krijonin piktuarat jo për t'i shitur, por **për të zbukuruar** me to shtëpitë e miqvet dhe të shokëvet, shkollat, spitalet, zyrat. Dentistët nuk do t'u kërkonin njerëzvet **qimet e kokës** për t'u shkulur një dhëmballë. Panorama e pakësimit të nëpunësvet në të gjitha instancat është aq e larmishme dhe aq tërheqëse, sa **vetëm një diskutim shumë i gjërë** rreth kësaj çështjeje, me një vështrim tërësisht **HUMANIST**, do të mund ta konkretizonte në përfytyrimin sot për sot të çoroditur të njerëzimit. (f.87, 1982)

{Sa kohë që njerëzit nuk do t'u kthehen rrugëvet të **HUMANIZMIT**, ata s'kanë nga shkojnë tjetër, veçse nëpër

rrugët e **ANTIHUMANIZMIT**. Dmth. nëpër rrugët kundër vetëvetes si qenie. 2012}

Të rendurit pas ***QOSHES SË REHATSHME*** është një nga dukuritë që gjallon në shoqërinë tonë si mbeturinë e së kaluarës dhe që Partia jonë (PPSH) e ka dënuar me forcë. Ky, në të vërtetë, është njëri nga aspektet e synimevet për rindarjen e shoqërisë në klasa antagoniste. Por, kush arrin, në fakt, faktikisht, të zërë një qoshe të rehatshme? ***Qoshen e rehatshme*** arrin ta zërë ai hileqar social, i cili, me dredhi, ia del ta gënjejë shoqërinë, duke e paraqitur punën që i është ngarkuar, aq të vështirë, sa të tjerët të mendojnë se ajo nuk është një ***qoshe e rehatshme***. Në jetën tonë të përditshme këtë dukuri e hasim në të gjithë mjediset, pra edhe midis fshatarëvet dhe punëtorëvet, por forma e së quajturës ***qoshe e rehatshme*** që haset midis nëpunësvet, është shoqërisht shumë më e rrëzikshme se midis punëtorëvet e fshatarëvet. Se në cilin ambient janë më idealë kushtet e ***qoshes së rehatshme***, do të mjaftonte vetëm një e dhënë statistikore fare e thjeshtë: Ku ka më shumë njerëz të dhjamur? Shfaqja dhe shtimi i njerëzvet me bark e me gushë të dhjamur nuk është shenjë e mirë. Është dëshmi e parazitizmit, që me fjalë të tjera do të thotë: ***"Të punojnë të tjerët e të ha unë!"*** Është një nga rrugët më të sigurta që e çon socializmin drejt dështimit. Por, kush është i thirrur për të mos lejuar kthimin prapa? Janë ata njerëz që në literaturën marksiste-leniniste i kanë quajtur ***pararojë***. Pra, **komunistët**. Si t'i bëhet hallit, kur komunistët janë njerëz të sinqertë, naivë e të pazotë? E kanë thënë në një vend, s'më kujtohet se ku, Lenini apo Stalini, se "***njerëzvet tanë, komunistëvet të sinqertë e të padjallëzuar, do t'ua hedhin armiqtë e pushtetit e të sovjetëvet***". Në projektin tim, kur komunistët, njerëz me universitet, madje ajka e universitarëvet, do të jenë larguar vetë nga ***qoshja e rehatshme***, nuk do të mund të ndodhë më që dikush tjetër ta shfrytëzojë një të tillë ***qoshe***. (f.88, 1982)

{Në kohën tonë, një pjesë e konsiderueshme e banorëvet të Planetit, e ka shndërruar në ideal **TË JETUARIT PA PUNË**. Kjo rrugë nuk e çon tjetërkund njerëzimin veçse në **GREMINË**. Dmth, në **KATASTROFË**! 2012}

Lakmia për **karrierë** lind te njerëzit që e konsiderojnë veten më të zotë se të tjerët. Në kapitalizëm karrierizmi është në natyrën e shoqërisë. Atje, qysh në djep, fëmija ushqehet me aspiratat për karrierë. Në socializëm kjo është po ashtu si dhe kërkimi i qoshes së rehatshme, shprehje e synimit për t'u rindarë shoqëria në klasa antagoniste. **MITI I KARRIERËS** në socializëm është po

aq i dëmshëm sa edhe miti i qoshes së rehatshme, vetëm se ky, zakonisht, nuk shoqërohet me dhjamosje. Si të shkatërrohet ky mit? Kurrsesi ndryshe, veçse duke shpallur si ideal të rinisë të kudërtën e "***të ngjiturit lart***", që është "***të zbriturit***" për të jetuar e punuar midis punëtorëvet. Për shumëkënd ndoshta kjo do të dukej një "***romantikë disi e ashpër***", por një gjë duhet të jetë e qartë: Ata që këtë "***romantikë të ashpër***" do ta bënin të tyren, do të këputnin njëherë e përgjithmonë shkallaren e karrierës për këdoqoftë. Karrierë nuk do të kishte më. Do të kishte vetëm punë në shërbim të popullit, lumturi bashkë me popullin. (f.89, 1982)

{Shikimi im i sotëm është ky: Të shpallurit e karrierës si mentalitet të dëmshëm, e kish çuar shoqërinë e atëhershme në dyert e një barazimtarie banale. Pagesa e njëllojtë ose përafërsisht e njëllojtë edhe për të talentuarit e punëdashësit, edhe për të paaftët e dembelët, ishte një ndër shkaktarët e shkatërrimit të ekonomisë socialiste. Karriera pozitive, ambicja pozitive duhej të inkurajohej. Por, si të kryhej kjo punë? 2012}

Me vënien në jetë të një metode të këtillë thelbësisht revolucionare për pranimet në partinë marksiste-leniniste, **BREZI QË VJEN FILL MBAS BREZIT TË LUFTËS**, **KA edhe ai ÇFARË TË BËJË**, në kuptimin më të plotë të kësaj shprehjeje. Idealet që i hapen para syvet këtij brezi, mund të themi me plot gojën se nuk janë aspak më të zbehtë se idealet e brezit të luftës. Në RPS të Shqipërisë njerëzëvet që e mbajnë mend kohën e Paraluftës, u bëjnë shumë përshtypje ndryshimet që janë bërë në këtë vend në 3-4 dhjetëvjetëshat e Pasluftës. Me kushtin e ri të pranimevet në PPSH, brezit të Pasluftës i krijohet mundësia që pas 3-4 dhjetëvjetëshavet të tjerë njerëzvet gjithashtu t'u bëjnë përshtypje ndryshimet. Çfarë ndryshimesh do të mund të bëheshin në këtë periudhë, as që mund të përfytyrohen, por një gjë është e sigurtë: Ideali që lind në mendjen e në shpirtin e komunistëvet punëtorë me arsim maksimal, është një ideal madhështor. Qytetet e rinj dhe veprat industriale do të shtoheshin në këtë periudhë si lulesa jargavanësh. Udhët dhe hekurudhat do ta bënin hartën e vendit si dantellë vajzash të sapofejuara. Do të lidhej me hekurudhë çdo skaj i atdheut tonë dhe me rrugë të asfaltuara çdo fshat e lagje fshati. Bujqësia do të shkonte drejt asaj që të mund t'i jepeshin popullit prodhimet bujqësorë pothuaj falas dhe vendi do të mund t'i ngjante një lulishteje përrallore. Arsimi e kultura do të vinin duke u përmirësuar pa ndërprerje, ndërsa dukuritë josocialiste do të vinin duke u rralluar e pakësuar, si një sëmundje që luftohet me profilaksi. Duke vënë në jetë mënyrën e re të pranimevet në partinë marksiste-leniniste, brezin e ri

papritur fillon ta preokupojë një çështje e re, një çështje e madhe, çështja e hapjes së rrugëvet për në komunizëm. Natyrisht, e gjithë kjo as që mund të përfytyrohet pa një luftë të ashpër klasash, pa përpjekje e pa sakrifica, por e rëndësishme do të ishte të kuptohej se këtu, sido që të vinte puna, iniciativën do ta kishin në dorë forcat përparimtare, ata përfaqësues e trashëgimtarë të brezavet që e kanë mbajtur dhe mbajnë me vete peshën e progresit shoqëror. Me brezin e shkuar, me gjeneratat e komunistëvet, që koha nuk i kish lënë të jenë aq të ditur, por që, megjithatë, kanë bërë mrekullira, komunistët e rinj do të kishin, pa tjetër, marrëdhënie respekti e dashuri mirënjohëse. Brezi i vjetër do të vazhdonte të militonte në parti, duke shkrirë të gjitha energjitë e veta për idealet e socializmit e të komunizmit. Ai do të përbënte një bazë të shëndoshë përvoje klasore, mbështetje e mirë për brezin e ri të komunistëvet. (f.90, 1982)

{Ky ka qenë një përshkrim i asaj çfarë synohej me kalimin e një pjese të intelektualëvet në punë prodhuese. Ishte një përfytyrim. A do të mund të ndodhte ashtu apo jo, nuk mund të parashikohej. Por, nëse nuk zbatohej kjo ide, dështimi i komunizmit do të ishte i sigurtë. 2012}

Me hyrjen në parti dhe me kalimin në prodhim, të njerëzvet që kanë një diplomë të lartë, **koncepti i diplomës** në tërë shoqërinë do të ndryshohej rrënjësisht. Diploma nuk do të ishte më gjë tjetër, veçse një vërtetim se **ky njeri, po qe se ka nevojë shoqëria, është i aftë të kryejë edhe një punë tjetër**, veç punëvet si punëtor i thjeshtë. Në rast se zotëruesi i diplomës është komunist (i pranuar në parti pasi e ka mbaruar universitetin), atë nuk do ta lejonte statuti i partisë që të ushtronte profesionin e sferës intelektuale si nëpunës i paguar, ndërsa, në qoftë se zotëruesi i diplomës do të ishte jashtë partisë, atëherë **ai do të kishte mundësi të kërkonte e të gjente punë mbi bazën e diplomës**, dhe pikërisht nga kjo kategori njerëzish do të përbëhej inteligjenca popullore e një vendi të caktuar. Intelektuali popullor kështu nuk do ta kishte të mjaftueshme pasjen e një diplome, por do t'i duhej edhe të punonte shumë mirë. Ai zotërues diplome, i cili do të tregohej i paaftë ose neglizhent, do të mund të çohej pa ndonjë hezitim në çfarëdo pune të thjeshtë dhe, me rastin e çuarjes atje, ai nuk do ta ndiente veten aspak të dënuar. Kjo ka rëndësi të kuptohet: **Nuk do ta ndiente veten të dënuar**, për arsye se shokët e tij universitarë komunistë do të kishin shkuar atje prej kohësh, vullnetarisht. Në këtë mënyrë, edhe klasa punëtore do të forcohej

akoma më shumë me njerëz të ditur, edhe inteligjenca, administrata, do të ishte e gjallëruar, e shkathët, operative, pa rutinë e pa liberalizëm.

Mirëpo, me këtë rast, do të ishte mirë të sqarohej edhe një çështje tjetër: **AUTORITETI I KUADRIT**, i njeriut të emëruar, cili do të ishte nën këta kushte të rinj? Gjithë shoqëria, e në mënyrë të veçantë komunistët, duhet ta kenë të qartë se, **PA IU NËNSHTRUAR NJË AUTORITETI, ASGJË NË NJË SHOQËRI TË PËRPARUAR NUK MUND TË FUNKSIONOJË.** Prandaj, **AUTORITETI I NËPUNËSIT**, i kuadrit, do të mbrohej me ligje e me vendosmëri nga vetë partia dhe konkretisht nga të gjithë komunistët që do të punonin në bazë. **Urdhërat e eprorit do të vazhdonin të ishin ligj për vartësin**. Vartësi do të detyrohej t'u bindej atyre urdhërave pa kundërshtime, qoftë ai edhe anëtar partie me universitet, bile ai ca më mirë. Autoriteti i diplomës në këtë kuptim do të kish peshën e vet dhe do të qëndronte në vendin e vet. Gabimet e nëpunësvet nuk do të diskutoheshin rrugëvet, por atje ku e kanë vendin për t'u diskutuar. (f.91, 1982)

QARKULLIMI i vërtetë në shoqërinë socialiste do të bëhej e mundur të realizohej vetëm pasi të vendosej forma e pranimit të shkollarëvet në parti, duke i bërë ata punëtorë prodhimi. Së pari, në këtë mënyrë do të sigurohej një **qarkullim social** i rregullt e sistematik **NË RELACIONIN INTELIGJENCË – KLASË PUNËTORE E FSHATARËSI**, gjë që është me rëndësi të dorës së parë për t'u imunizuar shoqëria nga krijimi i çdo lloj elite të dëmshme. Me këtë rast, duke "***zbritur***" (më saktë: duke "***u ngjitur***"), në prodhim vetë komunistët, do të krijoheshin mundësi të mira edhe për forma të tjera të **qarkullimit** në po atë relacion: inteligjencë – kalasë punëtore e fshatare. Së dyti, duke çuar në administratë komunistët punëtorë e fshatarë, me më së paku nga 10 vjet stazh pune krahu, në fakt bëhet një qarkullim i mirëfilltë **NË RELACIONIN KLASË PUNËTORE E FSHATARE – INTELIGJENCË**, veç asaj që nëpunësit pa parti (jo anëtarë partie), edhe në të ardhshmen do të ishin kryesisht bij punëtorësh e fshatarësh. Në këtë mënyrë, në relacionin klasë – inteligjencë dhe anasjelltas do të mbyllej **qarku i qarkullimit social**. Së treti, duke pranuar në partinë marksiste-leniniste nëpunës të ndryshëm, midis tyre, natyrisht, edhe nga dikasteret qendrorë, nga aparatet administrativë të komitetevet ekzekutivë, nga administratat e uzinavet e të kombinatevet, nga ushtria, nga fakultetet e nga institutet shkencorë, nga rredaksitë e nga shtëpitë botuese, kuptohet se atje do të mbeteshin vende bosh, të cilët do të plotësoheshin vijimisht me kuadro të rinj nga shtresat që quhen ***të ulëta***, por që, në kushtet e përmbysjes së pushtetevet, do të duhej quajtur ***të larta***. Kështu edhe qarkullimi **NË**

RELACIONIN BAZË – QENDËR do të funksiononte më në rregull. Kur marrim parasysh që një parti, e revolucionarizuar në këtë mënyrë, pra, subjektivisht, nuk do të lejonte që në organet drtejtues të kish bartës të burokratizmit, rutine etj, por do t'i pastronte organet drejtues në vazhdimësi, kuptohet se edhe ky do të ishte një **qarkullim** i tillë **social**, i cili vazhdimisht do të realizonte shëndoshjen e aparatevet administrativë.

QARKULLIMI ËSHTË NJË NGA ARMËT MË EFIKASE PËR LUFTËN KUNDËR SYNIMEVET TË RINDARJES SË SHOQËRISË NË KLASA ANTAGONISTE.

Fëmijët e udhëheqësvet, me këtë metodë, ose nuk do të pranoheshin fare në partinë e prindërvet të vet, gjë që nuk do të ishte normale, ose **do të bëheshin domosdo punëtorë**. Do të ishte mrekullia vetë, kur një anëtar byroje, një minister, një profesor akademik, t'i kishte në shtëpi 1 ose 2 punëtorë dhe aty të diskutohej në mënyrë të natyrshme si për problemet "***e mëdhenj***" shtetërorë e partiakë, diplomatikë, shkencorë etj, ashtu edhe për problemet "***e vegjël***" të cilësisë së vajit lubrifikant, të vrugut pranveror, të pluhurit që ngre makina shirëse, të qëndisjevet artizanale dhe të ujitjevet, me përmbytje ose pa përmbytje. Kjo është **ëndrra e një shoqërie pa klasa antagoniste**. (f.92-93, 1982)

{Popujt, që e patën në dorë ta realizonin një ëndërr të tillë, nuk deshën të lodheshin me të tillë "***BUDALLALLËQE***" dhe, në vend të të tillë "***BUDALLALLËQEVE***", i bënë fare "***MENÇURISHT***" vajzat e veta **PROSTITUTA** nëpër Evropë. Moldavia, Polonia, Shqipëria dhe shumë vende të tjerë ish-komunistë realizuan kështu një lloj tjetër qarkullimi social, shumë "***MË TË KËNDSHËM***", "***MË TË BUKUR***" dhe ***"MË TË LEHTË"*** për t'u realizuar. 2012}

Megjithëse kjo çështje del qartë nga sa kam parashtruar gjer tani, është e nevojshme të thuhen disa gjëra më konkretisht. Në partinë marksiste-leniniste do të pranoheshin zakonisht nëpunës të rinj, me rreth 5 vjet stazh pune zyrtare ose më pak. Ata do të pranoheshin sipas nevojavet që do të kishte çdo organizatë-bazë dhe ajo do t'i zgjidhte kandidatët për komunistë nga radhët e nëpunësvet vendës, në sektorin ku ajo vepron. Për dikasteret dhe në përgjithësi për organizatat ku nuk ka punëtorë, natyrisht që do të procedohej krejt ndryshe. Është e kuptueshme që edhe kjo punë do bëhej në mënyrë të centralizuar, me plan e me orientim nga udhëheqja e partisë lidhur

me numrin e kandidatëvet që do të afroheshin në një vit, lidhur me përfaqësimin në parti meshkuj edhe femra etj, por sidoqoftë, kjo do të ishte kryesisht punë e organizatës-bazë. Me këtë rast, do të ndodhte që një vend pune të mbetej bosh. Si do të plotësohej vendi bosh në zyrën përkatëse? Vedi i mbetur bosh do të plotësohej si në rastet kur ka mungesë kuadri. Në rastet kur ka mungesë kuadri, kur s'ka fare kuadër, kur kuadri (nëpunësi) transferohet, kur martohet e ndërron vend, kur del në pension, kur vdes papritur, si veprohet për ta plotësuar vendin që ka mbetur bosh? Emërohet një kuadër i ri. Se ku të gjenden nëpunësit për të plotësuar boshllëqet, qeveria, si në qendër, ashtu edhe në rrethe, ka mënyrat e veta tashmë të njohura e të praktikuara prej disa dhjetëvjetëshash. As në këtë punë nuk do të ndryshonte asgjë, vetëm se shkaqevet të të mbeturit bosh të vendevet të punës, tani do t'u shtohej edhe një shkak më shumë: **SHKUARJA NË BAZË PËR SHKAK TË PRANIMIT NË PARTI.** Por duhet kuptuar që ky shkak është i një rëndësie tepër të madhe. Në praktikën e derisotme, një martesë, një ndërrim vendbanimi, një invalidim, një shkuarje ushtar, vë në lëvizje krejt një qeveri vendore, një komitet ekzekutiv dhe një komitet partie, gjersa të plotësohet vendi i lënë bosh. Kështu do të ndodhë edhe me rastin e pranimevet të rinj në parti, veprim ky nga më jetikët, që **LIDHET DREJTPËRSËDREJTI ME FATET E VAZHDIMIT APO MOSVAZHDIMIT TË SISTEMIT SOCIALIST.** Gjithë problemi qëndron te të kuptuarit e rëndësisë së këtij akti, nga më revolucionarët, që njerëzimi pret ta shohë e ta njohë. (f.94, 1982)

{Asgjë prej kësaj që po shkruhej, s'kish ndërnend të vihej në jetë. Libri im, 2 ekzemplarë, do të lihej diku nëpër sirtarët e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë ose në arkivin e Ministrisë së Punëvet të Brendshme, ndërsa një ekzemplar, i rruajtur në shtëpinë time, mezi do t'u shpëtonte minjvet, lagievet dhe procesit shkronjëzhdukës prej mykut. 2012}

KOMUNISTËT E RINJ, FSHATARË E PUNËTORË ME ARSIM UNIVERSITAR, s'ka dyshim se do të ishin njerëz të pararojës në radhët e klasës punëtore e të fshatarësisë. Për këtë nuk mund të ketë asnjë dyshim. Si të tillë, kuptohet, jo në të gjithë rastet, por në shumë raste, ata do t'i zgjidhte populli në kryesitë e të quajturavet **ORGANIZATA TË MASAVET**. Në këtë mënyrë, organizatat profesionale në bazë, byrotë e organizatavet të rinisë nëpër reparte uzinash e fabrikash e në fshatra, kryesitë e organizatës së frontit demokratik, gjykatat popullore, doemos do të punonin më mirë. Është

shumë i besueshëm një parashikim i këtillë. Mirëpo, të kesh të quajturat organizata të masavet, poshtë në bazën e tyre, kaq të forta, është një garanci e fortë që punët të ecin mirë në krejt shoqërinë.

Kjo është **MËNYRA MË EFIKASE PËR TA BËRË KLASËN *TË FLASË***, për t'i dhënë mundësi klasës që të ushtrojë pushtetin e vet, të fituar me aq sakrifica. Gjallërimi i punës në **ORGANIZATAT E MASAVET**, në periudhën pas ndërtimit të bazës ekonomike të socializmit, është një nga kushtet vendimtarë për ecjen përpara të ekonomisë e të kulturës së një vendi socialist. Shuarja dhe amullimi i këtyre organizatave është një shenjë nga më tipiket që tregon mungesë entuziazmi dhe rënie të vrullit revolucionar në këtë sistem shoqëror. (f.95, 1982)

{Vrulli revolucionar pikërisht në ata vite po binte deri në squllje të plotë. Nuk kish më vrull. Kish shqetësim, kish keqardhje, kish edhe frikë: ***"ÇFARË DO TË BËHET ME NE?!"*** Ndërkaq, jeta në të quajturin **BLLOK I UDHËHEQËSVET**, i ngjante një mëzati, një kau të vetëtredhur, impotent, i cili tashmë nuk mund të pillte **ASGJË TË RE**, përveç kthimit rrëmujazi në kapitalizëm. Në vend të të quajturavet **ORGANIZATA TË MASAVET**, vendin e prisnin qindra të quajtura **OJQ**, prodhime në seri të hipokrizisë kapitaliste. 2012}

Sapo të shtrohet kërkesa: "***Të gjithë pranimet nga radhët e të shkolluarvet, me kusht që këta të heqin dorë nga nëpunësia***!", shumëkush mund të thotë: "***Kjo nënkupton që praktikisht të mos ketë më pranime në parti, pasi, me këtë kusht kaq të rëndë, askush nuk do të dëshirojë të bëhet anëtar partie***." Pa e provuar, një parashikim të tillë nuk mund ta marrim si të sigurtë, ashtu si nuk mund të besojmë lehtë as te ndonjë parashikim i kundërt, se gjithë rinia e shkolluar tani e tutje do të jetë e gatshme për ta lënë nëpunësinë e për t'u futur në parti, **POZICION NGA I CILI UDHËHIQET VENDI**. Por 2 gjëra mund të thuhen me saktësi: E para, **PA VENDOSUR NJË KUSHT TË TILLË TË PRANIMEVET NË PARTI, SOCIALIZMI NUK MUND TË PËRFUNDOJË SË NDËRTUARI DHE RUGA PËR NË KOMUNIZËM AS QË DO TË HAPET NDONJËHERË**, e dyta, në rendin socialist, po edhe në kapitalizëm, njerëzit që aspirojnë apo ëndërrojnë për komunizëm, janë të shumtë. Duke i bashkuar këta 2 pohime, del se ata

që do ta kuptojnë që **SHKUARJA NË KOMUNIZËM NUK BËHET NDRYSHE**, nuk kanë se si, për hir të një nëpunësie, ta braktisin aspiratën e vet.

Në fund të fundit, kjo varet shumë prej punës bindëse e propaganduese të partisë marksiste-leniniste. Në qoftë se partia do të krijojë bindjen se **kjo është e vetmja rrugë e drejtë që duhet të ndiqet**, edhe kandidatë për të hyrë në parti kanë për t'u gjetur. Për krahasim mund të marrim një shembull: atje ku partia komuniste nuk ishte e bindur që e vetmja rrugë për ndërtimin me sukses të socializmit ishte, misdis tjerash, kolektivizimi, atje nuk u bë kolektivizimi dhe nuk u ndërtua socializmi. Atje ku bindja e partisë ishte e kundërt me të sipërmen, kolektivizimi u krye dhe socializmi vazhdoi në rrugën e vet, deri sa i dolën pengesa të tjera.

Ndërkaq, pyetjes: "***Kush do t'i sulmojë në këta kushte dyert e partisë***?" ne mund t'i përgjigjemi kështu: "***Është krejt e sigurtë që njerëzit që kanë qëllime të përfitimit vetjak*** (personal), ***nuk do të kërkonin për të hyrë në këtë lloj partie. Aty do të kërkojnë të hyjnë vetëm njerëz të mbrujtur me idealet e lartë të komunizmit.***" Kjo nuk mund të mos konsiderohet fitore e madhe për një parti që gjendet në pushtet. (f.96, 1982)

{Të qe zbatuar ky parim në Bashkimin Sovjetik dhe në Kinë, unë edhe sot kam bindjen se: në më pak se 50 vjet, **NJERËZIT NUK DO TË IKNIN NGA LINDJA NË PERENDIM, POR NË TË KUNDËRTËN.** Në të kundërtën, **SEPSE NË LINDJE RROGAT DO T'UA KALONIN TREFISH ATYRE TË PERENDIMIT.** A mund të merret si i besueshëm ky pohim?! A mund t'i besohet këtij pohimi?! Meqë nuk u provua, natyrisht që nuk ka pse besohet. Por, as të hidhet poshtë, nuk ka arsye, **PA U PROVUAR**.

Mirëpo, ne s'po kemi kohë tash të merremi me të këtillë **EKSPERIMENTE**, sepse po na duhet të bëjmë trafik organesh, trafik droge, trafik e shfrytëzim fëmijësh, transport klandestinësh, trajnim kamikazësh, vrasje fëmijësh nëpër shkolla, rrëmbime vajzash nga 200 përnjëherësh. Po na duhet edhe të shtojmë e të përsosim armatimet e t'i ngrehim raketat sa më këcënueshëm kundër njëri-tjetrit. Të përsosim armët bërthamore, armët biologjike, armët kimike. Të përsosim

kibernetikën, në shërbim të një kacafytjeje gjithnjerëzore. Këto po na duhen. Po na duhet **EDHE TË SHAJMË SA MË "*BINDSHËM*" KOMUNIZMIN,** sepse **AI** është "***SHKAKTARI***" i të gjitha këtyre që i numëruam. 2012-2014}

Të quajtur ***KOMUNISTË TË MEFSHTË***, si dukuri, nuk do të kishte më. Logjika na e thotë se ky lloji tjetër i komunistëvet, **PUNËTORË KRAHU ME ARSIM UNIVERSITAR**, në përgjithësi, do të ishin njerëz shumë energjikë, njerëz të palodhshëm, të cilëvet do t'u punonin pareshtur, si mendja, edhe dora. Njerëz që do të udhëhiqnin me shembullin vetjak, agjitatorë të zotë! Njerëz të papajtueshëm gjer në fund me të metat që hasen në shoqëri! Si **NJERËZ TË KOMUNIZMIT**, si njerëz të një sistemi të ardhshëm shoqëror, këta as që mund të përfytyrohen ndryshe. Megjithatë, nuk përjashtohet që aty-këtu të shfaqet edhe nga radhët e tyre ndonjë anëtar partie i mefshët. Kjo do të ndodhte me ata komunistë që nuk do të mësoheshin dot me punën e krahut. Të tillët do të mërziteshin, do ta ndienin veten të lodhur e të përtacëruar, madje mund të mendonin se janë të sëmurë (se ashtu u krijohet përshtypja jorezistentëvet), dhe kështu do të tërhiqeshin në vetëvete si mikroborgjezë të zënë ngushtë. Rruga e vetme e veprimit me të këtillë anëtarë partie, pas gjithë përpjekjeve për t'i gjallëruar e aktivizuar, do të ishte përjashtimi, ashtu siç veprohet zakonisht në rastet kur shfaqet mefshtësia në radhët e një partie marksiste-leniniste. Mirëpo, në të tillë raste, partisë do t'i duhej të parashikonte një tjetër rrëzik: "***MEFSHTËSIA***" do të mund të shfaqej edhe si pasojë e dëshirës për t'u rikthyer në zyrë. Prandaj, një partie që është në gjendje t'i parashikojë rrëziqet, sepse kjo do të mund të shndërrohej në epidemi, do t'i duhej të vendoste edhe një rregull shtesë: ***"Ai që përjashtohet nga partria, për çfarëdo arsyeje, nuk mund të emërohet nëpunës."*** (f.97, 1982)

{Duke lexuar faqet e këtij libri, **INTELEKTUALËT E MIRËFILLTË**, do të binin në mendime, do të rezononin, do të bënin analiza, dhe jam i bindur që nuk do t'i kundërshtonin të këtilla ide, sado që vetë ndoshta nuk do të mund t'i viheshin një të këtillë rruge. Pjesa tjetër e **KALEMXHINJVET**, dihet: Ata do të gjenin këtu rastin për të bërë humor. 2012}

Cilësitë më të çmuara të organizatavet-bazë të një partie të përbërë nga punëtorë me arsim maksimal, do të ishin 2: **DISIPLINA E NDËRGJEGJSHME DHE VETËVEPRIMI**. Disiplina e ndërgjegjshme do të vinte nga fakti se ata komunistë do të jetonin e punonin si punëtorë dhe

dihet që disiplina e punëtorëvet është gjithmonë më e mira. **VETËVEPRIMI** do të vinte nga fakti se ata komunistë do të ishin njerëz me njohje të gjëra, si në teori edhe në praktikë. Duke qenë se në një organizatë-bazë do të militonin njerëz të pajisur me dituri nga fusha të ndryshme, kuptohet se një organizatë e tillë do të ishte edhe e aftë t'i zgjidhte vetë problemet në fusha të ndryshme. Në kushtet e një uniteti mendimi e veprimi, siç e kërkojnë parimet e partisë marksiste-leniniste**, NJË E TILLË ORGANIZATË-BAZË DO TË KTHEHEJ SHUMË SHPEJT NË NJË TRANSFORMUESE TË ATILLË TË REALITETIT, QË BOTA NUK E KA PARË GJER MË SOT.** Një të tillë organizate-bazë, partia nga lart nuk do të ishte e detyruar t'ia përsërisë direktivat nga disa herë. Aty do të kish ose zbatim, ose përgjegjësi për moszbatimin. "***MË JEPNI NJË ORGANIZATË REVOLUCIONARËSH, QË TA PËRMBYS RUSINË*** (CARISTE)!" Ka thënë, përafërsisht, V.I.Lenini, në një rast, duke folur për rolin e Partisë Bolshevike Ruse. Me një të tillë organizatë-bazë partie, masa e popullit gjithnjë e më pak do të kish nevojë për t'i shkruar letra udhëheqjes së lartë të partisë e qeverisë. Të gjithë hallet e popullit kish për t'i zgjidhur pushteti lokal, i udhëhequr nga një e tillë organizatë partie. (f.98, 1982)

{Por, me sa duket, në vendet ku pat triumfuar revolucioni, organizatat e revolucionarëvet erdhen duke u pakësuar gjithnjë e më shumë. TANI E KISH RADHËN **KUNDËRREVOLUCIONI** E JO **REVOLUCIONI**. 2012}

Komunistët punëtorë e fshatarë me arsim të lartë do të ishin **NJERËZIT MË KUALITATIVË TË SHOQËRISË**. Në kohë paqeje ata do të ndodheshin në frontet më të vështirë të prodhimit. (Duhet të mos harrojmë se në frontet më të vështirë të prodhimit ata nuk do të shkonin vetëm sepse **ATJE I KËRKON DETYRA**, por edhe sepse atë detyrë mund ta kryenin **VETËM ATA**, sepse **ATA** e kanë zotësinë e nevojshme, sepse **ATA** janë të zgjedhurit midis individëvet më të aftë të shoqërisë.) Duke qenë të tillë, në kohë paqeje **ATA DO TË JEPNIN KONTRIBUTIN E VET EDHE NË PËRGATITJEN E GJITHANSHME TË POPULLIT, CILITDO POPULL, PËR MBROJTJE**. Në stërvitjet ushtarake këta komunistë, vetëkuptohet, do të kryenin detyrën e oficerit rezervist. Por në kohë luftërash ata njerëz do të ishin, pa asnjë dyshim, oficerët më të mirë e më kualitativë. Në këtë pikë nuk është aspak e nevojshme të hyhet më thellë në analiza. Veçse duhet ditur që **ASNJË AKADEMI NUK ËSHTË NË GJENDJE**

TË PËRGATISË OFICERË MË TË ZOTË, MË TË MIRË DHE MË HUMANISTË SE *"AKADEMIA E KLASËS PUNËTORE".* (f.99, 1982)

{I shihnim, nëpër stërvitjet ushtarake të forcavet rezerviste, **INTELEKTUALËT**, të veshur si **OFICERË**. S'ka dyshim që ata ishin pjesa më patriote, pjesa më e vetëdijshme mbi domosdoshmërinë për të mbrojtur atdheun, në rast se ai do të sulmohej. Teorikisht, s'do mend se ishin më të përgatiturit, por fizikisht nuk ia thoshin as sa më i dobti kooperativist. Stërvitjet, që nga rreshtimi, nuk i bënin dot as mirë, as bukur. Marshimet nuk i përballonin dot. Uniforma u rrinte aq shëmtueshëm, sa kurrsesi nuk mund t'i merrje për ushtarakë. Merrej me mend se ç'do të ndodhte, në një rast lufte, me njësitë që ata do të komandonin. 2012}

Si përfundim, i krejt kësaj që e parashtrova, unë mendoj se: Për të krijuar **NJERIUN E KOMUNIZMIT**, të cilin po e pret skena e historisë, nuk ka rrugë tjetër më të përshtatshme se kjo. Atë **NJERI** duhet pa tjetër ta krijojë ajo parti marksiste-leniniste, e cila ndodhet në pushtet. Atë tip të ri njeriu nuk mund ta krijojë askush tjetër, përveç një parti, gjithmonë marksiste-leniniste, e cila ia ka arritur, duke qenë në udhëheqje të shtetit, të ndërtojë një bazë solide ekonomike.

Me qenë se në kohën tonë nuk ka në botë një vend tjetër, veç Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë (RPSSH), që t'i ketë plotësuar kushtet e mësipërm, atëherë unë mendoj që kjo detyrë historike duhet të fillojë pikërisht këtu. I takon, pra, PPSH-së që ta hapë këtë rrugë **HEROIKE**. Kjo është një detyrë madhështore që duhet ta marrin përsipër për ta kryer bijtë e revoloucionarëvet e partizanëvet të lavdishëm. Kjo është mjaft e vështirë, por jo aq e vështirë, sa ç'ishte detyra e prindëvet të tyre, kur i patën hyrë punës për të bërë revolucionin me armë e për të çliruar vendin. Kjo do të jetë e vështirë, por njëkohësisht do të jetë edhe një punë e bukur, plot romantikë dhe entuziazëm. Universitari me kominoshe, me hekura, me pinca, me kazëm, me shat, me kosë, me kultivator, me leva e me çelësa nëpër duar, dhe me teser partie në xhep. Zotërues punësh të popullit dhe **UDHËHEQËS I POPULLIT**. **KOMUNISTI ME UNIVERSITET, QË, NË SHPËRNDARJEN E TË MIRAVET MATERIALE MERR PJESË SI ÇDO PUNËTOR TJETËR, NDËRSA AFTËSITË E TIJA MENDORE I VË PLOTËSISHT NË SHËRBIM TË SHOQËRISË NJERËZORE, ME MODESTI E ME THJESHTËSI, JA CILI ËSHTË NJERIU I**

KOMUNIZMIT. Ai lloj njeriu fillon të shfaqet me vendosjen e një rregulle të re në një statut partie, punon e lufton me këmbëngulje kundër konceptevet e paragjykimevet të llojllojshëm, në vetëvete dhe retherrotull, në mikroambient, në shkallë shteti e në shallë botërore, ndihmohet e përkrahet nga partia e tij, nga brezi që po i dorëzon "***stafetën***", nga klasa ku e ka rrënjën, dhe i shton radhët me të njëjtë e me të ngjashëm me vetëveten. Pas 40 a 50 vjetësh e ndoshta më parë, e gjithë partia përbëhet prej njerëzish të tillë. Në të njëjtën kohë, edhe shkalla kulturore e masës së popullit është ngritur thuajse në të njëjtin nivel. Dhe, më në fund, krejt natyrshëm, në një sfond botëror më të volitshëm, vjen vetë **KOMUNIZMI**, ëndrra e klasës punëtore dhe realisht e mbarë njerëzimit. (f.100, 1982)

Klos, 1975-1982. **Gjokë Dabaj.**

{Ky ishte libri, këto ishin idetë, realiteti ishte i atillë që asgjë prej këtyre nuk mund të vihej në jetë. Brenda këtyre ideve kishte edhe mendime të gabuar (Do t'i parashtroj pak më vonë.), por, sidoqoftë, mesazhi ishte ky: "***DONI TË BËNI KOMUNIZËM?! KOMUNIZMI NUK BËHET NDRYSHE.***" 2012}

TË RIPAROHET SHKAKU

{Kjo rrugë, të cilën unë e pata parashtruar në atë libër, ishte pa dyshim rruga e vetme, e cila do të mund ta shpëtonte sistemin komunist. Jo në shkallë Shqipërie, as në shkallë Bashkimi Sovjetik, por në shkallë botërore. Mirëpo, komunistët **PËRTUAN!** Komunistët **PËRTUAN** ta çojnë më tutje revolucionin e vet, i cili u kish kushtuar aq shtrenjtë, me dëshmorë, me burgje, me privacione dhe me masakra. U kish kushtuar vërtet shtrenjtë! Le të lexohet **HISTORIA**! Jo **S H P I F Ë R I A**, por **HISTORIA**, nga Komuna e Parisit e këndej!

Të krishterët, për 300 vjet i kishin predikuar idetë e veta **NËPËR KATAKOMBE**. Ideali i tyre ishte: ***Të gjithë njerëzit të barabartë përpara Gjyqit të Zotit!*** U përpoqën, me përkushtim dhe me sakrifica të panumërueshme, 300 vjet,

dhe **NUK PËRTUAN** të vuanin e të binin theror brez pas brezi për atë ide.

Komunistët patën si ideal themelor: ***Të gjithë njerëzit të barabartë para Gjyqit Njerëzor!*** Por nuk i qëndruan kësaj ideje. Nuk e bënë dot këtë ide ideal të brezavet. Madje nuk e çuan dot shpirtin e sakrificës as deri te brezi i dytë. Shkaku, pa dyshim, qëndron te fakti që komunistët deshën të marrin pushtetin para se të krijonin institucionet e vet **IDEOLOGJIKË,** "**KISHAT" E VETA**. Nëse më parë do t'i kishin krijuar "**KISHAT" E VETA** dhe nëse do t'i kishin predikuar idetë e veta në ato "**KISHA"**, jo për disa dekada, por për nja 10 breza, dmth për nja 300 vjet, natyrisht, edhe duke i modifikuar ato ide, psh idenë mbi shpronësimet etj, atëherë edhe mund të shpresohej që ato ide, ***mbi barazinë reale të njerëzvet para Ligjevet Njerëzorë***, të kishin triumfuar.

Tani s'mbetet tjetër, veçse **të ulen njerëzit, ata njerëz që janë të kthjellët mendërisht, dhe të kërkojnë një rrugë të atillë që do të transmetohej brez pas brezi dhe që më në fund do të arrinte të bënte, në të mirë të njerëzimit, atë që duhet bërë**. Përndryshe, **KATASTROFAT JANË DUKE ARDHUR MË TË LLAHTARSHME SE KURRË MË PARË**. 2012}

KËSHTU NUK BËN

Thelbi domethënës i librit tim ishte ky: **Kështu nuk bën**. Komunizmi është i mirë si ide, me përmasa epokale, por edhe si veprimtari revolucionare, gjithashtu me përmasa globale dhe epokale, por ai nuk mund të funksionojë, gjatë dhe qëndrueshëm, në formën siç është projektuar dhe me mënyrat që janë praktikuar gjer më tani. O duhet gjetur një mënyrë efikase, afatgjatë e rezultative, pra, të modifikohet, së pari në teori e pastaj në praktikë, ose të hiqet dorë prej tij.

Nuk isha unë as i pari, as i vetmi, që e shfaqja këtë mendim. Në gjysmën e dytë të shekullit XX, por edhe në gjysmën e parë, nuk është folur në botë për gjë tjetër më shumë se për

komunizmin. Në të gjithë botën, por sidomos në vendet ku diktatura e quajtur e proletariatit tashmë ishte vendosur. Në çdo kolektiv pune, në çdo mininjësi ekonomike, në mos çdo ditë a çdo mbrëmje, të paktën 1 herë në javë bëhej mbledhje. Kryesitë e ndërmarrjevet dhe të entevet bënin mbledhje, organizatat e rinisë bënin mbledhje, organizatat e tjera të quajtura të masavet, organizatat e gruas, organizatat profesionale, organizatat-bazë të partivet komuniste, organet partiakë e shtetërorë në qendrat administrative, në rrethe, në komuna, në rajone, deri në organet qendrorë të shtetevet. Në që të gjitha këto mbledhje, biseda e komente, temë kryesore, në mos e vetmja temë, ishte: **TË FUNKSIONUARIT APO TË MOSFUNKSIONUARIT E SISTEMIT SHOQËRORO-SHTETËROR KOMUNIST.** Dëshira ish, për të funksionuar, rezultati s'ish ai që dëshirohej.

Përfytyroni një të këtillë territor, që nga Kamçatka, në kufi me Japoninë, deri në Llubjanë të Sllovenisë, në kufi me Austrinë dhe me Italinë, dhe që nga Inkursku deri në Hanoj. Në gjithë atë hapësirë mund të bëheshin 5 milionë mbledhje në ditë. Në 10 ditë, 50 milionë mbledhje. Në 1 vit, 1 miliardë e gjysmë mbledhje. Në 50 vjet, 75 miliardë mbledhje e 3 apo 5-fish më shumë artikuj, biseda. Është thjeshtë një llogari e hamendur me përafërsi, në mënyrë që të mund të krijohet përfytyrimi sa është diskutuar, në shkallë botërore, për problemet që shtronte komunizmi në gjysmën e dytë të shekullit XX: ***"PËR KËTË TË URUAR KOMUNIZËM"***, siç do të thoshte një shkrimtar shqiptar, Dritëro Agolli. Rezymeja e që të gjithë atyre debateve të pafund ka qenë kjo: Qëllimi ynë, i udhëheqësvet të klasës punëtore e fshatarësisë, i njerëzve që e shikonin dhe e gjykonin rëndë kapitalizmin, është: ***TA VËMË NË JETË VIZIONIN E VIZIONARËVET GJIGANTË TË NJË BOTE TË RE***. Ta vëmë në jetë, por, kështu si po vepron ti (ose: kështu si po veprojmë ne), **NUK SHKON**. Kështu **NUK ËSHTË MIRË**!

75 miliardë herë është përsëritur kjo thënie, në 75 miliardë mbledhjet që janë bërë në vendet komunistë në gjysmën e dytë të shekullit XX, është thënë, për një ose për një tjetër person

apo veprim: **KËSHTU NUK BËN**! Dikush kritikohej rëndë, dikush ndëshkohej. Një pjesë, ata më ekstremët, të cilët thoshin: ***"KËSHTU NUK BËN"*** dhe donin ta kthenin sistemin shtetëroro-shoqëror nga kishte ardhur, edhe burgoseshin. Atje ku diktatura ishte më e rreptë, disa, pasi gjykoheshin, dënoheshin edhe me vdekje. Nuk mund të përfytyrohet ndryshe një betejë kaq e madhe, për një sistem shoqëror, i cili po kërkonte të konsolidohej dhe nuk po kosolidohej dot.

Për burgosjet dhe pushkatimet, nga këndvështrimi pikërisht i atyre që burgoseshin e pushkatoheshin, një informim nga më të plotët i jepet njerëzimit, siç e dimë tashmë, nëpërmjet librit të bashkëkombësit tim, Atë Zef Pllumit.

Ndërkaq, nga masa e stërmadhe e këtij debati gjigant, e kësaj përplasjeje gjigante, lindën natyrshëm teoricienët dhe artistët. Teoricienët kërkonin rrugë (V.I.Lenini, J.V.Stalini, Mao Ce Duni, Enver Hoxha), shkrimtarët artistë dhe artistët e tjerë, e përjetonin dhe e pasqyronin sistemin në të cilin gjendeshin. **NUK ËSHTË E VËRTETË QË NUK KA PASUR NJË ART TË REALIZMIT SOCIALIST**. Ka ekzistuar një art shumë i madh i të pasqyruarit të atij realiteti. V.Majakovski e tha me të madhe: ***"KËSHTU NUK BËN! KËSHTU NUK BËHET KOMUNIZMI!"*** Por ai nuk e mohoi komunizmin. Ai ishte më i sinqerti ithtar i komunizmit, i cili e dha me një forcë të jashtzakonshme mendimin që i takonte për ta dhënë dhe, më në fund, dha edhe jetën. Të njëjtën gjë tha, në mënyrën e vet, edhe N.Ostrovski. Kush do ta bënte komunizmin?! Një i paralizuar?! Një i verbër, si Pavel Korçagini?! Edhe A.Fadejevi te "***Garda e Re***", s'është tjetër, veçse një përkrahës, por edhe pasqyrues i **MOSSHKUARJES MBARË** të komunizmit në Bashkimin Sovjetik. Komunizmi i Bashkimit Sovjetik dështoi me rastin më të parë të një sulmi ushtarak përballë një kapitalizmi gjerman të egërsuar. U tërhoq ushtria, u evakuua krejt populli, iu la çdo gjë ushtrisë së Hitlerit. E vetmja shpresë mbetën disa të rinj, të përfytyruar prej shkrimtarit si shpëtimtarët e situatës. Shollohovi bëri të njëjtën gjë: **KU PYESTE ASKINJA PËR SOCIALIZËM E PËR KOMUNIZËM**!? Pas këtyre, erdhën shkrimtarë të tjerë, të cilët e thanë edhe më

qartas: ***KËSHTU NUK BËN***! Sollzhenicini, Jevtushenkoja, Pastërnaku, Ahmatova. Në Çeki, V.Haveli. Julius Fuçiku, para Vacllav Havelit, kish uluritur: "***NJERËZ, JINI VIGJILENTË!***" Vacllav Haveli, me gjakftohtësi, kërkoi dhe realizoi restaurimin. Midis teoricienëvet, dallohet edhe Prudoni me mendime të ndryshëm nga radikalët.

Në RPSSH, I.Kadareja i shfaqi idetë e veta mbi komunizmin në një varg veprash. Midis tyre, më e dobëta artistikisht, por më e hapura, më troçja, më e drejtpërdrejta, ishte poema "***PASHALLARËT E KUQ***". Komunizmi në Shqipëri fare lehtë do të mund të kalonte në feudalizëm. (Në Korenë Veriore dhe në Kubë, në fakt, u vendos feudalizmi, duke e kthyer postin e kryetarit të shtetit në fron monarkik të trashëgueshëm, nga babai te djali e nipi, ose nga vëllai më i madh te vëllai më i vogël.) D.Agolli e tha, në stilin e vet, ***"KËSHTU NUK BËN"***, te vepra "***SHKËLQIMI DHE RËNIA E SHOKUT ZYLO***". R.Pulaha krijoi një seri dramash me të njëtën ide: ***"KËSHTU NUK BËN!"*** Koço Kosta, nëpërmjet një alegorie të shkëlqyer, "***GJONI I BARDHË E GJONI I ZI***" (një shpend që është i paracaktuar për të sjellë mbarësi), tregoi se si, në komunizëm, një njeri i mirë ("***GJONI I BARDHË***") mund të kthehet, zhgënjimisht e tragjikisht, në njeri të keq ("***NË GJON TË ZI***"). Në po ata vite u bënë me dhjetëra filma, me temën e ndërtimit të asaj shoqërie, por në të cilët pa pushim dilte në krye ideja zgjidhjekërkuese: "***KËSHTU NUK BËN***!" ***"BISHTI I QENIT MBETET BISHT QENI!"*** Tentuan të thonë të njëjtën gjë edhe Fadil Paçrami, Minush Jeroja, Visar Zhiti.

Mbas dështimit **EDHE INSTITUCIONAL** (shtetëror) të komunizmit, një pjesë e këtyre teoricienëve dhe artistëve dolën me flamurin e ***"VETERANËVET"*** antikomunistë. Mirëpo, nuk mund të mohohet që, as disidenti më i ashpër (përveç atyre që ishin të paracaktuar kundër, dhe ata nuk quhen disidentë), nuk e ka hedhur poshtë **QËLLIMIN E MIRË** të atij sistemi. Disidentët, të quajtur antikomunistë, kanë urryer e stigmatizuar më shumë prishësit e komunizmit se sa ndërtuesit e asaj shoqërie. E gjejmë këtë te "***FATI I NJERIUT***", e gjejmë te "***DOKTOR ZHIVAGOJA***". Kush ua nxinte jetën

heronjvet të këtyre 2 veprave?! Ua nxinin jetën ata që shtireshin si komunistë e që nuk ishin komunistë. Prandaj, kryefjala e më të sinqertëvet të epokës madhështore, titanike, të komunizmit, ishte pikërisht kjo: "***KËSHTU NUK BËN***!"

Po si BËN, pra?! A BËN ky kapitalizëm që njohim ne e që po na e mbush Detin Mesdhe me mijëra kufoma, jo veç të rriturish, por edhe fëmijësh?! Nëse ky kapitalizëm BËN, s'po e lodhim fort mendjen. Po në qoftë se S'BËN as kapitalizmi, atëherë si t'ia bëjmë?! Ku të mbyten popujt, nëse as kapitalizmi aktual s'është ai që duhet?! (2012)

BIRBOKRACIA
NË VEND TË DEMOKRACISË

(Disa dhjetëra faqe, nga 1 milion faqe që mund dhe duhet të shkruhen, për çfarë ndodhi pas restaurimit të kapitalizmit në vendet ish-komunistë.)

1.*"UNË ZOT, TI ZOT, PO GOMARIN KUSH E KULLOT?"*

Nuk ishin të gjithë kundër komunizmit. Përkundrazi, shumica e shtetasvet ishin të vetëdijshëm se socializmi (komunizmi) kish prurë shumë gjëra të mira në jetën e tyre. Aq të mira, sa asnjë rend tjetër nuk do të mund t'ua binte. Njerëzit e dinin që, për të arritur mirëqenien, duheshin bërë sakrifica, duheshin përpjekje, duhej lodhje. Mungesat që haseshin në jetën e përditshme, arsyetoheshin përgjithësisht me 4 shkaqe:

1.Prapambetja e trashëguar (Shqipëria pat trashëguar një prapambetje të tmerrshme nga koha e Pushtimit Osman.).

2.Bllokada ekonomike nga ana e shtetevet kapitalistë dhe atyre që u quajtën revizionistë (Nuk ish bllokadë e sajuar prej propagandës komuniste të këtushme, por ish një bllokadë reale, e vërtetë, e organizuar dhe e zbatuar prej atyre shteteve.)

3.Shpenzimet që bënte shteti për ngritjen e vepravet industriale dhe për forcimin e aftësisë mbrojtëse.

4.Pengesat burokratike dhe ato subjektive, deri te inatet personalë, grupimet kundër njëri-tjetrit, shoqëritë e quajtura ***të sëmura***.

Mirëpo, midis gjithë këtij, të thuash, mirëkuptimi mbi gjendjen e përgjithshme, te secili shtetas vërehej tendenca për t'ia lehtësuar **VETES**, si gjendjen ekonomike, ashtu edhe pozitën shoqërore. Propaganda thoshte (dhe kish të drejtë): ***Atdheu mbi të gjitha***! ***Të punojmë atje ku ka më shumë nevojë Atdheu***! ***Të shkojmë nga qyteti në fshat.! Të ndihmojmë Veriun (***se Veriu ish tradicionalisht më i prapambetur***)! Ta bëjmë stazhin (e Partisë) në veprat e pesëvjeçarëvet***! ***Të jetojmë gju më gju me popullin***! Por, kur vinte puna, **askush nuk e linte Tiranën me dëshirë**. Të gjithë donin të punësoheshin në Tiranë. Nëse nuk arrinin të vendoseshin në Tiranë, kërkonin të rrinin në qendrat e rrethevet, në qytete, jo në fshatra. Mbetej pa martuar djali kryeqytetas, nëse rrinte (me emërim) disa vjet në ndonjë „***provincë***". Vajza edhe më keq. Thinjej e nuk martohej, jo se s'kish djem në vendin ku ajo shërbente, por sepse nuk donte të mbetej "***përjetësisht***" në zona të thella. Ik! Ik! Ik! Largohu prej vështirësivet dhe kërko "***qoshe sa më të rehatshme***"! Kush ish familje dëshmori, e vinte fort në dukje sakrificën që kish bërë ajo familje "***për këtë ditë***". Kush s'kish në familje një dëshmor apo një veteran lufte, e kërkonte në farefis një të tillë, në mënyrë që „***biografia***" t'ia siguronte punën e privilegjuar. Ai që s'kish ku ta merrte dëshmorin, për t'u kapur pas gjakut të tij të derdhur për liri, mundohej t'u mbushte mendjen nëpunësvet punadministrues që familja e tij, vërtet s'ka derdhur gjak, por "***e ka ndihmuar***" Ushtrinë Nacionalçlirimtare.

Kur është fjala për dëshmorët, nuk po mund të mos shënoj edhe një të këtillë **TURP TË PAGËLLTITSHËM**: Krejt familja me ditë të tëra ish munduar t'ia mbushë mendjen djalit për të mos shkuar në luftë. Natë për natë kish kërcitur sherri: "***Po na merr më qafë! Do të na e djegin shtëpinë gjermanët dhe ballistët***!" Më në fund, ditën kur djali ish nisur për në luftë, **E ËMA** e kish përcjellë me të këtillë "***urime***": "***Shkofsh e mos u kthefsh, or bir***!" Kurse në vitet e Mbasluftës, mbasi djali vërtet nuk ishte kthyer, ***E ËMA*** s'kish pasë turp të endej zyrë më zyrë, për të kërkuar **PENSION,** si **NËNË DËSHMORI**, dhe për të siguruar privilegje mbas privilegjesh, si familje dëshmorësh. Djali i vëllait të një të atillë **NËNE** "***atdhedashëse***" arrinte të bëhej edhe anëtar i KQ të PPSH-së, duke rrahur gjoksin se si, kushëriri i tij,

djali i hallës, ishte konsakruar në altarin e lirisë. **RROFTË LIRIA QË NA E PRUNË TË TJERËT! NE, QË S'BËMË SAKRIFICA, NE QË I MALLKONIM ATA QË NISESHIN PËR NË LUFTË, "MERITOJMË" TË QEVERISIM!**

Erdhi kështu një kohë kur që të gjithë "***u rehatuan***", me përjashtim të atyre që ishin "***me damkë***". Por edhe ata, përveç "***damkës***", pak gjëra i dallonin prej të tjerëvet. Mirëpo, kur "***të rehatoheshin***" të gjithë, dmth kur të gjithë ta merrnin atë "***copë rrogë***", sado të vogël, **pa punuar** ose duke punuar fare pak, **PUNËT** që ishin për t'u bërë, **KUSH DO T'I BËNTE**? Është një thënie e vjetër popullore te ne shqiptarët: "***Unë zot, ti zot, po gomarin kush e kullot***?" **Askush**! **Gomari le të ngordhë**!. Në këtë rast, gomari ishte Atdheu! Me një të tillë të kuptuar të sistemit të ri shoqëror, shoqëria socialiste s'kish si të mos shndërrohej në një komunitet të ngjashëm me atë të Sodomës dhe Gomorrës.

2.SODOMASIT DHE GOMORRASIT NË SKENËN E SHEKULLIT XX

Projekti im edhe mund të kish funksionuar, sikur **NJERIU** të kish pasë ndryshuar sadopak nga ai i Sodomës dhe Gomorrës së dikurshme. Me projektin tim, **NJERIUT**, nga njëra anë, i ofrohej **vërtet PUNË MË E RËNDË, por edhe PUSHTET**, nga ana tjetër, **PUNË MË E LEHTË, por PA PUSHTET**. **Intelektuali që donte pushtet, duhej të pranonte kushte më të vështirë pune, intelektuali që kërkonte ta fitojë bukën me laps, duhej të hiqte dorë nga pushteti**. Mirëpo, sodomasit dhe gomorrasit i duan të 2-ja: **EDHE PUSHTETIN, EDHE MOSPUNËN**. Madje ata, pasi ta kenë fituar pushtetin, pasi të kenë arritur ta kenë një punë sa për formë, ku mund të merret një rrogë vetëm duke figuruar në listën e pagesavet, kërkojnë të marrin para më tepër se ata që punojnë. Kërkojnë para, por kërkojnë edhe qejfe. **JETË DITE**, matine, por edhe **JETË NATE,** suare. Kërkojnë **SEKS** më tepër nga ç'mund t'u japë jeta bashkëshortore. Pastaj prapë **SEKS**, pastaj **SEKS** përsëri. Të zhveshur lakuriq në ambiente të mbyllur, pastaj të zhveshur lakuriq edhe në ambiente të hapur. Kërkojnë veshje tjetër, 3 kostume, pastaj 7 kostume, pastaj 30 kostume dhe prapë të mos u mjaftojnë. Kërkojnë banim më luksoz, pastaj edhe më luksoz. Muzikë "***të fortë***", pastaj "***edhe më***" "***të fortë***". Pije cilësore dhe të bollshme, pastaj "***edhe më***" "***cilësore***", deri atje ku s'mban më, **DERI TE DROGA**. Seksi, mashkull me femër, nuk mjafton më, tani duhet edhe seksi femër me femër e mashkull me

mashkull. Njeriu duhet të ketë veturë personale. Pastaj duhet të ketë veturë "***fantastike***", pastaj "***edhe më***" "***fantastike***". Njeriu i Sodomës dhe i Gomorrës i do pushimet në ndonjë plazh të afërm, por pastaj as kjo nuk i mjafton: Ai i do pushimet jashtë shtetit. Por edhe jashtë shtetit s'e kënaqin pushimet "***dosido***". **A IA JEP DOT KOMUNIZMI NJERIUT TË SODOMËS DHE TË GOMORRËS TË GJITHA KËTO?!** Komunizmi, jo vetëm që nuk ia jep njeriut të Sodomës dhe të Gomorrës të gjitha këto, por edhe ia **NDALON**. Durohet një regjim i tillë?! Vetëkuptohet që një i tillë regjim, një i tillë komunizëm "***NUK DUROHET***". Të parët që e shprehin këtë mosdurim, janë bijtë e udhëheqësvet. Ata mblidhen dhe filozofojnë në cepat e shtëpivet. I transmetojnë njëri-tjetrit njohuritë mbi "***BOTËN E JASHTME***", ia shtojnë njeri-tjetrit mosdurimin, fryhen nga inati, duan të çlirohen nga "***skllavëria***". "***Skllavëri***", e cila e mbështet filozofinë e jetës **TE PUNA**. Mirëpo, çunat dhe gocat e "***BLLOKUT***" nuk duan **PUNË**. Për ata, kanë punuar baballarët. Ideja përhapet jashtë "***Bllokut***", shkon te studentët, shtrihet në rrethe, në "***MINIBLLOQET***", rreth djemvet dhe vajzavet të Sekretarit të Parë, të Kryetarit të Komitetit, deri te biri i mësueses dhe biri i doktorit... Dhe vjen ashtu "***revolta popullore***" kundër "***tiranisë***" komuniste.

3.FRAGMENT NGA BIBLA

(Abrahami) iu afrua (Zotit) dhe (i) tha: "***Vërtet se bashkë me fajtorin do të zhdukësh edhe të drejtin? Nëse në qytet do të jenë rastësisht 50 të drejtë, vërtet do ta zhdukësh atë vend dhe nuk do ta falësh për shkak të atyre 50 të drejtëvet që do të jenë në të? Larg qofë prej teje, që ta zhdukësh të drejtin bashkë me të mbrapshtin! A do t'i bësh baraz të drejtin me fajtorin? Larg teje! A thua gjykatësi i mbarë botës nuk do ta shtjerë në veprim drejtësinë***?"

Zoti iu përgjegj: "***Nëse do t'i gjej në Sodomë 50 të drejtë, brenda në qytet, për hir të tyre, do ta fal krejt qytetin***."

Abrahami e mori përsëri fjalën: "***Ja, unë po marr guxim të flas me Zotin tim, unë që jam hi e pluhur: Po e zëmë se ndër ata 50 të drejtë, do të jenë 5 më pak. A thua se për shkak të atyre 5-ve do ta zhdukësh tërë qytetin***?" (Zoti) i tha: "***Nuk do ta zhduk nëse i gjej 45 të drejtë***."

Abrahami s'u durua e i tha: "***Po qe se atje do të jenë vetëm 40***?" Hyji u përgjigj: "***Nuk do ta ndëshkoj*** (qytetin) ***për hir të atyre 40-vet***."

(Abrahami) përsëri tha: "***Nuk më hidhërohet Zoti im nëse flas: E, po qe se atje janë vetëm 30***?" "***Ja, prapë po marr guxim***", tha "***të flas me Zotin tim: Po nëse ndoshta atje do të jenë vetëm 20***?" Hyji i tha: "***Nuk do ta zhduk për hir të atyre 20-vet.***" "***Po të lutem***," vazhdoi (Abrahami), "***Zoti im nuk do të më hidhërohet, nëse flas vetëm edhe njëherë: Po qe se atje janë ndoshta vetëm 10***?" Zoti tha: "***Unë nuk do ta zhbij*** (qytetin) ***për hir të atyre 10-vet.***" (***Bib.*** Ferizaj 1984, f.37-38)

Mirëpo, as sodomasit, as gomorrasit, nuk e merituan mëshirën e Zotit.
Citoj prapë ***Biblën***: "***Atëherë Zoti lëshoi mbi Sodomën e Gomorrën, në formë shiu, sulfur e zjarr. Ata binin prej Zotit, prej qiellit. I zhbiu ata qytete dhe tërë krahinën përreth, të gjithë banorët e qytetevet dhe tërë bimësinë mbi tokë.***" (***Bib.***, f.39)

Simbolika këtu nuk ka vlerë vetëm për sistemin **SOCIALISTO-KOMUNIST**, i cili, siç u pa, **DËSHTOI** në fundin e shekullit XX (sepse njerëzit filluan të sodomizohen dhe të gomorrizohen), por ka vlerë edhe për sistemin **KAPITALIST**. **Squfuri e zjarri, që bien në formë shiu, s'duhet të kuptohen ndryshe nga njeriu i sotshëm, veçse si "SHIRA" SHPËRTHIMESH TË BOMBAVET ATOMIKE DHE TË CENTRALEVET ATOMIKË**.

4.PRONA, MË I VËSHTIRËRREGULLUESHMI HANDIKAP GJITHNJERËZOR

Pronë quhet pasuria që i përket dikujt. Nisur nga ky përkufizim, pronën mund ta kemi: Private personale, private grupore, shtetërore, kombëtare, fetare, racore dhe gjithnjerëzore.

Me **pronë private personale** do të kuptojmë çdo pasuri që e ka një vetje, një person, dhe që përgjithësisht mund ta përdorë si ta shohë ai të arsyeshme. Themi përgjithësisht, sepse, në thelbin e vet, **ASNJË PRONË, ASNJË PASURI, NUK MUND TË JETË APSOLUTISHT E 1 PERSONI TË VETËM.** Madje, puna arrin deri atje, sa edhe vetëvetja, që mund të mendohet se është tërësisht pronë e vetëvetes, nuk do nënkuptuar si e tillë, pasi normalisht asnjë person nuk mund ta përdorë veten si të dojë vetë. Sidoqoftë, ora, unaza, çorapet, janë deri diku pronë personale.

Me **pronë private grupore** kuptojmë çdo pasuri që e ka një grup njerëzish [çift bashkëshortor, familje, vëllazëri, fshat, shoqatë, institucion

(kulturor, arsimor, shkencor etj), kompani, korporatë, trust, kartel] dhe që grupi zotërues i asaj pasurie e përdor atë sipas rregullavet të caktuara prej vetë atij. Natyrisht, në përputhje edhe me rregullat shtetërore e gjithnjerëzore.

Me **pronë shtetërore** kuptojmë ato pasuri, të cilat i ka një shtet dhe që i përdor sipas rregullave e kërkesave që i vendos ai vetë në përputhje, **TË HARMONISHME OSE JO**, me interesat e krejt shtetasvet të vet, por edhe në përputhje, të harmonishme ose jo, me interest e shtetevet të tjerë. Marrë në kuptimin më të mirëfilltë, edhe prona shtetërore është pronë grupi.

Me **pronë kombëtarre** kuptojmë ato pasuri, të cilat i takojnë një kombi dhe që duhet të përdoren sipas interesavet të atij kombi. Edhe kjo formë prone, në kuptimin e saj më të mirëfilltë, është një pronë grupi. Prona kombëtare (psh gjuha, etnokultura, tradita historike, veprat e artit, monedha), është pronë grupi, por nuk është ekuivalente me pronën shtetërore.

Me **pronë fetare**, **pronë të religjionevet dhe besimevet**, kuptojmë doktrinat, perenditë, idhujt, shenjtët, përfytyrimet, ritet, librat, objektet e kultit, veshjet e veçanta, muzikën etj. që ithtarët e një feje, një religjioni apo një besimi i kanë krijuar dhe i përdorin në përputhje me rregullat dhe traditën e vet. Edhe ky lloj prone është pronë grupi apo pronë grupesh.

Me **pronë racore** kuptojmë çdo gjë që i takon një race njerëzore, qoftë ajo dhunti natyre, si ngjyra, tiparet truporë etj, qoftë pasuri kulturore (gjuhë, grupe gjuhësh, rite, folklor, lloje sportesh, mënyra të të ushqyerit, etikë, moral etj etj) që njerëzit e një race, i vlerësojnë, i praktikojnë, i përdorin dhe i ruajnë sipas traditavet përkatëse. Edhe prona racore është pronë grupi, e cila dallohet: edhe prej pronës shtetërore, edhe prej pronës kombëtare, edhe prej pronës fetare.

Me **pronë gjithnjerëzore** kuptojmë çdo pasuri që i takon gjithë njerëzimit dhe që përdoret sipas rregullavet të caktuara, **NË INTERES OSE JO**, të njerëzimit. Marrë në kuptimin më të mirëfilltë, çdo lloj pasurie që ekziston në sipërfaqen e këtij planeti, brenda këtij planeti dhe rrotull këtij planeti, është pasuri gjithnjerëzore. Në këtë kuptim, edhe **vetë njeriu** dhe çdo gjë që ka njeriu, edhe grupet njerëzorë dhe çdo gjë që kanë ata grupe njerëzorë, janë **pronë e krejt njerëzimit**. **PRONË E KREJT NJERËZIMIT** janë, midis këtyre që përmenda, edhe **ajri, uji, flora, fauna, pjesët e forta të planetit tonë**, si dhe çdo gjë, e mirë ose jo aq e mirë, që e ka krijuar njerëzimi (**qytetet, kapacitetet prodhues, paraja, gjuhët, artet, mjetet e komunikimit, profesionet, industritë, ligjet, institucionet,**

armët, shkencat, dijet, sistemi arsimor, sistemi mjekësor, trtegtia, morali).

Disa lloje të pronës apo disa foma të sajat, fillojnë te individi, janë të individit, por, në varësi prej përdorimit, ato bëhen të grupit ose të krejt njerëzimit: aftësitë mendore, aftësitë fizike, talenti, zëri, gjenialiteti, vepra e artit apo çfarëdo vepre tjetër, prodhimi, sendi, shtëpia, vendbanimi, fjala, propaganda, bindjet. Të gjitha këto njeriu i ka vetë, janë pronë e tija, por, në varësi nga mënyra e të përdorurit dhe vlera që kanë, kalojnë te individët apo grupet e tjerë njerëzorë dhe bëhen pronë edhe e atyre. Tragjedinë "***Hamleti***" e ka krijuar Shekspiri, ka qenë pronë e tija, por ajo tani është edhe pronë e imja. Bashkëshortja është prone e vetëvetes, por është edhe e burit, ashtu si burri që është edhe pronë e gruas.

Edhe politika është një formë prone, edhe pozita shtetërore, posti qeveritar, nëpunësia, por edhe llojet e profesionevet deri te punët fare të thjeshta. Në të gjithë rastet ekzistojnë të paktën 2 palë dhe kjo dëshmon që **PRONA S'ËSHTË KURRË VETJAKE, INDIVIDUALE.**

Madje as tingujt e violinës nuk janë pronë vetëm e atija që i ekzekuton, pasi, edhe në mos i dëgjoftë askush, ai, duke u kënaqur momentalisht vetë, mendon sa do të kënaqet me ta dikush tjetër, kur t'i dëgjojë. Dmth, në finale, ata tinguj do t'i dëgjojë një publik dhe do të **paguajë** për ta, në një mënyrë apo në një tjretër mënyrë. Kushdo që thotë: "***Kjo pronë është e imja dhe e askujt tjetër"***, mashtron gjithë ditën veten dhe të tjerët, duke ngatërruar konceptin e nxjerrjes në treg të një prone dhe vetë pronës.

Paraja përbën një lloj prone krejt të veçantë. Ajo është krijim grupor, por duket sikur i shërben vetëm individit. Në të vërtetë, as që mund të mendohet që paraja është pronë e individit, sepse s'është veçse mjet shkëmbimi, ku marrin pjesë, e pakta 2 dhe e shumta disa milionë njerëz.

Në të gjitha kohët njeriu-individ, filluar që nga familja (burrë-grua, grua-burrë, prind-fëmijë, fëmijë-prind, vëlla-vëlla) e deri te korporata apo shteti, kur s'ka qenë udhëhequr nga një **MORAL POZITIV** apo kur s'ka qenë e detyruar nga një **LEGJISLACION** i caktuar, është munduar që pasuritë, sipas llojevet, ose **T'I KETË PËR VETE,** ose **T'UA IMPONOJË TË TJERËVET**. (Paratë do t'i ketë për vete, bindjet do t'ua imponojë të tjerëvet). I forti i tribusë ua ka marrë fillimisht pjesëtarëvet të tribusë gjahun dhe prodhimet bujqësorë, pastaj e ka çuar tribunë në luftë, për t'u rrëmbyer

pasuritë edhe të tjerëvet. I ka zënë rob edhe vetë njerëzit dhe kështu ka lindur skllavopronaria (edhe njeriu është bërë pronë e një njeriu tjetër.)

Në rrjedhë të kohëvet, format e përvetësimit të pasurivet kanë ndryshuar, por thelbi ka mbetur po ai: **Individi (pa moral pozitiv dhe i padetyruar nga ligjet) dëshiron dhe përpiqet t'i ketë të gjitha PËR VETE dhe t'u imponojë të tjerëvet çdo gjë që ai e quan "*të arsyeshme*"**. Kur e sheh që s'ka mundësi, ai, **dinakërisht**, bën aleancë me individë të tjerë, krijon grupe, nxjerr rregulla, por gjithsesi për të marrë për vete ç't'i pëlqejë dhe për t'u imponuar të tjerëve ç't'i duket atij "***e mirë dhe e arsyeshme***". **Kjo është NATYRA KAFSHËRORE E NJERIUT. Është, pra, ana kafshërore e tij.**

Me qëllim që të mund të frenohet një e këtillë natyrë **KAFSHËRORE** e njeriut, e individit ose e grupevet të individëvet, **njerëzimi** ka krijuar **MORALIN dhe LIGJET**. Rregullat e moralit njerëzor (moralit pozitiv, sepse ka edhe "***moral***" negativ), në të gjitha kohët, u janë kundërvënë cilësivet **KAFSHËRORE**, që qenia njerëzore i bart me vete që nga zanafillat e veta evolucionale. Janë shpikur idetë filozofike, janë shpikur religjionet, frikësimi me perendi, frikësimi me ferr e me xhehnem, janë përdorur forma nga më të larmishmet të propagandës humaniste, njerimbrojtëse e natyrëmbrojtëse, janë shkruar me mijëra vepra arti, për ta dënuar këtë trashëgimi të mbrapshtë **KAFSHËRORE**. Pjesa e dëmtuar i është kundërvënë pjesës dëmtuese, pjesës gllabëruese, pjesës negativisht imponuese. Luftërat i kanë origjinën dhe shkaqet pikërisht te kjo tendencë për të gllabëruar pasuritë e të tjerëvet dhe për t'u imponuar negativisht të tjerëvet vullnetin e vet.

KOMUNIZMI qe një rend shoqëror, i cili **U MUNDUA** t'i japë fund kësaj tendence vetëshkatërruese të njeriut, por, **PËR SHKAK TË GABIMEVET NË DOKTRINË, NË STRATEGJI DHE NË TAKTIKË, NUK IA DOLI DOT**. Megjithkëtë, kjo kurrsesi nuk do të thotë që komunizmi nuk i dha njerëzimit asgjë pozitive. Përkundrazi, nëse njerëzimi nuk do t'i pohojë dhe përdorë përvojat pozitive të komunizmit, do të gabojë rëndë.

Do thënë shkurt e qartë: **KOMUNIZMI ËSHTË URREJTUR VETËM PËR SHKAK TË QËNDRIMIT TË TIJ NDAJ PRONËS.**

5.PRONA NË KOMUNIZËM

KOMUNIZMI E SHPALLI PRONËN PRIVATE, përfshirë aty personalen, familjaren dhe gruporen (kompanioren etj), si **BURIMIN E TË GJITHA TË KËQIAVE SOCIALE**. (Unë i kam besuar kësaj teorie pa asnjë rezervë.) Me ta marrë pushtetin, komunistët iu vunë punëvet për ta çliruar popullin "***prej kësaj së keqeje shumë të madhe***". U shpronësuan kapitalistët (edhe feudalët, atje ku kishte), shtresa e mesme e pronarëvet gjithashtu u shpronësua, por pak më vonë. Në këtë mënyrë, në shumicën e vendevet me regjim komunist, prona, si formë e zotërimit të pasurisë, përfundoi në **pronë shtetërore** dhe, siç thuhej, përkohësisht ose tranzit, **pronë kooperativiste**. Pronë personale mbetën (u quajtën): shtëpitë, orenditë shtëpiake, veshjet, sendet e pëdorimit vetjak, biçikletat, kuajt, librat, stolitë. Mbetën, gjithashtu, pronë personale, pra pronë private (aq sa mund të ishin), edhe **PARATË** që merreshin në formë rroge.

Në të gjitha etapat e një të këtillë procesi, që u quajt ***proces historik, epokal***, dolën shumë probleme. Nuk ish puna se po mbetej masa e popullit pa pronë. Në gjithë botën kapitaliste ka me qindra milionë njerëz (madje ndoshta i kalojnë edhe miliardat), të cilët **nuk kanë ASGJË**, veç trupit të vet, ose që kanë diçka, por që nuk u hyn fare në punë. Nuk ish as problemi te vënia në jetë e operacionevet të shpronësimit, sepse diktatura arrin t'ua imponojë shtetasvet të vet vullnetin e vet me mjetet e diktaturës. Problemi qëndronte te fakti se, si rregull, **në një shtet komunist askush nuk duhej as të synonte për të pasur pronë më shumë se ç'u tha pak më sipër**. Këtu qëndronte

problemi: **Iu prish individit ËNDRRA për të vënë pasuri**. ËNDRRA!

Mundësia në formë dëshire, të cilën, megjithatë, numri më i madh i individëvet nuk do ta realizonin dot kurrë.

Në shumë raste, vetë ata që ishin udhëhequr nga kjo teori, nga **teoria e heqjes dorë prej pronës private**, kur erdhën në pushtet, nuk i qëndruan dot tundimit. Kështu psh Titoja, për shkak të "***meritavet të mëdha***", i kish të vetat DISA vila (në Dedinje të Beogradit, në ishujt Brione, në Zagorje…), kish anijen "***Galeb***", kish trenin e vet të quajtur "***Treni i Kaltër***", kish madje

edhe një **lopë** personale, që e merrte me vete ngado që shkonte. Vetë Jovanka, e shoqja e Titos, kish një jaht të mrekullueshëm.

Askush nga njerëzit që kishte merita lufte nuk pajtohej me parimin për të qenë i barabartë në pasuri me ata që s'i kishin dhënë asgjë revolucionit ose që edhe mund të kishin qenë kundër. I vetmi duket se ish **Enver Hoxha** ai që nuk lejonte lëshime në këtë çështje të madhe parimore të marksizëm-leninizmit. Ai nuk i lejoi pasuri as vetes, as familjes së vet. Megjithatë, disa shtëpi pushimi, gjithsesi duke qenë shtetërore, përdoreshin në mënyrë të privilegjuar vetëm prej udhëheqjes. Kështu, **TË MOSNDJERIT KOMOD PA PRIVILEGJE E PA PRONA, FILLOI TE ATA QË E KISHIN UDHËHEQUR DHE BËRË LUFTËN PIKËRISHT KUNDËR PRIVILEGJEVET DHE PRONËS PRIVATE**. Te bijtë e këtyre, që në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë, u quajtën ***BIJTË E BLLOKUT***, pakënaqësia që prindët e tyre i kishin lënë pa prona, erdhi gjithnjë duke u shtuar. Pakënaqësi, kuptohet, kishin edhe ata që kishin pasur dikur prona, por **PAKËNAQËSI NDJENIN EDHE ATA QË S'KISHIN PASUR KURRË ASGJË**. Ata që s'kishin pasur kurrë asgjë ose që kishin pasur sa për të mbajtur shpirtin gjallë (e që tani merrnin të ardhura mujore 5-fish më shumë se në kohën e carit rus, kralit sërb apo mbretit shqiptar), ishin **SHUMICA** e banorëvet të secilit vend komunist dhe, që të gjithë këta kishin **PRETENDIME**. Për çudi, pikërisht kjo shumicë banorësh në vendet komunistë, nuk pajtohej dot me idenë që **KURR MË NUK DO TË KETË PRONË PRIVATE**. Pyetja shtrohet: **PSE NDODHTE KËSHTU EDHE ME ATA QË DIKUR QUHESHIN PROLETARË APO GATI PROLETARË**? Ndodhte kështu, sepse në shpirtin e njeriut nuk mund të shuhet kurrë dëshira për të pasur diç ***"TË VETËN"***. Mospasja e pronës krijoi një boshllëk në shpirtërat e njerëzvet. Lulet e mollës, **NUK E DINË** që 80% a më shumë e tyre, nuk do të lidhin **KURRË** kokrra, prandaj dhe çelin që të gjitha.

Një dukuri tjetër lidhur me pronën, ishte edhe fakti që, vërtet **NJERIU I KEQ e kish përdorur pronën private PËR KEQ**, **por NJERIU I KEQ po e përdorte edhe PRONËN SHTETËRORE, pra pronën e përbashkët PËR KEQ, madje edhe MË PËR KEQ**.

Shoferi apo traktoristi, apo kombajneri lante duart me naftë si të ishte nafta ujë çesme. E derdhte naftën në tokë, aq sa aty për vite me radhë nuk mbinte më bari.

Kooperativistin e porosiste brigadieri që të hedhë pleh kimik nëpër bimët. Çoheshin thasët me pleh në anë të parcelës. Që andej duhej marrë me kova dhe duhej çuaj pranë çdo bime në sasinë që e kërkonte agroteknika. Vetëkuptohet që nuk ish punë e lehtë. Por punëtori, për t'i rënë "***shkurt***" ***"procedurës agroteknike"***, e derdhte thesin në një kanal dhe i thoshte brigadierit: "***E kreva punën! I kam plehëruar rrënjë për rrënjë***!"

Roja e natës, pranë objektit industrial, digjte tavolinat e karriket që i liheshin për t'i ruajtur. I digjte për zjarr.

Gruri derdhej nëpër magazina, lagej nga pikët e shiut dhe kalbej.

Kashta e silazhuar kalbej nëpër gropat e silazhit, ndërsa në muajin mars, lopët ngordhnin, se s'kish ç't'u jepej.

Në Kiev të Ukrainës rojet i zinte gjumi dhe plaste reaktori bërthamor.

E keqja më madhe ish se as njerëzit e administratës, që ishin caktuar për t'i menaxhuar punët, nuk i kryenin punët sikur prona të ish e tyrja. (Sepse, në të vërtetë, s'ish e tyrja.) Madje, as ata, as të tjerët, nuk e konceptonin dot që ajo pasuri mund të ishte e dikujt. Erdhi ashtu një kohë kur **PRONA SHTETËRORE,** dmth prona e përbashkët, **TRAJTOHEJ SI PRONË E ASKUJT**. Nocioni "***POPULLI PRONAR"*** ishte një nocion tepër abstrakt për t'u vënë praktikisht në jetë.

Të mirat që u sillte njerëzvet komunizmi, rendi socialist, nuk ishin të pakta. Të të bëheshin të gjithë shërbimet shëndetësorë pa pagesë të drejtpërdrejtë, dmth falas, nuk ishte gjë e pakët. Mjekësia në socializëm mori zhvillim të madh dhe u bë vërtetësisht humane. Sëmurej njeriu, shtrohej në spital njeriu, operohej, i viheshin në allçi frakturat, por nuk shkatërrohej ekonomia familjare. Ekonomia familjare mbetej ajo që ishte. Invalidët trajtoheshin me pensione të veçantë. Për sëmundjet profesionale, silikozë etj, jepeshin pensione edhe në moshë të re. Bëheshin vaksinime të rregullt, njerëzvet u rregulloheshin dhëmbët pa kurrfarë pagese. Nënat me shumë fëmijë merrnin shpërblime të veçantë. Lejet e lindjes paguheshin rregullisht në një madhësi relativisht të pranueshme. Kur një i punësuar detyrohej të rrinte në shtëpi për shkak të sëmundjes, qoftë edhe prej një gripi të lehtë, ose kur shtrohej në spital, atij i paguhej rroga në masën 70%. E, praktikisht, që të gjithë shtetasit ishin të punësuar.

Erdhi një kohë kur edhe taksat e tatimet e drejtpërdrejtë u hoqën krejt. Kështu ndodhi në Repupblikën Popullore Socialiste të Shqipërisë. Për Bashkimin Sovjetik, për Republikën Popullore të Kinës e shtete të tjerë ish-socialistë, nuk e di si qëndronte puna e tatimevet, por këtu kjo ishte një ngjarje vërtetë shumë lehtësuese për jetën e krejt popullit. Nuk po hyjmë tani në procedurat se si bëhej taksimi duke mbajtur pagat në nivel të ulët, duke u marrë kooperativavet një pjesë të madhe të prodhimit etj. Kjo gjithsesi do të ndodhte, sepse shteti nuk mund të mbahet ndryshe. Por heqja e taksimit dhe e tatimimit të drejtpërdrejtë ia lehtësonte shumë telashet familjes. Familja e dinte që, ato para që merrte, ishin 100% të sajat. Të drejtën për t'u mjekuar falas e kishin të gjithë shtetasit, përfshirë aty edhe të quajturit "***të deklasuar***".

Një e mirë tjetër që masavet të popullit u dha mundësi të pajiseshin me dituritë bazë, ishte edhe **ARSIMIMI FALAS** për të gjithë. Nuk mund të vihet në dyshim që arsimimi falas i të gjithë shtetasvet ka qenë një ndër të mirat më të dukshme të atij sistemi. 8 vjet shkollë ish i detyruar t'i bënte secili fëmijë e kjo do të thotë që arsimi fillor u arrit të realizohet 100%. 12 vjet shkollë mund t'i bënte kushdo që dëshirote dhe kushdo që i kish mudësitë familjare apo të largësisë nga shkolla më e afërt. Vetëm shkollimi i lartë bëhej me një lloj seleksionimi, jo vetëm në pikëpamje të cilësisë, por edhe në aspektin, të quajtur „***biografik***" apo „***politik***".

Të gjitha këto nuk mund të konsiderohen të mira të pakta, të cilat deri atëherë vetëm rendi socialist (komunist) ua kish sjellë popujvet. Themi ***deri atëherë***, sepse në ata vite edhe në vendet kapitalistë, sidomos në disa prej tyre, me regjim më të përparuar, u arrit që vështirësitë sociale të masavet të popullit të pakësoheshin.

Mirëpo, me gjithë këto të mira që nuk mund të mohohen, rendi socialist, në vendet ku ai kish triumfuar, po degradote dukshëm.

Është për t'u vënë re, jo kalimthi, por themelisht, një dukuri tepër e rëndësishme: **PJESA MË PUNËTORE E POPULLSISË, NJERËZIT E PRIRUR PËR TË PUNUAR SHUMË, QOFTË SHTETAS TË THJESHTË, QOFTË INTELEKTUALË, FILLUAN TA NDIEJNË VETEN TË DISKRIMINUAR.** Ata punonin me gjithë shpirt, kishin talent dhe e shkrinin talentin në të mirë të atdheut e të socializmit, siç thuhej, por, në fund të fundit, **ASKUSH NUK UA DINTE PËR NDER**. Jepeshin disa **STIMUJ MORALË**, por ata, sado që e nderonin personin, praktikisht ishin

tepër të pamjaftueshëm. Erdhi një kohë kur ata stimuj dukeshin si qesharakë ose edhe më keq, ofendues ndaj njeriut që i shkrinte të gjitha energjitë për të mirën e përgjithshme. Ndërkohë, një masë e madhe **PARAZITËSH** ose **GJYSMËPARAZITËSH** bënin jetën e tyre, shkëlqenin nga shëndeti, u dilte koha për të pushuar, për të luajtur e për t'u argëtuar. Përse duhej që një pjesë të lodheshin e një pjesë të mos lodheshin fare?! Sigurisht që edhe ky ka qenë **NJË NDËR FAKTORËT QË KOMUNIZMI DËSHTOI** në gjysmën e dytë të shekullit XX, në një kohë kur ai, nëse ish për të triumfuar, i kish që të gjitha mundësitë që të triumfonte.

Ishin të gjitha mundësitë për t'u rritur mirëqenia e njerëzvet, megjithatë, në vend të mirëqenies, **ERDHI VARFËRIA (RELATIVE!)**. Erdhi varfëria relative personale, relative familjare dhe ajo relative shtetërore. Ushqimi nuk ishte i atillë, siç duhej të ishte. Në mbrëmje, poshtë dritarevet të pallatevet, vinte erë specash të skuqur dhe era gjizë. Një nuse apo një grua meraklie e kësaj kohe, nuk kish mundësi të blinte, dhe ta kish për dit të shënuara, një kostum krahinor apo kombëtar, në një kohë kur gjyshja e saj i kish pasur ato mundësi. Një intelektual i apasionuar nuk krijonte dot një biliotekë për të qenë, pa dëmtuar ekonominë e familjes. Përse po ndodhte kështu?! Përse po e mbulonte ky lloj varfërie relative shtetin socialist?! Po ndodhte kështu, sepse në rendin socialist (komunist) **PO PAGUHEJ MOSPUNA**. Kishin të drejtë të gjithë të ishin në punë dhe ishin në punë, por **JO TË GJITHË PUNONIN**. Madje, erdhi një kohë kur shumica punonin pak ose fare pak dhe e merrnin pagën, jo për **PUNËN**, por për **MOSPUNËN** e tyre.

DETASHMENTI I BIRBOVET

U krijua ashtu në shoqërinë socialiste **DETASHMENTI I MADH I BIRBOVET**. Ky **DETASHMENT I MADH I BIRBOVET**, kërkonte ndryshime në rendin shtetëroro-shoqëror. **KËRKONTE NDRYSHIME, JO PËR TË BËRË DIÇKA MË TË MIRË**, por thjeshtë për t'u rikthyer në kapitalizëm, sepse atje *"**KEMI MUNDËSI TË PASUROHEMI**"*. Po të shikohet hollë, se çfarë kërkonte **KY DETASHMENT BIRBOSH** fodullë, del që ata faktikisht **NUK KËRKONIN PROGRES**. Thërrisnin: "***MJAFT KEMI DURUAR***!", por se çfarë do të bënin, mbasi ta kishin rrëzuar regjimin, askush prej tyre nuk ish në gjendje të bënte kurrfarë programi. Nuk u deshën, veç fare pak muaj, që të kuptohej sheshazi se çfarë kërkonte ky formacion i madh jopunëdashësish. Ky formacion i madh jopunëdashësish kërkonte anarki dhe mënyra johumane për të zhvatur kë të mundnin dhe si të

mundnin. Dëshmia më **LAKURIQE** e punëvet **TË ULËTA** të kësaj **BIRBOLUKUNIE** shikohet te të quajturat **FIRMA PIRAMIDALE**. Sapo e morën pushtetin, **BIRBOT** (prandaj dhe i quajmë **BIRBOKRATË)** ia hynë punës (sigurisht të instruktuar edhe së jashtmi) për ta **RRJEPUR** popullin e vet në mënyrën më *"**SHEMBULLORE"***.

Them ***"edhe së jashtmi"***, sepse këta **BIRBOT** e anës së këndejme, të Ish-Bashkimit Sovjetik, të krejt Evropës Lindore, të RPSSH-së, pjesë e Evropës Juglindore, çfarë do të bënin pa një **DETAASHMENT BIRBOSH** edhe në krahun e përtejmë?! **DETASHMENTI I BIRBOVET** në Lindje e gjeti të fuqishëm homologun e vet në Botën Kapitaliste Perendimore. Ç'është Silvio Berluskoni, përveçse një **BIRBO**?! Italianët e njihnin mirë, por tashmë po e njeh krejt bota.

LE TË MBURREN ME KURORA BIRBOSH APOLOGJETËT E KËTIJ LLOJ KAPITALIZMI!
****

VAZHDIM: **PRONA NË KOMUNIZËM**

Le të kthehemi, pra, edhe njëherë prapa! **HEQJA E PRONËS PRIVATE**, **VEPRIM QË QUHEJ *"THEMELI, THELBI I SHOQËRISË SË RE SOCIALISTE"***, që më vonë duhej ta çonte njerëzimin **në komunizëm**, doli **E PAREALIZUESHME**.

Thënë në formë definicioni, **KOMUNIZMI E KISH DEFEKTIN E VET QË NË DOKTRINË: TE PARIMI I ELIMINIMIT TË PRONËS PRIVATE DHE, PËR INERCI, TE NDRYDHJA E INICIATIVËS PERSONALE ME ANË TË PAGËS SË BARAZUAR.**

I gjithë sistemi doli bllof dhe është dashur të kuptohet që, **ME ATË PARIM, NUK DO TË MUND TË SHKOHEJ MË TUTJE**. **Mao Ce Duni**, siç duket, e pat kuptuar qysh heret rrëzikun e kësaj rruge dhe nuk i shtetëzoi pronat e vogla e të mesme. **Titoja** hoqi dorë qysh në vitet 1950 nga kolektivizimi i bujqësisë, ndërsa me industrinë eksperimentoi të quajturin ***vetadministrim të ndërmarrjevet***. Në Bashkimin Sovjetik u përdor e quajtura ***pjerjestrojkë***, për ta rikthyer pronën private mbi mjetet e prodhimit. Në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë Enver Hoxha i qëndroi besnik teorisë së marksiszëm-leninizmit dhe nguli këmbë që ***lulëzimi***

ekonomik të kërkohej, jo te prona private, por te prona e përbashkët. U ngul këmbë, u insistua, por nuk iu arrit qëllimit dhe as që mund të arrihej.

Një e metë e madhe qëndronte sidomos te **STUDIMET**. Bëheshin **studime**, por ata ishin **studime themelisht të gabuar ose pjesërisht të gabuar**. Një i tillë studim ishte edhe studimi im, që sapo lexuam në këtë libër. Nuk mund të shkohej në të atilla rrugë. **DUHEJ RIKTHYER PRONA PRIVATE** e pasojisht duhej rikthyer **INICIATIVA PERSONALE**, jo ajo negativja, por pozitivja, e cila doemos **duhej shpërblyer në mënyrën që e meritonte**.

Si të bëhej, që **PRONA PRIVATE** dhe **INICIATIVA PERSONALE** të mos e çonin prapë njerëzimin nëpër gremina?! Në këtë kahe, nuk u bënë **STUDIME TË REZULTATSHËM**, as në shtetet socialistë dhe as në ata kapitalistë.

Themi: "***AS NË ATA KAPITALISTË"***, sepse keqvajtja, **kthimi jo me rregull në kapitalizëm**, i vendevet që kishin tentuar, **JO PA ARSYE**, të sillnin një rend të ri, do t'i shkaktonte **KREJT NJERËZIMIT,** pra edhe vendevet tradicionalisht kapitalistë, **PERTURBACIONE** aq tronditës, sa brezat e shekullit XXI do ta kenë tepër vështirë për t'i përballuar. Në mos të pamundur.

6.ENVERIN E PËRCOLLËM ME LOT TË SHUMTË

Ditën kur u lajmërua vdekja e **Udhëheqësit të Shqiptarëvet**, në shkollën ku unë punoja, fillimisht zotëroi heshtja. Në të gjitha klasat (shkolla jonë kish rreth 1500 nxënës), u komunikua lajmi. Pat një heshtje zie, pastaj ia filloi të qarët, një vaj i paparë ndonjëherë. Pasi ra zilja për të dalë në oborr, atje, të qarët e të gjithëvet, nxënës dhe mësuese, u bë edhe më i papërmbajtshëm. Qahej me zë të lartë, lotët lagnin jo vetëm faqet e skuqura, por mjekrrën, fytin dhe gjoksin. Disa shtriheshin në bar dhe qanin, ose përmbys, ose me fytyrën drejt qiellit. Disa rrinin ulur me fytyrat mbështetur mbi gjunjë dhe me grushtet pranë tëmthavet. Pat edhe raste të të fiktit, kur mësuesit detyroheshin, duke qarë edhe vetë, t'i lagnin nxënësit me ujë, t'i merrnin për krahësh dhe t'i çonin në ambientet e brendshëm. Në dërrasat e zeza qenë shfaqur ndërkaq disa fjalë të fuqishme premtuese (fjalë, të cilavet thuajse askush nuk do t'u përmbahej).

Edhe në qytezën e Klosit, të paktën ndër ato familje me të cilat ne kishim kontakte, të qarët ishte i pranishëm. Njerëzit e dinin që **PAS ENVERIT NUK DO TË VINTE PËR SHQIPTARËT NJË UDHËHEQËS SI AI**. Disa edhe e shprehnin: "***U deshën 500 vjet për të ardhur në krye të shqiptarëvet një Skënderbe i dytë, do të duhen edhe 500 vjet të tjerë për të ardhur një i tretë.***" Njerëzit e dinin që, pas Enverit, komunizmi nuk do të mund të vazhdonte më. Njerëzit e dinin që, gjatë udhëheqjes së Enverit, jo çdo gjë pat shkuar mirë. Madje kish pasur shumë privacione. Por ata e kishin të qartë që socializmi (komunizmi), megjithatë i kish sjellë shumë të mira këtij populli.

Te Ramizi nuk kish besim thuajse askush. Ai ish një zhele, e cila qe hequr zhag, ndoshta prej dikujt, në mënyrë tepër të kujdesshme, nëpër Byronë Politike, vit pas viti, dhe tani po i lihej peshqesh këtij kombi, për ta çuar jo drejt ditëvet më të mira, por ndoshta drejt kohëvet më të zeza që ky popull nuk i kish merituar. Unë dyshoja shumë që ky njeri mund të ishte rekrutuar prej jugosllavëvet që në moshë të re. Ky dyshim i imi nuk është vërtetuar ende me dokumente dhe ndoshta nuk do të vërtetohet asnjëherë.

U shkruan edhe në shkollën tonë me qindra vargje elegjiakë. Redaktimin e tyre e bënim kryesisht Eli Çollaku dhe unë. Gjatë 2 netëvet fill pasi u muar vesh vdekja e Enverit, shkrova edhe unë një poemë të gjatë përshkruese të asaj që po shikoja e po përjetoja.

Hartova shumë strofa. Më kujtohet që një shumicë e atyre strofave fillonte me shprehjen "***kurrë më***". Psh "***Kurrë më 'Zëri i popullit' nuk do të jetë zë i popullit***". Por në redaktimin përfundimtar, i hoqa krejt ato strofa, që s'ishin tjetër, veçse një parashikim real dhe i zymtë i së ardhshmes së kësaj pjese të kombit tim, dhe lashë vetëm ato strofa që nuk i zbulonin mendimet e mi më thelbësorë. Poema u afishua midis krijimeve të tjerë, në stendën e shkollës, dhe sakaq erdhën 2 oficerë sigurimi për ta lexuar, për ta kopjuar dhe për ta komentuar kushedi se ku poemën time. Nuk e kishin hequr, as vërejtje s'më bëri askush. Mora vesh vetëm tërthorazi për ardhjen e oficerëvet dhe më erdhi mirë që s'i kisha nxjerrë vetes telashe me vargjet e mi zindjellës.

Kështu i kaluam vitet deri më 1991, kur i rrëzuan të gjitha përmendoret e Enver Hoxhës dhe kur unë, përsëri, prej së njëjtës kategori njerëzish

kuazivigjilentë, do të duhej të ruhesha të mos e thosha publikisht çdo mendim timin.

Enveri tashmë kish vdekur. RPSSH-në e kishin të tjerët në dorë. **GABIMI MË I MADH I ENVERIT** ka qenë, që ai (të paktën me aq sa dimë deri më sot), **NUK E KISH PROJEKTUAR EDHE KTHIMIN NË KAPITALIZËM**. **Nuk ka gjeneral në Botë që i hyn një beteje, pa planifikuar edhe taktikën e të tërhequrit**. Mirëpo ne nuk mund të themi që ai nuk do ta bënte një manovër të tillë, nëse do të kish rrojtur edhe 5 vjet të tjerë. Nuk mund të themi, as po, as jo. Nëse nuk do ta kish bërë, gabimi do t'i mbetej tërësisht atij. Madje ai do të mund të quhej edhe **FAJ**, ashtu siç i quajmë **FAJ** të gjitha punët që bëri, deri në vitin 1992, Ramiz Alia. Por, nëse do ta kishte bërë kthesën, unë jam i bindur që kthesa e Enverit do të ishte shumë më e mençur, sado që, siç do të shohim, forcat antishqiptare dhe, në thelb, edhe antievriopiane, nuk do ta lejonin një rrugë normale për ne.

7.KUR RRËZOHET NJË MUR

Rënia e komunizmit në Evropën Lindore e në Azinë Veriore, përtej Uralit, u shënua simbolikisht me rrëzimin e Murit të Berlinit. Nuk mund të thuhet dhe nuk duhet thënë që rrëzimi i këtij Muri mbylli një epokë të errët. Historikisht do të thuhet që, në këtë mënyrë, **ME RRËZIMIN E MURIT TË BERLINIT, U MBYLL PA LAVDI NJË EPOPE E LAVDISHME,** e cila u përpoq dhe ia arriti ta çojë njerëzimin përpara deri diku, në rrugën e vet të ndryshimevet progresivë, por që, në fund, u vetërrëzua.

Kryengritja e Spartakut, v.73-71 p.e.s, si përpjekje për ta rrëzuar me dhunë rendin skllavopronar, vërtet qe shuar dhe pat dështuar, por kurrsesi nuk mund të thuhet që ajo kryengritje nuk pat sjellë ndryshime progresivë në historinë e Perandorisë Romake e, rrjedhimisht, në historinë e Evropës e të Mesdheut dhe, prapë rrjedhimisht, në historinë e krejt njerëzimit.

Mirëpo, siç ndodh në çfarëdolloj dështimi, edhe në një ndeshje fare të rëndomtë sportive, në palën humbëse, ku më pak e ku më shumë, ndodhin shthurje. Në disa raste, madje, si psh në RPSSH e Jugosllavi, në Çeçeni, Igushteti etj, restaurimet u shoqëruan me ndodhi tepër tragjike. Tragjike, deri në palcë. Por as në Bjellorusi, Rumani apo Ukrainë s'u kalua lehtë, as po kalohet lehtë.

Në Gjermani, restaurimi u bë më mirë se kudo gjetkë. Ndoshta, i krahasueshëm me atë të Kinës, ndonëse Kina, prapë, ka tjetër histori. Ka histori tjetër, se e bëri vetë restaurimin. Nuk e ndihmoi askush. Për Gjermaninë nuk e kanë meritën ish-komunistët e Gjermanisë Lindore. Për Gjermaninë e ka meritën pjesa patriotike perendimore, pra, Gjermania Kapitaliste dhe, individualisht, kristiandemokrati Helmudt Khol. Gjermanoperendimorët, të prirë prej një të mençuri Helmudt Khol, e ditën që, po të japin sot 5, për mbajtjen më këmbë, për mosprishjen, për rivitalizimin **ME RREGULLA KAPITALISTE**, të ekonomisë socialiste, nesër do të marrin 10 e 15 po prej asaj ekonomie. Gjermanoperendimorët e kuptuan që kapitalizmi në Gjermaninë Lindore duhej restauruar jo me anarki, por me rregulla të një kapitalizmi të përparuar. Edhe në vende të tjerë ish-komunistë pati njerëz të mençur e me kulturë, që nënkupton: **EDHE PATRIOTË**, të cilët, në procesin e restaurimit, i çuan vendet e tyre drejt progresit, jo drejt regresit. Të tillë qenë: Vacllav Haveli në Çeki, Shevarnaxe në Gjeorgji, Tugjmani dhe Mesiqi në Kroaci. Në ish-Jugosllavi shkaktoi gjakderdhje dhe shkatërrim të madh shovinizmi sërb. Ai shovinizëm buron prej një nacionalizmi historikisht tepër të mbrapshtë pravosllav, i cili, në të gjitha kohët, u ka shkaktuar privacione të papërfytyrueshëm jo vetëm fqinjëvet jopravosllavë, por edhe vetë pravosllavëvet: sërbë, malazezë, sllavomaqedonë, pravosllavëvet të Bosnjës, të cilët miopisht janë të prirur ta quajnë veten sërbë, duke qenë boshnjakë e jo sërbë. Bullgarët pravosllavë e kapërcyen disi, por me vështirësi, këtë prag rikthimi në kapitalizëm. U normalizuan në një farë mënyre edhe rumunët. Ndërsa pravosllavizmi rus mbeti ai që ishte: i dëmshëm dhe i rrëzikshëm, për krejt Evropën, por edhe për vete. Në Slloveni dhe në Kroaci ndihmoi shumë kultura evropianoperendimore, e konsoliduar aty në shekuj. Edhe në Poloni ndihmoi katolicizmi, ndonëse aty ka faktorë që krijojnë pengesa dhe ngecje të forta në rrugët e progresit. E gjithë kjo është vetëm pjesërisht, të themi, pozitive. Dhe, kur themi ***pjesërisht***, kjo do të totë që e ardhshmja nuk është aspak shpresëdhënëse, as për ata vende që nuk e përjetuan rendin komunist, as për ata vende që e patën dhe e rrëzuan atë rend.

I gjithë problemi qëndron këtu: "***KOMUNIZMI DËSHTOI! PO ME KAPITALIZMIN Ç'DO TË BËHET?!"*** Shenjat nuk janë aspak të mira.

E vetmja rrugëzgjidhje që njerëzimit të mos i përsëriten më katastrofat (Eksodet Irlandezë nuk do të gjejnë më askund asnjë Amerikë, për të mbijetuar!), është **KAPITALIZMI SHKENCOR**. I quajturi socializmi shkencor pësoi disfatë. Ai lindi si përpjekje për të shpëtuar prej kapitalizmit

klasik më se mizor. Lindi, u provua, por nuk ia arriti. **AI SOCIALIZËM NUK MUND TË PËRSËRITET MË**, por prej dështimit të tij duhet me doemos të nxirren mësime: **KAPITALIZMI TË MOS LIHET MË I ATILLË SIÇ KA QENË PARA SE TË PËCISTE REVOLUCIONI KOMUNIST, SEPSE, PO U LA I ATILLË, TASHMË S'KA NË BOTË REND TJETËR PËR TË DËSHTUAR, PËRVEÇ VETË KAPITALIZMIT. Oligarkia kapitaliste e tashme, i ka të gjithë mjetet për të mos lejuar rikthimin në komunizëm.**

Në Republikën e Shqipërisë, ndërkaq, tipar kryesor ishte **SPOSTIMI I PATRIOTIZMIT DERI NË PAVEPRUESHMËRI THUAJSE TË PLOTË**. Derisa në shumicën e shtetevet të tjerë, patriotizmi qe faktor mjaft i rëndësishëm i një kalimi disi **më racional** nga komunizmi në kapitalizëm, **në Republikën e Shqipërisë patriotizmi u minimizua** aq shumë, sa që, kombi shqiptar, në një çerek shekulli, mbas 1990-s, përveç asaj pak lirie që fitoi një pjesë e Kosovës, nuk mundi të bëjë thuajse asgjë **PËR VETE**.

Ramiz Alia, nuk e ka pasë vështirë të studiojë partiakisht **NJË MËNYRË SA MË RACIONALE TË KTHIMIT NË KAPITALIZËM**. Por ai nuk mori as më të voglën masë **RACIONALE**, që kjo punë të bëhej me sa më pak dhimbje. Edhe **KAPITALIZMI PROGRESIST EVROPIAN** do të mund të bënte një program më human në të mirë, edhe të shqiptarëvet, edhe të vetëvetes. **SHBA-ja** gjithashtu nuk bëri për Republikën e Shqipërisë atë që duhej. Në krejt këto punë, me sa duket, luajtën rol subversiv dhe shkatërrues shovinizmat që e kanë rrethuar në shekuj kombin shqiptar.

8. SI DUHEJ BËRË „*TRANZICIONI*“ NË SHQIPËRI?

Të parët që duhej të vendosnin „***tranzicionin***“, dmth restaurimin e kapitalizmit në Rep.Pop.Soc. të Shqipërisë, duhej të ishin **komunistët „*E REFORMUAR*“**. Ata, pasi ta kishin vëzhguar situatën në Evropë e nëpër Botë, duhej të kishin mbledhur një kongres të jashtzakonshëm dhe të shpallnin „***REFORMIMIN*“** e tyre. Kjo do të thoshte që ata duhej të shpallnin **ME ARGUMENTE kthimin në kapitalizëm**. Do të bënin arsyetimin, do të kritikonin vetëveten, ku i kanë bërë gabimet dhe të parashtronin platformën, si mendonin ata për t'u kthyer në kapitalizëm. Si do të kalonte ekonomia në duart e privatëvet, si do të ruheshin veprat industriale duke i privatizuar, si do t'u ktheheshin tokat ish-pronarëvet, duke dalluar mirë cilës kategori duhej t'i kthehej toka dhe cilës kategori nuk i duheshin

kthyer tokat. (Sepse, pronësia mbi tokën në Shqipëri nuk kish të njëjtat karakteristika, ta zëmë, si në Sllovaki apo në Hungari.) Sigurisht, kjo nuk do të ish punë e lehtë, por s'ish as punë që nuk mund të bëhej. **Komunisët kishin realizuar MARRJEN e pronavet, që ish 1000 herë më vështirë se sa DHËNIA e pronavet**. Pse të mos mund të bëhej kjo në mënyrë shkencërisht të organizuar dhe në kohë sa më të shkurtër?!

Ndaj **ENVER HOXHËS** duhej të mbahej ky qëndrim: "***Ai i bëri MIRË këto e këto punë, por i bëri KEQ këto e këto punë. Ne e kemi pasur udhëheqësin tonë, prandaj figurën e tij nuk do ta hedhim poshtë, sepse ashtu hedhim poshtë edhe vetëveten. Nuk do ta hedhim poshtë edhe në nderim të atyre njerëzve, të cilët VETË kishin bërë kërkesa për anëtarësim në Partinë e Punës. Tani që Enveri ka vdekur, nuk do të ish e moralshme ta përbaltnim atë, sepse do të ish ulje e pajustifikueshme ndaj vetë atyre që iu bashkuan atij për gati gjysmë shekulli."***

Në atë parti, në partinë e komunistëvet që duhej të reformohej, doemos do të kish edhe anëtarë komunistë të pareformuar. Komunistëvet të pareformuar kongresi do t'u jepte të drejtën për të ruajtur partinë e tipit të vjetër. Në të njëjtën kohë, komunistët e reformuar do të shpallnin që në Rep.e Shqipërisë kanë të drejtë të krijojnë partitë e veta edhe shtresa të tjera të shoqërisë shqiptare.

Komunistët e pareformuar, vetëkuptohet që do t'i shpallnin armiq e tradhtarë shokët e tyre të reformuar, por kjo, sidomos në rast se reformimi do të inicohej së larti, nuk do të përbënte ndonjë rrëzik.

PARTIA E LEGALITETIT, e cila do të mund të krijohej në ato rrethana, duhej të riorganizohej pas shumë vitesh dhe puna e parë që do të bënte, duhej të ishte: ***Kritikë ndaj paraardhësvet të vet***. Ku kishte gabuar Ahmet Zogu?! Kjo duhej të ishte kryetema e analizavet të tyre. Legalistët nuk duhej të prisnin që t'ua shanin të tjerët lidershipin e tyre. T'ia thoshin **Ahmet Zogut** një për një **të mirat dhe meritat**, por t'ia thoshin dhe t'i publikonin një për një edhe **të metat, gabimet, shkeljet dhe krimet**.

Po kështu duhej të ndodhte edhe me **BALLISTËT**. Edhe ata do të duhej të mblidheshin, të bënin kongresin e tyre dhe t'i analizonin mirë punët, duke mos ua hedhur fajin të tjerëvet, por vetëvetes. Jo të thoshin: ***"NUK NA LANË KOMUNISTËT!"***, por të thoshin: "***GABUAM KËTU E KËTU!"*** Unë mendoj që qëndrimi i ballistëvet gjatë Luftës së Dytë Botërore duhet

dalluar nga qëndrimi i legalistëvet. Legalistët e kishin humbur betejën në vitin 1939, me largimin nga mbretëria të kryekomandantit të tyre, mbretit Ahmet Zogu. Ata duhej të kishin reflektuar shumë më mençurisht, në mënyrë që të mund ta rifitonin besimin e popullit. Për ballistët, ndërkaq, nuk mund të thuhet se vepruan tradhtisht kur i bashkuan forcat me italo-gjermanët. Italo-gjermanët patën bërë një lloj korrigjimi, sado jo të plotë, të Konferencës së Londrës dhe të Marrëveshjes së Versajës. E vetmja vërejtje që mund të bëhet për ballistët, është se ata nuk e parashikuan dot humbjen e Boshtit.

Por historianët duhet të thonë edhe këtë: Në qoftë se anglo-amerikanët do ta kishin përkrahur, edhe ata, abrogimin e Konferencës së Londrës dhe të Konferencës së Paqes në Paris, duke i dhënë të drejtë Nacional-Çlirimtares, ballistët nuk do të ishin konfrontuar, por do të kalonin masivisht kundër nazistëvet gjermanë. Ky ka qenë gabimi më i rëndë, jo vetëm i ballistëvet, por edhe i aleatëvet perendimorë, të cilët, në Mbledhjen e Mukjes, tentuan t'i vënë në të njëjtën peshore meritash, si partizanët, ashtu edhe ballistët.

Legalistët dhe ballistët kishin pasur 50 vjet kohë për t'i përpunuar teorikisht, filozofikisht, organizativisht, strategjikisht dhe taktikisht, të gjithë aspektet e ekzistencës së vet, kishin pasur kohë ta studionin e parashikonin mirë mënyrën e rikthimit në Shqipëri, kishin pasur kohë të punonin racionalisht me aleatët dhe me miqtë e tyre dhe rrëzimi i Murit të Berlinit nuk duhej t'i gjente kurrsesi kaq të papërgatitur.

Ata që duhej të krijonin **PARTINË DEMOKRATIKE**, duhej të ishin **komunistët e dënuar prej Enver Hoxhës**, bijtë e të pushkatuarvet dhe të të burgosurvet, të cilët dikur kishin qenë anëtarë të Partisë së Punës. Kjo duhej të ishte **PARTIA DEMOKRATIKE**. Parimisht s'kish pse përziheshin ata, as me zogistët, as me ballistët dhe s'kish pse përziheshin as me keqtrajtuesit, dënuesit apo persekutuesit e tyre. Ata mund të bënin aleanca me cilëndo parti, por jo të përziheshin, sepse vetë pikëpamjet e tyre kishin qenë dhe mbeteshin të diferencuara.

Qëllimi i të gjithëvet duhej të ishte **përparimi**, **jo rrënimi** i Republikës së Shqipërisë. Përparimi dhe evropianizimi, ashtu siç e kishin edhe sllloganin: "***E DUAM SHQIPËRINË SI EVROPËN!***" Nuk u bë kështu, u bë e kundërta, dhe vendi ynë përjetoi një shkatërrim të tmerrshëm. Fajin kryesor nuk e patën as zogistët, as ballistët, as ish-të burgosurit e Kohës së Enverit. **FAJIN KRYESOR E PATËN ATA QË DIKUR E KISHIN DASHUR**

DHE KRIJUAR KOMUNIZMIN NË SHQIPËRI, DHE QË, MBASI NUK U KISH PËLQYER MË KRIJESA E TYRE, NUK DININ, NUK IA KISHIN HABERIN, SE SI MUND TË KTHEHESHIN ANDEJ NGA KISHIN ARDHUR.

Po bëj një paralelizëm: E kemi bërë këtë vendbanim, këta fshatra e këta qytete, me arkitektë e me inxhinierë. Nuk po na pëlqen mënyra se si e kemi ndërtuar. Po duam ta ndryshojmë. Por si t'ia bëjmë që, orenditë, që i kemi blerë me para, të mos na dëmtohen, tullat të mund t'i ripërdorim, hekurin të mund ta ripërdorim, tjegullën të mund ta ripërdorim, tubacionet e ujit, tubacionet e ngrohjes, elektroinstalimet, si t'ia bëjmë, që të mund t'i ripërdorim?! Nga ndërtimet që, sidoqoftë, nuk janë krejt të pavlera, cilat të ruajmë e si t'i ruajmë? Si t'ia bëjmë që të mos na zënë karabinatë nën vete? Të mos na vriten njerëz! Të mos vrasim njëri-tjetrin! Të mos na shkërdhehen gratë nëpër qoshet e gërmadhavet! Të mos na shiten fëmijët nëpër rrugët e Botës! Djemtë, që i kemi bërë nga 20 vjeç, të mos i varrosim, një sot e një nesër!

Por, kush do ta bënte këtë?! Kush do ta tregonte këtë kujdes?! **A DETASHMENTI I BIRBOVET?!** Tashmë kish hyrë në veprim **DETASHMENTI I BIRBOVET** dhe po e shkatërronte Shqipërinë!

Në **KOSOVË** duhej të ish krijuar **Lidhja Demokratike**, ashtu siç u krijua në të vërtetë, prej ish-anëtarëvet të LKJ-së, por duke i shtrirë degët në të gjitha trevat shqiptare. Ajo nuk duhej të pranonte të kufizohej vetëm në Kosovë dhe emri i saj duhej të ishte **Lidhja Demokratike e Shqiptarëvet në Jugosllavi** (LDSHJ). Të shpallte distancimin, në të vërtetë shkëputjen nga LKJ-ja dhe të hartonte programin e vet, i cili duhej t'i çonte shqiptarët e asaj federate drejt shkëputjes. LDSHJ-ja, pra, as **LDK-ja**, **NUK KISH PSE TË MERREJ ME ENVER HOXHËN**, sado presion të kish nga kushedi se çfarë qarqesh nëpër Botë. **LDK-JA DUHEJ TË MERREJ ME TITON** dhe me pasardhësit e Titos, duhej të merrej me partitë sërbe, malazeze, sllavomaqedone. Me ata të merrej dhe me vetëveten, me strategjinë dhe me taktikën e vet, për ta shkëputur krejt atë pjesë të Shqipërisë nga Jugosllavia, e cila ish tashmë në shpërbërje. Natyrisht që do të bënte lidhje dhe do të kërkonte përkrahje dhe ndihmë prej Rep.së Shqipërisë, qoftë ajo edhe e shkatërruar, ashtu siç u gjend nga viti 1990 e këndej. Nuk ndodhi kështu. LDK-ja u mor me Enverin, ndësa Titon, Rankoviqin, i la të prehen të qetë në varret e tyre, sikur s'u kishin bërë asnjë të keqe shqiptarëvet.

Pyetjet që do të kërkojnë përgjigje në të ardhshmen janë këto: "***PSE VEPROI LDK-JA NË ATË MËNYRË?! KUSH E ORIENTOI TË VEPROJË ASHTU LDK-në?!"*** Dhe: Pse u shkatërrua në atë mënyrë Rep. Pop. Soc. e Shqipërisë?! ***KUSH FUTI HUNDËT QË SHQIPËRIA, PRA, KREJT SHQIPËRIA, TË KATANDISEJ KËSHTU?!*** Autori Viktor Çami na jep disa të dhëna dhe bën disa konkluzione shumë të vlefshëm në këtë drejtim, por gjithsesi të pamjaftueshëm.

NJË TJETËR PARTI SHQIPTARËSH NË ISH-JUGOSLLAVINË KOMUNISTE, duhej të ishte ajo **E TË BURGOSURVET.** Ish-të burgosur, familjarë të të vrarëvet e të të pushkatuarvet etj. Anëtarësia e asaj partie nuk mund të bazohej në anëtarësinë e LDSHJ-së (LDK-së), por as armiqësi s'kish pse të kish, sepse qëllimi i të 2-javet do të ishte dhe normalisht ishte i njëjtë. Të 2-ja ato parti duhej ta çonin popullin e krejt asaj pjese të Shqipërisë drejt një pavarësie të plotë, këtë herë jo copa-copa, por si një e tërë. Nuk u bë! Megjithatë, disa gjëra janë të kuptueshme dhe të justifikueshme, ndryshe nga çfarë ndodhi në Rep.e Shqipërisë, krerjtësisht e pajustifikuar.

Krahas këtyre, në Shqipëri, në të 2 pjesët ish-komuniste të Shqipërisë, natyrshëm do të ish krijuar edhe ndonjë parti tjetër, por jo për t'u grindur njëra me tjetrën. Kështu, ne shqiptarët, do të kishim shkuar drejt një përparimi më të qëndrueshëm. Më të qëndrueshëm dhe më të shpejtë. S'u bë ashtu, mbetet që brezat e ardhshëm të bëhen **MË SERIOZË** në punët që lidhen me fatet e Atdheut të tyre dhe me fatet e fëmijëvet të tyre. Po them: **TË BËHEN MË SERIOZË SE NE DHE MË TË MENÇUR SE NE!**

9. LE T'I GËRVISHTIM PAK ANALET

Restaurimi u bë. Ngjarjet rrodhën të bujshme njëra pas tjetrës. Shekulli XX po mbyllej me një grumbull të stërmadh analesh. Polonia. Les Valesa. Gorbaçovi, Jelcini. Pjerestrojka. Shpërbërja e Bashkimit **TË MADH** Sovjetik. Në Kinë, një restaurim kapitalizmi nën të njëjtën diktaturë, trashëguar prej komunizmit. Kolona refugjatësh në kufirin hungaro-austriak. Shembja e Murit të Brelinit. **Një rrëzim simbolik i blloqevet të betonit, por PA NDONJË TEORI TË PËRPUNUAR SHKENCËRISHT**. Fundi pa lavdi i çiftit Çaushesku, pa lavdi apo me lavdi një fund që do të pasohej me një Mehmet Sheh, me një Sadam Husein dhe me një Moamer Gadaf, thuajse në të njëjtën formë. (Ç'përfaqëson në historinë njerëzore të kohës

sonë ky lloj "***FUNDESH***"?!) Rrëzimi me trokëllima copash bronxi i shtatores së Enver Hoxhës. Vërshimi i miliona njerëzve drejt vendevet me kapitalizëm të zhvilluar, jo për t'u përmbyllur, por për t'u vazhduar kjo punë me një krizë të fortë financiare në BE dhe në SHBA. Të mbyturit e mijëra kërkuesish "***të një jete më të mirë***" në ujërat e Mesdheut. **EPOKA MAKABRE E LAMPEDUZËS!**

E gjithë kjo, ndodhi, shoqëruar kuriozitetshëm me lajme gazetash, por pa asnjë shpjegim **SERIOZ** të fenomenit dhe, për pasojë, pa asnjë masë **SERIOZE**, që ngjarjet të menaxhoheshin ashtu si duhej. Iu la çdo gjë **SPONTANITETIT**, stihisë dhe **LOJËS PREJ PRESTIGJATORËSH MISTERIOZË TË SHËRBIMEVET TË FSHEHTË PERENDIMORË**, shpershherë në kontradiktë me njëri-tjetrin, dhe **ATYRE TË PALOGJIKË ANTIPERENDIMORË**, me një agresivitet, sa të papërmbajtshëm, aq edhe regresivë. Në të gjithë rastet, tashmë, jo kundër komunizmit, por **KUNDËR VETË KAPITALIZMIT PËRPARIMTAR**. Do pohuar me të madhe, që, me këtë rast **NUK PO VRITEJ KOMUNIZMI.** (Ai e kishte vrarë veten me kohë!) Me këtë rast **PO VRITEJ KAPITALIZMI PROGRESIST.** Ai po vritej dhe ai thuajse është vrarë tashmë në kryeqendrat e tija më të përparuara.

Në Republikën e Shqipërisë restaurimi i kapitalizmit u bë në mënyrën më të keqe të mundshme. Kjo ndodhi, sepse politika në këtë shtet, ai i quajturi lidership politik, nuk e mbajti fare parasysh, ose e mbajti krejt shtrembër, interesin **KOMBËTAR** të shqiptarëvet. (Në Poloni, psh intersi kombëtar ishte në krye të krejt politikës.) Këtu u tha: "***E DUAM SHQIPËRINË SI EVROPËN***", por doli se e "***donim***" Evropën (atë të zezën, jo të bardhën) më shumë se Shqipërinë. Madje doli që, një pjesë e këtyre politikanëve, i "***donin***" më shumë Greqinë edhe Sërbinë, se sa Shqipërinë. U veprua në mënyrë aq idiote, sa, ky shtet, mbas 20 vjetësh të sorollaturash rreth vetes, si ai qeni që i është shurdhuar njëri vesh, Republika e Shqipërisë është tash shumë më larg se para 20 vjetësh, prej asaj që thoshte se e donte aq shumë, dmth prej Evropës Perendimore.

Në Kosovë dhe në pjesët e tjera të Shqipërisë, të mbetuar nën Jugosllavinë komuniste, punët shkuan edhe më keq, dhe kjo ndodhi sepse i quajturi lidership në Republikën e Shqipërisë nuk merrte vesh fare nga **PATRIOTIZMI**. "***Patriotizmi***" i lidershipit shqiptar i atyre viteve drejtohej nga dikush tjetër, që nuk ishte shqiptar. Mjafton të përmendim faktin që në Ushtrinë Çlirimtare të Ksovës kish shumë pak luftëtarë nga Republika e

Shqipërisë. Mezi bëheshin 150 vetë, përfshirë aty edhe shoqëruesit e mushkavet. Kish shumë më pak, pakrahasimisht më pak, luftëtarë nga Republika e Shqipërisë në UÇK, se ç'kish në forcat sërbe, rusë apo bjellorusë. (Ose më keq akoma: Në Kosovë, për çlirimin e Atdheut të vet, shkonin nga Republika e Shqipërisë vetëm 150, ndërsa në Siri, për idealet e fesë islame shkojnë mbi 600 shqiptarë.) Këtu, në Republikën e Shqipërisë, i shpallnin dezertorë ata ushtarakë që tentonin për të shkuar në luftë për çlirimin e Kosovës. Ndërsa në SHBA përgatiteshin batalione shqiptarësh dhe niseshin për në Kosovë, këtu u vihej flaka repartevet të ushtrisë dhe shpërthenin eksplozivet e baruti duke vrarë brenda në tunele nga 20 a 30 fëmijë e gra. (Kujto Frankthin në rrethin e Matit!) Si mund të shpjegohen këto "***politika***"?!

Sado që në pjesët e Shqipërisë që ndodheshin nën Jugosllavi, **PATRIOTIZMI** jo vetëm **NUK MUNGONTE**, por ish pikërisht ai që e kish mbajtur gjallë atë popull, mungesa e patriotizmit midis shumicës së politikanëvet, idiotë, injorantë dhe kopukë, në Rep.e Shqipërisë, çështja kombëtere shqiptare, në këtë periudhë të kalimit nga komunizmi në kapitalizëm, u dëmtua rëndë e më shumë se rëndë. Ndërsa të tjerët e frynin, e pomponin nacionalizmin e vet dhe **INVESTONIN**, jepnin para, për të dobësuar sa më shumë kombin shqiptar, politikanët tanë, këtu në Rep.e Shqipërisë, mendonin që aduti i politikës së tyre ishte: **TË SHARËT, TË DENIGRUARIT E ENVER HOXHËS**. Ata mendonin që, **SA MË SHUMË TA PËSHTYNIN ENVERIN, AQ MË KRAHHAPUR DO T'I PRISTE EVROPA**. Nuk e dinin, nuk ishin në gjendje ta kuptonin, sepse ishin **IDIOTË** dhe **INJORANTË**, kurse në pikëpamje morale **TOTALISHT TË PASKRUPULL** dhe as që u shkonte ndërmend që **vetë Bashkimi Evropian ish një marrëveshje midis KOMBESH**. Ata nuk e dinin, nuk e kuptonin, nuk mund ta kuptonin, që **KOMBI NË KAPITALIZËM ËSHTË THEMELI I TË EKZITUARIT TË KAPITALIZMIT NË ATË VEND**. Ata nuk e dinin, nuk e kishin aftësinë mendore për ta ditur që, nëse në **BE** nuk do të plotësoheshin interesat e tyre **KOMBËTARË**, psh anglezët do t'i thoshin qysh nesër lamtumirë **BE**-së. Po kështu do të vepronin gjermanët, po kështu edhe të tjerët. Sërbët do ta kushtëzonin hyrjen në **BE** me pranimin ose jo nga ana e **BE**-së deri edhe të absurdevet të tyre *"**GJOJA KOMBËTARË**"*. Shqiptarët ndërkaq, këta që luanin politikën këtu në Tiranë, mbaheshin fort pas absurdit të mosdhënies asnjë lek për problemet e **KOMBIT** të vet. Psh: Sa shqiptarëvet ortodoksë të Çamërisë u ka lidhur pensione shteti kapitalist shqiptar, si përgjigje që ortodoksëvet shqiptarë të Himarës, që nuk janë grekë, shteti kapitalist grek u

jep pensione?! Sa shqiptarëvet të Mitrovicës së Veriut, Rep. e Shqipërisë u ka lidhur pensione?! Sa shqiptarëvet të Preshevës u ka lidhur pensione Rep. e Shqipërisë? Sa shqiptarëvet katolikë të Tivarit u ka lidhur pensione Rep. e Shqipërisë? Themi pensione, por kjo republikë as **FJALË** nuk ka shpenzuar për ata bashkëkombës, jo më të shpenzojë **PARA**. Sa shpenzon Franca për frankofonët nëpër botë, që gjithsesi nuk janë francezë?

U nis ashtu që me Ramizin dhe ashtu po bitiset kjo punë, me të vetmen shpresë që ky **KOMB** të nxjerrë në sipërfaqe, sado vonë, një tjetër kastë të politikës: Një kastë mirëfilli **KOMBËTARE**.

E gjithë kjo, as për shqiptarët dhe për Shqipërinë, as në shkallë botërore nuk mund të lihet vetëm me një të gërvishtur të analevet. **Në shkallë botërore duhet që njerëzimi t'u qaset, si problemit të restaurimit të kapitalizmit në vendet ish-komunistë, ashtu edhe problemevet të kapitalizmit postkomunist në ish-vendet kapitalistë, në mënyrë sa më SERIOZE**. Dhe ende më e rëndësishme: Analet duhet të "***gërvishten***" e "***rigërvishten***", por jo me mendjelehtësinë që i ka karakterizuar gjer më sot "***analegërvishtësit***".

Le të shikojmë ç'po bën Bashar al Asadi me popullin e vet! Vrau 250 mijë e më shumë, nxori rrugëvet miliona fëmijë dhe miliona të rritur. Ku po e çon **KAPITALIZMIN** botëror ky lloj "***menaxhimi***" i situatavet?!

Le të shikojmë çfarë po bëjnë **KAPITALISTËT** grekë me popullin e vet! Me popullin grek! I morën **PËR VETE** 600 a 700 miliardë euro, i fshehën nëpër banka, ndërsa kërkojnë **PARA LËMOSHË** nga taksapaguesit gjermanë dhe të tjerë, për të ushqyer kalamajtë dhe pleqtë e Greqisë me supë makaronash. Ku po shkon kështu **KAPITALIZMI** botëror?!

Në SHBA po hyn vrasësi në shkollë dhe po vret me dhjetëra fëmijë dhe mësues. Po hyn vrasësi tjetër në ambientet e marinës dhe po vret prapë njerëz. Në Suedi vrasësi po vret dhjetëra pushues e pastaj po thotë: "***E bëra për inat***." Diku tjetër, përdhunuesi i gravet po i fsheh me vite nëpër bodrume gratë e përdhunuara, kurse ***"spiunazhi"*** **KAPITALIST** po e zbulon përdhunuesin vetëm atëherë kur ai të jetë vetëzbuluar. Ai atje, në Afrikën e Zezë, po rrëmben 200 vajza përnjëheresh dhe po i humb diku, ndërsa **KAPITALIZMI** bashkëkohor s'po është në gjendje t'i kapë rrëmbyesit.

Unë nuk ëndërroj që, një ditë, njerëzimi të gjejë apo të shpikë një „***sistem***“ pa keqbërje e pa krime, „***tërësisht të pastër***“. Por jo edhe kështu! Sepse **KËSHTU** nuk kemi të bëjmë me krime të veçuar, por me **DEFEKTE SISTEMI**, që e çojnë njerëzimin në katastrofa **TË P A R I P A R U E S H M E**!

A KY ËSHTË KAPITALIZMI?!

Shtatoret e **ENVER HOXHËS** u rrëzuan. Kush i rrëzoi?! Sigurisht, jo ata që mendonin thellë, por ata që mendonin cekët e u dukej sikur po mendojnë thellë. Unë, ime shoqe dhe qindra të tjerë, në lokalitetin ku jetonim, i dhamë lamtumirën Udhëheqësit tonë, duke pohuar që Ai tash e tutje po hynte në histori, dmth Ai tash e tutje i takonte së kaluarës, duke pohuar që rruga e Tij tash e tutje vërtet nuk do të mund të vazhdohej, por që emri i Tij, megjithatë nuk kish për t'u harruar për çdo gjë të mirë që kish bërë për këtë vend e për këtë popull. Populli reagoi ndaj rrëzimit të atyre shtatoreve, duke krijuar një shoqatë ***Vullnetarët e Enverit***. Atë e themeloi Hysni Milloshi, një njeri që fillimisht u përpoq të bëjë një punë të lavdërueshme, por që, në rrjedhë të vitevet, degradoi deri në shkallën e vetëpërçudnimit. Në shkollën ushtarake ***Skënderbej*** pati një tentativë revolte, por një veprim i tillë ishte i gabuar. Në këta vite e në vitet më këndej, Republika e Shqipërisë mori një rrokullimë 20-a më shumë vjeçare. Ishte ky një nga **TURPET** që ky komb është mësuar tashmë t'i gëlltisë.

Rinia e Tiranës dhe pastaj kush mundi, prej Tiranet e prej rrethevet, iu vërsulën ambasadavet. Fillimisht asaj gjermane e pastaj edhe disa të tjerave. 1000, 2000, 3000, 6000, 10000 vetë. Pyetja që bëhet, është kjo: Një shtet **KAPITALIST "*i përparuar*"** gjerman, a nuk mund ta parashikonte një mësymje të tillë dhe të merrte masat me kohë për të mos ndodhur të tilla rrëmujëra? Një shtet **KAPITALIST "*i përparuar*"** gjerman, shembullin e të cilit po kërkonte të imitonte kjo rini shqiptare, "***e zhgënjyer***" prej komunizmit, a nuk ish në gjendje t'i thoshte me kohë asaj rinie, vetë, po edhe nëpërmjet qeverisë shqiptare, me të cilën të bënte marrëveshje, **ANTIKOMUNISTE**, por **PROKAPITALISTE**, t'i thoshte, pra, kështu: "***Të dashur djem e të dashura vajza! Në KAPITALIZËM nuk shkohet duke u hedhur sipër murevet. KAPITALIZMI është sistemi i mrerkullivet e, në radhë të parë, sistemi i rregullavet dhe i ligjevet. Prandaj, shkoni në shtëpi, bëni secili nga një lutje, paraqiteni zyrtarisht në sportelet e kësaj ambasade dhe qeveria jonë, në bazë të marrëveshjes shumë favorizuese***

për ju, që ju e keni lexuar të gjithë, do të bëjë çmos për t'i plotësuar kërkesat tuaja." Në vend të një të këtillë veprimi, prej të cilit popujt, që nuk e donin **KOMUNIZMIN**, do të krijonin simpati për **KAPITALIZMIN**, përreth ambasadavet në Tiranë ndodhi **KREJT E KUNDËRTA**. Prandaj njerëzit pyesnin atëherë e pyesin edhe sot: ***A KY ËSHTË KAPITALIZMI***?!

Një shofer e theu murin e ambasadës dhe u fut atje me gjithë kamion. Qeveria gjermane dha "***strehim politik***" për 3000 vetë, pikërisht nga ata që, përmes ulurimave, kishin depërtuar "***në ambientet e shtetit gjerman***". "***Strehim politik***", në një kohë kur në Rep.e Shqipërisë tashmë s'kish asnjë lloj shtërngese politike. As thyerja e kufirit shtetëror nuk quhej më tradhti ndaj atdheut, as të shkruarit nëpër gazeta nuk bartte konsekuenca, as djegia demonstrative e vepravet të Enver Hoxhës nuk quhej blasfemi. Gjermania dha "***STREHIM POLITIK***" për 3000 "***PUSHTUES***" të ambasadës së saj, por për 3 milionë a më shumë shqiptarët e tjerë, nuk bëri asgjë nga ato gjëra që do t'u mbushnin mendjen miliona njerëzve se **KAPITALIZMI** është vërtet shumë i mirë. Ish po ajo Gjermani, e cila, para shpërthimit të shqiptarëvet, u kish dhënë punë nja 7 milionë turqve, ikur, jo prej **KOMUNIZMIT**, por prej **KAPITALIZMIT**.

Thonë që krejt kjo puna e "***PUSHTIMIT***" të ambasadavet paska qenë një inskenim i shërbimevet të fshehtë, me qëllim që bota ta marrë vesh sa i keq paska qenë **KOMUNIZMI**. Por, tash që nuk ka më **KOMUNIZËM**, duke parë ato ngjarje e ato skena, duke parë edhe ngjarjet e skenat e sotme, bota vazhdon të pyesë: ***A KY ËSHTË KAPITALIZMI***?!

Pas ambasadave, ne të mbeturit pa bukë ia mësymë Durrësit dhe Vlorës. Iu kacërruam anijevet. Me dhjetëra ngjiteshin për litarësh. Dhjetëra binin në det. Ata që dinin not, notonin dhe kapeshin prapë te litarët e trashë. Bota shikonte filma rrënqethës. Anijet u mbushën e u tejmbushën. Në sheshet e portevet dhe nëpër rrugët e Durrësit e të Vlorës mbetën dhjetëra mijë të tjerë, që nuk mundën të kacërroheshin te mjetet lundrues. Ata u kthyen të dëshpëruar, se nuk mundën të shkonin në **BOTËN E LUMTURISË**. Anijet e tejmbushura i ranë detit dhe dolën matanë. Në Brindizi **KAPITALIZMI** triumfues, i frymëzuar me mëshirë e me dhimbje, doli për t'i pritur viktimat e **KOMUNIZMIT** tashmë të shpartalluar. Shpërtheu **EKSODI** këndej, shpërtheu **HUMANIZMI** andej! Bota prapë pati rastin të shikojë filma nga më rrënqethësit.

Ishte një turp i madh për shqiptarët dhe për Shqipërinë, të cilët para gjysmë shekulli i kishin hyrë një pune për ta kryer dhe s'e kishin kryer dot. E kishin demaskuar Italinë **KAPITALISTE** për 50 vjet dhe tash po shkonin e po i faleshin asaj. Në vend që italianët e papunë t'ia mësynin Rep.Pop.Soc.të Shqipërisë për të gjetur punë, po shkonim ne për të kërkuar punë te **KAPITALIZMI**.

Vetëkuptohet që ky turp s'ish vetëm për shqiptarët. Turpi ish edhe për bullgarët, edhe për rumunët, edhe për sovjetikët, edhe për polakët, edhe për gjermanolindorët, sepse krejt kufiri midis Evropës Lindore dhe Evropës Perendimore, gëlonte prej turmash të ikanakëvet. Krejt ish-bota **KOMUNISTE** po përjetonte tani emocionet poshtërues të disfatës. Vetëm Kina, thonë, i doli zot vetes dhe i tha SHBA-së: "***Unë edhe i hap kufijtë, po deshe ti. Por duhet ta dish që, brenda një kohe fare të shkurtër, SHBA-ja flet kinezçe***."

Por pyetjet konkluduese, që shtrohen sot në adresë të botës së ***"konsoliduar"*** **KAPITALISTE**, janë këto: ***"A bëhej kjo rrëmujë, psh në Brindizi e Bari të Italisë, për shou mediatik, për t'u dëshmuar popujvet të Botës sa antinjerëzor paska qenë KOMUNIZMI, apo KAPITALIZMI nuk mund t'i menaxhonte më mirë këto punë? A ish i konsoliduar KAPITALIZMI, apo ish i qorrollepsur?!"*** Në të 2 opcionet, në të 2-ja mundësitë, njerëzit me të drejtë do të thonë: ***A KY ËSHTË KAPITALIZMI***?!

Në vitet 1990 Rep.Pop.Soc.e Shqipërisë dhe Rep.e Greqisë i **KISHIN** ambasadat në Athinë e në Tiranë, i **KISHIN** pikëkalimet në kufi. Tashmë, për nga regjimi, që të 2 shtetet ishin **KAPITALISTË**. Qeveria e Tiranës, sado e dështuar, ekzistonte, dhe shteti grek i kish të gjitha mundësitë për ta trajtuar në mënyrë krejt normale çështjen e emigrimit të shqiptarëvet, qoftë edhe të eksodevet. Por nuk ndodhi ashtu. Njerëzit tanë, thjeshtë iu vërsulën atij shteti **KAPITALIST**, nëpër të gjithë shtigjet, **PËRVEÇ PIKËKALIMEVET TË RREGULLT** të kufirit. Shqiptarët iu vërsulën kufirit grek, nëpër shkurre, nëpër pyje, nëpër monopate, nëpër shkëmbinj, nëpër borë, nëpër akull, nëpër shi, nëpër mjegull, të rrëzikuar prej ujqërvet, prej arinjvet dhe prej ushtarëvet grekë, të cilët, nëse nuk ndaleshe, të vrisnin, nëse ndaleshe, të rrihnin kafshërisht.

Atje, në thellësi të shtetit grek ikanakët gjenin punë. Afendikonjtë grekë i punësonin më me qejf shqiptarët se sa grekët. Ata, përgjithësisht, ishin punëdhënës të mirë. U jepnin ushqim punëtorëvet, u piqnin pulë për drekë.

Ndonjëherë u jepnin edhe strehim, por shumicën e rastevet shqiptarët flinin nëpër barraka, magazina e kasolle. Paga ishte sa 1/3 e të zakonshmes. Dmth punëtori emigrant paguhej 3 herë më pak se punëtori vendës. Një kërkesë e veçantë e grekëvet ishte që shqiptarët të bëheshin ortodoksë dhe të merrnin emra grekë. Se ku do të mbërrinte kombi grek me këtë politikë, një Zot e di. Por krahas kësaj, krahas kërkesës për t'u bërë *"**FETARISHT DHE ZYRTARISHT**"* grek, qeveria greke organizonte herëpas'here edhe të famshmet **FSHESA**. Vinte policia, hynte nëpër vendstrehimet e shqiptarëvet dhe, duke ushtruar dhunë, arrestonte kë mund të kapte. I fusnin nëpër furgona, i rrihnin me shkopinj, me shqelma, me qyta pushkësh, dhe i nxirrnin në këtë anë të kufirit. "***A KY ËSHTË KAPITALIZMI***?!"

Çfarë ka për t'i lëvduar këtij sistemi shoqëroro-shtetëroro-ekonomik, kur ai s'është në gjendje, ose nuk do, nuk dëshiron të vendosë ligje dhe të zbatojë ligje në lidhje me punën dhe punësimin dhe në lidhje me hyrjet e daljet e të huajvet nëpër kufirin shtetëror?! Në Greqi nuk hyjnë klandestinë vetëm nga vendet ish-komunistë, Rep.e Shqipërisë, Rep.e Bullgarisë, Rep. Polake, ku **KOMUNIZMI** tashmë ka falimentuar, por hyjnë edhe nga vendet **KAPITALISTË**, Kurdistan, të cilit **KAPITALIZMI** nuk i jep të drejtë për të krijuar shtetin e vet, Pakistan, fuqi bërthamore, e cila as e mban dot popullin e vet brenda vetes, as bën dot marrëveshje për një emigracion të rregullt. "***A KY ËSHTË KAPITALIZMI***?! "

Ka shumë shqiptarë që rregullohen disi në shtetin fqinj. Sigurojnë një jetesë deri diku të pranueshme. Ka nga ata që janë të suksesshëm, falë të dhënavet natyrore gjenetike dhe falë **SHKOLLIMIT** që kanë marrë këtu në **KOHËN E ENVERIT**. Megjithatë, shumë shqiptarë, shkuar atje në mënyrën siç e përshkruam, nëpër male, mënyrë krejt primitive, aspak e qytetëruar, as prej nesh e as prej shtetit pritës, mbeten përgjithësisht të pasigurtë. Një pjesë e tyre kryejnë delikte, arrestohen, dënohen rëndë, më rëndë se vendësit, madje më rëndë edhe se pjesëtarë të kombevet të tjerë. Paguhen më pak se të tjerët dhe dënohen më shumë se të tjerët. Mbushen burgjet me të dënuar shqiptarë. Statistikat kanë për detyrë të bëjnë krahasime, sa shqiptarë ka dënuar me burg regjimi **KOMUNIST** i Enver Hoxhës, nga viti 1944 deri më 1985 dhe sa shqiptarë ka dënuar me burg regjimi **KAPITALIST** i shtetit grek, nga viti 1992 deri në vitin 2012. Të nxiren këto statistika, me shkallë krahasimi në përqindje, dhe të bëhen konkluzione. T'u shtohen këtyre konkluzioneve edhe pretendimet e bezdisshëm të funksionarëvet të shtetit grek "***mbi të drejtat e minoritetit të tyre këtu në Rep.e Shqipërisë***", në një kohë kur për shqiptarët, as ortodoksë, as myslimanë, në atë shtet **KAPITALIST**, nuk ekziston

ASNJË E DREJTË NACIONALE. T'u shtohen po këtyre konkluzioneve edhe këngët kërcënuese të ushtarëvet të Greqisë ndaj shqiptarëvet, mu në parakalimet para presidentit të tyre. Të vihen re ca manovra qesharake që bën ushtria greke në anën e përtejme të Gramozit, kundër bandavet ***"armike"*** imagjinare "***UÇK***" dhe "***UÇÇ***". Pastaj të pyesim e ripyesim: "***A KY ËSHTË KAPITALIZMI***?!"

Në Republikën e Shqipërisë tashmë kishte ardhur **KAPITALIZMI**, jo ashtu si duhej, por ashtu si nuk duhej. Ngjarja më e rëndë ishte **VDEKJA E EKONOMISË**. A vdiq vetë apo e vranë, kjo u takon historianëvet të ardhshëm për ta dokumentuar. Nëse vdiq ***"vetëvetiu"*** një ekonomi, përse vdiq? A nuk kish mundësi të shpëtohej? Kush qe fajtori, që e la të vdesë një ekonomi jo të vogël, në një shtet të vogël? Nëse e vranë, **PËRSE TA VRISNIN NJË EKONOMI?!** Me egzistencën e vet, ajo ekonomi, duke u shndërruar në ekonomi **KAPITALISTE** (një operacion i tillë ish plotësisht i mundshëm), nuk do ta dëmtonte ekonominë ballkanase e aq më pak atë evropiane. "***A KY ËSHTË KAPITALIZMI***?!"

Me qindra makineri, punëtori, ofiçina, reparte, fabrika, bashkime fabrikash, që kishin 2 emërtime, kombinate dhe uzina, papritur heshtën dhe rreth 1 milion të punësuar mbetën pa punë. Qeveria e Ramiz Alisë vendosi që këtyre të lënëve pa punë, këtyre të përjashtuarve nga puna, t'u paguante përkohësisht 80% të pagës që kishin marrë, kur punonin. Ish rast që s'kish ndodhur ndonjëherë në këtë vend, që **TË PAGUHESHE PËR TË MOS PUNUAR**. **KAPITALIZMI** po u jepka njerëzvet një rrogë, sado minimale dhe tragjikisht të përkohshme, me kusht që **TË MOS SHKONIN NË PUNË**, me kusht që **TË MOS PUNONIN**. Njerëzit rrinin në shtëpi ose dilnin e sorollateshin rrugëvet, bisedonin njëri me tjetrin, por s'dinin ç'të thoshin, përpiqeshin të sajonin ndonjë mënyrë për të bërë para, por shanset e ndershëm ishin tmerrësisht të pakët. "***A KY ËSHTË KAPITALIZMI***?!"

Zyrat e administratës mbetën bosh. Vdiqën edhe ato. Atje tashmë nuk hynte askush, se s'kish pse të hynte. Autori i këtyre radhëve pat rast për disa muaj të ketë një zyrë në një ministri. Njeriu i vetëm, përherë i pranishëm, në dhomën e tij të vogël, në kat të parë, pajisur mes tjerash edhe me një krevat, ishte roja. Ai, sigurisht habitej kur më shihte tek ngjitja shkallët çdo mëngjes dhe tek zbrisja andej mbas dite. Ishte vërtet e trishtueshme të rrinin të 3 katet e një ministrie me muaj të tërë pa njerëz. Shihje vetëm në të rrallë ndonjë që shkonte në banjë ose që dilte andej. "***A KY ËSHTË KAPITALIZMI***?!"

Këtë pyetje nuk e bëja vetëm unë. Këtë pyetje me siguri e bënin mijëra të tjerë. Fabrikat mbetën pa punëtorë e pa nëpunës. Paga e quajtur 80%, që u dha shteti nëpunësvet dhe punëtorëvet, me kusht që ata të pranonin të rrinin në shtëpi, në kushtet e tregut **KAPITALIST**, s'e kish as vlerën e 8-përqindëshit. Filloi ashtu degradimi i krejt kapacitetevet prodhues. Korrozioni ishte ai që i nxirte makineritë jashtë përdorimit. Individë të ndryshëm, kush mund e si mund, bënin çmontime dhe merrnin çfarë mund t'u hynte në punë. Një inustri e tërë, e madhe në raport me numrin e popullsisë, në pak vite u asgjësua. "***A KY ISHTE KAPITALIZMI***?!"

A s'mund të kalohej në një mënyrë tjetër nga **KOMUNIZMI** në **KAPITALIZËM**?! Në spital, jo vetëm që duhej të paguaje, aq sa i kishin ***"tarifat"*** mjekët dhe personeli, të cilëvet deri atëherë u kish mjaftuar vetëm rroga shtetërore, por nuk kishe as çarçafë, as batanie, as këllëfë jastëkësh. Të gjitha duhej t'i merrje nga shtëpia, ndërsa të sëmurin duhej ta ruanin njerëzit e familjes. Edhe ujin, edhe ushqimin duhej familja t'ia siguronte të sëmurit, ndonëse spitali ishte shtetëror. Me ilaçet bëheshin spekullime nga më antihumanët. Edhe me organet e trupit të njeriut **KAPITALIZMI** po sillej në mënyrën më antihumane. Ata organe të trupit të njeriut shkonin e transplantoheshin në **KAPITALIZËM**. Ishin **KAPITALISTËT** ata që i blinin organet , për t'u vënë njerëzvet të vet, në mënyrë që jeta e tyre të zgjatej, pa çka se jeta e këtyre shkurtohej! "***A KY ISH DHE ËSHTË KAPITALIZMI***?!"

Njerëzit thoshin që, në botën "***e jashtme***", **KAPITALISTE**, s'ishte kështu. Por, pse këtu në vendin tonë, pikërisht kur kërkuam të kalojmë në **KAPITALIZËM** po na e binin kaq të vështirë këtë sistem shoqëror?! Shumë herë më të keq se ç'na e kishte përshkruar për gati gjusmë shekulli gazeta "***Zëri i popullit***"!? Magazinat e tregtisë ishin plot me mallra, trashëguar nga koha e **KOMUNIZMIT**. Në Tiranë dhe në të gjithë qytetet e tjerë, mallrat ishin depozituar me disiplinë e me rregull dhe qenë ruajtur me roja të armatosura. Tash, shteti **KAPITALIST** nuk ishte në gjendje t'i ruajë ato magazina. Grupe hiliganësh, udhëhequr nga eksponentë të partisë opozitare, shkonin në mbrëmje, neutralizonin rojat, i largonin në një farë mënyre, hapnin portat e hekurta me leva apo me eksploziv, dhe hynin për të plaçkitur. Merrnin ç'të donin e ç'të mundnin, i ngarkonin në ca kamionë të markavet sovjeto-kineze, dhe largoheshin, duke lënë çdo gjë hapur. Populli merrte vesh që ishin hapur magazinat, madje kjo gjë pështpëritej qysh para se ato të hapeshin. Shkonin të gjithë banorët për të marrë ç'të kish tepruar. Gjithë natën hynin e dilnin mijëra qytetarë e fshatarë, ngarkuar me thasë, me

arka, me sende nga më të ndryshmit, dhe i çonin në shtëpitë e veta, duke u kujdesur që t'i fshihnin sa të ish e mundur më mirë. "***A KY ISHTE KAPITALIZMI***?!"

Nuk mund të thuhet me përqindje, por një sasi e madhe, jashtëzakonisht e madhe, derdhej, ose aty, nëpër ambientet e magazinavet, ose rrugëvet. Në fund, ndaj të gdhirë, u vihej zjarri pjesëvet të kartonta dhe atyre të drunjta. Ndodhte që të digjeshin brenda edhe njerëzit, si rasti i Fushë-Arrësit. Të nesërmen, asfaltet, trotuaret, sheshet e betontë, rrugët dhe rrugicat, ishin "***TË SHTRUARA***" me grurë, me oriz, me fasule, me makarona, me sheqer, me kafe, me copëra pjatash, me gota të thyera, me lloj-lloj tekstilesh, me lidhëza këpucësh, me lugë të shkelura, me njolla vaji. I gjithë qyteti, deri thellë në periferi e në fshatrat më të afërt, ishte "***I STOLISUR***" me këtë lloj "***DEKORI***", indinjues e njëkohësisht të neveritshëm. "***A KY ISHTE KAPITALIZMI I SAPOINSTALUAR***?!"

Në fshatra, **KAPITALIZMI** iu vu punës për të prishur kooperativat. Se cila ishte arsyeja filozofike dhe social-ekonomike për ta bërë këtë prishje, kjo mbetet për t'u shpjeguar. A nuk mund të shndërroheshin në ekonomi **KAPITALISTE** këto ekonomi **ISH-KOMUNISTE**, pa e degraduar bujqësinë? Të parat që u sulmuan, ishin magazinat e kooperativavet dhe stallat e bagëtivet. Lopët i morën individët. Ata më të fuqishmit morën lopët më të mira. Atyre më të humburvet u mbetën lopët më të dobëta, gjysmë të ngordhura, një pjesë nuk morën fare. U "***ndanë***" edhe bagëtitë e imëta. Dikush merrte 15, dikush 2 kokë. Sipas forcës dhe sipas pushtetit. "***A KY ËSHTË KAPITALIZMI?! A KËSHTU BËHET KTHIMI NË KAPITALIZËM?!"***

Vetë Ramiz Alia kish dhënë "***orientimin***": "***Veproni fshatçe***!" Tradhti më të ulët ndaj fshatarësisë nuk mund të kishte. Ish po ai njeri që për 40 vjet kish predikuar mbi epërsinë e bujqësisë **SOCIALISTE** ndaj asaj **KAPITALISTE**. Tani, pasi e kish degraduar vetë atë bujqësi deri në faliment, hiqte dorë prej atij predikimi si një palaço, si një fundërrinë. Të njëjtin qëndrim ndaj bujqësisë mbajti edhe e quajtura opozitë, ajo që e çoi në burg Ramizin. Në vazhdim të asaj procedure antifshatare, ndodhi shkatërrimi i stallavet dhe rrënimi i kanalevet ujitës… Nuk ka pasur pak kanale ujitës në shtetin tonë **KOMUNIST**. Ka pasur shumë kanale dhe ata ishin të aftë ta çonin ujin në shumicën e tokavet bujqësore… Individët, kush mundte, merrnin pjesët e betonta dhe i çonin në shtëpi, për të rrethuar oborret e vet. Bënin mure me pllakat e kanalevet ujitës. Shtyllat dhe telat i ngulnin rreth

tokavet të veta, shpeshherë jo të vetat, por të zaptuara, një pjesë të madhe të të cilavet shumë shpejt kishin për t'i mbuluar shkurret. Magazinat, me mijëra ton pleh kimik rrinin hapur. Plehu kimik tashmë as që u hynte në punë fshatarëvet, të shndërruar sarkastikisht në "***pronarë***". Uzinën e Superfosfatit në Laç dhe Azotikun e Fierit, shteti shqiptar **KAPITALIST** i braktisi dhe i la në mëshirën e shpërbërjes. Pjesët e hekurta të atyre uzinave, të ndryshkura e të stërndryshkura, edhe mbas 20 vjetësh do të gjendeshin aty, "***të vlefshme***" vetëm për hekurshkrirësen e Elbasanit, me emrin "***Kurum***". "***Çeliku i Partisë***", i dikurshmi, qe shndërruar tashmë në "***Çelik Kurumi***". Paratë që fitoheshin prej Kombinatit "***Çeliku i Partisë***", duke na i përdorur për skrap edhe kapakët e pusetavet, tani nuk i merrte Partia, dmth populli, por dikush që ne shqiptarët nuk e njihnim.

Ndërkaq, amerikanët do të sillnin në Durrës një lloj tjetër plehu për bimët, me emrin ***DAP***, dhe, meqë nuk po u shitej, do të deklaronin me kompetenca të parrëzueshme: "***Shqiptarët duhet të mësojnë ta blejnë plehun".***

Në qendrat e fshatravet dhe nëpër qytete, filloi therja masive e bagëtivet. Thereshin qengja, viça, keca, cjep, desh, dele, mushtjerra, lopë kokadhekërcyera, që mezi i çonin deri te tregu. Tregjet e dikurshëm të fshatarëvet, pranë qytetevet dhe qytezavet, u rikthyen jo bukur në jetën e këtij populli. Sheshe, me kunja ku lidheshin gjëtë e gjalla, mbusheshin me kafshë e me njerëz 1 ditë në javë. 6 ditët e tjera, aty shihje vetëm qen, pula, njolla gjaku të piksur dhe bajga, bajga gjithandej, aq sa edhe kur kaloje andej, jo më këmbë, por me makinë, duhej t'i mbyllje hundët. Në ditët e pazarit, midis fshatarëvet që nxirnin bagëti për të shitur, gëlonin matrapazët. Njerëz të shkathët, njerëz që flasin prerë dhe me *"**KOMPETENCË**"*, që dinë t'ia mbushin mendjen fshatarit se malli i tij nuk vlen më shumë se kaq. Në fillim, bagëtitë ishin fare lirë, sa për të nxjerrë 2 lekë dhe për të ikur sa më parë, në Greqi ose në Itali. Midis matrapazëvet, filluan të shfaqen djem trashaluqë me zinxhirë të trashë floriri në qafë. Kuptohej qartë që këta nuk merreshin thjeshtë me blerje e shitje bagëtish.

Nëpër fshatra, përveç bagëtivet, tregtoheshin edhe **VAJZA**. Thuhej se, për një **KAPITALIST** të këtushëm, "***punonin***" përtej detit nga 20 femra. Ato "***punonin***" atje, në **KAPITALIZËM**, ua shisnin trupin e vet ca meshkujve mjeranë e moralkalbur, këta këtu, me paratë e atyre femrave, ndërtonin motele e hotele, supermarkete, qendra tregtare, parqe automobilash dhe vriteshin njëri me tjetrin. "***A KY ËSHTË KAPITALIZMI?! A KËSHTU U BËKA AI FARË TRANZICIONI DREJT NJË JETE MË TË MIRË?!"***

Nuk do harruar që, në kohën kur, në po këto hapësira, njerëzit punonin për ndërtimin e socializmit, përtej kufijvet nuk pushonin së përgatituri diversantë për ta prishur këtë socializëm. Po tani, pse nuk po ndërhynin nga jashtë për të mos e prishur kapitalizmin? Ku e kishin hallin vendet kapitalistë perendimorë, që po i linin të shkatërroheshin kështu ekonomitë e vendevet ish-komunistë?!

Paralel me thikat për të prerë e rrjepur bagëtitë, madje dhe më parë, njerëzit morën edhe sëpata e sharra, për të prerë e rrëzuar përtokë çdo dru që mund të shërbente për t'u djegur ose për diçka tjetër. Plepat gjigantë anash rrugëvet, pishat në parqet e qytetevet, agrumet nëpër plantacionet, trungjet e hardhivet (mijëra hektarë), ullinjtë, mollët, kumbullat. S'u la thuajse asgjë në këmbë. Një fermë e madhe "***Perlat Rexhepi***" në rrethinë të Shkodrës, u shua fare. Ferma, edhe më e madhe, "***Gjergj Dimitrov***" në rrethinë të Tiranës, u shkretua krejt dhe më vonë u mbulua me betonin e ndërtimevet në të egër, pa kurrfarë urbanizimi. Pyjevet, kudo që të ndodheshin, ose u vihej sharra, ose u vihej zjarri. Dikur rruga nga Fushë-Arrësi për në Kukës, vërtet ishte e largët dhe tepër e lodhshme, por njeriut i kënaqej syri prej pyjevet të pafund. Tash, njeriun e zinte trishtimi tek shihte mijëra hektarë të atyre pyjeve, rrëzuar prej sharravet dhe shkrumbuar prej zjarrevet. Drurin e arrës e shitën **KAPITALISTËT** e rinj në tregjet e jashtëm dhe paratë i morën për vete. Liqenet e bukur të Lurës u shëmtuan tragjikisht. Fshatrat dhe qytezat apo qytetet, të krijuar thuajse nga e para në gjysmëshekullin e **KOMUNIZMIT**, tashmë po mbeteshin pa njerëz, por edhe pa pyje. Pyjet ndoshta do të rriteshin prapë. Po njerëzit, vallë, a do të rishtoheshin ndonjëherë?! "***A KY ËSHTË KAPITALIZMI***?! ***KY E BËKA MË TË MIRË JETËN E POPUJVET?!"***

Në shkolla s'mbeti gjë pa u thyer e pa u shkatërruar. Xhamat e dritarevet, dyert, orenditë. Bibliotekat u dogjën, si ndër shkolla ashtu edhe në shtëpitë dhe vatrat e kulturës. Bashkë me ***Veprat*** Enverit, digjeshin edhe G.Floberi, U.Shekspiri, Xh.Steinbeku, Stendali, M.Tueni, A.P.Çehovi, T.Draizeri, Ç.Dikensi, N.Frashëri, J.De Rada, S.Çomora, J.Xoxa, I.Kadareja, V.Majakovski, P.Markoja, D.Agolli, R.Brahimi, D.Shaplloja. S'e di nëse ka ndodhur kështu në vendet e tjerë **ISH-KOMUNISTË**, por në Republikën e Shqipërisë **KËSHTU** u dogj „***KOMUNIZMI*****"** dhe kështu erdhi **KAPITALIZMI**, duke djegur në zjarr **KRYEAUTORËT E LETËRSISË BOTËRORE**.

Në qytetin e Rrëshenit, intelektuali Gjon Marku dhe bashkëshortja e tij, morën fëmijët dhe shkuan e fjetën në bibliotekën e qytetit. Kur erdhën libradjegësit, Gjoni dhe bashkëshortja e tij u thanë: "***Orenditë, në ju hyfshin në punë, merrini. Librat jo.***" Libradjegësit kërcënuan, u munduan edhe ***"të arsyetojnë"***, por çifti iu përgjigj: " ***Më parë do të kaloni sipër fëmijëvet tanë, pastaj mund t'i digjni edhe librat***." Sot ajo bibliotekë është nga thesaret më me vlerë që ka Rrësheni. Ndrecë Ndue Gjoka qe njëri hero i arsimit e kulturës mirditore në hyrje të një epoke, Z.Gjon Marku dhe bashkëshortja e tij janë 2 Ndrecë Ndue Gjokë në mbyllje të asaj epoke, në historinë e kësaj krahine. Në të 2 rastet, ishin **BIRBOT** ata që nuk e donin kulturën në Mirditë. Donin që Mirdita ta ngjyente bukën me shëllirë!

Kabinetet mësimorë, ku shpjegoheshin e demonstroheshin shkencat, u bënë sakaq të papërdorshëm. Sipërfaqet rreth shkollavet, këndet sportivë, u uzurpuan prej gjoja ish-pronarëvet, ose prej ish-pronarëvet të vërtetë, por që nuk duhej të guxonin të vinin dorë mbi institucionet arsimorë. Rrethimet e shkollavet u prishën. Portat u shkallmuan. Oborret e shkollavet u mbushën me gjahtarë femrash. Prindët kishin frikë t'i çonin vajzat në shkollë, se mund të mos u ktheheshin në shtëpi, siç po ndodhte pothuaj përditë. Prindët kishin frikë t'i çonin djemtë në shkollë, se mund t'u ktheheshin nga shkolla të rrahur e të gjakosur. Mësuesit vazhdonin të merrnin nga një rrogë të keqe, por mësues nuk ishin më. Autoriteti i mësuesvet kish vdekur. Ata hynin në klasë krejt formalisht dhe dilnin nga klasa pa i transmetuar dot brezit pasardhës asnjë njohuri. Në vend të diturisë, nëpër shkolla hyri droga. Ndër vajzat u kultivua, u pompua, bindja se ato duhej të pajiseshin me sa më shumë "***eksperiencë seksuale***" dhe, në zbatim të kësaj ideje, 90% e nxënësevet, sidomos në qytete e veçanëtisht në konviktet, bëheshin **GRA** qysh në moshën 13 vjeçare, dhe, po në atë moshë, ato braktiseshin prej "***të dashurvet***" të parë. Në atë mënyrë, shkollat tona u mbushën me **GRA TË LËSHUARA**. **90% e nxënësevet s'ishin më vajza, por GRA TË LËSHUARA E TË STËRLËSHUARA**. Mund të thotë dikush që këto po ndodhnin në vendet ish-komunistë! Por teoria e ***"përvojës seksuale"*** vinte prej **KAPITALIZMIT** dhe praktika e marihuanës vinte po prej **KAPITALIZMIT**!

Sheshet, rrugër dhe rrugicat e kryeqytetit dhe të qytetevet të tjerë të Rep.së Shqipërisë u mbushën befas me karroca qoftexhinjsh. Ishin 2-rrotëshe ose 4-rrotëshe, sajime mjeshtrorë me rrota biçikletash, me kushineta dhe forcuar me saldimet përkatës. Kishin një mbajtëse qymyri, një **zgarë** (siç quhej me një lloj zëshmimi për t'iu shmangur keqkuptimit, ***skara***), tepsitë një mbi një

me qofte të parapërgatitura, me salsiçe 2-3 llojesh dhe aty-këtu edhe me bërxolla derri apo biftekë viçi, tasa me spec të bluar dhe me kripë, shishe a bidona të vegjël me ujë, kanistra me bukë, thikë, këthyese të pjekjevet mbi zgarë (një lloj mashe), ndonjë fshesë të vogël bërë me pendë shpendësh dhe përsipër, montuar në karrocë, një çadër, e cila mbronte edhe nga dieli, edhe nga shiu. Kjo ndodhte në të gjithë sheshet e qytetevet të Rep.së Shqipërisë, por veçanërisht në Shesin ***"Skënderbej"*** të Tiranës. Në Sheshin "***Skënderbej***", ndërsa Kombinati Ushqimor "***Ali Këlmendi***" nja 2 km më tutje, ku ish prodhuar me vite edhe sallami, po shkonte tash drejt asgjësimit. Krejt ekonomia dikurshme **SOCIALISTE**, tani në duart e **KAPITALIZMIT**, po shkatërrohej. Pse?! Pse duhej shkatërruar kjo ekonomi shqiptare?! A që **KAPITALISTËT** e përtejkufijvet të mund të shisnin më mirë prodhimet e vet, apo që të mos kish më Tiranë, Korçë e Shkodër, sepse duhej ta sundonin Ballkanin Beogradi e Athina?! Rreth monumentit të Gjergj Kastriotit Skënderbeut ngriheshin avuj suxhukësh, qoftesh e bërxollash të përcëlluara, dhe e mbështillnin pa pushim kokën dhe bishtin e kalit, si edhe vetë kalorësin tonë prej bronxi. Aty ku deri para pak kohësh kish qenë Monumenti i Enverit, tani gëlonin lypësat. Sidomos po t'u dukeshe si "***i jashtëm"***, të shqyenin rrobash, duke kërkuar që t'u falje ndonjë monedhë. ***"A PRANDAJ QE RRËZUAR E ZVARRITUR NËPËR ATË SHESH ENVER HOXHA, QË AI SHESH TË MBUSHEJ ME LYPSARË?! A KY ËSHTË KAPITALIZMI, I CILI E SHAN AQ SHUMË ENVER HOXHËN?!"***

Mbi pllakat e trotuarevet, po edhe mbi pluhur apo aty ku kish mbetur sadopak bar, u shtruan shtroja, gjithfarë lëndësh e gjithfarë ngjyrash (pëlhurë, kompensatë, teneqe, të murrme, të bardha, me lule, pa lule, me figura gjeometrike, me viza: viza të kuqe, viza jeshile, kaki, bezh, të verdha), dhe sipër atyre shtrojave "***u ekspozuan***" mallrat për shitje. Rreshtat e të këtillë "***dyqaneve***" fillonin te Rruga e Elbasanit dhe mbaronin te Ushtari i Panjohur. Pastaj, në të gjitha rrugët dhe në të gjithë qytetet e Republikës sonë **ISH-KOMUNISTE** e tash **KAPITALISTE**, kudo ku kish pak vend për të nxjerrë diçka e ku shpresohej se mund të kalonte dikush. Aty ku dihej që do të kalonin shumë njerëz, aty thuajse u ziheshin rrugët kalimtarëvet. **ISHIN *"EKSPOZITAT"* MË TË ÇUDITSHME QË ISHIN PARË NDONJËHERË.**

Gjeje, dmth shihje, në ato "***ekspozita***" ç'nuk ta merrte mendja. Lugë, rrota ingranazhesh, kushineta, kopsa pantallonash, bluzash e këmishësh, të madhësivet e të formavet nga më të ndryshmet, tela alumini, tela bakri,

çorape, tenxhere, mbërthecka, bloqe shënimesh, kaçavida, pjata (se nga erdhën ca pjata plastike me gjithfarë zbukurimesh), elektrotransformatorë, pulovra, pallto dimërore, pompa uji, gjilpëra qepëse, rrota penjsh, këpucë, (me qafa, pa qafa), sandale (me rripa lëkure ose imitim lëkure), çekiçë, kukulla, darë, pinca, vegla muzikore, pula plastike, (por kish aty pranë edhe pula të gjalla), morseta, zinxhirë për qentë, rafte librash, libra (të vjetër si datë botimi, ose të rinj si datë botimi, por të vjetruar nga tymërat, libra profesionesh, libra fetarë, revista, në italisht, në rusisht, në anglisht, në greqisht, në shqip, revista porno, revista shkencore, fjalorë rusisht-shqip e shqip rusisht), pandofla, pasqyra (pasqyra makinash, pasqyra xhepi, pasqyra dhome, pasqyra për në banjo), pjesë për makina qepëse, brisqe xhepi, brisqe rroje, thika të madhësive nga më e vogla deri te ajo e shpatës mesjetare, kanarina me kafazë, sodë buke, sapunë, çamçakëz, gota uji, gozhdë, të madhësivet, që nga thumbat e këpucëvet, deri te ato që përdoreshin dikur në portat e kështjellavet.

Me kohë, këta mallra filluan të ndahen në kategori. U krijuan në kryeqytet edhe kryetregjet përkatës me të këtillë lëndë (të prodhuar diku, dikur ose sot): "***INDUSTRIA***" e bardhë dhe ajo elektrike në një vend, "***INDUSTRIA***" tekstile në një vend tjetër, ajo e quajtura ***E GABIT*** më vete, për ta pasur më lehtë që t'ua digjnin, nëse ndonjë ditë do t'i tekej ndonjë racisti, "***INDUSTRIA***" e mobiljevet të përdorura, "***INDUSTRIA***" e komunikacionit (varreza të panumërta makinash kudo pranë rrugëvet nacionale), "***INDUSTRIA***" e motoçikletavet dhe biçikletavet.

Fjalën "***INDUSTRI***" po e vë nën thonjëza, sepse, në të vërtetë, këtu kishim të bënim jo me industri **të mirëfilltë**, por me **MBETURINA TË MIRËFILLTA**. Industria e mirëfilltë, ajo prodhuesja, në këtë vend ish-komunist, tashmë qe rrënuar themelisht.

Këto mbeturina industrie mbetën ashtu "***të ekspozuara***", deri sa të zotët e tyre **falimentuan**, ose, deri sa gjetën ndonjë mundësi tjetër për të jetuar. Disa, prej të këtillë biznesmenësh, arritën të kapen dhe t'i hyjnë ndonjë tregtie më të mirëfilltë, por këta ishin fare të pakët. Shumica e atyre njerëzve identifikoheshin me vetë mallrat, të hedhur ashtu nëpër rrugë e nëpër rrugica, mbeturina shpirtcfilitëse të një shoqërie në ardhje, tepër të dyshimtë dhe tepër të pasigurtë. "***A KY ËSHTË KAPITALIZMI?! NGA PO VJEN KY KAPITALIZËM?! NGA KOMUNA PRIMITIVE?!"***

Në vend të asaj industrie, të cilën e kish themeluar dhe ndërtuar **KOMUNIZMI**, por që s'kish qenë në gjendje ta mbante, në vend të industrisë **MEKANIKE**, në vend të industrisë **TEKSTILE**, në vend të **METALURGJISË**, në vend të industrisë **KIMIKE**, në vend të industrisë së **MINIERAVET**, në vend të industrisë **USHQIMORE** (miell, makarona, vaj, sheqer, oriz, sapun, biskota, çdo gjë që i duhej njeriut të zakonshëm) (të zakonshmit, jo atij me teka), në vend, pra, të kësaj industrie, në Rep.e Shqipërisë u ngritën, "***INDUSTRIA***" e pasaportavet fallco, "***INDUSTRIA***" e vizavet fallco, "**INDUSTRIA**" e patentavet për shoferët, e diplomavet shkollore, "***INDUSTRIA***" **E TRAFIKIMIT TË QENIEVET NJERËZORE,** në format nga më "***ATRAKTIVET***"! Vetë emërtimi "***QENIE***" dëshmon që këto gjallesa tashmë nuk konsideroheshin 100% njerëz, sado që shumica ishin me shkollë të mesme dhe një pjesë e mirë edhe me fakultete."***A KY ËSHTË KAPITALIZMI?! A KËTO QENKAN TË DREJTAT E NJERIUT?!"***

Kontigjenti i parë i kësaj ***"INDUSTRIE"*** ishin **VAJZAT**. Ato po çoheshin në Evropën e bukur në numër gjithnjë e më të madh, sepse, me sa duket, atje kërkesa për to ish e madhe. (Doemos, botë e përparuar! **KAPITALISTE**!) Dikur, nga Rep.Pop.Soc.e Shqipërisë eksportoheshin: kromi, bakri blister, teli i bakrit, agrumet, tash Rep.e Shqipërisë (pa Pop. Soc.) po eksportonte **FEMRA**. Po kështu, secila me nuancat dhe specifikat e veta, po vepronin edhe Polonia, Rusia, Rumania, Moldavia, Bjellorusia, Ukraina. Do shënuar këtu që **VAJZAT E VENDEVET ISH-KOMUNISTË DONIN VETË** të shkonin **ATJE KU FITOHEN PARATË ME ANË TË SEKSIT**. Është gabim të thuhet që ato çoheshin atje me dhunë. Tjetër është mashtrimi e tjetër dhuna. Tjetër është se çfarë do të mendonin ato kur të shkonin atje dhe çfarë mendonin fillimisht, pa i hyrë ende atij "***profesioni***". E theksova këtë, për të vënë më mirë në dukje se **EDHE SHTETET ISH-KOMUNISTË DESHËN VETË, PA SHKUAN NË KAPITALIZËM**. Shtetet ish-komunistë u ngjanin mirëfilli **KURVAVET** në fund të shekullit XX dhe në fillim të shekulli XXI. **KY ISHTE KAPITALIZMI QË *"DESHËN"* SHTETET ISH-KOMUNISTË**?!

Në folklorin shqiptar ekziston një thënie: **"*MEMETI NGA PËRMETI, E KËRKOI DHE E GJETI*."**

MALL ME VLERË për Evropën tradicionalisht **KAPITALISTE**, krahas prostitutavet, ishin edhe **PUNËTORËT DHE INTELEKTUALËT.** Ata

çoheshin atje jo me dokumente të rregullt. Tingëllon disi rëndë, të thuash ***KRAHAS PROSTITUTAVET***, por ne jemi të detyruar ta themi, ndryshe nuk kuptohet procesi, nuk kuptohet fenomeni. Ç'do me thënë, për një djalë, për një vajzë, për një grua nënë fëmijësh, për një intelektual me goxha diplomë, të pranosh një pasaportë të falsifikuar, të japësh para për ta marrë atë pasaportë, të pranosh të hipësh ilegalisht në një gomone (pasi **ME VULLNETIN TEND** të kesh paguar edhe për këtë gomone qimet e kokës, t'u nënshtrohesh urdhëravet, madje britmavet arrogante dhe kërcënimevet me pistoletë të një skafisti, të zbresësh (në Evropën e bukur, në Evropën e pasur, në Evropën ku ka **"*PARA ME GRUSHTA*"**), jo në një mol të rregullt, por diku fshehurazi, duke u hedhur në ujë me gjithë plaçka apo me fëmijë ngrykë?! A nuk është ky një **PROSTITUCION** i llojit të veçantë, sado të mundohesh që ta ruash dinjitetin?! Le pastaj punët që je i detyruar të bësh atje ku ke për të shkuar! Një pjesë e mirë e gravet të ish-vendevet **KOMUNISTË** lajnë uturakët e pleqvet në vendet tradicionalisht **KAPITALISTË**. K**y ishte KAPITALIZMI, të cilin popujt e vendevet ish-komunistë lejuan t'u rikthehej*!!***

MIRË T'U BËHET! Nuk deshën të bëjnë punë të thjeshta dhe të jenë zot në vendet e tyre! Skafet, të quajtura gomone, prodhoheshin në Itali ose në ndonjë vend tjetër me industri të zhvilluar. Edhe motorët me iks ipsilon kuajfuqi, të atillë që të mund t'ia kalonin cilësdo ***guardia di finançia***, prodhoheshin në **KAPITALIZËM**. Njeriu që pranonte, që kërkonte vetë, që paguante për të hipur në ato gomone, kish një çmim të caktuar: 2000, 3000, 4000 dollarë (më vonë euro). **AQ ISH VLERA E TIJ**! Nëse binte ngushtë trafikuesi, ai mall, i quajtur **QENIE NJERËZORE**, edhe mund të hidhej në det. Një i tillë mall, me 83 **QENIE NJERËZORE**, të nacionalitetit shqiptar, u mbytën në Otranto dhe askush s'dha llogari. Edhe 800 të ishin mbytur, s'do të pyeste kush për ta. **Po hapej kështu një epokë e re e KAPITALIZMIT aq shumë të lakmuar: EPOKA E LAMPEDUZËS!!**

KAPITALIZMI i restauruar e la popullin në Rep. e Shqipërisë pa dritë elektrike. Net të tëra, javë të tëra, në terr total. Forma e re e ekonomizimit privat, e quajtur biznes i mesëm ose i vogël, nuk po funksiononte, sepse po e paralizonte një biznes më i madh: ai i eksportit ilegal të energjisë elektrike. Megjithatë, u gjet një mënyrë për t'i mbajtur gjallë edhe këta lloje biznesi. Gjallë, me shpirt ndër dhëmbë. U prunë, prej **KAPITALIZMIT TË ZHVILLUAR**, gjeneratorët, prodhuesit individualë të energjisë. U mbushën qytetet e Republikës së Shqipërisë, tashmë **KAPITALISTE,** me mijëra të atillë zhurmues, aq sa, kur të ecje nëpër qytet, të të dukej sikur je mes

motorëvet të ndonjë anijeje rrangallë. Me të këtillë prodhues të palevëdishëm të energjisë sigurisht që industria në **KAPITALIZMIN E ZHVILLUAR** përfitoi shumë herë më shumë se me një restaurim të rregullt. Industria në **KAPITALIZMIN E ZHVILLUAR** përfitoi edhe prej qirinjvet. Miliona qirinj parafine u importuan në Rep. e Shqipërisë, në një kohë kur eksportoheshin ilegalisht, nga po ky vend, miliona kilovat-orë energji elektrike, prodhuar në hidrocentralet e ***Kohës së Enverit***.

A i këtillë duhet të jetë rendi që pretendon se është më i mirë se **KOMUNIZMI**?! Qytetet shqiptarë mbetën edhe pa ujë. **INDUSTRIA, NË VENDET E KAPITALIZMIT TRADICIONAL,** përfitoi edhe nga kjo mbetje tragjikomike pa pikën e ujit në një vend ku uji buronte me tepricë. Ajo **INDUSTRI** e huaj**,** e shtoi prodhimin e pompavet të ujit, pruri dhe shiti këtu dhjetëra mijë pompa nga më të ndryshmet. Shtoi edhe prodhimin e të quajturavet depozita të ujit, të cilat u detyrua t'i blinte çdo familje. Tarracat e pallatevet morën një pamje të veçantë, të denjë për të shuar kuriozitetin e dhjetëra brezave që do të vijnë pas nesh. Por ne, të detyruar dëshprimisht t'i stolisim qytetet tanë me të tillë pejzazhe, nuk do të pushonim së pyeturi: "***A KY ËSHTË KAPITALIZMI?!"***

Në kohën kur në Republikën e Shqipërisë **ISH-KOMUNISTE**, tash **KAPITALISTE**, po shkuleshin vreshtat me mijëra hektarë, kur drurët e ullinjvet, të mollëvet, të portokajvet e të mandarinavet po përdoreshin për zjarr, kur tokat, tashmë pronë private, po shndërroheshin në shkurrishte qindramijëhektarëshe, tregjet tanë të fruta-zarzavatevet po mbusheshin me rrush importi, me portokaj importi, me mandarina importi, me mollë, me shalqin, me speca e me domate. Prej të gjitha këtyre, sigusrisht, po përfitonte **KAPITALIZMI TRADICIONAL**, duke vrarë që në lindje një **KAPITALIZËM TË SAPORESTAURUAR**. "***A KY ËSHTË AI KAPITALIZMI I MREKULLUESHËM, TË CILIN DJEMTË E VAJZAT TONA MEZI PRISNIN PËR TA PROVUAR E PËR TA SHIJUAR?!"***

Ku donin ta provonin e ta shijonin djemtë e vajzat tona **KAPITALIZMIN**? Këtu në Shqipëri, në atdheun e vet, apo atje ku mblidhej kapitali botëror, siç mblidhen byku e kashta në një turrë drushë, para se t'i vihet flaka?!

Dua të them: A ky **KAPITALIZËM** do ta çojë **BOTËN** përpara?! U asgjësua një bujqësi, të cilën e kish krijuar **KOMUNIZMI**, e cila, pa u asgjësuar, do të mund të shndërrohej në bujqësi normale **KAPITALISTE**. U ndanë tokat ***"me frymë"***, siç do të ndahej një tortë. U copëzuan tokat pa pikë

logjike, në vend që **SHKENCËTARËT E RESTAURIMIT**, të cilët fatkeqësisht as që ekzistonin, të kishin kërkuar një rrugë tjetër. *"**IDEATORËT"*** **E RESTAURIMIT**, kërkuesit e të bërit të Republikës së Shqipërisë "***si gjithë Evropa***", ishin ca njerëz dritëshkurtër, ca dallkaukë të paskrupuj, që s'dinin as për vete ç'do të bënin, jo më të projektonin të ardhshmen e vendit të tyre. Nëse do të ekzistonte farë serioziteti lidhur me të ardhshmen e bujqësisë, që është një pjesë e rëndësishme e cilitdo vend, do të mund të përkrahej krijimi **I 10-HEKTARËSHAVET PRIVATË**, ku do të mund të përdorej lirisht mekanika moderne, dhe ajo bujqësi do të mbetej bazë e fuqishme e një **KAPITALIZMI** vërtet të zhvilluar. Në vend të kulturavet bujqësore vërtet njerëzore, që i pat kultivuar sistemi kooperativist, parcelëzat tortoide dhe bakllavoide, u mbollën me kultura mirëfilli antinjerëzore, me kanabis sativa e me bimë të tjera njerëzmbytëse. "***A KY ËSHTË KAPITALIZMI, QË S'LA GUR PA LËVIZUR, PËR TA RRËZUAR KOMUNIZMIN?!"***

Ç'interes pat bujqësia **KAPITALISTE** e zhvilluar, që të katandiset kështu bujqësia në vendet **ISH-KOMUNISTË**?! Azgjë, përveç interesit të konkurencës **JOPOZITIVE**, e cila, duke qenë **JOPOZITIVE**, është në thelb **ANTINJERËZORE**! Pjesa e njerëzimit që po kalonte nga **KOMUNIZMI** në **KAPITALIZËM**, të paktën kjo që shihnim këtu në Rep. e Shqipërisë, përjetoi një **VDEKJE MORALE** nga më indinjueset. Shembujt janë me shumicë. Studiuesit le t'i shqyrtojnë ata një nga një. Shpresat u mbeten vetëm kohëvet që do të vijnë…

KLINIKAT DENTARE u shtuan aq shumë, sa të dukej sikur në çdo hap që bëje, të thoshte dikush: "***HAJDE TË T'I SHKUL DHËMBËT!"*** A mendoni se ata dentistë, ata stomatologë, e kanë hallin te shëndeti i dhëmbëvet të njërit apo tjetrit?! A mendoni se stomatologët i shtyn humanizmi për të hapur klinika në çdo rrugë e në çdo lagje?!. Këtë "***përvojë***" na e solli **KAPITALIZMI** këtu në Republikën e Shqipërisë, ndërsa në SHBA një Martin Shkrel do të burgosej, sepse paska guxuar ta shesë ilaçin e sidës shumëfish më shtrenjtë se ç'e ka koston. Në SHBA burgoset një Mark Shkrel, por nuk burgosen disa milionë "***dentistë***", të cilët, për një shkulje dhëmbi marrin 200-fish më shtrenjtë se ç'e ka koston shkulja e dhëmbit.

Në **FAKULTETET E DREJTËSISË** u dyndën "***kandidatë***" me mijëra, për t'u regjistruar në degët e atyre fakulteteve. A mendoni se ata "***kandidatë***", të rinj që sapo kishin kryer gjimnazet, dhe prindët e tyre, të cilët merrnin para borxh dhe paguanin ryshfete, e kishin vërtet hallin te **DREJTËSIA** dhe

DONIN TË VENDOSNIN DREJTËSI NË MARRËDHËNIET MIDIS NJERËZVET?! A mendoni se i shtynte humanizmi këta njerëz për t'u bërë juristë?!.

FAKULTETET E MJEKËSISË u sulmuan me numër të jashtzakonshëm "***kandidatësh***" të rinj që dëshironin të bëheshin mjekë. A thua ishin në merak të madh këta të rinj, se populli i tyre po vuante nga sëmundjet?! **A HUMANIZMI PO I SHTYNTE** këta dhe familjet e këtyre, të paguajnë "***nën dorë***" nga 3000 deri 4000 dollarë për t'u regjistruar në mjekësi?!.

Ndërkaq, në fakultetin e histori-filologjisë shkonin, nga halli, vetëm ata që mbeteshin pa u regjistruar askund. Pse nuk po sulmoheshin degët e albanologjisë si juridiku e si mjekësia?! **A THUA I SHTYNTE PATRIOTIZMI**, një fragment ky shumë i rëndësishëm i humanizmit, të rinjtë e një ish-vendi komunist, **QË TË MOS I STUDIONIN GJUHËN DHE HISTORINË E KOMBIT TË VET?**

Në kryqëzimet e rrugëvet, në dalje të qytetevet dhe kudo nëpër vendet ku parkoheshin mikrobusë, të quajtur "***forgonë***", dhe autobusë, me dhjetëra njerëz u suleshin kalimtarëvet, me zhurmë të madhe dhe me një agresivitet të jashtëzakonshëm, duke kërkuar me ngulm që njeriu të hipte në furgonin ose në autobusin e tyre. **A HUMANIZMI I SHTYNTE KËTA BËRTITËS**, këta kërkues kaq agresivë pasagjerësh, të mos i linin njerëzit të shkonin të qetë në punët e veta?! A i preu barku pronarët e furgonëvet e të autobusëvet se mos po mbeteshin njerëzit pa udhëtuar?! Ky, pra, ishte, së paku ndër ne, **KAPITALIZMI, PA HUMANIZËM dhe PA PATRIOTIZËM! KAPITALIZMI, i cili e kish shpallur KONKURENCËN "*E LIRË*" SI "*PROMOTOR*" TË ZHVILLIMIT TË EKONOMISË.**

Në hapësirat rreth Bankës Kombëtare u shfaqën ca njerëz me tufa parashë ndër duar. **KAMBISTËT** e famshëm, të cilët nuk do të bëheshin kurrë as bankierë, as zotër të ndonjë kapitali, por që do t'u shërbenin, si **SKLLEVËR** me shkollë, **PARAPASTRUESVET**! Skllevër, sepse s'kishin mundësi tjetër për të jetuar! Ishin intelektualë, të cilët qeveritë tona "***PLURALISTE***", ose i kishin flakur nga puna, ose ua kishin bërë punët e tyre, profesionet e tyre, të palevërdishëm: Oficerë, mësues, ekonomistë, inxhinierë gjeologë, aktorë, madje kish midis tyre edhe ndonjë doktor shkencash, nga ato shkencat, të cilat ekonomia e tregut i kish "***klasifikuar***" në kategorinë e dijevet të zhvleftësuara. **KY ISHTE KAPITALIZMI, NË NJËRIN PREJ SHTETEVET ISH-KOMUNISTË.**

U shfaqën nëpër sheshe **"*SPECIALISTËT*" E PARË TË BIXHOZIT**. Grupe mashtruesish që improvizonin me letra bixhozi mbi pllakat e trotuarevet ca lojëra prestigjatorësh dhe u rrëmbenin para të paditurvet dhe naivëvet. Prej këtyre, për fatin e zi të qindra familjeve, u krijua dhe u "***konsolidua***" **"*INDUSTRIA*" E BASTEVET DHE E KAZINOVET**.

Më në fund, krejt këtë atmosferë të një **KAPITALIZMI** jo të pëlqyeshëm, jo të pranueshëm, jo lumturiprurës, siç ëndërronte rinia **NAIVE** e **KOMUNIZMIT**, e "***kurorëzuan***" 2 lloje **VDEKJESH FIZIKE** nga më të tmerrshmet: **AKSIDENTET NË KOMUNIKACION DHE VRASJET E BANORËVET NJËRI ME TJETRIN**. Le të shkohet nëpër varreza dhe le të shikohet, me **evidencë statistikore**: **SA JETË SHQIPTARËSH JANË KËPUTUR NË MES?!** Le të bëhen statistika dhe le të krahasohen ato me jetët e këputura në mes në Kohën e Enver Hoxhës këtu në Republikën e Shqipërisë. Të njëjtat statistika krahasuese, për 2 epokat, është e mundur të nxirren, në shërbim të shkencës, në të gjithë vendet **ISH-KOMUNISTË**. Dhe pastaj, të gjitha përrallat do të lihen mënjanë dhe njerëzit anembanë Botës do të pyesin: "***A KY NA QENKA AI KAPITALIZMI I MIRË, QË DUHEJ TA ZËVENDËSONTE ATË KOMUNIZMIN E KEQ?!"***

Një shtet me mbi gjysmën e popullsisë të emigruar; një shtet ku shtetasi i diplomuar nuk zë dot një vend pune pa i paguar "***nën dorë***" zyrtarët; një shtet, ku diploma dhe vendi i punës blihen me para, pa marrë parasysh je apo s'je i aftë për ta kryer aksh punë; një shtet, ku gjyqin e fiton ai që ka më shumë para, qoftë ai edhe një kriminel qartësisht i vërtetueshëm; një shtet, ku s'ka ditë që njerëzit të mos vrasin njëri-tjetrin: vëllai vëllanë, burri gruan, gruaja burrin, i jati të birin apo të bijën, i biri apo e bija të jatin, fqinji fqinjin, bariu bariun, grabitësi të përtugrabiturin, huadhënësi huamarrësin, kalimtari kalimtarin; një shtet, ku s'ka ditë të mos vdesin njerëz në aksidentet rrugorë, më keq se në një luftë; një shtet, ku brenda 1 jave arrestohen 89 vetë (gusht 2012); në të hyrë të Shkodrës gjejnë vdekjen 5 djem në 5 sekonda; në Pogradec e në Librazhd, në 1 ditë humbin jetën 7 njerëz; **NJË NËNË VARROS 3 DJEM PËRNJËHERËSH**; një shtet, të cilit i tejmbushen ambientet e burgjevet, aq sa çdo ditë lind nevoja për të ndërtuar burgje të rinj; një shtet, ku 19 mijë shtetas e bëjnë jetën të ngujuar, ku fëmijët lindin e rriten pa dalë një herë jashë oborrit të shtëpisë; një shtet, ku edhe sakatët detyrohen të lypin për padronët; një shtet ku gruaja s'ka siguri të mbajë varur në qafë një varëse floriri, se e vrasin për atë varëse; një shtet, ku policia tatimore dhe policitë e tjera të të gjithë llojevet, gjobisin

subjektet ekonomikë dhe personat, jo se këta shkelin rregullat, por sepse policët gjobitës duan para për vete; një shtet, ku polici rrugor të gjobit, kur ti s'ke shkelur asnjë rregull qarkullimi, sepse do para për vete; një shtet, ku politikanët gënjejnë sa herë hapin gojën për të folur; një shtet që s'është në gjendje të bëjë një regjistrim popullsie; një shtet, ku edhe të verbërit detyrohen të dalin në rrugë për protesta, dhe shteti as i sheh e as i dëgjon, sepse ai nuk do, nuk dëshiron t'i dëgjojë zërat e protestuesvet, qofshin ata edhe për t'u mëshiruar; një shtet, ku diplomatët e huaj, kujdestarë të këtij gjoja shteti, vijnë gjithë kohën vërdallë, nga selia në seli e nga zyra në zyrë, duke u treguar përsosurisht të mirë, por pa kryer as edhe një punë të mirë.

Përfundimisht: "***A S'KA NDONJË KAPITALIZËM TJETËR MË TË MIRË SE KY ?!***"

Ata që janë mësuar ta quajnë veten të mençur, pa qenë as përafërsisht të tillë, do të më thonë: "***Ka***!" Dhe do të më tregojnë me gisht: Italinë, Gjermaninë, Francën, Britaninë, SHBA-në, Kanadanë, Suedinë. Por ata nuk mund, nuk janë të aftë, t'i kenë 2 gjëra parasysh: 1.Kapitali botëror **ATJE** është mbledhur e po mblidhet, duke lënë në pikë të hallit 4/5 e botës. 2.Mjerimi është i pranishëm **EDHE ATJE**, me gjithë fasadat që ua lëbyrin sytë mendjevet të cekëta.

Unë nuk mund të rri pa konstatuar, dhe njerëzimi nuk duhet të rrijë pa e shqyrtuar me vëmendje këtë që do të them këtu poshtë: **Kur komunizmi, qysh prej V.I.Leninit e deri te Enver Hoxha, pat vendosur për të krijuar një rend më të mirë shoqëror, komunistët shkonin fabrikë më fabrikë e fshat më fshat dhe u shpjegonin njerëzvet si do të oganizoheshin ato punë. Ata e kishin çdo gjë të programuar e të detajuar. Ndërkaq, ideatorët e resataurimit të kapitalizmit, as në vendet me kapitalizëm të konsoliduar, as në vendet ish-komunistë, nuk bënë asnjë përpjekje për të mos u dëmtuar popujt në procesin e ndërrimit nga një sistem në sistemin tjetër. Ky nuk është HUMANIZËM! Ky qëndrim është ANTINJERËZOR dhe njerëzimi shumë shpejt ka për ta PAGUAR shumë shtrenjtë këtë qëndrim antinjerëzor, nëse nuk reagon dhe nëse nuk çlirohet nga kjo qorrollepsje dëshprimisht tragjike.**

Komunizmi kish shkolla, kish INSTITUCIONE, lidhur me mënyrat e kalimit nga kapitalizmi në komunizëm. Ku i ka kapitalizmi INSTITUCIONET lidhur me kalimin nga komunizmi në kapitalizëm?! Ky konstatim, kjo e vërtetë që thashë tani, s'ka ku na çon tjetër, përveç

te parashikimi më se i kobshëm: Kur komunizmi, i përgatitur me aq kujdes, dështoi dhe u solli miliona njerëzve mjerim, kapitalizmi, nëse nuk ulet për ta studiuar veten seriozisht, në procesin e vetëshkatërrimit, MILIARDA JETË NJERËZISH, PËRFSHIRË NË RADHË TË PARË VETË KAPITALISTËT, KANË PËR T'U DJEGUR NË ZJARRIN E KATASTROFAVET.

* * *

Me këtë, dua të them:
U asgjësua bujqësia në Rep.e Shqipërisë, siç pamë pak parë. U asgjësua industria e mirëfilltë dhe u zëvendësua, psh në relacionin Tiranë-Vorë, po edhe gjetkë, me një industri, nga jashtë mjaft të bukur, të veshur me xhama, por nga brenda mjerane deri në palcë, thjeshtë ambalazhuese.

Përse u bënë këto punë?! A kish një bazë **HUMANE** një e këtillë veprimtari e botës antikomuniste? Nëse nuk kish bazë **HUMANE** asgjësimi ose asfiksimi i bujqësisë dhe industrisë së një hapësire të madhe në Evropën Lindore, **KU PO E ÇON VETEN KAPITALIZMI ME NJË TË KËTILLË PRAKTIKË ANTIHUMANE, ANTINJERËZORE**?! Fundja, vetë propaganda antikomuniste a ka pasur qëllim human gjatë 50 vitevet të Luftës së Ftohtë? **KOMUNIZMI U RRËZUA VETË**. Këtë e pamë. Po **TË KISH DITUR** të qëndrojë, po të kish arritur të gjente rrugët për të qëndruar, atë nuk do të mund ta rrëzonte asnjë propagandë dhe asnjë luftë, as e ftohtë e as e nxehtë.

Mirëpo tani, shkencat sociale janë të thirrura të shikojnë anën tjetër të problemit: **A po udhëhiqet sot sistemi kapitalist nga HUMANIZMI**? Në botë ka shtete kapitalistë, të cilët, përgjithësisht, ia kanë arritur të krijojnë dhe të zbatojnë një legjislacion shumë të përparuar ekonomiko-social. Shembull për këtë janë: Kanadaja dhe Vendet Skandinavë. Përndryshe, **NË TË GJITHË BOTËN KA FORCA KAPITALISTE DHE GRUPE KAPITALISTËSH DHE INDIVIDË, QË MISHËROJNË TENDENCA MIRËFILLI POZITIVE**. Të tilla forca ka edhe në Evropë, edhe në SHBA, edhe në Kinë, edhe në Rusi, edhe në Indi, edhe në Brazil, edhe në Vendet Arabë, edhe në Iran, edhe në Turqi. Por çështja është: **KUSH PO E UDHËHEQ BOTËN E SOTME**?!

Në rastin që unë po shqyrtoj, pra **në Republikën e Shqipërisë, procesin e kanë dirigjuar forcat NEGATIVE, si të brendshmet, ashtu edhe ato të jashtmet. Ndër të brendshmet ka pasur forca pozitive, por ato u shtypën**

dhe u ndrydhën. Ndër të jashtmet, edhe në ka pasur forca pozitive, ato kanë qenë të pafuqishme, thjeshtë dashamirëse.

ARMATA E HIPOKRITËVET

E kemi përshkruar më parë mënyrën se si e përcolli populli shqiptar **ENVER HOXHËN**. E qanë që të gjithë, përjashtuar, sigurisht, ata që gjendeshin nëpër burgje e internime, si dhe kundërshtarët e tjerë, të deklaruar ose jo. Por për ne është me interes t'u hedhim një vështrim atyre shqiptarëve që **E QANË UDHËHEQËSIN e tyre atë ditë që Ai vdiq dhe që 5 vjet më vonë e në vazhdim s'do të linin fjalë sharëse pa përdorur kundër tij**. Një pjesë e atyre që **kanë QARË atë ditë që vdiq ENVERI**, janë edhe të filmuar. Më 11 prill dhe gjithë javën e zisë, ata derdhën aq lot sa iu ënjtën sytë. Rreshti i përzishëm zgjatej me qindra metra. Edhe aty janë të filmuar. Ato ditë, që të gjithë mundoheshin të thoshin diçka sa më të mençur lidhur me **RËNDËSINË E VEPRËS SË ATIJ PRIJËSI**. Me mijëra ishin ata që thurën vargje dhe i botuan. Thuajse të gjithë shkrimtarët shkruan dhe botuan poezi me frymë elegjiake. **SHKRIMTARËT TANË MË TË MËDHENJ**, ashtu siç pritej, bënë elegji shumë bukura, të cilat recitoheshin në të gjitha shkollat. **ELEGJITË E TYRE KUSHTUAR ENVER HOXHËS JANË EDHE SOT SHUMË PREKËSE.**

Le t'i kërkojnë tani statistikanët, historishkruesit, sociologët, emër për emër ata njerëz që e shfaqën ato ditë, **TË PAMASË** dhimbjen për humbjen e udhëheqësit të tyre të dashur dhe le të bëjnë konkluzionet që u duhen: edhe historiografia, edhe sociologjia, edhe psikologjia, edhe filozofia! Por edhe morali gjithnjerëzor! Një shumicë sish, aq e madhe, sa njeriu nuk mund ta quajë ndryshe, veçse "***ARMATË"***, gjendet sot në kampin e madh të **ANTIENVERISTËVET**. ***"USHTRI"***! Ndoshta spanjist do të tingëllonte më përshtatshëm: ***"ARMADË"***. Si ndodhi që një sasi kaq e madhe njerëzish e ndërroi bindjen e vet kaq rrënjësisht? Kur kanë qenë apo janë **HIPOKRITË** këta njerëz, **ATËHERË, NDAJ ENVERIT**, apo **TASH, NDAJ TË GJITHË ATYRE QË U INTERESON TË MOS E DUAN SHQIPTARËT ENVERIN**?! Le që, kjo pyetje as që mund të qëndrojë, sepse, kur njeriu shfaqet **HIPOKRIT** në njërën rrethanë, ai mbetet i tillë, mbetet **HIPOKRIT**, edhe në të tjerë raste e në të tjera rrethana.

Mund të nxirren gjithfarë justifikimesh, mund të bëhen shpjegime e përmbishpjegime, por e vërteta mbetet gjithmonë po ajo. **ENVERIN** kishin

të drejtë ta urrenin këto kategori shqiptarësh: Ish-të burgosurit, ish-të trajtuarit si kulakë, ish-të internuarit, bashkë me rrethin e tyre më të ngushtë. Por ata, të cilët **kishin bërë LUTJE** për t'u anëtarësuar në **PARTINË E ENVERIT** dhe që kishin **NËNSHKRUAR ME DORËN E VET**, ata që, edhe pa qenë anëtarë të Partisë së tij, e kishin simpatizuar e madje adhuruar, ata që, si të thuash, i kishin bërë duart gjak, kur ai mbante fjalime, ata që derdhën aq shumë lot, kur **ENVERI** vdiq, nuk kishin të drejtë **MORALE** ta hidhnin poshtë me aq mendjelehtësi njeriun që ata kishin adhuruar. Nuk kishin të drejtë morale, përveçse në paçin qenë, në formimin e tyre, **TË PAMORALSHËM**. Asnjë prej atyre që kishin bërë **LUTJE** për t'u pranuar në **PARTINË E ENVERIT**, nuk duhej ta kish hequr nga dhoma **PORTRETIN E ENVERIT**. Themi: **NUK KISHIN TË DREJTË**, jo se e ulnin **ENVERIN**, por sepse **ULIN VETËVETEN**. **E ASGJËSONIN VETËVETEN**! Mund të përligjet deri diku të heshturit, mosprononcimi në publik me bujë e me protesta, për të mos fyer palën tjetër, por të vetëdeklaruarit kundër nuk mund të përligjet kurrsesi, veçse me **PABURRËRI, me HIPOKRIZI**.

Një e tillë **HIPOKRIZI** nuk ka ndodhur në këso përmasash në asnjë vend tjetër **ISH-KOMUNIST**. Titon, adhuruesit e tij, edhe sot e mbajnë nëpër familje, në dhomat e pritjes, madje edhe nëpër zyra. Edhe Mao Ce Dunin e mbajnë, madje në monedha. E pra nuk është komunist shteti i sotëm kinez. Edhe Leninin e mbajnë. Kanë edhe buste. Titoja nuk ka qenë më pak vrasës dhe persekutues se sa Enveri. Madje ai ka qenë vrasës dhe persekutues shumëfish më tepër se Enver Hoxha dhe shumëfish më i padrejtë se Enver Hoxha. Ata që i studiojnë këto gjëra, le t'i marrin dhe le t'i shikojnë nëpër statistikat këta aspekte të historisë. T'i shikojnë e t'i peshojnë, edhe statistikisht, edhe juridikisht, edhe moralisht.

Sido që të rrotullohemi, ngado që të sillemi, një qëndrim i tillë ne shqiptarët nuk na ka nderuar. Kur themi: ***ARMADË HIPOKRITËSH***, fare lehtë do të mund të thoshim, sado me dhimbje, edhe: ***KOMB HIPOKRITËSH***. A jemi ne shqiptarët një ***KOMB HIPOKRIT*****?!**

KUR TË FLASIM PËR ENVER HOXHËN

a) GLORIFIKUES PA DASHJE

ENVER HOXHA është personaliteti më i shquar i shtetit shqiptar dhe i krejt Kombit Shqiptar, mbas GJERGJ KASTRIOTIT SKËNDERBEUT. Këtë pohim nuk mund ta hedhë poshtë, as ta zbehë, asnjë propagandë, asnjë denigrim, asnjë cektësi gjykimi, asnjë miopi historishkarravitëse, asnjë makinacion i çfarëdo lloji, qoftë individual, qoftë në kor, qoftë në grupe koresh apo në simfoni e kakofoni nga më të ndryshmet.

Figura e tij ndoshta do të kish mundësi të zbehej, **VETËM nëse PERENDIMI, SHBA dhe BE, do të kishin pasur KUJDES** që, fill mbas përmbysjes së komunizmit, të kish ardhur në krye të Rep. së Shqipërisë një njeri më i aftë, më pozitiv dhe më **REZULTATIV** se Enveri, sidomos në aspektin **EKONOMIK**. Të mos varfëroheshin shqiptarët, të mos detyroheshin të bridhnin nëpër botë për copën e bukës, të mos krijohej hendek kaq i madh midis të pasurvet pakicë dhe të varfërvet shumicë dërrmuese. Vetëm atëherë mund të kishin gojë shqiptarët të thoshin: ***"Ai e kish fajin"***. Në Gjermani, psh, erdhi në postin e kancelares një zonjë nga Gjermania Lindore, vend ish-komunist, e cila, për mendimin tim (mund të jetë edhe ndryshe), është më e aftë dhe më pozitive se ç'ishin pararendësit e saj komunistë në Gjermaninë Lindore. As Vacllav Haveli nuk mund të vihet më poshtë se pararendësit e tij komunistë në Ish-Çekosllovaki. Përkundrazi. Por në Republikën e Shqipërisë nuk ndodhi ashtu. Këtu erdhën në pushtet **BIRBOKRATËT** dhe ata ia **RRITËN** vlerën Enver Hoxhës. (Sigurisht, pa dashjen e tyre. Duke qenë të cekët, duke qenë edhe të babëzitur. Sidomos, duke mos qenë **ASPAK PATRIOTË**.)

Kjo që do të themi tash, është një parashtrim ndoshta me ngarkesë ironike, por shkencërisht më se i mbështetur mbi një të vërtetë historikisht të parrëzueshme.

1. **ENVER HOXHA** nuk do të kish dalë kurrë në skenën politike shqiptare, nëse shtetin shqiptar nuk do ta kish pushtuar Italia Fashiste dhe nëse mbreti Ahmet Zogu nuk do ta kish braktisur Atdheun. Pra, **ENVER HOXHËN, SADO TËRTHORAZI, E KANË PRURË NË ARENËN E HISTORISË SË KËTIJ KOMBI, FORCAT NEGATIVE TË PERENDIMIT DHE FORCAT NEGATIVE, JOATDHETARE, TË VETË SHQIPËRISË**. Analizojeni me kujdes dhe do të shihni që kjo është **E VËRTETË**! B.Musolini dhe A.Zogu, janë 2 personat që, tërthorazi, indirekt, e kanë nxjerrë Enver Hoxhën në skenën e historisë.

2. **ENVER HOXHA** nuk do të kish mbetur **PERSONALITETI MË I SHQUAR SHQIPTAR** i kësaj epoke, nëse Perendimi, siç thashë, do të kish treguar kujdesin e nevojshëm që Shqipëria Pasenveriane të mos shkatërrohej, dhe nëse pushtetin në Rep.e Shqipërisë nuk do ta kishin marrë në dorë forcat vendëse **NEGATIVE**, joatdhetare, madje joserioze. Aq joserioze, sa, në krye të lëvizjes antikomuniste u vunë të atillë injorantë, të cilët, kur dilnin para popullit, për të mbajtur fjalime, nuk zotëronin as elementët më të domosdoshëm të sintaksës së gjuhës shqipe. Erdhi z.Bejker dhe hoqi këpucët e u fut në xhami. Erdhi z.Rajerson dhe s'dinte ç'të bënte me Rep.e Shqipërisë, se nuk e njihte. Erdhi z.Prodi në Vlorë dhe iu duk sikur, njeriu që do t'i mbaronte punët, ishte Zan Çaushi. Këtu ka material të mjaftueshëm për shumë e shumë **TRAGJIKOMEDIRA**.

Pra, **ENVER HOXHËN, sado tërthorazi, po e bëjnë përditë e më të madh shkatërruesit e këtij Kombi dhe të Atdheut të këtij Kombi**. **Këta janë, pa dashjen e tyre dhe duke qenë xhuxhë përpara tij, glorifikuesit e Enver Hoxhës**. Të ngjashëm **GLORIFIKUES** të Gjergj Kastriotit Skënderbeut, pa dashjen e tyre, kanë qenë sulltanët osmanë, Murati II dhe Mehmeti II Pushtuesi, si dhe vendësit renegatë, Evrenozët, Ballabanpashë Badera e të tjerë e, në shërbim të tyre, edhe kronikanët aq të zellshëm, të cilët, duke e quajtur Gj.K.Skënderbeun ***djall me brirë***, u dukej se po thoshin të vërtetën. Ashtu edhe sot, kronikanëvet të mirëpaguar, kur po bëjnë gara për ta cilësuar Enverin me terma sa më denigrues, po u duket sikur po flasin objektivisht. Këta po u ngjajnë sarkastikisht kronikanëvet të sulltan Muratit II dhe të sultan Mehmet Pushtuesit.

b) PSE PO SHPREHEN KAQ KEQ PËR ENVER HOXHËN?

Nuk është zor i madh për ta njohur veprimtarinë e Enver Hoxhës. Ajo njihet, është e shkruar, është e filmuar. Punët që janë bërë në kohën kur Ai ishte në krye të partisë e të shtetit, njihen. Edhe ato janë të publikuara që të gjitha. Qëndrimet e tij njihen, sepse i ka thënë botërisht. Në krejt këtë lëndë, në krejt këtë material, që njihet mirë (për këdo që dëshiron ta njohë), mund të dallohen lehtë edhe **të metat e gabimet**, madje edhe fajet, si të atij vetë, ashtu edhe të të tjerëvet, që vinin mbas tij. Sado të mundohet dikush për të gërvishtur në gjëra që vetëm me anë të gërvishtjevet mund të bëhen gjoja **TË RËNDËSISHME**, ato nuk i ndryshojnë asgjë asaj që është **E**

QENËSISHME dhe **MADHORE** në veprimtarinë e këtij udhëheqësi të madh të shqiptarëvet.

Prandaj po them se nuk është zor i madh për ta njohur Enver Hoxhën, pikërisht ashtu siç ka qenë. Është vështirë për të zbuluar dhe për të kuptuar: **PËRSE PO NGULMOHET KAQ SHUMË PËR TA DENIGRUAR PERSONIN DHE VEPRËN E ENVER HOXHËS**?!

Nuk iu la as **VARRI** atje ku e kishte. (Ndonëse, mund të mos e kish atje vendin, sepse nuk ka qenë dëshmor.) Nuk iu lanë **PËRMENDORET**. (Mundet që ai në sheshin "***Gj.K.Skënderbeu***" të mos e kish aty vendin, por edhe ai duhej hequr ndryshe.) Nuk iu lanë **LIBRAT**. Iu dogjën, iu grisën, iu hodhën në plehra të gjithë librat që ai i kish shkruar e botuar si asnjë udhëheqës tjetër i shqiptarëvet deri më sot. (Kjo s'duhej të kish ndodhur kurrsesi.) Pse ndodhi kështu?!.

Por nuk është kjo e keqja më e madhe. E keqja më madhe është se këtu u shkatërruan gjer në themel **VEPRAT EKONOMIKE E KULTURORE**, që **ENVERI S'I KISH BËRË PËR VETE**. Veprat ekonomike e kulturore, të cilat quheshin ***VEPRA TË 5-VJEÇARËVET***, vërtet që ishin ideuar prej tij, por ato nuk ishin të tijat. Përse duhej të shkatërroheshin?! Dhe pyetja më e afërt që na vjen sakaq, është kjo: ***"a bëhet fushatë denigruese ndaj ENVERIT, për të justifikuar shkatërrimin e këtyre veprave ekonomike e kulturore, apo u shkatërruan veprat ekonomike e kulturore, për inat se ato i kish projektuar e supervizuar ENVERI?"*** Thjeshtë: **A është punë inati kjo punë, apo ka diçka tjetër**?! Ka edhe një pyetje që vjen pas kësaj: **Pse të jenë pikërisht SHQIPTARËT, madje, më së shumti ata shqiptarë që dikur kishin qenë më të privilegjuarit në regjimin e tij, të cilët flasin kundër ENVER HOXHËS më shumë se të huajt?!** Nuk është lehtë. Sidomos kësaj së fundit pyetje nuk është lehtë t'ia gjesh përgjigjen. Mbas vdekjes së Gj.K.Skënderbeut, ata që i shkatërronin kishat, ata që u zinin prita priftërinjvet, që i kërcënonin, që i rrihnin priftërinjtë, që i ngulnin në hunj, kanë qenë kryesisht arbër të islamizuar. Të islamizuar dhe të veshur me pushtet. Rrallë ndodhte që të huajt t'i torturonin të krishterët e këtushëm.

c) AKUZAT NË PESHORE

Nuk pretendoj që peshorja ime të jetë rigorozisht precize, pasi këndi i vlerësimevet të një personaliteti historik është shumë i gjërë dhe, edhe te

unë, ashtu si te kushdo tjetër, ka doemos doza subjektiviteti. Por pasaktësi flagrante do të përpiqem të mos i lejoj vetes.

Është thënë se **ENVER HOXHA** e pat izoluar Rep.Pop.Soc.të Shqipërisë, prej Evropës dhe prej krejt botës që e rrethonte këtë shtet. Është thënë kështu dhe është marrë kjo thënie si absolutisht e vërtetë. "***TË MENÇURIT TANË***" madje as të lënë të diskutosh për këtë çështje dhe nguten për të numëruar ***"faktet"***: ***"Nuk na lejohej të dilnim jashtë shtetit, nuk na lejohej të shikonim televizionet e huaj, nuk, nuk, nuk."*** Ndërkaq, e gjithë kjo duhet të shikohet më kthjellët dhe më me realizëm. Në atë kohë përdorej shumë fjala ***bllokadë***. Thuhej: "***Të punojmë shumë, për të përballuar bllokadën! Të kursejmë, për të përballuar bllokadën***!" Do parë, pra, a mos vërtet bota që na rrethonte, po na bënte **bllokadë**? Dua të them: A mos po na izolonte bota ne, apo ne po izolonim veten? Në ditët e sotme është në përdorim shprehja "***LUFTA E FTOHTË"***. **Kjo** "***LUFTA E FTOHTË"* në çfarë konsistonte? A vetëm në atë që vendet komuniste po izolonin vetëveten, apo edhe në atë që kapitalizmi po i izolonte këta vende?** Përveç këtij arsyetimi, kemi edhe një arsyetim tjetër: Mbas vitit 1990 ne ***"e nxorëm veten nga izolimi"***. Por kapitalizmi nuk na lejoi të shkonim në Perendim as me viza të rregullta, le më pa viza. Na detyroi të thyejmë qafën nëpër shkëbinjtë e Gramozit dhe të mbytemi me gra e me fëmijë në Adriatik e në Jon. **Sa vjet na u desh të prisnim të shumëdëshiruarin liberalizim të vizavet**? Sa vjet po na duhet të presim që të mund të eksportojmë diçka në tregjet rretherrotull, qoftë perendimorë, qoftë lindorë, tani që s'ka më komunizëm dhe tani që nuk po vetizolohemi? Le që, **BIRBOKRATËT** tanë e bënë vendin tonë teneqe dhe s'kemi as çfarë të eksportojmë, as me çfarë të blejmë për të importuar. Pra, **kush e ka izoluar më shumë këtë vend, ENVER HOXHA apo këta që e shkretuan Atdheun e shqiptarëvet dhe që nuk e "*ÇUAN*" dot në Evropë këtë popull për më se 25 vjet?!**

Kur thuhet, **ENVER HOXHA** eliminoi ose neutralizoi kundërshtarët e vet, është më drejt të thuhet: ***kundërshtuesit e idealit të vet***. Ideali i **ENVER HOXHËS** ishte: **Vendosja e rendit komunist në Rep. e Shqipërisë** (dhe kjo jo pa arsye) **dhe zhdukja, ose të paktën minimizimi i shfrytëzimit të njeriut prej njeriut**. Në të gjithë vitet, sa mori frymë, shikohet vetëm ky synim i tiji. Kërkonte mënyra, studionte, vriste mendjen, analizonte rezultatet që i ofronte zbatimi në praktikë, por nuk ia arriti dot. Nuk u arrit në shkallë botërore dhe nuk ia arriti as **ENVER HOXHA**, as të instalonte me afat të gjatë komunizmin në vendin e vet dhe as ta zhdukte shfrytëzimin e njeriut prej njeriut. Ky ishte edhe shkaku që ai u detyrua të përdorë

DHUNËN. Është më e drejtë, pra, të mos thuhet: ***Përdori dhunën***, por të thuhet: ***U detyrua të përdorë DHUNËN***. Dhe atë, në shumicën e rastevet, e përdori duke nxjerrë më parë ligjet përkatës. Nuk shtrohet këtu pyetja: ***"A bëri mirë?"*** Pyetja shtrohet: ***"A mund të bënte ndryshe?"***

Mirëpo, kur të themi, ***u detyrua të përdorë dhunën***, ose, ***përdori dhunën***, ne, nëse duam të jemi objektivë, nuk na lejohet ta mbajmë këtë konstatim pa bërë fare krahasime. E kanë sharë Enver Hoxhën në shkallën më të lartë të mundshme, s'kanë lënë gjë pa thënë kundër tij, por janë shmangur ta krahasojnë atë me të tjerë personalitete, që historia, me gjithë dhunën që e kanë përdorur në rrugën e tyre, prapëseprapë, nuk i ka hedhur poshtë. Rasti më i dukshëm e më i prekshëm është ai i Alipashë Tepelenës. Enverit ia rrëzuan shtatoren, me urrejtjen më të madhe, ndërsa Alipashë Tepelenës, për të cilin dihet mirë çfarë krimesh ka bërë mbi popullin e vet, nuk ia rrëzuan, por përkundrazi, ia bënë edhe më të madhe shtatoren. E akuzuan Enver Hoxhën se ka vrarë kunatin e vet dhe kjo ish një arsye më shumë për ta urrejtur atë dhe për t'ia shembur çdo gjë që kish krijuar ai, kurse Ahmet Zogut, i cili gjithashtu e kish vrarë kunatin e vet, Cenobeg Kryeziun, i ngritën buste e përmendore gjithandej.

ç) QYQARIA E QYQARËVET

Alipashë Tepelena i shfarosi kardhiqotët. I torturoi në lëmin e drizavet në mënyrën më cinike dhe i masakroi. Alipashë Tepelena i shoi, i shpërnguli dhe i zhduku hormovitët. Gratë e Sulit u hodhën nga shkëmbinjtë me gjithë foshnja, për të mos rënë në dorë të Alipashait. Gratë dhe fëmijët e Pargës Alipashai i shiti si skllevër në tregjet e Egjiptit. Megjithatë, ne nuk po themi: Pse shqiptarët po i ngrejnë monumente Alipashait? Ne po themi: Pse duheshin prishur monumentet e Enverit, kur të Alipashait nuk po prisheshin?

Ahmet Zogu i detyroi të syrgjynosen Fan.S.Nolin dhe të gjithë kundështarët. Shumë prej tyre, "***Syrgjyn gjallë e syrgjyn vdekur***." U detyruan të syrgjynosen, sepse, po të qëndronin në Atdhe, Zogu, o do t'i vriste, o do t'i nënshtronte, dmth poshtëronte. Italia u mbush me të arratisur shqiptarë, për shkak të Ahmet Zogut. Italia dhe krejt Evropa.

Unë po përmend këtu vetëm një pjesë fare fare të vogël të atyre personaliteteve shqiptarë që ikën prej Ahmet Zogut pas dhjetorit 1924.

Shumicën i ka përmendur Sejfi Vllamasi, vetëm **në faqen 435** të librit të tij "***Ballafaqime politkë në Shqipëri***". Qazim Koculi, Bahri Omari, Mustafa Kruja, Stavro Vinjau, Riza Dani, Riza Cerova, Xhevat Korça, Kolë Tromara, Qazim Kokoshi, Koço Tasi, Ali Këlcyra, Shefqet Korça, Omer Nishani, Ariz Çami, Sejfulla Malëshova, Rasim Babametoja, Hysni Peja, Qamil Çela, Selim Shpuza, Haki Stërmilli, Llazar Fundoja, Reshat Këlliçi, Sotir Peci, Lano Borshi, Xhelal Preveza, Rexhep Mitrovica, Leonidhë Frashëri, Sheh Ibrahim Karbunara, Dhimitër Bala, Koço Muka, Lekë Margjini, vetë Sejfi Vllamasi.

Ahmet Zogu, sapo erdhi në fuqi në dhjetor të vitit 1924, i burgosi një varg klerikësh katolikë: Dom Ndre Mjedën, Dom Lazër Shantojën, Atë Anton Harapin OFM, Atë Bernardin Palajn OFM, Atë Klement Mirajn OFM. Atë Gjergj Fishta u detyrua të largohet përkohësisht, për t'i shpëtuar arrestimit. Imz. Fan S. Noli mërgoi përjetësisht, për shkak se kish tentuar të vendoste demokraci ndër shqiptarët. (Krs. gazetën ***"Drita"***, janar 2012, f.14). Ahmet Zogu (Jo personalisht me dorë, por me mënyrat që ia jep pushteti secilit pushtetar), vrau këdo që mundi dhe këdo që e pa ai të nevojshme: Canobegun, Avni Rustemin, Bajrambegun, Luigj Gurakuqin, Hasan Prishtinën. Megjithatë, ne nuk po themi, historiografia dhe komentografia e mirëfilltë nuk po thonë: "***Pse po i ngrihen monumente Ahmet Zogut***?" Ne po themi: "***Pse s'po i ngrihen monumente Enver Hoxhës, deri sa po i ngrejmë monumente Ahmet Zogut***?" ***"Pse po ia rrëzojmë ata që i kish dhe pse s'po i ngrejmë të tjerë Enver Hoxhës?"*** Nuk po themi: ***"Pse s'po i ngrejnë zogistët monumente Enver Hoxhës?"*** Atyre nuk u takon t'i ngrejnë monumente Enverit. Atyre u takon t'i ngrejnë monumente Ahmet Zogut dhe le ta bëjnë atë punë sa më mirë e sa më bukur! Natyrisht, nëse gjejnë arsye të mjaftueshme. Por ata që gjithë jetën ishin pro Enver Hoxhës, ata që ishin anëtarë të përkushtuar të partisë së tij, dhe bijtë e tyre, si dhe ajo pjesë jo e vogël e popullit që u bashkua shpirtërisht me regjimin e tij, pse s'po i ngrejnë monumente Enverit? Pse s'po bëjnë muzeume kushtuar atij?

Nëse puna matet me vrasjet, vrasje kanë bërë që të gjithë ose thuajse që të gjithë udhëheqësit dhe sundimtarët botërorë. Ose kanë bërë vrasje, ose kanë qenë shkaktarë të drejtpërdrejtë që, veç armiqvet, me të cilët bënin luftë, të vriten me mijëra bashkatdhetarë të tyre, madje edhe shokë të idealevet, por të devijuar, ose, me mijëra civilë të vendevet, me të cilët ishin në luftë.

Napoleon Bonaparti u bë subjekt, u bë shkak, që u vranë francezë më shumë se ç'do të vriste Hitleri 150 vjet më vonë. Napoleon Bonaparti i veshi në të

zeza qindra mijë nëna franceze, duke mbledhur deri edhe çuna 15-vjeçarë dhe duke i bjerrë nëpër fushat e malet e Evropës, duke ua mbjellë kockat nëpër borën e trashë të Rusisë. Le të mblidhen statistikat dhe le të bëhen krahasime: Sa francezë janë vrarë për shkak të marrëzisë së Napoleon Bonapartit dhe sa francezë janë vrarë për shkak të çmendurisë së Adolf Hitlerit?! E, megjithatë, Napoleoni i ka monumentet anembanë Francës.

Shikoni në Stamboll sa muzeume ka për sulltanët! A mund të gjenden gjëkundi vrasës më mizorë se sulltanët e Perandorisë Osmane, të cilët shquhen, midis tjerash, edhe si vrasës vëllezërish të vet?! Ka sulltanë që akuzohen se kanë vrarë deri 50 vëllezër, nga ata që baballarët e tyre i kishin lindur me gratë e veta të haremevet. Megjithatë, sulltanët, në Turqinë e sotme postsulltanore, i kanë muzeumet dhe monumentet mu në Stamboll, nga më tërheqësit për turistët.

Shkoni në Goli Otok, në Sremska Mitrovicë, në Bileqe, e kudo nëpër ish-burgjet e ish-Jugosllavisë, shfletoni dokumentet dhe shihni: Sa komunistë kanë vdekur në ata burgje, burgosur prej komunistit Josip Broz Tito?! Megjithatë, komunisti Tito nuk është sharë kaq sa po shahet komunisti **ENVER HOXHA**.

Edhe Xhorxh Vashingtoni ka vrarë amerikanë. Merrni statistikat historike dhe shihni sa amerikanë ka vrarë Xhorxh Vashingtoni! Por kryeqyteti i SHBA-së mban emrin e tij dhe askush nuk thotë, nuk qorton askush: ***"Pse ia keni vënë këtij qyteti këtë emër?!"*** Dollarët amerikanë kanë portretin e Xhorxh Vashingtonit (me plot të drejtë). Monumentet i ka nga më impozantët gjithandej. Të gjithë presidentët amerikanë janë bërë shkaktarë të drejtpërdrejtë dhe kanë vrarë, amerikanë dhe joamerikanë, kush më shumë e kush më pak. Le të përmendim vetëm 2 a 3 shembuj. Sa amerikanë u vranë në Vietnam, me urdhër dhe nën komandën kushtetuese të presidentëvet të SHBA-së? Sa amerikanë u vranë në Irak? Sa u vranë e po vriten në Afganistan? Sa janë vrarë, në mesin e shekullit XX, në Kore? Trumani vrau, në 2 sekonda kohë, 250 mijë civilë japonezë, dhe nuk u hodh poshtë prej amerikanëvet. Përkundrazi, u ngrit në piedestal. Madje as vetë japonezët, zyrtarisht dhe shtetërisht, nuk e quajn (Trumanin?) kriminel. Asnjë nga presidentët amerikanë nuk është trajtuar prej amerikanëvet siç po trajtohet **ENVER HOXHA** prej shqiptarëvet.

Ne nuk po themi dhe s'kemi asnjë të drejtë të themi: Pse amerikanët, apo francezët, nuk po i ngrejnë monumente **ENVER HOXHËS**? Ne po themi:

Pse shqiptarët, konkretisht **ajo pjesë e shqiptarëvet që i bënte duart gjak duke e duartrokitur kur ai ishte gjallë**, nuk po marrin shembull prej amerikanëvet dhe prej francezëvet, pse nuk po ndërtojnë muzeume për **ENVER HOXHËN**, pse nuk po i ngrejnë atij monumente? Pse nuk po bëjmë sesione shkencorë kushtuar jetës dhe veprës së Enver Hoxhës? Pse nuk po propozojmë që Enver Hoxhës t'i jepet Çmimi "***Nobel***"?!

Konkluzioni është, se ne shqiptarët nuk jemi aq sa duhet, as të mençur, as burrërorë. Nuk jemi burra, por jemi thjeshtë burrecër, megjithëse na e ka qejfi ta konsiderojmë veten si më të mençurit e Botës dhe si më burrat midis të gjithë burrave që na rrethojnë. Konkluzioni tjetër është, se në Rep. e Shqipërisë, për shkak të paburrërisë e për shkak të qyqarisë sonë, nuk sundon demokracia, por sundon **BIRBOKRACIA**. Birbokratët, në vendin tonë, janë sundimtarët e gjithfuqishëm mbi qyqarët dhe mbi të paburrat, mbi burrecët. Ndryshe nuk do të ndodhte që, për një thes miell, t'ia japim votën cilitdo birboje që do të na e ofronte një të tillë thes, qoftë edhe përgjysmë me krunde!

d) DOEMOS, VRASJET S'JANË TË MIRA

Gjithkush e di që vrasjet s'janë të mira. Por edhe t'u hedhësh njerëzvet hi syvet, s'është mirë. Të vrasësh trurin e njerëzve, të vrasësh, me sajime të gënjeshtërt, trurin e popullit tënd, prapë s'është aspak mirë.

Janë dhënë, për krimet e Kohës së Enverit, një varg shifrash. Është thënë që, në 41 vjet, apo, nëse llogarisim edhe të Luftës (gjë që do të duhej veçuar), në 44 vjet, janë ekzekutuar, prej regjimit të Enver Hoxhës, 5037 burra dhe 457 gra, midis tyre 354 shtetas të huaj, përfshirë edhe 95 kosovarë. Janë dënuar me burg 16788 burra dhe 7367 gra, janë internuar rreth 70 mijë njerëz. Del kështu që regjimi i Enverit ka dënuar me pushkatim diku rreth 120 njerëz në vit, por jo të shtrirë njëtrajtësisht në të gjithë vitet. Dënimet më të shumtë janë dhënë në vitet e parë të diktaturës. Më vonë ka pasur gjithnjë e më pak humbje jetësh njerëzore. Edhe kjo do mbajtur parasysh në analizat që bëjnë historianët.

Komunisti Tito miratoi dhe lejoi në shtetin e tij dhunë shumëfish më të egër se Enver Hoxha, mbi të gjithë kombet, por veçanërisht mbi shqiptarët. Intriga, keqtrajtime, arrestime, tortura, që vetëm kur përmenden rrënqethet njeriu, jo më t'i provojë në trupin e vet, internime, shpërngulje e dëbime me

mijëra, dënime me burgje të rëndë, vrasje të kurdisura, pushkatime, edhe 1 nga 1, edhe në grupe. Le të shikohen dokumentet dhe le të bëhen krahasime! Megjithatë, nuk shkruhet kundër Titos, as në Rep. e Kosovës, as në Rep. e Shqipërisë, as në Rep. Ish-Jug. të Maqedonisë, kaq sa shkruhet kundër Enver Hoxhës. Është e domosdoshme të bëhen analiza realiste: **PSE KA NDODHUR DHE PSE PO NDODH KËSHTU**?

Duke folur keq për Enver Hoxhën, them unë, **NUK ËSHTË QËLLIMI KRYESOR TE ENVERI**. Ai është një person. Ai mund edhe të lihet në heshtje, siç janë lënë psh Titoja apo Teodor Zhivkovi. Por **QËLLIMI ËSHTË QË KOMBI SHQIPTAR TË LIHET PA NJË FIGURË KOMBEATDHEDASHËSE, SIÇ ISHTE FIGURA MADHORE E NJË ENVERI**. Është qëllimi që **TË SFUMOHET ATDHEDASHURIA TE SHQIPTARËT**. Është qëllimi që **TË ÇORIENTOHET KY KOMB**, në mënyrë që të mos mund të ecë në rrugët që t'i dalë zot vetes. Se i kujt është ky qëllim, nuk është vështirë të kuptohet e të dihet. **Ky qëllim buron prej politikavet shoviniste, shqiptarasgjësuese TË SLLAVËVET PRAVOSLLAVË dhe TË GREKËVET.** Por çudia më e madhe është: Pse shqiptarët bien në të tillë kurthe qartësisht antishqiptarë? Ndryshe nga rumunët, ndryshe nga bullgarët, ndryshe nga kroatët, ndryshe nga gjeorgjianët! Shkoni shihni ç'qëndrim kanë gjeorgjianët ndaj J.V.Stalinit! Shkurt thënë, ne jemi "***më të forte***" se të gjithë kombet e tjerë, në aftësinë, në gjenialitetin, për të denigruar vetëveten. Hallall! Na lumtë!

Të gjithë heronjtë, legjendarë apo historikë, të të gjithë kombevet të botës, janë vrasës. Robin Hudi është vrasës! Hamleti është vrasës! (Ka vrarë vrasësin e nënës së vet.) Zhanë d'Ark është vrasëse! Vilhelm Teli është vrasës! Por, që të gjithë, **ADHUROHEN**! Nuk urrehen, por adhurohen dhe kjo ndodh pikërisht sepse ata kanë vrarë në emër të një ideali shumë të lartë. Në kohën e Enverit, shqiptarët, në Republikën e Shqipërisë, nga 1 milion e dyqind mijë, u bën 4 milionë, shkollat u mbushën me fëmijë, fshatrat u mbushën me rini, tokat u zbukuruan si kurrë ndonjëherë, krejt vendi u mbush me industri dhe askush nuk vuante për bukë.
Në 20 vitet e **birbokracisë pasenveriane**, vetëm në vitin 1997, janë vrarë njëri me tjetrin 4000 shqiptarë. Në po këta 20 vjet të **birbokracisë pasenveriane**, përjashtuar 1997-n, u vranë njëri me tjetrin, për çështje prone dhe të tjera çështje "***personale***", rreth 7000 njerëz. Kështu thuhet, por shifrat ekzakte mund të dalin vetëm pasi të jemi çliruar nga tendencioziteti ynë vetëgjymtues. E prapë në po këta vite, në fatkeqësitë rrugore kanë gjetur vdekjen mbi 6000 njerëz, burra, gra, djem të rinj, fëmijë, pleq, e pakta

gjysma e tyre krejtësisht të pafajshëm. Po të mbledhim vetëm këto shifra, del që **birbokracia**, jo me mënyrën e Enverit, por me mënyrën e vet prej **birbokrati** ka çuar në varr rreth 17 mijë (17000) shqiptarë, që i bie rreth 850 njerëz në vit. Janë, pra, shqiptarë të vrarë, të asgjësuar, të "***pushkatuar***" me "***mënyrat***" **birbokratike**, 4 herë më shumë se në kohën e **enverokracisë.** Nuk është njësoj, t'i vrasësh një familjeje 1 djalë dhe 4 djem. Që të dyja janë tragjedi, por e dyta është tragjedi 4 herë më e madhe se e para.

Në statistikat enverofobe vihet në dukje që, në 41 ose në 46 vjet të sundimit të **ENVERIT** janë burgosur 7367 njerëz, pa e vënë në dukje që, në vitet tanë të **birbokracisë**, vetëm në Greqi janë dënuar me burg mbi 10 mijë (10000) shqiptarë, shumica, më shumë se ç'e kishin merituar.

Në statistikat enverofobe, të paraqitura si virgjërisht "***objektive***", në 41 ose 46 vjetët të sundimit të **ENVERIT**, janë numëruar, siç e pamë, rreth 70 mijë (70000) shqiptarë të internuar. Mund të jenë edhe më shumë. Sidoqoftë, nuk është thënë që, në vitet tanë të **birbokracisë**, vetëm përdorues droge ka mbi 40 mijë (40000) dhe se nëpër Evropë përdoren si prostituta mbi 30 mijë (30000) femra shqiptare. Sigurisht që, nën prizmin e analistëvet enverofobë e komunistofobë, mund të jetë e pranueshme dhe "***krejtësisht e natyrshme***" kur njeriu është i lirë të bëjë ç'të dojë me vetëveten: Të marrë drogë, duke i mjeruar veten dhe familjen në mënyrën më sfilitëse të mundshme, ose të prostituojë "***me dëshirën e vet***", nën dajakun e një tutori, sesa të jetojë në një kamp internimi, duke hapur kanale për bujqësinë nën kërbaçin e një polici komunist. Mirëpo, unë (dhe besoj se ka edhe të tjerë si unë), do të pranoja më parë 50 vjet internim në cilindo fshat të Rep. së Shqipërisë, se sa të më drogohet ndonjëri fëmijësh apo të më "***punojë***" si prostitutë ndonjëra vajzash.

Le t'i shtojmë kësaj "***panorame***" edhe 600 "***të punësuarit***" në grumbujt e plehëravet në periferi të Tiranës dhe në kazanët e plehëravet kudo nëpër Tiranë. Në shkallë republike, sigurisht që ka të tillë "***të punësuar***" nja 10 herë më shumë. Cila është, moralisht dhe materialisht, punë më e përballueshme: Të jetosh në Çermë, në Gradishtë, në Seman apo në Llakatund, si i internuar, me një punë e me një rrogë sado të vogël, por të garantuar, apo të gërmosh kanaçe e shishe plastike nëpër plehëra qysh në moshën 4 vjeç deri sa të të vijë vdekja?! Vetëm në një skandal të një shtëpie greke, gjoja fëmijëmbrojtëse, doli që s'dihet ku janë çuar mbi 500 fëmijë shqiptarë. Sapo u lajmërua (viti 2016) që, në Evropën Perendimore, rezultojnë të humbur **10 MIJË FËMIJË**! **25%** e të vrarëvet në Afganistan, gjatë vitit

2015, janë **FËMIJË!** Mos më flisni për këtë lloj **KAPITALIZMI**! Po mundët, ndërtoni ndonjë **KAPITALIZËM** tjetër, në mënyrë që të mund ta miratojnë edhe ata që nuk janë të verbër!

Kjo që parashtrova në këtë kapitull, është vetëm një skicë fare e pjesshme krahasuese midis realitetit të paraqitur **TË ZI** të vitevet të **enverokracisë** dhe realitetit të paraqitur **SHPËTIMTAR** të vitevet të asaj që unë e kam quajtur **birbokraci**. Analistët mirëfilli objektivë, le të bëjnë punën e tyre në vitet e ardhshëm.

Intermexo - Shkrim i ndërfutur në redaktimin përfundimtar:

PSE DUHEJ TË VRITEJ ENVER HOXHA?!

Në gazetën „***Telegraf***“, 24 shtator 2015, në faqen e parë, lexojmë: „***Plani i kryeministrit britanik për vrasjen e Enver Hoxhës,... tentativat në Durrës, Tiranë, Pezë e Sarandë***“

Që ka pasur, jo 1, por disa plane e tentativa për ta vrarë udhëheqësin e Shqipërisë Socialiste, Enver Hoxhën, është tashmë e ditur dhe e njohur prej të gjithë atyre që janë marrë me biografinë e këtij udhëheqësi shqiptar.

Por unë po shtroj, në këtë përvjetor të lindjes së tij, disa pyetje jo pak të rëndësishme dhe që kërkojnë shqyrtim e studim serioz dhe objektiv, qoftë prej historishkruesvet të sotëm, qoftë prej atyre që do të vijnë pas nesh.

Përse donin ta vrisnin Enver Hoxhën?! A kishin të drejtë të huajt ta vrisnin Enver Hoxhën, qoftë morale, qoftë ligjore? Arsye personale, familjare apo edhe grupore, brenda vendit, dihet që ka pasur. Nuk ka udhëheqës shteti në botë që të mos ketë cënuar dikënd, kurse për diktatorët, dihet që, në këtë drejtim, janë më të akuzueshmit. Por fjala është për arsye HISTORIKISHT OBJEKTIVE. A ka pasur arsye HISTORIKISHT OBJEKTIVE për të kurdisur kaq atentate për këtë njeri?! Aq më tepër, kur marrim vesh që, një kryeministër i një vendi DEMOKRATIK perendimor, e paska miratuar personalisht një plan për të vrarë udhëheqësin legjitim të një shteti sovran, qoftë ai edhe diktator.

Këtu ka shumë hapësirë për të diskutuar, por unë po marr tash vetëm njërin prej aspektevet të veprimtarisë së Enver Hoxhës, atë **TË BUJQËSISË E BLEGTORISË**, dhe po shtroj pyetjen përkatëse shoqëruese: ***A PËR KËTË***

GJË DUHEJ VRARË ENVER HOXHA?! Njerëzit, sigurisht, duhet të bëjnë edhe krahasimet midis **ASAJ** bujqësie e blegtorie në kohën e Enver Hoxhës dhe **KËSAJ** bujqësie e blegtorie pas vdekjes së Enver Hoxhës dhe pas zvarritjes së tij nëpër Sheshin "***Skënderbej***". Kush do të duhej vrarë në këtë rast, ai apo këta që erdhën pas tij?! Dhe, a keni dëgjuar që dikush në Perendim të ketë bërë plane për të vrarë ndonjërin prej këtyre që i shkatërruan, bujqësinë dhe industrinë, në Republikën e Shqipërisë? Përkundrazi, mund të kemi dëgjuar që dikush ka paguar për t'i vrarë, bashkë me Enver Hoxhën, edhe bujqësinë, edhe industrinë e këtij vendi.

***

Nga viti 1945 e deri në prag të vdekjes, më 1985, Enver Hoxha ka folur për **BUJQËSINË E BLEGTORINË** më shumë se 300 herë. Nuk po them, ***I KA PËRMENDUR***, por ***KA FOLUR GJËRË GJATË*** për këtë degë të ekonomisë dhe është marrë intensivisht me këtë punë, duke u përpjekur, mbështetur në teorinë marksiste-leniniste dhe në praktikën e Leninit dhe atë të Stalinit, për ta përparuar sa më shumë këtë degë të ekonomisë. Duhet theksuar këtu me shumë forcë, që, në krejt këto përpjekje, vetë Enveri, personalisht apo familjarisht, **NUK KISH PËR QËLLIM TË FITONTE ASGJË PËR VETE**. Enveri nuk ka qenë as pronar tokash, as feudal, as latifondist.

Nëse shikohet në aspektin klasor, mund të thuhet që Enver Hoxha, duke u përpjekur që t'i përparonte bujqësinë e blegtorinë, mbronte interesat e fshatarësisë dhe të krejt masavet punonjëse të shtetit të vet.

Më 25 nëntor 1945, në fshatin Gore të Lushnjës, Enver Hoxha demonstron pajisjen e fshatarëvet me tapi. Fillon ashtu **REFORMA AGRARE**, e cila do t'i shpronësonte feudalët dhe do t'u jepte tokat fshatarëvet.

3 janë fjalitë që do të duhej t'i rikujtonim sot, mbas 70 vjetësh: 1." ***Mbi kurrizin tonë shkelnin çizmet e gjakosura… të bejlerëvet feudalë.***" (Vep.3,f.191) 2."***Ju duhet të dini…se fati juaj është i lidhur ngushtë me fatin e këtij pushteti.***" (f.194). 3."***Rrëzimi i lëtij pushteti do të ishte skllavërim për popullin tonë***." (f.194).

Tani, që është rrëzuar ai pushtet, ne na intereson veçanërisht fjalia e tretë: A u riskllavëruan fshatarët e këtij vendi? Fjala është për ata fshatarë që i shohim thuajse përnatë në emisionin "***Shqipëria tjetër***" dhe për qindra mijë

të tjerë, të cilët i shohim, që nga varrezat tona mbushur me djem të rinj e deri te burgjet e Greqisë, Italisë, Zvicrës dhe Francës.

Më 1 tetor, në fshatin Drashovicë të Vlorës, Enveri ka thënë: "***Populli mori fuqinë në dorë, ua mori edhe tokën atyre që vite me radhë shfrytëzonin djersën tuaj dhe qeveria ua dha fshatarëvet***." (Vep.3, f.213). Tani, studiuesit duhet të shkojnë në Drashovicë dhe në 1000 katunde të tjerë të Republikës së Shqipërisë, dhe të shikojnë: Si është gjendja e fshatarëvet pas vdekjes së Enver Hoxhës? Si është gjendja, edhe e atyre fshatarëvet që kanë mbetur e vazhdojnë të jetojnë në ata fshatra, por edhe e atyre që janë shpërngulur prej andej?

Më 9 nëntor 1947 përfundon kanali ujitës "***Naum Panxhi***". Enveri shkon në përurimin e tij dhe mban atje fjalimin e rastit. Sot është e udhës të vizitohet me kamera televizive **GJITHË RRJETI UJITËS**, i ndërtuar në kohën e Enver Hoxhës, dhe të bëhen konkluzione.

Më 12 tetor, Enveri përuron fazën e parë të tharjes së Kënetës së Maliqit. 2 janë objektet që duhen studiuar sot në zonën e Maliqit: Cila është gjendja e Kënetës dhe e fshatarëvet që rrojnë aty, dhe ç'është bërë me Fabrikën e Sheqerit në Maliq pas vdekjes së Enverit?

Më 8 nëntor 1948, në Kongresin I të PKSH-së, Enver Hoxha ua kushton, **BUJQËSISË, BLEGTORISË DHE PYJEVET 74 FAQE**. Bën analizë të hollësishme, me shifra e me pasqyra statistikore. Unë po sjell këtu vetëm njërën prej atyre statistikave. Para reformës agrare, në Republikën Popullore të Shqipërisë kishte 7 familje latifondistësh me mbi 14 mijë hektarë tokë, kish gati 5 mijë familje pronarësh të mëdhenj me afër 100 mijë hektarë tokë, pronarë të vegjël e të mesëm kish afër 130 mijë familje dhe fshatarë pa tokë kish mbi 21 mijë familje.
Reforma agrare ua kish marrë tokat pronarëvet të mëdhenj dhe ua kish pjesëtuar fshatarëvet simbas një kriteri të përcaktuar me ligj. Më vonë do të bëhej **KOLEKTIVIZIMI**, por pa e shpronësuar masën e fshatarëvet. Të shpronësuar duhen konsideruar vetëm pronarët e mëdhenj.

Si pasojë e kësaj reforme, në vitin 1948, toka shfrytëzohej në mënyrën më optimale të mundshme për atë kohë. Pra, jo në mënyrë absolutisht optimale, por në mënyrë relativisht optimale.

Pyetjet që shtrohen tash, janë këto: A bëri mirë Enver Hoxha që e kreu reformën agrare, apo bëri keq? Mbas vitit 1990, a duhej t'u ktheheshin 7 familjevet latifondiste të 14 mijë hektarët dhe a duhej t'u ktheheshin të 5 mijë pronarëvet të mëdhenj të 100 mijë hektarët? A mund të quhet ***DEMOKRACI***, pushtet i demosit, pushtet i popullit, krijimi dhe favorizimi i një klase latifondistësh, qoftë të vjetër, qoftë të re? A duhej të planifikonte Perendimi një vrasje të Enver Hoxhës apo një rrëzim të pushtetit të tij, sepse ai kish kryer një reformë agrare në vendin e vet? Aq më tepër, kur të gjithë regjimet në shtetet perendimorë e quajnë veten ***DEMOKRATIKË****, regjime të demosit*?

Më 15 shkurt 1949 Enver Hoxha mban fjalim në Kongresin e Parë të Kooperativavet Bujqësore. Në 25 faqe të fjalimit të tij, ai e ka arsyetuar gjërë e gjatë, pse dhe si po krijoheshin dhe pse dhe si duheshin krijuar **KOOOPERATIVAT BUJQËSORE**.

Më 16 mars, Enveri prapë ka folur për problemet e fshatit.

Në vitin 1950, më 2 shkurt, më 29 mars, më 27 tetor, më 15 dhjetor dhe në të gjithë rastet e tjerë, përpjekjet e tija ishin, për ta **PËRMIRËSUAR** gjendjen ekonomike të fshatarëvet.

Në vitin 1951, vazhdon po ajo përpjekje. Enveri flet për bujqësinë, më 16 shkurt, më 21 maj, më 17 gusht dhe më 31 tetor. Në Maliq tashmë është vënë në punë fabrika e sheqerit. Enveri e vlerëson këtë vepër si një ndër fitoret më të mëdha të atyre viteve.

Viti 1952. Më 25 janar, më 31 mars (Kongresi II i PPSH-së), më 5 maj, më 6 qershor, më 17 qershor, më 12 nëntor, Enveri merret shumë seriozisht, krahas shumë problemevet të tjerë, edhe me problemet e bujqësisë. Më 8 dhjetor ai mban një fjalim plot me shqetësime në Ndërmarrjen Bujqësore të Sukthit.

Më 21 prill 1953, mbahet Kongresi II i Kooperativavet Bujqësore dhe Enveri vazhdon gjatë gjithë atij viti të interesohet dhe të japë udhëzime, me të vetmin qëllim që jeta e fshatarëvet të **PËRMIRËSOHET** sa më shumë.

Edhe viti 1954 është plot me veprimtari partiake, shtetërore e organizative, në mënyrë që edhe popullsia rurale shqiptare, ashtu si ajo urbane, (të paktën brenda RPSH-së) të ketë një jetë sa më të mirë. Ai flet për këta probleme, më 21 shkurt, më 6 mars, më 27 mars, në Konferencën e Parë Kombëtare të NBSH-vet (të ndërmarrjevet bujqësore shtetërore). Më 7 shtator flet për kultivimin e pambukut, më 21 shtator flet në lidhje me çmimet e prodhimevet bujqësorë e blegtoralë, pastaj prapë më 13 tetor, më 29 tetor dhe më 7 dhjetor, gjithnjë **PËR BUJQËSINË E BLEGTORINË**. Në këtë të fundit, më 7 dhjetor, jep orientime mbi organizimin e mekanikës bujqësore.

Në të gjithë këtë veprimtari të papushimtë të Enver Hoxhës, **PËR TA BËRË JETËN E QINDRA MIJË FSHATARËVE SA MË TË MIRË**, unë nuk shoh asnjë arsye të shëndoshë për ta vrarë këtë njeri. Përkundrazi, shoh shumë arsye për ta nderuar ndërkombëtarisht.

Më 3 gusht 1956, Enver Hoxha angazhohet në përmirësimin e udhëheqjes së partisë së tij në sektorin shtetëror të bujqësisë. Më 25 maj, në Kongresin III të PPSH-së, mirëqenies materiale të fshatarëvet i kushton plot 42 faqe analiza të hollësishme mbi prodhimin e drithëravet, mbi ngritjen e mëtejshme të blegtorisë, mbi kolektivizimin e bujqësisë, mbi mekanizimin e punëvet në bujqësi, mbi ndërmarrjet shtetërore të bujqësisë dhe mbi metodat e drejtimit të punëvet në bujqësi.

Pse duhej vrarë ky njeri dhe pse i duhej zvarritur shtatorja nëpër Sheshin "***Skënderbej***"?!

Më 1 maj 1957, Enver Hoxha u shkruan letër komitetevet të Partisë në Vlorë e në Bilisht me rastin e përfundimit në ata rrethe të **KOLEKTIVIZIMIT**. Më 15 maj, më 27 maj, më 2 qershor, më 18 qershor, më 2 nëntor dhe krejt viti 1957, është plot me angazhimin e Enver Hoxhës, me qëllim që punët në **BUJQËSI E BLEGTORI** të shkojnë sa më mirë. Ai shqetësohet deri edhe për ngordhjen e 20 deshvet në Lushnjë dhe ky shqetësim i tiji, pse ngordhën 20 desh nga pakujdesia e dikujt atje, nuk përbën kurrfarë krimi, as kombëtar, as ndërkombëtar. Meqë jemi në Lushnjë, mund të thotë dikush që "***në atë rreth ndodheshin me qindra njerëz të internuar dhe Enveri mund të shqetësohej për deshtë, por për ata të internuar as që i bëhej vonë***". Nuk është e vërtetë që Enveri nuk

shqetësohej, edhe për të internuarit, edhe për të burgosurit. Për këtë ka (ose ka pasur) me mijëra dokumente. Mjafton të përmendim vetëm 1 fakt: Të gjitha letrat që dërgoheshin në adresën e tij prej të burgosurvet, i lexonte më parë vetë ai dhe pastaj mund t'i jepeshin dikujt tjetër prej zyrtarëvet, me shënimet përkatës, shënime që, në shumicën e rastevet, shprehnin përkrahje ndaj letëshkruesit.

Në vitin 1958, kemi plot 17 a 18 analiza e udhëzime të Enver Hoxhës, që lidhen e bëjnë fjalë për fatin e popullsisë fshatare në RPSH: Më 18 janar, më 25 shkurt, më 28 shkurt, më 1 mars, më 2 mars, më 4 mars, më 23 mars, më 23 prill, më 26 prill, më 26 shtator, më 4 tetor, më 5 tetor, më 3 nëntor dhe më 11 dhjetor. Le t'i lexojnë njerëzit dhe le të na thonë: A ka aty ndonjë arsye për ta shpallur tjerin kriminel, në mënyrë arbitrare, pa asnjë gjykim, as kombëtar, as ndërkombëtar?!

Viti 1959 vazhdon me të njëjtin preokupim të Enver Hoxhës: Të përmirësohet, me punë dhe me organizim, jeta e krejt popullit e veçanërisht jeta e popullsisë fshatare, e cila objektivisht i kish kushtet më të vështirë se ajo e qytetit: 16 shkurt, 21 prill, 22 prill, 5 maj, 18 maj, 19 qershor, 21 qershor, 21 tetor, 24 tetor.

Vjen viti 1960. Do të kalojnë edhe 25 vjet deri sa Enver Hoxha të vdesë. Kundërshtarët e tij shqetësohen. Kundërshtarët e tij kërkojnë argumente për ta akuzuar, bëjnë plane për ta asgjësuar dhe për të përmbysur pushtetin e tij. Por brezat që do të vijnë, do të pyesin: A kishin të dejtë?! Ata që donin ta mposhtnin Enver Hoxhën, a kishin hallin e Shqipërisë, apo kishin ndonjë hall tjetër?! Do të vijë viti 1990 dhe do ta shohim ku do ta çojnë Shqipërinë kundërshtarët e Enver Hoxhës. Në vitin 1960, Enveri flet për **BUJQËSINË E BLEGTORINË**, më 15 janar, më 2 shkurt, më 6 prill, më 18 prill, më 2 qershor, më 3 qershor, më 14 qershor. Asnjeri nga fjalimet apo analizat e tija nuk përbëjnë shkelje të kodit penal dhe nuk ka asnjë mbështetje ligjore që dikush të kërkojë për ta vrarë autorin e atyre fjalimeve dhe analizave.

Hyjmë në vitin 1961. Zhvillon punimet Kongresi IV i PPSH-së, më 13 shkurt, dhe Enveri lexon aty raportin e vet. 8 faqe ua kushton rezultatevet të deriatëhershëm në fushën e **BUJQËSISË E BLEGTORISË**, pa harruar asnjëherë të flasë edhe për pyjet, dhe 7 faqe ia kushton zhvillimit të mëtejshëm të këtyre degëve të ekonomisë. Më 28 mars merr në shqyrtim

zonat e thella malore të RPSH-së. Më 14 qershor gjendet në fshatrat, Ndroq, Petrelë, Vaqarr, Bërzhitë. Më 19 qershor flet për specialistët e bujqësisë, më 25 tetor porosit që kooperativat bujqësore ta forcojnë nivelin e jetesës së fshatarëvet e jo ta dobësojnë dhe më 19 nëntor, në një miting në Himarë, premton që "***Bregdeti Shqiptar do të kthehet në një kopsht të lulëzuar***". Nuk pushon kurrë së kujdesuri për të shtuar ushqimin e popullit të vet, në një kohë kur për vete kënaqej me një pjatë trahana në mëngjes.

Në vitin 1962, Enveri ka folur për **BUJQËSINË E BLEGTORINË**, midis tjerash, edhe në këto data: 19 janar, 18 shkurt, 3 maj, 18 shtator, 19 shtator, 19 tetor, 28 tetor dhe 17 dhjetor. Më vjen çudi: Pse nuk shkruajnë njerëzit, qoftë biografë, qoftë gazetarë, autorë artikujsh të shkëputur, për këtë aspekt të veprës së Enver Hoxhës, por merren me ca aspekte krejt anësorë e joesencialë të jetës së tij?

Në vitin1963, më 22 janar, Enveri do të kërkojë që të futet kultura socialiste në çdo familje të fshatit tonë. Nuk do të kërkojë që të përdoret droga, nuk do të kërkojë që të kultivohet droga, nuk do të kërkojë që të tregtohet droga. Përse duhej rrëzuar qeveria e tij?!

Më 11 shkurt, në Bishqethëm të Lushnjës, do të mbajë një fjalim, ku, midis tjerash, do të thotë: "***Mendja dhe dora e njerëzvet tanë do ta bëjnë Fushën e Myzeqesë edhe më të bukur e më pjellore***." Po atë ditë, Enveri do të japë orientime lidhur me rolin e traktoristëvet në ambientet fshatarë, si dhe mbi rëndësinë e madhe të eksperimentevet në fushën e prodhimit bujqësor. Më 10 maj Enver Hoxha tërheq vëmendjen mbi të metat që ishin vënë re në blegtori. Më 6 qershor ka folur për gjendjen ekonomike, sociale e kulturore të fshatit. Më 13 shtator, mbi artizanatin në fshat. Më 16 shtator, në një takim me kuadrot e kooperativavet bujqësore të Beratit, kërkon intensifikimin dhe modernizimin e bujqësisë. Më 4 tetor shtron nevojën e grumbullimit dhe përdorimit në bujqësi të plehut të bagëtivet. Më 5 tetor flet prapë për mekanikën bujqësore. Më 21 tetor, me shumë seriozitet e largpamësi, por edhe me një brengë të pashprehur, i kërkon popullit shqiptar që të mos i mungojnë kurrë buka dhe fishekët. Buka, për të jetuar pa ia shtrirë dorën kujt, fishekët, për të mbrojtur atdheun pa kërkuar prej të tjerëvet që të na mbrojnë. Kuptohet, fjalët ***BUKË DHE FISHEKË***, janë metonimi. Më 26 tetor Enveri flet për blegtorët, të cilët duhet ta duan dhe të kenë pasion për profesionin e vet. Nuk shohim në asnjë vend që Enver Hoxha t'i këshillojë shtetasit e vet për t'i shkatërruar bujqësinë e blegtorinë.

Një e tillë inondatë, sigurisht e kurdisur, ka për të ndodhur vetëm pas vitit 1990, 5 vjet mbasi Enveri të ketë vdekur dhe fill pasi shtatoret e tija të jenë rrëzuar. U kuptua qartë që, planifikuesit dhe përgatitësit e atentatevet, kishin për qëllim të rrëzonin e të shkatërronin, jo thjeshtë personin, por **KOMBIN** të cilit ai i përkiste.

Në vitin 1964, Enver Hoxha merret përsëri gjërësisht, veç tjerash, edhe me problemet e bujqësisë, blegtorisë dhe në përgjithësi me jetën rurale të vendit të vet: 2 maj, 19 qershor, 20 qershor, 29 qershor, 15 shtator, 16 shtator, 2 tetor. E shohim në Shkodër, në Kooperativën Bujqësore "***Perlat Rexhepi***", në Bërdicë dhe, kudo që shkon, kërkesa e tij më kryesore është ngritja e nivelit të jetesës të fshatarësisë punonjëse.

Më 1965, Enveri flet për bujqësinë e për fshatin, më 23 janar, më 16 qershor, më 25 qershor, më 15 tetor, më 23 nëntor. Po i vë në dukje datat, sepse ç'nuk është thënë për atë njeri, ndërsa për jetën e tij **TË VËRTETË**, që të gjithë kanë heshtur. Përse është heshtur për punët e tija serioze dhe pozitive me vlera të mëdha shtetndërtuese dhe kombzhvilluese?!

Në vitin 1966 e shohim Enver Hoxhën në Divjakë, më 7 mars, në Kooperativën bujqësore "***Stalin***" të Krutjes, më 8 mars, pastaj, më 1 qershor, në kooperativën bujqësore të Shalësit, rrethi i Elbasanit dhe më 20 shtator prapë në Elbasan në kooperativën bujqësore të Shmilit.

Më 1 nëntor, në Kongresin V të PPSH-së, Enver Hoxha, veç pjesëvet të tjera ku flitet për fshatin dhe jetën e fshatarëvet, u kushton problemevet të bujqësisë, si përherë, edhe një kapitull të veçantë, prej 11 faqesh.

Viti 1967. Më 18 shkurt Enveri vjen në një kooperativë bujqësore të Shijakut. Më 24 shkurt flet për kooperativat bujqësore në zonat malore. Pas 1 muaji, më 24 mars, ai gjendet në Krujë, ku prapë trajton problemin e forcimit të kooperativavet bujqësore në zonat e thella malore. Më 25 mars mban fjalim në Kooperativën Bujqësore "***Partizani***" në Fushë-Krujë. Më 22 maj bisedon me bariun e dhivet Lezan Pisli. Më 27 maj flet për modernizimin e bujqësisë. Më 10 qershor dhe më 30 qershor, shtron për zgjidhje probleme të rëndësishëm të bujqësisë. Më 2 shtator e shohim në Rapshë të Këlmendit, ku pohon se vetëm duke luftuar traditën prapambetëse, mund të lulëzojë Malësia jonë. Më 4 shtator shkon në Troshan të Lezhës. Më

3 nëntor është në Shtërmen e Gostimë të Elbasanit. Më 10 nëntor flet për problemet e blegtorisë.

Asnjëherë nuk e shohim Enver Hoxhën të thur plane apo të tentojë për të vrarë ndonjë personalitet apo drejtues shteti të ndonjë vendi të botës. Flet kundër armiqvet e kundërshtarëvet, boton artikuj demaskues, por asnjëherë nuk i hyn aventurës për të vepruar apo për të komplotuar. Pse duhej të planifikonin të tjerët likuidimin e tij, në një kohë kur ai po merrej me hallet dhe problemet e vendit të vet?!

Në vitin 1968, më 10 janar, sërish merret me ngritjen e nivelit të jetesës në zonat e thella malore. Më 27 maj bisedon me punëtorët dhe me kooperativistët e Rubikut. Më 28 maj shkon në Përlat të Mirditës dhe shtron kërkesën që, për punët e bujqësisë, duhet të mendojnë të gjithë. Më 29 qershor Enver Hoxhën e gjejmë në Grecalli të Fierit, më 1 korrik në Kooperativën Bujqësore „***Shkurte Pal Vata***“ të Lushnjës. Për bujqësinë flet edhe më 19 shtator, si dhe më 16 tetor, në ditëlindjen e vet.

Viti 1969 është prapë plot me preokupime të Enver Hoxhës në lidhje me **BUJQËSINË**. Më 23 janar i shkruan letër Alo Qoses në Sojnik të Gramshit, më 26 shkurt bisedon me punëtorë, kooperativistë dhe kuadro të Beratit, më 27 shkurt gjendet në një darkë në Kooperativën Bujqësore “***8Nëntori***” të Kutallisë në rrethin e Beratit, më 3 mars, lëvizjen e disa grupeve fshatarësh nga Veriu në Jug e nga Jugu në Veri, e sheh si një nga mënyrat e afrimit shpirtëror midis krahinavet, ndërsa më 4 mars jep udhëzime që krahas industrisë të zhvillohet edhe **BUJQËSIA**. Më 6 prill shkon në fshatin Ninësh të Mallakastrës, për shkak se atje kish rënë tërmet, dhe po atë ditë ndalet edhe në Hekal. Më 5 maj flet për objektet social-kulturorë në fshat dhe më 6 maj flet për mekanizimin e punëvet në bujqësi. Më 27 maj është në Picar të Gjirokastrës, ndërsa të nesërmen, më 28 maj, mban fjalim në një miting në Libohovë. Më 22 shtator, në një letër që u shkruan kooperativistëvet të Lepushës në Këlmend, thotë se Malësia mund të prodhojë më shumë qumësht, mish, djathë dhe gjalp. Nuk thotë që Malësia mund të prodhojë kanabis sativa dhe, o burra, se po e kërkon Evropa. Në fshatrat Izvor e Rabie të Tepelenës, pas një tërmeti shkatërrues, janë ndërtuar shtëpi të reja, krejt falas, me punë vullnetare dhe duke e siguruar shteti të gjithë materialin e nevojshëm. Enveri, më 16 tetor, ka pritur në shtëpinë e vet një delegacion të atyre 2 fshatrave dhe ua ka uruar shtëpitë e reja. Më bën pështypje një fjali e tija: ***Kur të plakemi ne edhe ca më shumë, të rinjtë***

kanë për të na thënë: "Vërtet mirë keni punuar dhe keni ndërtuar ju, po ne tani do t'i bëjmë fshatrat tanë akoma më të bukur". (Vep.42,f.20) Do të ish mirë të bëhej një reportazh mbi gjendjen e sotme të fshatravet Izvor e Rabije. Ku gjenden sot banorët e atyre fshatrave? Sa për qind e banorëvet vazhdojnë të jetojnë aty? Sa prej tyre kanë ndrërtuar shtëpi të reja, më të bukura se ato të mëparshmet, e sa nuk kanë mundur t'i mirëmbajnë as ato që iu patën ndërtuar të reja në kohën e Enverit?

Vjen viti 1970. Më 11 mars Enveri bisedon me kooperativistët e Luzit të Vogël në rrethin e Kavajës dhe mban një fjalim në mitingun e organizuar me atë rast. Më 20 mars flet për forcimin e organizimit të punës në kooperativat bujqësore të zmadhuara. Më 29 maj, takim me punonjësit e Hasit e të Krumës, më 31 maj me kooperativstët e Dragobisë, më 2 qershor miting në Pukë, më 27 gusht miting në Kooperativën Bujqësore të Bashkuar „***Skënderbeu***" të Devollit, të nesërmen, më 28 gusht, në ndërmarrjen bujqësore shtetërore të Dvoranit. Më 2 tetor diskuton lidhur me varësinë e rritjes së prodhimit bujqësor nga transporti. Më 16 tetor pret një grup kooperativistësh të rrethit të Tiranës. Më 23 nëntor shtron idetë mbi një fazë ndërmjetëse të kalimit nga kooperativa bujqësore në ndërmarrje shtetërore bujqësore.

Fillon viti 1971, Enveri, më 5 maj, ngre shqetësimin dhe thotë: "***Pa organizim e disiplinë nuk mund të kemi bujqësi moderne***." Prapë, më 14 janar, trajton të njëjtën çështje dhe, më 18 të po atij muaji, kërkon që t'i kushtohet më shumë rëndësi zhvillimit të **BLEGTORISË**. Më 20 janar shtron dhe analizon çështjen e sigurimevet shoqërorë edhe të kooperativistëvet, siç veprohej me punëtorët e nëpunësit shtetërorë. Më 1 shkurt kërkon të bëhet më shumë kujdes për furnizimin e fshatarësisë. Në datat 13 shkurt, 26 shkurt, 23 mars dhe 16 prill, Enveri pa pushim merret me problemet që kishte **BUJQËSIA**, për të vazhduar pastaj, me të njëjtin preokupim më 17 maj, më 18 maj dhe më 26 maj. Më 29 nëntor shkon në Institutin e Projektimevet dhe flet për problemin e ujitjes. Më 13 dhjetor jep orientime për kultivimin e pambukut.

Më 12 prill 1972, flet mbi planin e grumbullimit të tepricavet dhe thotë që ky lloj plani nuk përbën detyrim. Më 20 qershor diskuton për modernizimin e bujqësisë dhe më 30 tetor, ekzistencën e kooperativavet të tipit të lartë e kushtëzon edhe me rendimentin e lartë në bujqësi.

1973-shin, më 11 janar, e fillon me kërkesën që në **BUJQËSI** duhet të ketë njerëz të kualifikuar. Më 22 janar i këshillon organet partiakë e shtetërorë që të mos nguten, por të bëjnë studime në lidhje me shndërrimin e kooperativavet bujqësore në ndërmarrje shtetërore. Më 28 mars kërkon të mos ketë konservatorizëm në futjen e mekanizimevet në punët bujqësore. Më 17 maj, në ndërmarrjen bujqësore të Elbasanit, vë në dukje që të rinjtë janë e ardhshmja e atdheut. Më 13 qershor Enveri shkon mysafir te kooperativisti Sulo Muço në Koplik. Më 16 tetor bën për kushedi të satën herë thirrje për forcimin e koopertaivavet bujqësore.

Më 10 maj 1974 Enveri flet prapë për kooperativat e tipit të lartë. Më 25 qershor tërheq vëmendjen te përparimi që duhej realizuar në zonat kodrinore e malore.

Më 3 mars 1975 Enver Hoxha, sigurisht, tashmë i shqetësuar, kërkon që fshati të ndihmohet efektivisht për mbrojtjen e shëndetit të nënës dhe të fëmijës. Më 22 mars u çon letër të rinjvet të Kooperativës Bujqësore „***Enver Hoxha***“ të Bujanit. Më 24 prill flet për të quajturit oborre të kooperativistëvet, një copë tokë dhe disa bagëti që u ishin lejuar fshatarëvet për të plotësuar disa nga nevojat e veta.

Në vitin 1976, më 26 prill, flet prapë për sigurimet shoqërorë që duhet të aplikohen edhe në fshat, veçanërisht në funksion të kujdesit për nënat me fëmijë të vegjël. Më 28 prill Enveri bën vërejtjen: „***Pa një kthesë në kokën e njerëzvet, nuk bëhet dot kthesa në prodhimin e ullirit***.“ Dhe prapë më 23 qershor flet për ullirin. Shihet që sa vjen e i shtohet shqetësimi. Ëndrra e madhe, por njerëzit të vegjël. Më 25 qershor ngre edhe njëherë çështjen e mekanizimit të bujqësisë, më 3 shtator flet për farërat, ndaj të cilavet duhet të tregohet kujdes i veçantë, më 1 tetor Enveri thotë që tregtia duhet ta inkurajojë e jo ta pengojë prodhimin bujqësor, më 4 tetor thotë: „***Po të shqetësohesh për furnizimin e kooperativistëvet, e gjen rrugëzgjidhjen***“. Më 1 nëntor, në Kongresin VII të PPSH-së, tregohen të arriturat në bujqësi dhe jepen orientime për zhvillim të mëtejshëm, duke u mbështetur në forcat e veta. Shqipëria, o do të mbështetej në forcat e veta, o do t’i dorëzohej konkurencës së vendevet të zhvilluar kapitalistë. Pas vitit 1990 u hoq dorë nga parimi i të mbështeturit në forcat e veta dhe u mbetet sociologëvet dhe

ekonomistëvet për të bërë krahasimet **SHIFRORË** midis 2 kohëvet. Midis kohës 10 vjet para se të vdesë Enveri dhe kohës 30 vjet pas vdekjes së tij.

Më 22 dhjetor Enveri flet për **TUFËZIMIN E BAGËTIVET**. Në të vërtetë, ai ka qenë një eksperiment i gabuar. Në këtë bisedë, Enveri kërkon të informohet për të gjitha hollësitë që lidhen me këtë lloj kolektivizimi brenda kolektivizimit.

Në vitin 1977, 28 janar, Enveri prapë tërheq vëmendjen që „***të ardhurat e kooperativës shtohen duke rritur prodhimin***". Por kujt t'i thuash?! Më 3 shkurt flet për **KOOPERATIVAT E TIPIT TË LARTË**. Duhet thënë që edhe ky ishte një eksperiment i gabuar dhe, në të gjitha analizat e tija, shihet që Enveri ishte i shqetësuar, në mos i alarmuar, sado që ai gjithmonë ka ditur t'i fshehë shqetësimin apo alarmin e brendshëm. Një udhëheqësi nuk duhet t'i lexohet në fytyrë ç'i zien përbrenda. Më 21 shkurt trajton sërish **BLEGRORINË E BUJQËSINË**, duke kërkuar që të 2-ja këto degë të vlerësohen njëlloj. Më 23 mars ka takim me kooperativistët e rrethit të Vlorës. Më 1 qershor, në takimin me sekretarët e Komitetit Qendror të PPSH-së, thekson me këmbëngulje, si përherë: „***Niveli i jetesës së kooperativistëvet ngrihet duke punuar më shumë***". Por kujt t'i thuash?! Më 21 shtator ai shtron kërkesën e forcimit të mëtejshëm të ndërmarrjevet bujqësore shtetërore.

Më 15 mars 1978, Enver Hoxha ka shkuar në Tepelenë dhe u jep porosi të veçantë kuadrovet të atij rrethi që **BLEGTORINË** ta kenë në qendër të vëmendjes. Më 20 mars mban një fjalim në Ksamil të Sarandës, me ç'rast i bën thirrje veçanërisht brezit të ri: „***Sa më pjellore t'i bëjmë fushat e malet tanë, aq më e fortë do të bëhet Shqipëria***". Më 28 mars gjendet në Lukovë të Sarandës, ku rinia kish hapur brezare për agrume e ullinj. Ato brezare ishin një mrekulli botërore dhe Enveri jep mendimin se aty mund të merren mesatarisht 50 kg ullinj për çdo rrënjë. Në ullinj të veçantë ata kishin arritur të merrnin përmbi 100 kg. Më 5 qershor shtron edhe njëherë domosdonë e bashkëveprimit midis **BUJQËSISË DHE BLEGTORISË**. Ai ngul këmbë në idenë e tij faktikisht të parrëzueshme, se blegtoria nuk mund të ecë pa bujqësinë dhe e ka fjalën për rrethin e Tepelenës, ku degë kryesore është blegtoria. Më 11 gusht e shohim Enver Hoxhën duke mbajtur shënime lidhur me bujqësinë dhe blegtorinë. Është vetëm, në zyrën e vet, por mendjen e ka atje ku prodhohen drithërat, mishi dhe qumështi. Më 28 gusht u thotë, midis

tjerash, sekretarëvet të Komitetit Qendror: „***Bujqësia kërkon punë të kujdesshme shkencore dhe organizative***.“ Por, kujt t'i thuash?!

10 dhjetor 1980. Enver Hoxha bisedon me sekretarët e Komitetit Qendror mbi mënyrat e të shpërblyerit të kooperativistëvet në kohën kur kooperativat bujqësore përgatiten për t'u shndërruar në ndërmarrje bijqësore shtetërore, sepse perspektiva ishte që edhe bujqësia, si industria, të shndërrohej e tëra në pronë shtetërore, që do të thoshte, në pronë të të gjithë popullit.

***

Enver Hoxha e udhëhoqi për 40 vjet Republikën e Shqipërisë (RPSH e më vonë RPSSH). Veprimtaria e tij ka qenë e gjithanëshme, por unë nuk mora këtu as industrinë, as tregtinë, as shëndetësinë, as arsimin, as ushtrinë, as organizimin e të quajturavet leva të Partisë (të PPSH-së) dhe as politikën e tij të jashtme, e cila, në të gjitha kohët, ka qenë dhe është tepër e vështirë për udhëheqësit shqiptarë. E gjithë kjo ka qenë një punë kolosale e Enver Hoxhës dhe historiografia nuk ka arsye të mos merret në mënyrë të hollësishme me analizën shkencore të krejt asaj pune.

Por unë mora këtu vetëm **BUJQËSINË DHE BLEGTORINË**, një vështrim krejt panoramik dhe ndoshta edhe monoton, në mënyrë që secili lexues të mund të krijojë sadokudo një ide të qartë **VETËM PËR NJËRËN NGA FUSHAT E PUNËS SË TIJ**.

Në ata 40 vjet RPSSH, nën udhëheqjen e Enver Hoxhës, arriti t'i ngjajë vërtet një kopshti me lule. Të huajt mahniteshin kur i shikonin tokat e këtij shteti aq bukur të sistemuara, të pacopëzuara, pa gjerdhe e pa thurje me ferra, me kanalizime dhe, që të gjitha të punuara. RPSSH-ja në atë kohë arriti ta prodhojë vetë bukën që i duhej. Vetëm mbas vdekjes së Enverit, në vitet kur shtetin e mori Ramiz Alia në dorë, ra prodhimi dhe vendi u katandis në pikë të hallit dhe mbas 1990-s ai u shkatërrua gjer në themele.

Në 40 vjet të qeverisjes së tij, Enver Hoxha krijoi një shtet ekologjik, krejtësisht të pastër, në një kohë kur bujqësinë e Perendimit po e mbulonte dhe po e mbizotëronte OMGJ-ja. Në 40 vjet të qeverisjes së tij, Enver Hoxha e mbajti të gjallë jetën në fshat dhe nuk lejoi që fshati të shkretohej, ashtu siç po ndodhte në krejt të ashtuquajturën „***botë e përparuar***“. Në 40 vjet të qeverisjes së tij, Enver Hoxha nuk nuk e shqetësoi Perendimin me kurrfarë eksodi masiv, siç ndodhi e po ndodh mbas vitevet 1990.

Enver Hoxha ia hoqi NATO-s Traktatin e Varshavës nga brigjet e Mesdheut dhe për këtë nuk mori kurrfarë falenderimi.

Duke i pasur parasysh këto që thashë, unë prapë po bëj pyetjen: ***PËRSE DUHEJ TA VRISNIN PERENDIMORËT ENVER HOXHËN?!*** Konkluzioni im është ky: 1.Perendimorët nuk e dinin, ose nuk donin ta dinin, sa e rëndësishme është Shqipëria për ta. Ata kanë qenë të verbër në politikat e tyre ndaj krejt Shqipërisë e veçanërisht ndaj RPSSH-së. (Fjala është për atë pjesë që bënte politikën në ata shtete.) 2.Perendimi, mbështetur kryesisht në synimet e fitimit, donte ta kishte Shqipërinë koloni të vetën, donte naftën, donte mineralet, donte treg shitjeje dhe nuk i pëlqente kurrsesi një ekonomi e pavarur në Shqipëri. 3.Idetë komuniste, prej të cilavet ishte frymëzuar Enver Hoxha, dihet që borgjezisë perendimore nuk kish si t'i pëlqenin. Por nuk duhet menduar kurrsesi që Evropa Perendimore dhe SHBA-ja do të na kishin trajtuar ndryshe nëse këtu nuk do të kish hyrë fryma komuniste. Ne gjithsesi do të ishim koloni dhe ndoshta edhe më keq, sepse do të mund t'u jepeshin fqinjëvet edhe pjesë të tjera të vendit tonë. Psh, i quajturi Vorio Epir, pas Luftës së Dytë, do të mund t'i jepej Greqisë.

Po cili duhet të jetë **VENDI I ENVER HOXHËS NË TË ARDHSHMEN**, në kushtet e një shikimi më të kthjellët të historisë? Evropa Perendimore duhet ta pranojë Enver Hoxhën si njërin prej personalitetevet më të shquar të gjysmës së dytë të shekullit XX. Mund të mendojë dikush: Po një pjesë e shqiptarëvet, ç'do të thotë? Ajo pjesë e shqiptarëvet që ka hedhur baltë mbi emrin dhe veprën e Enver Hoxhës, sapo ta nuhasë kthesën racionale të Evropës, do të vrapojë kush e kush ta lëvdojë më shumë, „***udhëheqësin tonë të lavdishëm***". Këtu kemi qenë, kur u bëheshin duart gjak nga duartrokitjet.

Organizma dhe organizata të ndryshme duhet t'i japin Enver Hoxhës **DEKORATA** e **ÇMIME** të ndryshëm, pas vdekjes, sepse vetëm në atë mënyrë do të mund të korrigjohen gabimet e rëndë që ka bërë Perendimi ndaj Shqipërisë. Enver Hoxhës duhet t'i jepet çmimi „***Nobel***" pas vdekjes.
Mund të thotë dikush që „***ëndrra***" e tij nuk u realizua, sepse ajo „***ëndërr***" nuk pati jetë të gjatë. Por as „***ëndrra***" e Nënë Terezes nuk është realizuar e megjithatë i është dhënë çmimi „***Nobel***". Mund të thotë dikush që Enver Hoxha ka dhënë orientime, pëlqime ose edhe urdhëra për të vrarë kundërshtarët e regjimit të tij. Por edhe Barak Obama ka dhënë urdhëra për të vrarë, psh, qindra talebanë. Megjithatë, atij i është dhënë çmimi „***Nobel***". E kam fjalën, **KUR BOTA TË MUND T'I SHIKOJË GJËRAT MË KTHJELLËT DHE ME MENDJE MË TË SHËNDOSHË**, Enver Hoxha duhet të zërë vendin që i takon midis njerëzvet më të shquar të Evropës.

(Shënim: Ky shkrim u publikua në tetor 2015. Gj.D.)

dh) ANGLIA DHE SHBA-ja, KUNDËR VETËVETES NË BALLKAN

Që të vërtetohet e të pranohet ky pohim, pohimi që **Anglia dhe SHBA-ja kanë vepruar KUNDËR VETËVETES këtu në Ballkan, duke përkrahur, duke marrë me të mirë, apo duke u bërë lëshime forcavet antishqiptare**, është e nevojshme të bëhen një varg pyetjesh dhe të shqyrtohen me mendje të kthjellët të gjithë problemet që ato pyetje i shtrojnë përpara analizuesvet të historisë. Por më parë dua të sqarohem, **çfarë mendoj unë për gjërat e mira që kanë bërë Perendimorët në favor të shqiptarëvet**.

Rëndësinë jetike të 2 aktevet më madhorë të Evropës dhe SHBA-së, miratimin e pavarësisë së një pjese të Shqipërisë në vitin 1913 dhe ndërhyrjen me armë kundër Sërbisë, për mbrojtjen e Kosovës, pra, të një pjese tjetër të Shqipërisë, në vitin 1999, shqiptarët nuk duhet dhe nuk do t'i nënvleftësojnë kurrë.

Ngritja e Flamurit Shqiptar në Vlorë, në vjeshtën e vitit të madh 1912, për pavarësinë e Shqipërisë, **nuk do të kishte kurrfarë vlere praktike**, në qoftë se kjo pavarësi, sado që gjysmake, nuk do të ishte sanksionuar në Konferencën e Londrës, më 29 korrik 1913. Përpjekjet **mbinjerëzore** (pa kurrfarë hiperbolizimi) të shqiptarëvet të mbetur nën Jugosllavi pas Luftës së Dytë Botërore, për t'u çlirtuar prej sundimit të jugopravosllavëvet, **nuk do të kishin kurfarë vlere praktike**, pa ndërhyrjen e NATO-s, dmth të Perendimit, kundër çmendurisë totale të jugopravosllavëvet kundër shqiptarëvet. **Unë, autori i këtij libri, jam, në të gjitha qelizat e qenies sime, properendimor**. Prandaj, i lutem lexuesit të më mirëkuptojë për çfarë do të them më poshtë.

1.Pse nuk **punuan** Aleatët Perendimorë që, në zjarrin e Luftës II Botërore, të krijohej një shtet i plotë shqiptar? Italia dhe Gjermania patën bërë diçka në këtë drejtim. Pse nuk bënë të njëjtën gjë edhe Aleatët? T'i kishin thënë **ENVER HOXHËS**: "***Ti je aleati ynë, ti je udhëheqësi i LN-së, ty të takon të vihesh në krye të të gjithë shqiptarëvet. Ne do të bëjmë çmos, do të punojmë me jugosllavët, do të punojmë me grekët, do të veprojmë në marrëdhëniet tona me sovjetikët dhe me të tjerët, që, gabimet e së shkuarës në lidhje me Shqipërinë të korrigjohen***." A thua nuk do ta kish pranuar

ENVER HOXHA një ofertë të tillë?! Çamët po masakroheshin e po dëboheshin, kosovarët dhe shqiptarët e tjerë po masakroheshin, prej të 2-ja palëve, edhe prej çetnikëvet nacionalistë, edhe prej komunistëvet gjoja "***internacionalistë***". Viktimat nuk ishin të pakta. Arrinin qindra mijë.

Ky, pra, është **FAJI** i Aleatëvet tanë Perendimorë. Nuk është **GABIM**. Është **FAJ** i rëndë ndaj një kombi, i cili s'e ka merituar një të tillë sjellje. **Është FAJ edhe ndaj SHBA-së e Anglisë**, **FAJ që vetë ata ia kanë bërë vetëvetes**, sepse, në këtë mënyrë pozitat e tyre, në këtë krah të Evropës, u dëmtuan aq rëndë, sa nuk dihet a do të mund të rifitohen ndonjëherë. Forcat antiperendimore do ta shfrytëzojnë këtë **FAJ TË PERENDIMORËVET** me të gjitha mënyrat e tyre të mundshme, për ta mposhtur Perendimin.

2.Aleatët tanë Perendimorë, fill pas Luftës, u vunë në përkrahje të atyre forcave shqiptare, që e kishin **humbur luftën**. Në **Greqi** u përkrahën forcat **antikomuniste**, ato që, të themi, po e **fitonin luftën**. Në **Itali** u përkrahën forcat **antifashiste**, përzier, nacionalistë e komunistë. Italisë madje, iu kthyen qyteti i Triestes dhe Goricia, duke ia marrë Jugosllavisë, që i kish çliruar prej gjermanëvet. Triesten, madje, ia dhanë vonë fare, në vitin 1953.

Por, në **Jugosllavi** prapë u përkrahën prej Perendimorëvet forcat **fituese**, që ishin komunistët. Pse s'iu morën Jugosllavisë ato pjesë të Shqipërisë, që i kishin pushtuar monarkët sllavë, tashmë të rrëzuar?

Vetëm në Rep.Pop. të Shqipërisë **nuk u përkrahën** forcat **fituese**, në një kohë kur Fan S. Noli, një demokrat dhe properendimor i dëshmuar, sado edhe përkrahës i trendevet demokratikë në Lindje, pat thënë me të madhe: "***GUBERNA E ENVER HOXHËS DUHET TË PËRKRAHET!***" Nuk u përkrah "***GUBERNA E ENVER HOXHËS***", as prej amerikanëvet, as prej anglezëvet.

Edhe këtu anglo-amerikanët kanë vepruar kundër interesavet të vet AFATGJATË në Ballkan.

3.Çfarë përfaqësonin forcat antienveriste, brenda dhe jashtë shtetit tonë? Le të bëhen analiza dhe le të konkludohet! A kërkonin ato forca rrëzimin, me ndihmën e të tjerëvet, të **ENVER HOXHËS**, sepse u dhimbej Shqipëria, apo sepse cënoheshin interesat e tyre personalë? Nëse do t'u dhimbej Shqipëria, atë e kishin 2/3 (dy të tretat), 66% (gjashtëdhjet e gjashtë për qind), jashtë sundimit të **ENVERIT**. Përse nuk u kërkuan miqvet

perendimorë që të çliroheshin më parë ato 2/3 të Shqipërisë, që s'i kish **ENVERI** nën sundim, dhe pastaj ta rrëzonin edhe **ENVERIN**?! Përgjigjja do të ishte kjo: **Angloamerikanët nuk e kishin as në cep të mendjes të punonin për interesat e vet AFATGJATË në Ballkan**. Ata punonin „***ME LLOGARI DITORE***", më keq se bakajtë e kasabavet të Orientit. Kështu që, të syrgjynosurit tanë, si sahanlëpirës që ishin, në vend që të shkruanin memorandume e të bënin peticione për çlirimin e pjesës së paçliruar të Shqipërisë, bërtisnin kundër **ENVERIT**. Nëse do të ishin sadopak të mençur, ata, dmth **politikanët perendimorë** dhe **të mërguarit shqiptarë** në Perendim, duhej ta dinin që, me çlirimin e pjesëvet të paçliruara të Shqipërisë, ose, e pakta me dhënien e autonomivet këtyre pjesëve, **ENVER HOXHA DO TË BINTE VETËVETIU**, pa qenë nevoja të çohej këndej asnjë diversant (për të djegur mullarët e kooperativavet).

…Pyetje me këtë temë mund të bëhen pa numër.

Ç'bënte mbreti Ahmet Zogu, kur në mbretërinë e tij bënin ç'të donin fashistët italianë dhe nazistët gjermanë? Këshillonte mbretin Faruk si duhej ta qeveriste Egjiptin?! Ç'bënte Mit'hat Frashëri, kur Atdheun tonë e shkelnin fashistët dhe nazistët? Ç'bëri në ata vite Abaz Ermenji? Ç'bëri dhe si i bëri punët Abaz Kupi?

A nuk mund t'i analizonin këto gjëra Aleatët Perendimorë më mirë se Bashkimi Sovjetik komunist dhe më mirë se Jugosllavia komuniste?

Jugosllavia komuniste dhe Bashkimi Sovjetik dinin t'i bënin për vete forcat fituese në Shqipëri, anglezët dhe amerikanët nuk dinin t'i bënin për vete këta njerëz, ndonëse gjatë gjithë Luftës i kishin **KËTU** misionet e vet.

Dolën, një Dushan Mugoshë dhe një Velimir Stojniq, më të fortë se **DISA** (e pësrsëris: se **DISA**!) ushtarakë anglezë e amerikanë që rrinin përditë e përnatë me **ENVER HOXHËN**. Pak më vonë e lanë **ENVERIN** në mëshirë ose pamëshirë të "**mbrojtësvet**" jugosllavë dhe u morën me ca malësorë të arratisur. I stërvitnin ata në Gjermani dhe i hidhnin në Rep.Pop. të Shqipërisë pikërisht nëpërmjet Jugosllavisë dhe Greqisë, të atyre 2 shteteve që kishin pushtuar 2/3 e Shqipërisë. A nuk mund ta kuptonin **Perendimorët** se, sa ta merrte vesh katundari patriot shqiptar nga po vinte diversanti, ai, edhe po të mos ish shpirtërisht me regjimin komunist, bëhej me të, u bashkohej Partisë Komuniste dhe **ENVERIT**, sepse diversioni po bëhej nëpërmjet Sërbit dhe nëpërmjet Grekut?!

Kjo nuk mund të emërtohet ndryshe, veçse një punë e pastudiuar dhe PA MEND e krejt politikës angloamerikane ndaj shqiptarëvet e njëkohësisht, një punë PA MEND EDHE NDAJ VETËVETES.

ATA DONIN T'I SHFAROSNIN SHQIPTARËT ME BOMBË ATOMIKE. PO PSE?!

"***Grahma e fundit***", roman i Romen Garrisë.

Romani "***Grahma e fundit***" është përkthyer në nja 20 gjuhë dhe, sado që flet në më shumë se gjysmën e vet për Shqipërinë, më saktë për **RPSSH**-në, problemi është gjithbotëror. Ç'po bëhet kështu me **NJERIUN** dhe me **PLANETIN**, në të cilin është krijuar, krahas gjallesavet të tjera, edhe ky lloj gjallese, që quhet ***NJERI***?! Sa po i shërben njeriut shkenca?! A po shërben shkenca për ta lumturuar njeriun, apo për ta marrë më qafë e për ta asgjësuar, atë dhe çdo gjallesë tjetër?!

Sa dhe si po i shërben njeriut politika?! "***T'i shndërrosh qeniet njerëzore në kafshë dhe t'u zhdukësh tiparet njerëzorë, a kjo quhet politikë***?" (f.262) E pyet njëri nga kriminelët shokun e vet, tek po përgatiteshin për të hyrë në **RPSSH**.
Në shqip na e ka prurë këtë roman **Prof.Dr.Agim Vinca** dhe unë e di që ai nuk i hyn punës për të shqipëruar çfarëdo vepre. **Agim Vinca** nuk shkruan asgjë që nuk do t'i shërbente, madje intensivisht dhe për kohë të gjatë, lexuesit shqiptar.

Autori i romanit është Romen Garri (Romain Gary). Thuhet se ka "***prejardhje***" ruse, se ka lindur në Lituani, se ka ardhur 14 vjeç në Francë dhe se konsiderohet shkrimtar francez. Për mua Romen Garria është një shkrimtar rus.

Në fund të shënimit në formë parathënieje R.Garria thotë: "***Shpresoj se lexuesi do ta lexojë 'Grahmën e fundit' me buzë në gaz***." (f.5) Unë nuk munda të buzëqesh. Unë nuk munda kurrsesi ta vë buzën në gaz. Përkundrazi, u shqetësova shumë dhe vazhdoj të jem i shqetësuar, sepse ka gati 40 vjet nga botimi i këtij romani (dhe i shumë veprave të tjera të kësaj natyre ndërgjegjethirrëse dhe kushtrimlëshuese) dhe gjendja gjithnjerëzore,

jo vetëm s'është përmirësuar, por po bëhet përditë e më me pak dritë në të 4 horizontet.

Njerëzimi po zhytet në katastrofë dhe vendi im, të cilit R.Garria i ka kushtuar më shumë se gjysmën e librit, e përjetoi, pas vitit 1990, një destruksion kaq të tmerrshëm, sa do të jetë një mrekulli, nëse del këndej i pasakatuar më keq se në shekujt XIX e XX.

Në f.50 kemi këto 3 të dhëna, të cilat, sado që kemi të bëjmë me një roman, nuk besoj të jenë larg të vërtetavet faktike: 1."***Fuqia*** (bërthamore) ***amerikane mund të shfaroste për 5 minuta të gjithë qytetet rusë me mbi 100 mijë banorë, 36 herë secilin***." 2. "***Fuqia*** (bërthamore) ***sovjetike mund t'i rrafshonte 12 herë secilin qytet amerikan.***" 3. "***25% e shkencëtarëvet të BRSS-së dhe SHBA-së merren vetëm me hulumtimin dhe përsosjen e armëvet të shkatërrimit në masë***."

Asgjë në botë nuk mund të ndodhë jashtë këtij konteksti të lemerishëm. Njeriu mund ta ketë një punë, njeriu mund të lindë fëmijë, njeriu mund të dashurojë ose thjeshtë t'i shkarkojë energjitë seksuale pa përjetuar kurrfarë dashurie, njeriu mund të ketë edhe ndonjë pasion, ndonjë hobi, mund të ketë edhe një ideal, të cilit t'ia kushtojë gjithë jetën. Por, që të gjitha, edhe frymëmarrjet, bëhen **NËN KËRCËNIMIN E NJË ASGJËSIMI TOTAL.**

Midis atyre 25% të shkencëtarëvet, është edhe Mark Matjëja, fizikan i madh bërthamor. Ai ka gjetur mënyrën për ta shndërruar energjinë shpirtërore të njeriut, në çastin kur ai është duke vdekur, në energji elektrike, të dobishme për ata që mbeten gjallë. Por sa pare bën?! Kujt i duhet energjia e dobishme dhe e padëmshme?!

Dhe prandaj, në f.52 konkludohet: „***Kontributi më i madh që një fizikan bërthamor mund t'i sillte njerëzimit, ishte të hiqte dorë nga çfarëdolloj kontributi***."

Sarkazma është sa therëse, aq edhe alarmuese. Je fizikan. Hiq dorë nga çdo lloj kontributi, sepse fizika po e shkatërron jetën, të cilën mezi e ka sajuar ky planet kaq i jashtzakonshëm.

„***Kërkimi shkencor ishte bërë i pamundur… prirja më e pastër e njeriut përfundonte në poshtërsi.***" (f.53) A mund të ketë konstatim më dëshpërues dhe më pesimist për një shkencëtar, të prirur për të bërë punë të mira?!

I gjendur përpara një të vërtete kaq të rëndë, shkrimtari, prapëseprapë, mundohet të kërkojë e të gjejë farë rruge për të dalë diku: „***Ndaj rrëziqevet të shkencës nuk ka përgjigje tjetës, veçse: më shumë shkencë.***“ (f.57) Por, në ç'drejtim do të orientohej kjo „***më shumë shkencë***“?! Në drejtimin e vetëshkatërrimit gjithnjerëzor, apo në udhët e shpëtimit dhe të përmirësimit e zbukurimit të jetës? Këtë ngërç do të mund ta zgjidhë vetëm **MORALI POZITIV** i mbështetur nga **LIGJE SHUMË TË FORTË**. Të mos përdoret shkenca ime për keq! Zbulimet që bëj unë, të mos përdoren për keq! Kjo do të ishte motoja udhëheqëse e çdo shkencëtari **TË VIRTYTSHËM**.

Shkencëtari Mark Matjë arrin deri atje, sa e shikon të domosdoshme që njerëzimi duhet të heqë dorë prej shpresës që jetën e këtij planeti të mund ta shpëtojë ndonjë **FORCË E MBINATYRSHME**. Është konstatim tepër i rëndësishëm! Ai pyet: „***Vërtet mendon se, nëse Zoti do të ekzistonte, unë do të interesohesha kaq gjatë për këtë lloj burimi të energjisë***?“ (f.68) Pra, nuk ekziston kurrfarë fuqie, e quajtur e mbinatyrshme, prandaj njeriu është **I DETYRUAR**, o t'i gjejë vetë rrugët e të mbijetuarit, ose t'i çojë veten dhe të gjitha gjallesat e tjera në rrugën e një asgjësimi me pamje nga më të papërfytyrueshmet.

Mark Matjë, simboli i një shkencëtari që, edhe merr vesh, edhe s'merr vesh nga politika, dhe që nuk u vendos dot asnjë lloj kushti atyre që duan ta shfrytëzojnë shkencën e tij, por gjithsesi i pakënaqur, shkon fillimisht diku në jug të Azisë, pastaj kalon në Kinë dhe ua ofron kinezëvet zbulimin e madh. Kinezët e marrin atë zbulim, e vënë në jetë dhe, fill pas asaj, vjen iluzioni grotesk: „***Nuk kishte më mjerim në Kinë...Fryma e popullit kinez ishte një frymë e shenjtë.***“ (f.83) Ky konkluzion e ka edhe simbolikën e vet. Duke u vendosur në Kinë rendi komunist, (vija e masavet dhe mobilizimi i masavet), u synua që të krijohej përshtypja që fryma e popullit ish vërtet një frymë e shenjtë.

Në anë tjetër, në krahun perendimor të botës, shkencëtari Mark Matjë nuk mund të mos e kish vënë re që „***Lokali Bon Tabak (Bon Tabac) ishte një vendtakim putanash.***“ (f.90)

Kush dëshiron të nxjerrë konkluzione, i ka të gatshëm në romanin „***Grahma e fundit***“. Në njërin krah grotesku: „***nuk ka më mjerim në Kinë***“, në krahun tjetër, „***Lokali Bon Tabak është vendtakim putanash***“. Mes tjerash, një

realitet terrori mbi shkencëtarët: numërohen rreth 14 shkencëtarë të asgjësuar vetëm në vitet 1970. (f.91).

Në faqet 104-122, gjithsesi, autori duket se e quan të nevojshme të vërë në dukje kontradiktën midis udhëzimevet **RACIONALË** të Mao Ce Dunit dhe zbatimevet **PA TRU** të atyre udhëzimeve.

„***Unë vetë, shoku gjeneral***“, i thotë Pejit një shofer,“***e kam zënë veten në faj, duke dëgjuar muzikën perendimore dekadente të Bet'hovenit***“. (f.107)

Është fjala për dukurinë e quajtur **SHPLARJE TRURI**. Të këtillë episode të trushplarjes në sistemin komunist të Kinës, në faqet 108-113, shkaktojnë te lexuesi një turbullirë të papërmbajtshme zhgënjyese: Si mund të katandiset deri në këtë gjendje mendja njerëzore?!

Peji, një ndër gjeneralët më të rinj të Ushtrisë Popullore Kineze, shkon në një spital për të parë një vajzë që e kish dashur dikur. „***U ul pranë shtratit dhe që të dy i buzëqeshnin njëri-tjetrit me optimizëm, me sigurinë e lumturisë së masavet të gjëra popullore që i rrethonte***“. (f.108). „***Këtë vit rritja jonë ekonomike ishte dy herë më e shpejtë se pjesa tjetër e botës.“ „Jam shumë e gëzuar“***, tha Lana. „***Shokët tanë të industrisë së tekstilit e kanë rritur rendimentin 70%.“ „E di.“*** Pështpëriti Lana. „***Ushtria jonë e lavdishme u ka futur dridhmat tradhtarëvet socialimperialistë të BRSS-së***.“ „***Të gjithë insektet dëmtues dhe zogjtë që kërcënojnë të vjelat tona, janë duke u shfarosur***.“ (f.109).

Por lexuesi i kthjellët, lexuesi, i cili nuk ka pranuar që t'ia shplajnë të tjerët trurin në mënyrë kaq skandaloze, nuk mund të mos konstatojë edhe në Perendimin kapitalist, në „***lokalin Bon Tabak të putanavet***“, të njëjtën dukuri. Vetë urrejtja patologjike ndaj komunizmit është dëshmi e një truri krejt të shplarë e të rrafshuar, pa asnjë rrudhë. Besimi me përkushtim në një perendi, në një allah, në një jetë, të lumtur apo jo të lumtur, pas vdekjes, a s'është dëshmi që në këtë planet ka qindra milionë fakirë me mendje krejt të rrafshuar?! Pastaj, iluzioni mbi një „***demokraci***“, së cilës as shembëlltyra nuk i shihet gjëkundi, iluzioni se vetëm me daljet nëpër rrugë, me të quajturat greva urie apo duke i gjuajtur me domate e me vezë kundërshtarët politikë, mund të fitohen të drejtat e nëpërkëmbura, iluzioni se „***gjithkush***“ „***mund të pasurohet***“, trajtimi përçudnues i femrës dhe iluzioni që femra „***nuk po poshtërohet***“, iluzioni që, legalizimi i „***martesavet***“ mashkull me

mashkull e femër me femër, është një ndër kulmet e „***realizimit***“ të „***të drejtavet të njeriut***“...

E gjendur përballë një të këtillë realiteti, madje fabrikuese e të këtillë realitetesh, dhe duke mos ditur ku e si „***ta shfryjë inatin ndaj vetëvetes***“, pjesa më përfaqësuese e kësaj bote, **BOTË PA TRU**, më në fund, arrin ta „***gjejë***“ „***fajtorin***“ dhe „***shkaktarin***“ e të gjithë tersllëqevet të kësaj epoke. „***Fajtori***“ dhe „***shkaktari***“ i të gjitha këtyre prapësive na qenka **SHQIPËRIA**! „***Rrëzikuesit***“ e jetës mbi këtë planet na qenkan **SHQIPTARËT**!

Nga faqja 159 deri në faqen 351, në gati 200 faqe, ky roman, dmth autori i këtij romani, do të merret vetëm me “***Luginën e Shqipevet***“. Pra, me Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Pasi në një ***Larus*** francez Shqipëria është “prezantuar“ vetëm me 9 rreshta, 24 herë me më pak rreshta se vendet fqinjë, papritur, po në Francë, na del po kjo Shqipëri si vendi që „***kërcënon të zhdukë***“, me një „***armë të re bërthamore***“, tri të katërtat e njerëzimit, në mos krejt njerëzimin.

Në f.174 presidenti i SHBA-së thotë: “***Dua që*** (Shqipëria) ***brenda 5 javësh të jetë fshirë nga faqja e dheut.***“ „***Ta fshijmë nga sipërfaqja e globit. Ta shfarosim***.“

Madje sajohet edhe mënyra se si „***do të hiqej qafet***“ kjo Shqipëri kaq „***e rrëzikshme***“: „***Aksident***“ i një rakete me mbushje bërthamore, e cila „***gabimisht devijon***“ nga trajektorja e saj. (Gjithnjë në f.174) Por sovjetikët nuk e pranojnë këtë „***variant***“, jo se u dhimbet Shqipëria, por, se nuk duan që teknologjia e tyre „***të diskreditohet***“.

Gjithsesi, Shtetet e Bashkuar të Amerikës bashkëpunojnë me Bashkimin Sovjetik kundër shtetit shqiptar. Krijohet një koalicion i madh ndërkombëtar për të vepruar në drejtim të këtij vendi kaq të vogël. Kjo shihet gjithandej nëpër këtë libër, nga f.159 e deri në fund, në f.351, por më shkoqur e më qartë ky bashkëveprim shikohet te grupi i diversantëvet që hyn në RPSSH.

Nuk po përtoj ta shënoj këtu krejt përbërjen e atij grupi shqiptarvrasësish: **Starri** oficer amerikan, **Koleku** kanadez, ekspert sabotimesh, **Grigorovi** ushtarak rus, **Stankoja** sërb, **Konarovi** rus, **Mniseku** polak, **Lavroja** sllavomaqedon, **Kaplani** fizikan, **Litelli** anglez, komandant i grupit,

Popoviqi një sllavojugor i martuar me një shqiptare, djali i të cilit parashikohet të ketë një rol të veçantë në të ardhmen e Shqipërisë. S'e di kush mund të ketë qenë konkretisht ky gjysmë sllav gjysmë shqiptar, i planifikuar qysh atëherë për ta bërë paçavure këtë çerek shteti të shqiptarëvet.

Por shihet që Romen Garria e ka njohur mjaft mirë veprimtarinë subversive antishqiptare, organizuar prej gjithfarë forcash regresive botërore kundër një shteti që s'kish tjetër faj, përveç atij që donte të dilte nga prapambetja dhe të zhvillohej i lirë.

Për ç'gjë tjetër do t'i duhej botës kapitaliste, (përfshirë aty edhe ish-sovjetikët që tashmë, pasi ishin „***ngopur***" me komunizmin, po rendnin me vrap drejt kapitalizmit), gjithë ky preokupim dhe gjithë ky angazhim forcash, për ta vrarë, për ta zhdukur apo thjeshtë për ta tjetërsuar shtetin, i cili sundohej prej Enver Hoxhës?! Ç'të keqe po i sillte botës ky shtet?! A mos kishin udhëheqësit e SHBA-së dhe të BS-së „***hallin***" e kooperativistëvet që po "***vuanin***" nëpër kooperativat tona?! Apo mos kishin „***hallin***" e punëtorëvet tanë?!

Enver Hoxhën, s'e di për ç'arsye, Romen Garria e quan Imir Xhuma. Por pyetja shtrohet: A ish botë pozitive kjo botë që po donte ta asgjësonte „***shtetin e Enver Hoxhës***", apo mos ish pozitiv Enver Hoxha, dhe bota që po donte ta asgjësonte „***shtetin e tij***", po shqetësohej, madje po alarmohej, pikërisht prej asaj shkëndije progreskërkuese?!

Sulmuesit diversantë e quajnë shtetin shqiptar, prapë s'e di përse, ***derrkuc*** ose ***derr***, dhe thonë: "***Ta nxjerrim 'derrin' jashtë përdorimit dhe të kthehemi***." (f.200) "***Të mbledhim informatat që na mungojnë në vendin e ngjarjes, por kryesorja të fitojmë në kohë, e cila do t'u mundësojë vendevet tanë të ndërtojnë derrin e tyre. Një derr prapësues***…(një) ***anti-derr.***" (f.201)

Në vitet 1990 u realizua ky qëllim. U mposht "***derri***" shqiptar dhe u vu në veprim, me kapacitet të plotë, "***derri prapësues***": u bë **RESTAURIMI I RRËMUJSHËM I KAPITALIZMIT**. Sikur të ish gjallë Romen Garria, me siguri do të na thoshte: "***A po shihni sa mirë e kam parashikuar?***" "***Derri prapësues***" kapitalist shkatërroi çdo gjë në Republikën e Shqipërisë dhe bëri, jo të mblidhen këtu ata shqiptarë që patën ikur prej komunizmit, por të ikin prej këndej edhe nja 2 milionë shqiptarë të tjerë.

"***Atje gjithçka është populllore***", thuhet në f.202 dhe, pak më poshtë, midis tekstit, gjejmë edhe këtë frazë: "***Pjesa më e rëndësishme e misionit tonë… konsiston në 'vrasjen' e shpirtit të kësaj gjëje***." E kjo do të thotë: Vrasjen e Republikës Populllore Socialiste Shqiptare dhe të gjithçkaje që aty është ***POPULLORE***.

"***U transferuan në Jugosllavi***." „***Starri pa një ëndërr... greko-ortodokse, një ëndërr përplot vrasës***." (f.205)

Përsëri autori Romen Garri na del një parashikues i përpikët. Greko-ortodoksët, ndaç thuaj: greko-sllavët, pas vitit 1990, bënë ç'deshën me shqiptarët dhe me pasuritë e shqiptarëvet. Na del kështu që personazhi **Starri**, oficeri amerikan, e paska ëndërruar, pra ditur, qysh në vitin 1977 se Republika e Shqipërisë, pas shuarjes këtu të „***çdo gjëje populllore***", do të mbushej **PËRPLOT ME VRASËS**, gjë që edhe ndodhi. E tmerrshme!

„***Kaluan në këmbë në Shqipëri***." (f.206) Ndërkaq, njëri prej diversantëvet e vlerëson jo pa mburrje këtë lloj të shkeluri në tokën e lirë shqiptare: „***Ne po hyjmë... mbase në ndonjë Bibël të së ardhmes... ne jemi të gjithë vrasës profesionistë.***" (f.208)

Në ndërkohë, për Enver Hoxhën, të cilin, siç thashë pak parë, s'e di pse nuk e ka dhënë me emrin e vërtetë, siç ka dhënë psh Mao Ce Dunin, thotë se „***ishte diktatori më i pastër dhe më i ashpër i botës komuniste.***" (f.222) Epitetet „***i pastër***" dhe „***i ashpër***" janë vlerësime realë për udhëheqësin tonë të asaj kohe. Por, në një vend tjetër, për Enver Hoxhën do të thuhet edhe kështu: „***Ishin gjurmë të një personaliteti të denjë për të qenë në krye të një fuqie shumë më të madhe se Shqipëria***." (f.311) Megjithatë, disa cilësi të tjera, që autori ia atribuon Enver Hoxhës, nuk janë shumë të sakta. E quan ***marshal*** (f.218), në një kohë kur në RPSSH ishin hequr gradat e ushtarakëvet, thotë: "***rrëkëllente gotat e vodkës***" (f.222), kur, ne të këtushmit e dimë që Enveri nuk e pinte shumë as rakinë, le më vodkën që është një pije e huaj. Përmendet aty një "***aparat dore për të lustruar këpucët***", i cili do t'i dhurohej Enverit (f.225), ndërsa dihet (sipas thënievet të Nexhmies), që Enveri i lustronte vetë këpucët me një leckë a me furçë të zakonshme, sa herë që nisej për në punë ose kur dilte shëtitje. (Veç në mos e pastë lexuar dikund R.Garria dhe ka dashur t'ia "***lehtësojë punën***".)

Edhe në faqen 285 ka një pasaktësi në lidhje me personin e Enver Hoxhës. Aty thuhet: "***Gjeneral Koçuku, nip i Imir Xhumës (Enver Hoxhës,***

Gj.D.)… pasardhës i paracaktuar i tij." Dihet historikisht që Enver Hoxha nuk la kurrfarë shtegu për ta shndërruar RPSSH-në në një monarki, siç ndodhi , psh, në Korenë e Veriut apo në Kubë.

Në një dialog midis presidentit të SHBA-së dhe sovjetikut Ushakov, presidenti amerikan thotë: "***Ne morëm vendim të pengonim shpërthimin bërthamor të shqiptarëvet***." (f.234)

Sigurisht, krejt kjo thënie do kuptuar figurshëm, sepse të gjithë e dimë, dhe vetë presidenti i SHBA-së e dinte, që RPSSH-ja nuk kish armë bërthamore. Në vend të armatimit bërthamor, shqiptarët punonin tokën (nën parullën: "***T'u qepemi malevet dhe kodravet, t'i bëjmë ato pjellore si fushat!***"), ndërtonin vepra industriale, shkolloheshin, bënin edhe bunkerë, për t'u mbrojtur, jo për të sulmuar.

"***Por kjo, a s'është ideologji, biri im***?" (f.235), i thotë presidenti i SHBA-së sovjetikut Ushakov. Pra, presidenti i SHBA-së, as më pak e as më shumë, zhvillimin ekonomik e kulturor të RPSSH-së, përpjekjet e saja për një pavarësi reale, i konsideron, siç duket, "***armë bërthamore***" dhe deklaron, i zemëruar prej "***kokëfortësisë***" së shqiptarëvet: "***Do të jap urdhër të bombardohet menjëherë kjo flliqësirë.***" (f.242). Kështu do të bënte, disa dekada më vonë, një tjetër president i SHBA-së, kundër Irakut.
Po pse, more burrë?! Pse e quan vendin tonë "***fëlliqësirë***" dhe pse po jep urdhër për ta bombarduar?! A nuk e di ti që ne, edhe kur të kundërshtojmë, duke kërkuar jo më shumë se ç'na takon, jemi **MIQTË MË NATYRALË** të SHBA-së në krejt këtë rajon që quhet Evropë Juglindore?!

Ndërkaq, në grupin ndërkombëtar të diversantëvet, produkt i koalicionit të thuash gjithbotëror antishqiptar, bëhen të këtillë dialogje: "***Ne formojmë një lloj aradhe multinacionale, të përbërë nga maskarenj profesionistë***." (f.261).

Pra, ata që kishin kuturisur të vepronin kundër RPSSH-së, ata që po donin ta shuanin shpirtin e këtij kombi fare të vogël, ishin **MASKARENJ PROFESIONISTË**! S'ka ku të vejë më shkoqur!

Komploti bërthamor ndaj RPSSH-së është i dyfishtë. Nga njëra anë presidenti i SHBA-së, me fjalët: "***Ne do ta bombardojmë. Ne do ta shpëtojmë botën prej tyre***." (f.292), mundohet t'i bindë aleatët e vet sovjetikë, që, me anë të një rakete, "***gjoja të orientuar gabimisht***", t'ia

hedhin një bombë atomike Tiranës, në anë tjetër, grupit të diversantëvet, përveç armëvet të zakonshme konvencionale, i kanë dhënë me vete edhe një bombë atomike.

"***Me këtë bombë bërthamore***", thonë ata, "***e cila rëndon kaq shumë mbi supet tanë, ne mishërojmë për mrekulli mbarë njerëzimin, që edhe pse i merren këmbët nga barra e ngarkersës, megjithatë ecën me guxim drejt së ardhmes***." (f.303)

Një e ardhme e zezë! Një e ardhme që e çon njerëzimin në rrugën e vetëshkatërrimit. Në një kohë kur shtetet e mëdhenj rrinë përballë njëri-tjetrit me kërcënimin permanent për ta shndërruar në pluhur radioaktiv njëri-tjetrin, nga 20 a 30 herë, merren me një Shqipëri, e cila nuk rrëzikon askënd në botë!

Një linjë më vete e romanit, siç e kam thënë, është ajo e të quajturit „***karburant i ri***". Zbuluesi është një shkencëtar francez, Mark Matjëja, por ai, zbulimin e vet e përhap gjithandej, e çon në Kinë, pastaj në RPSSH. Ky lloj „***karburanti i ri***" kalohet brez pas brezi, në mënyrë që njerëzit, kur vdesin, frymëmarrjen e fundit ua lënë të gjallëvet në formën e energjisë elektrike.
Për mua, ky është një simbol, një konvencion. Idetë e socializmit e të komunizmit lindin në Evropën Perendimore, në Francë, në Angli, në Gjermani, por ato po zbatohen, në mënyrën e vet, veç vendevet të tjerë, edhe në Kinë e në RPSSH, në „***Luginën e Shqipevet***", siç e quan R.Garria. Pikërisht ky duhet të jetë ai „***karburanti i ri***", i cili ka shqetësuar e alarmuar klasat që duan me çdo kusht të ruajnë **RENDIN E VJETËR**.

Ideja e autorit duket se është kjo: As njëri, as tjetri, pra as kapitalizmi, as komunizmi, s'kanë gjë në terezi.

Janar-prill 2016. Gjokë Dabaj

***

Nuk është se Amerika dhe Evropa, vetëm atëherë ishin miopë dhe tani, në fund të sh XX, iu qenkan çelur sytë. Po marrim prapë fare pak shembuj.

A e dinë euroamerikanët që, që të gjithë priftërinjtë e manastirevet, në Deçan, në Pejë, në Graçanicë, në Prizren e gjetkë, janë **antiperendimorë** dhe **antiamerikanë**?! Në mos e ditshin këtë, janë vërtet qorra. Por nuk është e mundur të mos e dinë. Atëherë, pse i përkrahin kaq shumë këta manastire? Manastiret, të quajtur sërbë, në kohën tonë, nuk janë asgjë më tepër sesa

objekte **muzealë**. Nëse dikush që ka 3 herë më tepër objekte muzealë, piktura, skulptura, pjata e vazo porcelani, psh në Luvër, do të kërkonte të drejta të veçanta mbi Luvrin, deri edhe të drejta territoriale, a do ta miratonte Franca një kërkesë të tillë?!

Arrin **Greqia**, historikisht antikatolike, dmth: **antiperendimore**, ose **me tendencë atavike për t'iu imponuar Perendimit** (kujto përçarjen e Kishës së Krishterë më 1054), arrin, pra, kjo Greqi të bllokojë aderimin në NATO të Ish-Rep.Jug. të Maqedonisë. Maqedonia Antike ka qenë **pushtues** i Greqisë. E gjithë historia është kjo. S'ka tjetër. Edhe Hungaria, në kohën e dinastisë austriake të Habzburgëvet, qe pushtuar nga Austria. Qe pushtuar njëherë, pastaj qe arritur një lloj kompromisi që të bashkëqeveriseshin dhe u bashkëqeverisën. Ç'do të ndodhte tash, nëse hungarezët do të përpiqeshin për t'i penguar nismat politike të Austrisë? A mund të thotë qeveria hungareze: ***Austria ka qenë e imja, sepse më ka pasë pushtuar dikur***?! Ose, ç'do të ndodhte, si do të kuptohej, nëse Çekia do të mundohej t'i pengonte hapat politikë të Gjermanisë, sepse Gjermania, në kohën e Hitlerit, e ka pasë pushtuar Çekinë? Hitleri e pushtoi Çekinë, ashtu si Filipi II dhe Aleksandri e patën pushtuar dikur Greqinë. Aq të drejta sa ka Çekia ndaj Gjermanisë, aq të drejta historike ka Greqia ndaj tokavet të Maqedonisë Antike. Janë absurditete nga më banalët, megjithatë, Perendimi i thotë Greqisë: ***Mirë po thua! Ke ti të drejtë! Nuk do ta përfshijmë Ish-Rep.Jug. të Maqedonisë në NATO, deri sa ty të të vijë qejfi.***

Absurdi tjetër, në një tjetër këndvështrim, është ky: As sllavët nuk kanë mbi Maqedoninë Antike asnjë të drejtë tjetër, përveç asaj të imigrantit.

Absurdi i tretë: Në territorin e Ish-Rep.Jug. të Maqedonisë nuk ka as 10% tokash që i kanë përkitur Ish-Maqedonisë Antike. Të gjithë territoret e tjerë, 90% të këtij shteti, të konstituuar në fund të shekullit XX, janë: ose Ish-Iliri, ose Ish-Thraki.

Për të gjitha këto, gjithmonë PËR INTERESAT E VET, Evropa Perendimore dhe SHBA-ja, do të duhej të tregoheshin më aktivë e sidomos më të kthjellët. Ata duhej të angazhonin shkencëtarë, të cilët të merreshin seriozisht me sqarimin e politikëbërësvet, diplomatëvet, qëndrimmbajtësvet, vendimprurësvet. Të vinin këtu, jo 1 por shumë shkencëtarë dhe t'u thoshin sllavëvet të këtushëm, me argumente shkencorë, se **Leka** (Aleksandri i Maqedonisë), të cilit ata po ia ngrejnë monumentin në Shkup, **nuk është paraardhësi i tyre** dhe se as shqiptarët e Shkupit, as ata

të Manastirit, as të tjerët, nuk janë të gjithë të zbritur nga malet, por janë vendës shumëshekullorë. Në funksion të të sqaruarit të çështjes, dijetarët perendimorë do të mund të sajonin një të këtillë shembull: "***Në qoftë se mbas 500 vjetësh, mbasi Francën ta ketë rrafshuar e tjetërsuar ndonjë katastrofë, ta zëmë, bërthamore, do të ngriheshin algjerianët dhe t'i bënin monument Luigjit XIV, duke thënë: Ky është paraardhësi ynë! Dhe t'u thoshin francezëvet: Ju jeni popull nomadësh, zbritur këtu nga malet e Zvicrës!***" Ç'duhej të thoshte **shkenca botërore** në një rast të tillë?!

EVROAMERIKANËT, SIÇ NUK KANË VEPRUAR ME MENDJE TË SHËNDOSHË, NË INTERES TË VET S T R A T E G J I K, NË QËNDRIMIN NDAJ ENVER HOXHËS, NUK PO VEPROJNË AS TASH ME MENDJE TË SHËNDOSHË NË QËNDRIMIN NDAJ KREJT ÇËSHTJES SHQIPTARE.

Po marr edhe një shembull, logjikisht fare të thjeshtë për t'u kuptuar:

BUNKERËT E "*ENVER HOXHËS*"

A duheshin prishur BUNKERËT që i pat ndërtuar Enver Hoxha me aq pasion e me bukuri aq të rrallë?! Bunkerët dhe krejt sistemi strehues dhe mbrojtës në Rep. e Shqipërisë përbëjnë një pjesë të historisë së Kombit tonë (tashmë të përçudnuar). Ata bunkerë ishin një mrekulli inxhinierike e strategjike, të cilët, qoftë edhe **VETËM PËR VLERA MUZEALE**, qoftë edhe vetëm për panoramë, duheshin ruajtur të paprekur. Nuk mund të pranohet arsyetimi që "***ai sistem fortifikimi nuk mund t'i shërbente askujt për mbrojtje"***. As kështjellat mesjetare , që i hasim sot në krejt Evropën e gjetkë, nuk mund t'i shërbejnë më askujt për mbrojtje. Megjithatë, ato, atje ku njerëzit i kanë mendtë në kokë, nuk po prishen. Përkundrazi, po ruhen, madje po vihen nën mbrojtjen e UNESKO-s. Pse nuk u vunë edhe ***BUNKERËT E "ENVER HOXHËS"*** (në të vërtetë: **TË SHQIPTARËVET**) nën mbrojtjen ligjore të UNESKO-s? Sepse, përveç vetë shqiptarëvet, edhe politikëbërësit e Evropës e të SHBA-së nuk janë **LARGPAMËS**. Janë **AGNOSTIKË**! Janë **BUROKRATË**! Janë **SKEMATIKË**! Janë **METAFIZIKË**!

Në të hyrë të Pogradecit ndodhet një bunker i kohës së gjermanëvet nazistë, dhe ai **nuk është prishur**. Nuk e kanë prishur as në **KOHËN E ENVERIT**. Në Durrës ndodhet një tjetër bunker i fashistonazistëvet të Luftës II Botërore, dhe as ai nuk është prishur. Përse Evropa dhe SHBA-ja lejuan prishjen e sistemit mbrojtës, ndërtuar në **KOHËN E ENVER HOXHËS**? (Nuk po themi: ***Urdhëruan*** ose ***miratuan***, por po themi: ***LEJUAN***.) A thua mos patën frikë, ata goxha gjeneralë, prej **ENVER HOXHËS**, i cili kish vdekur para 5-6 vjetësh? **ENVERI** nuk kish për t'u ngritur nga varri dhe rrugën e Tij, sa i përket sistemit shoqëror, s'kish ndërmend ta ndjekë më askush në Shqipëri. Evropa dhe SHBA-ja vepruan kështu qartazi kundër shqiptarëvet, por edhe **KUNDËR VETËVETS**, si në pikëpamje strategjiko-ushtarake, ashtu edhe në pikëpamje historiko-kulturore.

BUNKERËT nuk janë një armë agresive, siç mund të jenë avionët, tanket, anijet e luftës, nëndetëset, raketat apo edhe artileria, që është e lëvizshme. Bunkerët janë të stacionuar në një vend, të ngulur dhe të palëvizshëm, pra, janë një **ARMË**, nëse mund të quhen kështu, **TËRËSISHT MBROJTËSE**. Ç'të keqe ka, nëse një popull, një shtet, apo qoftë edhe një familje, kërkon të mbrohet nga dikush? Dihet që, ai dikushi, i cili vjen në vendin tënd, i cili hyn në një shtet sovran, me ushtri e me armë, në përgjithësi është **NEGATIV**. Dihet gjithashtu që Shqipërinë gjithmonë e kanë sulmuar forca drastikisht agresive, negative, antihumane, antinjerëzore. Dmth këtu nuk kanë ardhur asnjëherë forca për të vendosur drejtësinë, por kanë ardhur forca për ta nëpërkëmbur drejtësinë, duke bërë rregullisht masakra dhe genocid. Përse u duhej shkatërruar shqiptarëvet kjo mundësi, realisht fare e vogël, për t'u mbrojtur prej gjithfarë masakruesish?!

Mirë, ne shqiptarët që nuk arrinim ta kuptonim që **BUNKERËT** nuk duheshin prishur. Ne nuk kuptuam dot edhe gjëra më të thjeshta. Ne nuk e kuptuam as atë që agrumet dhe hardhitë nuk duheshin shkulur. Ne nuk kuptuam që librat nuk duhen djegur dhe që xhamat e shkollavet nuk duhen thyer. Por komandantët e NATO-s a nuk mund ta kuptonin që **BUNKERËT NË REP. E SHQIPËRISË** nuk ishin diçka që i prishnin punë NATO-s?! Komandantët e NATO-s, pasi ta kishin kuptuar që **BUNKERËT NË REP. E SHQIPËRISË** nuk përbënin ndonjë rrëzik për ta, a nuk duhej t'u thoshin pushtetarëvet **BIRBO** të Rep. së Shqipërisë: "***Mos i prishni!***"? Pushtetarët tanë **BIRBO**, duke qenë gjenetikisht servilë, me siguri do t'i kishin dëgjuar komandantët e NATO-s dhe do ta kishin nxjerrë një VKM, ku të ndalohej

një e tillë masakër mbi betonin, i cili tashmë nuk mund të konsiderohej kurrsesi "***komunist***".

100 mijë turistë në vit do të vinin këtu vetëm e vetëm për ta parë atë **MREKULLI** të papërsëritshme mbi faqe të Dheut. Më se 1 milion në vit do të vinin! Dikush do ta quante budalla ideatorin dhe konstruktorin e asaj mrekullie, dikush do ta konsideronte të mençur, dikush tjetër do të ndiente thjeshtë kënaqësi estetike, por paratë do të derdheshin njësoj në arkat e organizmavet privatë të turizmit **shqiptar** dhe në arkën e shtetit **shqiptar**. Do të ishte një atrakcion i rrallë, i cili do ta bënte Shqipërinë një vend vërtet shumë të veçantë. Këndshëm të veçantë. Të veçantë, jo për 3 apo 4 dhjetëvjeçarë, por për qindra e qindra vjet, sepse betoni nuk kalbet.

Mirëpo, ata **BUNKERË** u zhdukën. **Pejsazhi shqiptar humbi një nga stolitë më të bukura që kish njohur ndonjëherë Rruzulli i Tokës**.

Prapë, nuk është kjo më e keqja. Nuk është kjo fatkeqësia më madhe. **FATKEQËSIA MË E MADHE** zbulohet vetëm me pyetjet: **A këta janë ideologët, politikanët, strategët dhe komandantët ushtarakë të Euroatlantikut e të NATO-s, të cilët do ta ruajtkan Botën nga mynxyrat?! A këta janë njerëzit e Euroatlantikut dhe të NATO-s, që do të dinë t'i shmangin kërcënimet e luftëravet bërthamore?! A këto janë strukturat komanduese të paqëruajtësvet e NATO-s?! A kështu ruhet paqja në Botë, duke çuar në zero fuqinë mbrojtëse të një kombi, i cili është deklaruar pro NATO-s që nga fëmija 3 vjeç e deri te plaku 90 vjeç?!**

SHQETËSIMI ËSHTË SHUMË I MADH

Nuk është shqetësimi se dështoi **KOMUNIZMI,** një përpjekje dhe ndërmarrje gjigante për të zëvendësuar kapitalizmin me një marrëdhënie ndërnjerëzore më të mirë. Një përpjekje dhe ndërmarrje gjigante, për ta minimizuar shfrytëzimin e njeriut prej njeriut, për t'u sjellë kombevet liri e përparim, për të luftuar kolonializmin e neokolonializmin, për të shmangur luftërat grabitqare botërore.

Shqetësimi është, se ç'do të bëjë **KAPITALIZMI**, tani që **KOMUNIZMI** dështoi.

Nuk është problemi kryesor te **krimet** që ka bërë **KOMUNIZMI**, sepse **KAPITALIZMI** ka bërë e po bën **krime** pa pushim e pa kufi. Sa miliona asgjësoi Holokausti?! Sa miliona u vranë në luftën Iran-Irak?! Sa qindra mijë po vret pa pikë mëshire Bashar al Asadi?! Sa vrau Franca në Algjeri?! Sa vietnamezë dhe amerikanë vrau SHBA-ja në Vietnam?!

Hitleri e Stalini nuk mund të barazohen kurrë në vlerësime. Tjetër natyrë kanë krimet e Hitlerit e krejt tjetër natyrë kanë krimet, gjithsesi të zmadhuar, të Stalinit.

Nuk është problemi kryesor te shkeljet e „***të drejtavet të njeriut***“, sepse **KAPITALIZMI** i ka shkelur dhe po i shkel të drejtat e njeriut pa pushim e pa kufi. I quajturi trafik i qenievet njerëzore. Përdorimi i organevet të njeriut me mënyra ekstremisht antihumane. Trajtimi çnjerëzor i femrës (Nëpërmjet “***lirisë***” së saj për t’u bërë grua e për të mbetur vejushë qysh në moshën 12 vjeçe!). Të drejtat nacionale të nëpërkëmbura me të gjitha format: Kurdët, baskët, ujgurët, çeçenët, veriirlandezët, tibetasit.

Nuk është problemi kryesor te **lufta klasore**, sepse **KAPITALIZMI** e ka zbatuar dhe po e zbaton **luftën klasore** pa pushim e pa kufi. Duhet të kesh para, që të mund të bësh një gjyq. Duhet të kesh para, që të mund t’i rregullosh dhëmbët. Duhet të kesh para, që të shëtitësh. Ai që ka para, paguan për të shkuar në Hënë, ai që s’ka para, vdes nëpër kasollet e Afrikës, por edhe në një lagje të Njujorkut apo të Parisit. Kjo është **lufta e klasavet**, të cilën **KAPITALIZMI** kërkoi t’ia ndalë **KOMUNIZMIT**, sepse e donte monopol për vete.

Problemi kryesor është te **PRONA PRIVATE** dhe te **INICIATIVA PERSONALE**, të cilat **KOMUNIZMI** i pat shkurtuar dhe i pat çuar në rrugën e barazimtarisë. Këtu u prekën shumica e njerëzvet dhe **ky qe SHKAKU KRYESOR që kapitalizmi u restaurua në shkallë botërore**. E rimorën tokën fshatarët, por për çfarë po u hyn në punë?! E fituan lirinë për t’u bërë **KAPITALISTË** punëtorët, por sa prej tyre u bënë **KAPITALISTË** e sa përsëri mbetën proletarë?!

Problemi pra është: **Ç’DO TË BËJË KAPITALIZMI ME VETËVETEN**?! Me pronën private, që e rifitoi?! Me iniciativën personale, që e rifitoi?! **Me përdorimin NEGATIV të të gjithë llojevet të PRONAVET**?!

Ku po e çon njerëzimin ky sistem shoqëror?! Si do t'i trajtojë tani e tutje kapitalizmi **PRONËN PRIVATE** dhe **INICIATIVËN PERSONALE**?! A do t'i trajtojë po ashtu siç i ka trajtuar edhe më parë?!

Problem ishte në **KOMUNIZËM** edhe **IDEOLOGJIA**. U zëvendësuan religjionet me ideologjinë materialiste. Ç'do të bëjë tani kapitalizmi me religjionet?! Thënë ndryshe: Ç'do të bëjë tani e tutje kapitalizmi me **EDUKIMIN MORAL** të njeriut?!

A mos po e çojnë njerëzimin pikërisht ajo **PRONË PRIVATE**, ajo **INICIATIVË PERSONALE** e pakufizuar dhe **KONFRONTIMI I RELIGJIONEVET**, në një luftë **NJERËZIMASGJËSUESE**?!

Unë ngulmoj që, njerëzimi, pas rrëzimit të komunizmit, o duhet të gjejë **NJË RRUGË TJETËR** për të shpëtuar edhe prej **KAPITALIZMIT KLASIK**, ose jeta mbi këtë planet po shkon, në mos drjet shkatërrimit të plotë, drejt një rikthimi në formën primitive, te ameba dhe te fieri.

A do lejuar të shkojë dëm gjithë kjo **MADHËSHTI** që ka arritur gjer më tani kjo specie e jashtzakonshme, që e ka emrin ***NJERI*** ?!

NGA FJALIMI I V.I.LENINIT PARA RINISË KOMUNISTE DERI TE KATOVICA

Edhe një plenum partie i një rrethi apo krahine kish më shumë përembajtje se një Katovicë kapitullantësh të shpërfytyruar.

Në plenumet dhe kongreset e partivet komuniste diskutohej për problemet që kish populli. Flitej për ekonominë, flitej për edukatën e për moralin, kërkoheshin rrugë për eliminimin e të metavet. Vendet përparonin: Industria, bujqësia, arsimi, artet, sportet.

Kjo pamje mbizotëtroi në krejt Botën Komuniste, fill pas revolucionevet.

Por një ditë filloi papritur çdo gjë të zbehej. Erdhi formalizmi, burokratizmi, egoizmi, vetjak edhe grupor, dhe krejt kësaj epoke do t'ia vinte kapakun një Katovicë.

M.Gorbaçovi, më 1986-n, mblodhi aty ca ish-revolucionarë të katandisur në çapaçulë e rrjepacukë, siç ishte edhe ai vetë, dhe u tha: "***Ekonomia jonë po shkon drejt katastrofës. Duhet të gjejmë metoda të reja sipas sistemit perendimor."***

Askush nuk do të pyeste më as për katundaritn, as për punëtorin. Gjithkush do të kujdesej vetëm për vete, që nga sakati më i përçudnuar, deri te sekretari i parë i partisë. Sakati do të dilte në rrugë, duke shtrirë duart e babëzitura, sekretari i parë i partisë do të shkonte në zyrë për të mbledhur tentakulat e pasurimit për vete dhe për klanin dhe nga zyra do të dilte nëpër mitingje për të përhapur mashtrimet. Puna do të arrinte deri aty, sa do të ngarkohej një bombë atomike në një çantë shpine dhe bomba atomike do t'i binte kryq e tërthot Evropës, për të gjetur një blerës.

Ramiz Alia i ynë, i mblodhi byroistët e vet më 1989 dhe u tha: "***Sistemi ynë ka kapitulluar, ndaj jemi të detyruar të ndryshojmë strategji."***

Askush nuk duhej të priste prej të atillë njerëzish një rrugëzgjidhje. Problemi që duhej shtruar, prej socologëvet, prej filozofëvet, ishte: **Ç'DO TË BËJË TASH E TUTJE KAPITALIZMI?!**

Partiakët, sapo të shpërndaheshin nga Katovica, do t'u suleshin pasurivet kombëtare si hienat që i sulen një zebre të rrëzuar. Në vendet ish-komunistë do të fillonte **EPOKA E BIRBOKRACIVET**. Nuk do të shkonte shumë kohë dhe vendet do të sundoheshin prej kastës së **BIRBOVET**.

Në vendet tradicionalisht kapitalistë do të përfitonte kush të mund nga shembja e komunizmit: Do të lulëzonte puna në të zezë me emigrantë të uritur, që do të vërshonin prej komunizmit tashmë të prishur. Do të pasurohej kasta e trafikantëvet të të gjithë llojevet. Industria dhe bujqësia do të gjenin tregje në vendet ish-komunistë: Banane, agrume, lecka, këpucë të mbajtura, vetura të përdorura, motora shumë të fuqishëm, gomone, gjeneratorë, depozita për ujë. E gjithë kjo do ta shtonte pasurimin e dikujt në Botën Kapitaliste, por cila pjesë e kësaj Bote Kapitaliste do të pasurohej?! Doemos, ajo **NEGATIVJA**. Spekullantët do të pasuroheshin! Manjatët, bankierët do të pasuroheshin, ndërsa krejt botën do ta kanoste **KRIZA FINANCIARE**.

Ky ishte problemi: **Ç'DO TË BËNTE KAPITALIZMI?!** Por kapitalizmi fitimtar, jo për meritë të vetën, por për pameritë të atyre që i patën vënë

vetes detyrë për ta ndrequr botën, nuk veproi ashtu si duhej të vepronte. Nuk dolën teoricienë që do t'ia tregonin shoqërisë njerëzore rrugët e zhvillimit dhe, rrjedhimisht, nuk dolën as udhëheqës, për të realizuar progresin.

Tani s'ka mbetur tjetër, veçse, të gjithë së bashku, kapitalistë tradicionalë krahpërkrah me kapitalistët ish-komunistë, ta shpien botën me vrap drejt një lufte të përbotshme, të paparë ndonjëherë.

S'ka mbetur, pra, tjetër, veç të thërrasim: ***FORCA PROGRESISTE BOTËRORE, MBLIDHNI VETEN, SA S'ËSHTË VONË!***

Gjokë Dabaj, Klos-Durrës, 1982-2016

~~~~~~

© Pashtriku.org, Dhjetor'2016
~~~~~~